

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SPECIFIKIME TEKNIKE

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT:

SHËRBIM PROJEKTIMI ME OBJEKT:

“Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: Përmirësimi i shërbimit në Kopshtin Nr.4,

Rruga “Adem Sheme”, Sarandë”

Bashkia Sarandë

POROSITËS
FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

KONSULENT
BOE “TAULANT & ARKIMADE & ALTEA
GEOSTUDIO” sh.p.k.

Tiranë 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

SEKSION 1: SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME	6
1.1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME	6
1.1.1 Njësitë matëse	6
1.1.2 Grafiku i punimeve	6
1.1.3 Punime të gabuara	6
1.1.4 Tabelat njoftuese etj.....	6
1.2 DORËZIMET TE SUPERVIZORI	6
1.2.1 Autorizimet me shkrim	6
1.2.2 Dorezimet tek supervizori	7
SEKSION 2: PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI	7
2.1 PASTRIMI I KANTIERIT	7
2.1.1 Pastrimi i kantierit	7
2.1.2 Skarifikimi	7
2.1.3 Heqja e pemëve dhe shkurreve më të larta se 1.5 m.....	7
2.1.4 Prishja e godinave, gardheve dhe strukturave	8
2.1.5 Mbrojtja e godinave, rrethimeve dhe strukturave	8
2.1.6 Mbrojtja e vendit të pastruar	8
2.2 PUNIME PRISHJEJE	8
2.2.1 Skeleritë.....	8
2.2.2 Supervizioni	9
2.2.3 Metoda e prishjes.....	9
2.2.4 Siguria në punë.....	9
2.3 PRISHJA E ELEMENTËVE TË GODINËS	10
2.3.1 Prishja e taracave.....	10
2.3.2 Prishja e mureve të tullës	10
2.3.3 Prishja e dyshemeve	10
2.3.4 Prishja e veshjeve me pllaka të mureve.....	10
2.3.5 Heqja e dyerve dhe dritareve	10
2.3.6 Heqja e zgarave metalike	11
SEKSIONI 3: PUNIME DHEU, GËRMIME DHE THEMELËT	11
3.1 PUNIME DHEU	11
3.1.1 Përgatitja e formacioneve	11
3.1.2 Drenazhimi i punimeve të dherave.....	11
3.1.3 Mbrojtja e punimeve të dheut.....	11
3.1.4 Punimet e dheut gjatë periudhave të ngricave	12
3.2 GËRMIME PËR BAZA DHE THEMELE	12
3.2.1 Gërmime.....	12
3.2.2 Mbushjet	12
3.2.3 Përdorimi i materialit të gërmuar.....	12
3.2.4 Mbushja rreth strukturave	12
3.3 THEMELE STANDARDE	12

3.3.1 Themele betoni	12
3.3.2 Plinta për kolona	12
3.4 NDIHMESE PER THEMELET	13
3.4.1 Hidroizolimi i themeleve.....	13
3.4.1.1 Hidroizolimi i themeleve në ndërtesat pa bodrum.....	13
3.4.1.2 Mënyra e hidroizolimit	13
3.4.2 Drenazhimi perimetrale e sipërfaqësor.....	13
SEKSIONI 4: PUNIME BETONI ARMIMI DHE HEKURI	15
4.1 BETONI I DERDHUR NË VEND.....	15
4.1.1 Kërkesa të përgjithshme për betonet.....	15
4.1.2 Materialet.....	15
4.1.3 Depozitimi i materialeve.....	15
4.1.4 Klasifikimi i betoneve.....	16
4.1.5 Prodhimi i betonit.....	16
4.1.6 Hedhja e betonit.....	16
4.1.7 Realizimi i bashkimeve.....	16
4.1.8 Mbrojtja.....	16
4.1.9 Betoni në kushte të vështira atmosferike	17
4.1.10 Provat e betonit.....	17
4.2 ELEMENTË DHE NËN-ELEMENTË BETONI	17
4.2.1 Arkitrare të derdhur në vend	17
4.2.2 Trarë të derdhur.....	18
4.2.3 Breza betoni	18
4.2.4 Kolona.....	18
4.2.5 Soleta të armuara tip SAP.....	18
4.2.6 Solete b/a	18
4.2.7 Mbulesa në hyrjen kryesore	18
4.2.8 Struktura prej b/a	19
4.3 KALLËPET DHE FINITURAT E BETONIT	19
4.3.1 Përgatitja e kallëpeve	19
4.3.2 Depozitimi në kantier	19
4.3.3 Klasifikimi i sipërfaqeve të elementeve prej betoni.....	20
4.4 HEKURI.....	20
4.4.1 Materialet.....	20
4.4.2 Depozitimi në kantier	20
4.4.3 Kthimi i hekurit	20
4.4.4 Vendosja dhe fiksimi.....	20
4.4.5 Mbulimi i hekurit	21
4.4.6 Ngjitja e hekurave.....	21
4.4.7 Drejtimi i hekurit dhe paranderja	21
SEKSIONI 5: STRUKTURA E NDËRTIMIT.....	21
5.1 MURET DHE NDARJET.....	21
5.1.1 Llaç për muret	21

5.1.2	Specifikimi i përgjithshëm për tullat.....	22
5.1.3	Mur me tulla të plota 25 cm.....	22
5.1.4	Mur ndarës 12 cm	22
5.2	MBULESAT	23
5.2.1	Taraca	23
5.2.2	Ulluqet vertikale dhe horizontale.....	23
	SEKSIONI 6: RIFINITURAT	25
6.1	RIFINITURAT E MUREVE.....	25
6.1.1	Veshje fasade me polisterol t=8cm + rrjete + suva	26
6.1.2	Suva grafiato.....	28
6.1.3	Suvatim i brendshem ne ndertimet e reja.....	28
6.1.4	Suvatim i jashtem i ndertimeve te reja.....	29
6.1.5	Hidroizolimi me nje shtese llaci me baze cimento pergatitur me dy komponent A+B.....	29
6.1.5.1	Aplikimi i materialit dhe realizimi i hidroizolimit.....	29
6.1.5.2	Aplikimi i materialit.....	30
6.1.5.3	Sigurimi ne pune.....	30
6.1.5.4	Mbajtja paster e ambientit.....	30
6.1.6	Lyerje me boje ECO plastike.....	30
6.1.7	Lyerje me boje vaji.....	31
6.1.8	Lyerja e siperfaqeve metalike.....	31
6.1.9	Veshja e mureve me pllaka, granil, mermer, gure.....	32
6.2	RIFINITURAT E DYSHEMEVE	32
6.2.1	Dysheme me pllaka gres.....	32
6.2.2	Bordurat vertikale dhe aksesore te tjere.....	33
6.2.3	Hidroizilimi i dysHEMEVE ne nderkate	34
6.2.4	Dysheme me parket laminat	34
6.3	RIFINITURAT E SHKALLËVE	35
6.3.1	Shkallë betoni veshur me mermer	35
6.3.2	Korimanot metalike	35
6.3.3	Bordurat vertikale dhe aksesore të tjerë.....	36
6.3.4	Mbulesa e shkalleve metalike.....	38
6.3.5	Zingimi (Galvanizimi).....	38
6.4	DYER DHE DRITARE.....	38
6.4.1	Dritaret/informacion i përgjithshem/kerkesat	38
6.4.2	Komponentët	38
6.4.3	Dritare PVC	39
6.4.4	Dyert - Komponentet.....	41
6.4.5	Dyert - Vendosja në vepër	44
6.4.6	Kasat e dyerve	46
6.4.7	Dyer te brendshme.....	46
6.4.8	Dyer te jashtme	49
6.4.9	Dorezat	50
6.5	RIFINITURAT E TAVANEVE.....	52

6.5.1 Tavan i varur me pllaka gipsi	52
6.6 RIFINITURAT E TAVANEVE.....	53
6.6.1 Mbrojteset e kendeve te Mureve.....	53
6.6.2 Vetrata dopio xham me skelet PVC	54
6.6.3 Mbrojtese horizontale te mureve (shiritat).....	54
SEKSION 7: PUNIME TERRITORI	55
7.1 RRUGË.....	55
7.1.1 Nën-baza dhe baza	55
7.1.2 Shtrimi	55
7.1.3 Kullimet dhe drenazhimi.....	56
7.1.4 Shenjat rrugore dhe tabelat	56
7.1.5 Bordura betoni per trotuare.....	57
7.2 PEJZAZHI (SISTEMIMI I TERRENIT)	59
7.2.1 Nivelimi dhe pergatitja e terrenit	59
7.2.2 Mbjellja dhe pleherimi	59
7.2.3 Sistemi ujites	61
7.3 GARDHI DHE PORTAT	62
7.3.1 Gardh (rrethimi) me mur dhe kangjella.....	62
7.3.2 Dera metalike	63
7.3.3 Specifikime/norma për personat me aftësi të kufizuar.....	64

SEKSION 1: SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1.1 Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë Celsius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.”.

1.1.2 Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë supervizorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës. Informacioni që mban supervizori duhet të përfshijë: vizatime që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të godinës dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim; detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme; plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim, detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar si dhe supervizionin e punimeve. Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervizori, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervizori gjatë zbatimit të punimeve.

1.1.3 Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

1.1.4 Tabelat njoftuese etj.

Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga supervizori dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhet shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në anglisht dhe shqip.

1.2 DORËZIMET TE SUPERVIZORI

1.2.1 Autorizimet me shkrim

“Rregullat me shkrim” do t'i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Supervizori të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuara, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhërësa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohet që aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat, instruksionet, emërimet, urdhërësat e Supervizorit do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

1.2.2 Dorezimet tek supervizori

Kontraktori duhet t'i dorëzojë Supervizorit për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervizori.

Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, certifikata testi, kurdo që të kërkohen nga Supervizori. Supervizori do të pranojë çdo dorezim dhe nëse janë të përshtatshme do t'i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit për të bërë këto pranime.

Mostrat

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuar sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Supervizori për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit. Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave Kontraktori do t'i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

SEKSION 2: PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI

2.1 PASTRIMI I KANTIERIT

2.1.1 Pastrimi i kantierit

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirgjet e mbeturinave të tjera.

2.1.2 Skarifikimi

Largime të mëdha me ekskavatorë dhe skarifikime, të kryera me dorë ose makinë nga terrene, nga çfarëdo lloj toke, qoftë edhe e ngurtë (terrëne të ngurta, rërë, zhavorë, shkëmborë) duke përfshirë lëvizjen e rrënjëve, trungjeve, shkëmbinjve dhe materialeve me përmasa që nuk kalojnë 0,30 m³, duke përfshirë mbrojtjen e strukturave të nëndheshme si kanalizime uji, naftë ose gazi etj., dhe duke përfshirë vendin e depozitimit të materialeve brenda në kantier ose largimin e tyre në rast nevojë.

2.1.3 Heqja e pemëve dhe shkurreve më të larta se 1.5 m

Në përgjithësi duhet patur parasysh, që gjatë punimeve të pastrimit të mos dëmtohen ato pemë të cilat nuk pengojnë në rehabilitimin ose në ndërtimin e objektit të ri. Në rastet kur heqja e tyre është e domosdoshme, duhet të merren masa mbrojtëse në mënyrë që gjatë rëzimit të tyre të mos dëmtohen personat dhe objektet përreth. Për këtë, për pemët që janë të larta mbi 10 m, duhet që prerja e tyre

të bëhet me pjesë nga 3 m. Pjesa që pritet, duhet të lidhet me litar ose kavo dhe të tërhiqet nga ana ku sigurohet mbrojtja e personelit dhe e objekteve.

2.1.4 Prishja e godinave, gardheve dhe strukturave

Kontraktori duhet të heqë me kujdes vetëm ato ndërtime, gardhe, ose struktura të tjera të drejtuara nga Supervizori. Komponentët duhen çmontuar, pastruar dhe ndarë në grumbuj. Komponentët të cilët sipas Supervizorit nuk janë të përshtatshëm për ripërdorim, duhen larguar, punë kjo që kryhet nga kontraktuesi. Materialet që janë të ripërdorshme do të mbeten në pronësi të investitorit dhe do të ruhen në vende të veçanta nga kontraktori, derisa të lëvizin prej tij deri në përfundim të kontratës. Kontraktori duhet të paguajë çdo dëmtim të bërë gjatë transportit të materialeve me vlerë, të rrethimeve dhe strukturave të tjera dhe nëse është e nevojshme duhet të paguajë kompensim.

2.1.5 Mbrojtja e godinave, rrethimeve dhe strukturave

Gjatë kryerjes së punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit ku po kryhen këto punime prishëse. Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese dhe pronat publike të çdo lloji.

Kur përdoren mekanizmat për prishje si: vinç, ekskavatore hidraulik dhe thyes shkëmbinjsh të bëhet kujdes që pjesë të tyre të mos kenë kontakt me kablllo telefonik ose elektrik. Kontraktori duhet të informojë në fillim të punës autoritetet përkatëse, në mënyrë që ato të marrin masa për lëvizjen e kablllove.

2.1.6 Mbrojtja e vendit të pastruar

Kontraktori duhet të ngrejë rrjeta të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialet që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin ku do të kryhen punimet.

2.2 PUNIME PRISHJEJE

2.2.1 Skeleritë

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përputhje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë duhet të marrë përsipër ngritjen e skelërive të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit, të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skelëri të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë çdo masë e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skelëritë duhet të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të rrugës ku ka kalim si të kalimtarëve, ashtu edhe të makinave, duhet të merren masa që të bëhet një rrethim i objektit, si dhe veshja e të gjithë skelërisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Skelëri çeliku të tipit këmbalec, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementet horizontale duhet të kenë parmakë vertikale, me lartësi min. 15 cm, si dhe mbrojtjen me rrjete.

Skelëri çeliku në kornizë dhe e lidhur, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementet horizontale duhet të kenë parmakë vertikale, me lartësi min. 15 cm, si dhe mbrojtjen me rrjete.

2.2.2 Supervizioni

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelërive dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

2.2.3 Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Metodat e prishjes së pjesshme duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten.

Kur prishja e ndërtesës ose e elementeve të saj nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës, do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elemente çeliku dhe struktura betoni të forcuara do të ulen në tokë ose do të prihen për së gjati sipas gjerësisë dhe përmasave në mënyrë që të mos bien. Elementet e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të strukturës. Kur prishen elementet, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementet e tjera konstruktive mbajtëse, si dhe mos dëmtuar elementet e tjera.

Në përgjithësi, puna e shkatërrimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, pa ndërhyrë në elementet bazë strukturalë. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të transportohen nga ashensorë, pastaj do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën kontroll.

2.2.4 Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë:

- Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet
- Të siguruara nga një teknik kompetent dhe me eksperiencë
- Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit

Gjatë punës prishëse, të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si: helmata, syze mbrojtëse, mbrojtëse veshësh dhe bombola frymëmarrjeje.

2.3 PRISHJA E ELEMENTËVE TË GODINËS

2.3.1 Prishja e taracave

Shpërbërja e çatisë me tjegulla druri ose llamarinë të xinguar, me të njëjtat modalitete dhe të armatūrës përkatëse prej druri, duke përfshirë trarët e mundshëm, dyshemenë ose paretet (ndërmjetëzat) me dërrasa, armatūrën e madhe (e përbërë nga kapriatat, trarët dhe pjesët e armaturës), pjesët intersektuese, kanalet e ulluqëve horizontale, ulluqët vertikalë dhe kapset përkatëse metalike, kullëzat e oxhakut, duke përfshirë skelën, spostimin e materialeve që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë fund heqjes.

Heqja e tavanit të çfarëdo natyre, duke përfshirë strukturën mbajtëse, suvane dhe impiantin elektrik që mund të ekzistojë; duke përfshirë ndër të tjera skelën, spostimin e materialeve që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë plotësisht fund heqjes së tavanit.

Prishje e shtresës horizontale të hidroizolimit të tarracës me zhvillime vertikale, edhe në praninë e oxhaqeve, e ndërtuar nga tre shtresa të mbivendosura letër katramaje, duke përfshirë heqjen e kapakëve të parapetit e të çdo pjese metalike dhe vënien mënjane e spostimin në kantier të materialeve që formohen, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë fund plotësisht heqjes së tarracës.

Prishja e suvase në sipërfaqet vertikale deri në një lartësi të paktën 30 cm, deri në dalje në dukje të muraturës, për vendosjen e guainës.

2.3.2 Prishja e mureve të tullës

Prishje e muraturës me tulla të plota ose me vrima, e çfarëdo lloji dhe dimensionit, edhe e suvatuar ose e veshur me majolike, që realizohet me çfarëdo lloj mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie, përfshirë skelën e shërbimit ose skelën, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, riparimin për dëmet e shkaktuara ndaj të tretëve për ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave të zeza, ujit, dritat etj.), si dhe vënien mënjane dhe pastrimin e gurëve për përdorim, duke bërë sistemimin brenda ambientit të kantierit. Gjithashtu, edhe çdo detyrim tjetër që siguron plotësisht prishjen.

2.3.3 Prishja e dyshemeve

Prishja e dyshemeve të çfarëdo lloji dhe spostimin e materialeve, jashtë ambientit të kantierit.

2.3.4 Prishja e veshjeve me pllaka të mureve

Prishje e veshjeve të çfarëdo lloji dhe prishje e llaçit që ndodhet poshtë, pastrim, larje, duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

2.3.5 Heqja e dyerve dhe dritareve

Heqje dyresh dhe dritarësh, që realizohet para prishjes së murit, duke përfshirë kasën, telajot, etj. Sistemimin e materialit që ekziston brenda ambientit të kantierit dhe grumbullimin në një vend të caktuar në kantier për përdorim.

2.3.6 Heqja e zgarave metalike

Heqja e zgarave të hekurit dhe sistemimin e materialit që rezulton, brenda ambientit të kantierit, duke përfshirë përzgjedhjen e mundshme (të përcaktuar nga D.P.) dhe vënien mënjane në një vend të caktuar të kantierit për ripërdorim.

SEKSIONI 3: PUNIME DHEU, GËRMIME DHE THEMELËT

3.1 PUNIME DHEU

3.1.1 Përgatitja e formacioneve

Përgatitja e formacioneve përfshin këto punë:

- Njohja dhe saktësimi i rrjeteve të instalimeve nën tokë si p.sh.: tuba të furnizimit të ujës-jellës, tuba të shkarkimit, kablllo elektrike e telefonie etj.
- Matja e terrenit dhe marrja e provave të dheut.
- Shpyllezimi dhe heqja e rrënjëve prej terrenit.
- Heqja e dheut me humus dhe transportimi apo ripërdorimi i saj.
- Hapja e gropave të themeleve deri në thellësinë e nevojshme.

3.1.2 Drenazhimi i punimeve të dherave

Drenazhimi mund të bëhet me rrjet kullimi ose me kanal. Si materiale rrjeti kullues ka mundësi të përdoren tuba plastiku, tuba betoni ose tuba prej argjili. Tubat duhen vendosur nëpër kanale të hapura, të niveluara dhe sipas nevojës, të ngjeshura. Tubat do të vendosen pas hapjes së kanalit dhe mbushjes me zhavorr me të paktën një shtresë prej 7 cm. Mbas shtrimit të tubave hidhet zhavorr ose rërë 4/32 me një shtresë prej 10 cm në mënyrë që të mbrohet tubi. Pastaj kanali mbushet me dheun që ka mbetur kur ai është hapur. Drenazhimi me kanale bëhet në atë mënyrë që hapen kanalet dhe pastaj mbushen me zhavorr. Kanalet duhet sipas kërkesës të kenë një rën prej këtyre sipërfaqeve: 20x30, 30x40 ose 30x60 cm. Distanca ndërmjet kanaleve të përcaktohet sipas koeficientit të filtrimit të tokës.

3.1.3 Mbrojtja e punimeve të dheut

Tek punimet me dheun duhet nga njëra anë të mbrohen njerëzit, të cilët nuk janë të përfshirë në ndërtimin e projektit, e nga ana tjetër duhet të mbrohen njerëzit e inkuadruar në realizimin e projektit. Gjithashtu, duhet mbrojtur gropa e hapur për themelet. Mbrojtja e njerëzve të painkuadruar duhet bërë në atë mënyrë që të bëhet rrethimi (me gardh, rrjete gabion) i cili nuk i lejon ata (sidomos fëmijët) të rrezikohen. Gjithashtu, duhet vendosur tabelë paralajmëruese me të cilën ndalohe kalimi i rrethimit nga persona që nuk punojnë në projekt. Gropa dhe njerëzit që janë duke e punuar atë, duhen mbrojtur ndaj shembjes. Shkalla e ledhit e çdo grope duhet të jetë varësisht nga cilësia e dheut me min. 45 gradë deri në max. 60 gradë. Në rast se dheu përmban minerale, të cilat në kontakt me ujin e humbin stabilitetin, atëherë dheu dhe sidomos ledhi duhet të ruhet nga shiu duke e përforcuar me armatura mbajtëse sipas KTZ.

3.1.4 Punimet e dheut gjatë periudhave të ngricave

Punimet e dheut mund të kryhen edhe gjatë periudhës së dimrit, ku temperaturat janë nën zero gradë Celsius.

3.2 GËRMIME PËR BAZA DHE THEMELE

3.2.1 Gërmime

Gërmim dheu për themele ose për punime nën-tokësore, deri në thellësinë 1,5 m nga rrafshi i tokës, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të thatë ose të lagur (argjile edhe në qoftë se është kompakte, rërë, zhavorr, gurë etj.), duke përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjëve, trungjeve, gurëve, dhe pjesëve me volum deri në 0.30 m³, plotësimin e detyrimeve në lidhje me ndërtimet nën-dheshme si kanalet e ujrave të zeza, tubacionet në përgjithësi etj.

3.2.2 Mbushjet

Shtresë me gurë dhe copa tullash të zgjedhura, në shtresa të ngjeshura mirë, të pastruara nga pluhuri, suva-ja dhe materialet organike, që rezultojnë nga prishjet e përshkruara në artikujt e mësipërm. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishjet do të kontrollohen më parë nga Supervizori dhe ripërdorimi i tyre do të autorizohet nga ai.

3.2.3 Përdorimi i materialit të gërmuar

Materiali i përshtatshëm dhe materiali i rimbushur nga punë të përkohshme do të përdoren për rimbushje. Çdo material i tepërt do të jetë në dispozicion të mungesave të materialeve të kërkuara.

3.2.4 Mbushja rreth strukturave

Materiali duhet vendosur në mënyrë simultane në të dyja anët e mbajtëses mur apo shtyllë. Mbushjet e mëvonshme të nxirren nga një material i aprovuar nga Supervizori, duke hedhur në shtresa me trashësi 150 mm me ngjeshje.

3.3 THEMELE STANDARDE

3.3.1 Themele betoni

Themelet e kryera prej betoni marka 100 të dozuar për m³ dhe të pastruar në shtresa të trasha të vibruar mirë, me dimensione dhe formë të treguar në vizatimet përkatëse, duke përfshirë kallëpet, formën e punës, mbështetjen dhe të gjitha kërkesat për të kompletuar punën me cilësi.

3.3.2 Plinta për kolona

Plinta, të realizuara dhe të armuara në mënyrë të rregullt sipas udhëzimeve në projekt, me beton M 200, të hedhur në veprë në shtresa të holla dhe të vibrura mirë, me dozim sipas betonit M 200 me

inert, duke përfshirë hekurin e armaturës, kallëpet, përforcimet, si dhe çdo detyrim tjetër dhe mjeshtëri për mbarimin e punës.

3.4 NDIHMESE PER THEMELET

3.4.1 Hidroizolimi i themeleve

3.4.1.1 Hidroizolimi i themeleve në ndërtesat pa bodrum

Në ndërtesat pa bodrum bëhet hidroizolimi i rrafshit horizontal të sipërm të themeleve në kuotën e xokolaturës me llaç çimento-rërë 1:2. Sipas rastit, llaçit i shtohet çerezi. Kjo shtresë hidroizoluese duhet të lidhet me shtresën hidroizoluese të dyshemesë dhe me hidroizolim të faqes vertikale të jashtme të themelit, që ndodhet në zonën në mes të trotuarit dhe rrafshit të xokolaturës.

3.4.1.2 Mënyra e hidroizolimit

Para se të fillojnë punimet e hidroizolimit të themeleve dhe të strukturave të tjera nën-tokësore, duhet të pastrohet vendi nga skelat dhe pajandjet, të cilat pengojnë zbatimin e mirë të shtresave hidroizoluese.

Gjatë hidroizolimit të faqeve horizontale të themeleve të zbatohen kushtet e mëposhtme:

- rrafshohet sipërfaqja e themelit;
- para se të zbatohet shtresa me lluster çimento, fillimisht bëhet lagia me ujë deri sa të ngopet;
- llaçi të përgatitet me 1 pjesë çimento dhe 2 pjesë rërë të larë dhe të ashpër (të marra në volum) dhe llustra të ndërtohet me trashësi 20–30 mm dhe të nivelohet me mjet pune (malle). Në vende me lagështirë të madhe t'i shtohet sasisë së çimentos 8 deri 10 % çerezi.

Faqet vertikale të mureve të bodrumeve hidroizolohen me bitum (praimer), karton katramë etj., sipas parashikimit në projekt, në përputhje me nivelin e ujërave nën-tokësore dhe kushtet e terrenit. Hidroizolimi zbatohet nga poshtë lart. Shtresat hidroizoluese me karton katramë apo bitum (praimer) duhet të mbrohen sipas shënimeve në projekt, zakonisht me mur tullash me trashësi 12 cm. Jashtë murit mbrojtës vendoset argjilë me gjerësi 30–50 cm, që ngjeshet mirë. Shtresat e karton katramësë vendosen horizontalisht, duke respektuar mbivendosjet dhe sfazimet e shtresave.

3.4.2 Drenazhimi perimetrale e sipërfaqësor

Drenazhimi perimetrale bëhet përgjatë themeleve, por jo mbi to. Ky drenazh përbëhet nga linja unazore me tuba shkarkimi dhe puseta kontrolli.

Në qoftë se nën dyshemenë e godinës gjendet një shtresë kapilare, atëherë duhet të bëhet një drenazh unazor me tuba siç paraqitet në figurën Nr.1.

Në rastet kur duhet që drenazhimi të bëhet nën tabanin e themeleve, duhet që në këtë zonë tabani i themeleve të jetë më thellë.

Tubat do të shtrihen duke u nisur nga pika më e ulët, deri në pikën më të lartë në vijë të drejtë me pjerrësi, mbi një shtresë filtruese zhavorri 15 cm të trashë dhe mbulohet rreth 25 cm me të njëjtin material filtrues. Gjithashtu, duhet patur parasysh që tabani i tubit të jetë minimumi 20 cm në nivelin e dyshemesë, në mënyrë të tillë që uji të largohet pa problem nga shtresa kapilare.

Dimensionet e tubit duhet të jenë minimum 50 mm; zhavorri që do të përdoret për shtresën filtruese duhet të jetë me kokrriza jo më të vogla se 3.2 mm.

Përveç drenazhimit perimetrale, një rol të madh në largimin e ujit nga themelet luan edhe drenazhimi sipërfaqësor i cili realizohet si më poshtë:

Nën të gjithë sipërfaqen e dyshemesë realizohet një shtresë drenazhimi dhe sipër saj vendoset një shtresë ndarëse në mënyrë që të pengojë futjen e betonit të dyshemesë në shtresën drenazhuese. Në rast se për realizimin e drenazhimit përdoret zhavorr për beton 3,2 mm atëherë trashësia e shtresës drenazhuese duhet të jetë minimumi 30 cm e trashë, dhe në rast se përdoret zhavorr 4–32 mm, shtresa realizohet duke hedhur vetëm 10 cm në të gjithë sipërfaqen. Nën shtresën e drenazhimit vendosen tuba drenazhimi. Diametri dhe distanca ndërmjet tyre është në varësi të sasisë së ujit. Tubat e drenazhimit rrethohen nga shtresa filtruese zhavorri dhe lidhen me tubat e drenazhimit perimetrale.

Në figurat më poshtë paraqitet një mënyrë vendosjeje e tubave të drenazhimit.




Figura Nr. 1




Figura Nr. 2

SEKSIONI 4: PUNIME BETONI ARMIMI DHE HEKURI

4.1 BETONI I DERDHUR NË VEND

4.1.1 Kërkesa të përgjithshme për betonet

Betoni është një përzierje e çimentos, inerte të fraksionuara të rërës, inerte të fraksionuara të zhavorrit dhe ujit dhe solucionëve të ndryshëm për fortësinë, përshkueshmërinë e ujit dhe për të bërë të mundur që të punohet edhe në temperatura të ulëta sipas kërkesave dhe nevojave teknike të projektit.

4.1.2 Materialet

Përbërësit e betonit

Përbërësit e betonit duhet të përmbajnë rërë të larë ose granil, ose përzierje të të dyjave si dhe gurë të thyer. Të gjithë agregatet duhet të jenë pastruar nga mbeturinat organike si dhe nga dheu. Pjesa kryesore e agregateve duhet të jetë me formë këndore dhe jo të rrumbullakët. Përbërësit e betonit duhet të kenë çertifikatën që vërteton vendin ku janë marrë ato.

Çimento

Kontraktuesi është i detyruar që për çdo ngarkesë çimentoje të prurë në objekt, të paraqesë faturën e blerjes e cila të përmbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe çertifikatën e prodhuesit dhe shërben për të treguar që çimentoja e secilës ngarkesë është e kontrolluar dhe me analiza sipas standardeve. Për më shumë detaje në lidhje me markën e çimentos që duhet përdorur në prodhimin e betoneve, shiko në pikën 4.1.4, pasi për marka betoni të ndryshme duhen përdorur marka çimento të ndryshme.

Uji për beton

Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë i pastër nga substancat që dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argjila, vajra si dhe substanca të tjera organike. Në përgjithësi, uji i tubacioneve të furnizimit të popullsisë (uji i pijshëm) rekomandohet për përdorim në prodhimin e betonit.

4.1.3 Depozitimi i materialeve

Depozitimi i materialeve që do të përdoren për prodhimin e betonit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Çimentoja dhe përbërësit duhet të depozitohen në atë mënyrë që të ruhen nga përzierja me materiale të tjera, të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhimin e betonit dhe e dëmtojnë cilësinë e tij.

Çimentoja duhet të depozitohet në ambiente pa lagështirë dhe që nuk lejojnë lagjen e saj nga uji dhe shirat.

4.1.4 Klasifikimi i betoneve

4.1.4.1 → Beton marka 100, me zhavor natyror: Çimento marka 300, 240 kg; zhavorr 1,05 m³; ujë 0,19 m³.

4.1.4.2 → Beton marka 100 me inerte, konsistence 3–5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 300, 240 kg; rërë e larë 0,45 m³; granil 0,70 m³; ujë 0,19 m³.

4.1.4.3 → Beton marka 150 me inerte, konsistence 3–5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 260 kg; rërë e larë 0,44 m³; granil 0,70 m³; ujë 0,18 m³.

4.1.4.4 → Beton marka 200 me inerte, konsistence 3–5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 300 kg; rërë e larë 0,43 m³; granil 0,69 m³; ujë 0,18 m³.

4.1.4.5 → Beton marka 250 me inerte, konsistence 3–5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 370 kg; rërë e larë 0,43 m³; granil 0,69 m³; ujë 0,18 m³.

4.1.4.6 → Beton marka 300 me inerte, konsistence 3–5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 465 kg; rërë e larë 0,38 m³; granil 0,64 m³; ujë 0,195 m³.

4.1.5 Prodhimi i betonit

Betoni duhet të përgatitet për markën e përcaktuar nga projektuesi dhe recetura e përzierjes së materialeve sipas saj në mbështetje të rregullave që jepen në KTZ 37–75 “Projektim i betoneve”. Gjatë përgatitjes së betonit të zbatohen rregullat që jepen në kapitullin 6 “Përgatitja e betonit” të KTZ 10/1-78, paragrafët 6.2, 6.3 dhe 6.4.

4.1.6 Hedhja e betonit

Hedhja e betonit të prodhuar në vend bëhet sipas mundësive dhe kushteve ku ai do të hidhet. Në përgjithësi për këtë qëllim përdoren vinçat fiks që janë ngritur në objekt si dhe autohedhëse. E rëndësishme në procesin e hedhjes së betonit në vepër është koha nga prodhimi në hedhje, e cila duhet të jetë sa më e shkurtër. Gjithashtu, një rëndësi të veçantë në hedhjen e betonit ka edhe vibrimi sa më mirë gjatë këtij procesi.

4.1.7 Realizimi i bashkimeve

Betonimet duhet të kryhen pa ndërprerje nëse kjo gjë është e mundur. Në rastet kur kjo nuk është e domosdoshme ose e detyruar, atëherë duhet të merren të gjitha masat për të realizuar bashkimin e dy betonimeve të kryera në kohë të ndryshme. Ndërprerja e punimeve të betonimit të vendoset sipas mundësive duke realizuar: Lllamarinë me gjerësi 10 cm dhe trashësi 4 mm, nga të cilat 5 cm futen në betonin e freskët dhe betonohen, ndërsa 5 cm e tjera shërbejnë për betonimin e mëvonshëm. Shirit fuge, i cili duhet të vendoset sipas specifikimeve të prodhuesit.

4.1.8 Mbrojtja

Betoni i freskët duhet mbrojtur nga këto ndikime:

Shiu si dhe lagështitë tjera duke e mbuluar sipërfaqen e betonuar me plastmas dhe materiale të padëprueshme nga uji. Ngricat (duke i futur gjatë procesit të prodhimit solucionë kundra temperaturave të ulëta mundet të betonohet deri në temperatura afër zeros). Temperaturat e larta.

Betoni mbrohet ndaj temperaturave të larta duke e lagur vazhdimisht atë me ujë, në mënyrë të tillë që të mos krijohen plasaritje.

4.1.9 Betoni në kushte të vështira atmosferike

Rekomandohet që prodhimi dhe hedhja e betonit në objekt të mos realizohet në kushte të vështira atmosferike.

Ndalohet prodhimi dhe hedhja e betonit në rast se bie shi i rrëmbyeshëm, pasi nga sasia e madhe e ujit që i futet betonit largohet çimentoja dhe kështu që betoni e humb markën që kërkohet. Në rastet e temperaturave të ulëta nën 4 °C rekomandohet të mos kryhet betonimi, por nëse kjo është e domosdoshme, atëherë duhet të merren masa që gjatë procesit të prodhimit të betonit, atij t'i shtohet solucion i kundër ngricave në masën e nevojshme që rekomandohet nga prodhuesi i këtij solucion.

Prodhimi dhe përpunimi i betonit në temperatura të larta mund të ndikojë negativisht në reagimin kimik të çimentos me pjesët e tjera të betonit. Për këtë arsye ai duhet ruajtur kundër temperaturave të larta. Mënyra e ruajtjes nga temperatura e lartë mund të bëhet në atë mënyrë, që betoni i freskët të mbrohet nga dielli duke e mbuluar me plastmas, tallash dhe duke e spërkatur me ujë. Një ndihmë tjetër për përpunimin e betonit në temperatura të larta është të ngjyrosësh mbajtësit e ujit me ngjyrë të bardhë dhe të sigurojë spërkatje të vazhdueshme me ujë.

Tuba dhe dalje. Tubat si dhe kanalet e ndryshme që e furnizojnë një ndërtesë (uji, ujerat e zeza, rrjeti elektrik, etj.) duhet sipas mundësisë të mos futen në beton, që mos pengojnë në homogenitetin e pjesëve të betonit të cilat janë projektuar si pjesë mbajtëse, elemente betoni. Në rastet kur ky kusht nuk mund të plotësohet, atëherë duhet konsultuar inxhinieri konstruktor.

Për raste kur duhet kaluar nëpër mure ose nëpër pjesë të tjera mbajtëse si p.sh. soletat, atëherë duhet që gjatë fazës së projektimit të merren parasysh këto dalje dhe të planifikohen/llogariten nga inxhinieri konstruktor si dhe të bëhet izolimi i tyre. Po ashtu duhet që gjatë hedhjes së betonit të përgatiten këto dalje, nëpër të cilat më vonë do të kalojnë tubat si dhe kanalet e tjera furnizuese.

4.1.10 Provat e betonit

Pasi është prodhuar betoni, ai duhet kontrolluar nëse i plotëson kriteret sipas kërkesave të projektit. Mbas prodhimit dhe para hedhjes së tij, duhet marrë një kampion betoni për të bërë testime në laborator dhe rezultatet

4.2 ELEMENTË DHE NËN-ELEMENTË BETONI

4.2.1 Arkitrare të derdhur në vend

Arkitraret realizohen në të gjithë gjerësinë e muraturës me mbështetje min. 25 cm mbi shpatullat anësore, me lartësi të ndryshme në varësi të hapësirës së dritës, të armatur në mënyrë të rregullt dhe sipas udhëzimeve në projekt, të përgatitur nga beton M200 dhe M250, duke përfshirë skelat e shërbimit, kallëpet, perforcimet, hekurin e armaturës dhe çdo perforcim tjetër për mbarimin e punës.

4.2.2 Trarë të derdhur

Trarë betoni, të armatur në mënyrë të rregullt dhe sipas udhëzimeve në projekt, deri në lartësinë 4 m, i realizuar me betonin të dhënë në vepër, i shtuar në shtresa të holla të vibruara mirë, beton M200 me dozim sipas betonit marka 200 me inerte, duke përfshirë skelat e shërbimit, kallëpet, perforcimet, hekurin e armaturës si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

4.2.3 Breza betoni

Realizimi i brezit, në të gjithë gjerësinë e muraturës poshtë dhe lartësi prej 15 deri në 20 cm, i armuar sipas KTZ dhe STASH, i realizuar me betonin të prodhuar në vepër, i shtuar në shtresa të holla të vibruara mirë, beton M150 deri te M200 me inerte dhe siç tregohet në vizatime, duke përfshirë kallëpet, perforcimet, hekurin e armaturës, skelat e shërbimit ose skelerinë, si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

4.2.4 Kolona

Kolona betoni, të armuara në mënyrë të rregullt dhe sipas udhëzimeve në projekt, deri në lartësinë 4 m, i realizuar me betonin të dhënë në vepër, i shtruar në shtresa të holla të vibruara mirë, beton M200 me dozim sipas betonit marka 200 me inerte dhe siç tregohet në vizatime, duke përfshirë skelat e shërbimit, kallëpet, perforcimet, hekurin e armaturës, si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

4.2.5 Soleta të armuara tip SAP

Furnizim dhe vendosje në emër të soletës tip "SAP", e vendosur mbi muraturën e niveluar më parë me llaç M-1:2, e ankoruar në një brez lidhës dhe sipas udhëzimeve të projektit, e armuar në mënyrë të rregullt, beton M200 deri M250, e hedhur në vepër me shtresa të holla të vibruara mirë, dhe sipas hapësirës së dritës së kampatës do të duhet një armaturë hekuri dhe soletëz shtesë, duke përfshirë kallëpet, puntelimet, perforcimet, skelat e shërbimit ose skelerinë si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

4.2.6 Solete b/a

Solete monolite betoni të armuar në mënyrë të rregullt, realizuar në beton M200 sipas projektit, e dhënë në vepër në shtresa të holla të vibruara mirë, duke përfshirë hekurin, kallëpet, puntelimet, perforcimet, skelat e shërbimit ose skelerinë, si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

4.2.7 Mbulesa në hyrjen kryesore

Penisilina në hyrje të ndërtesës, e realizuar me solete beton/arme monolite, e cila është një me pjesën e shtresës beton/arme të korpusit të ndërtesës dhe mund të betonohet në formë tra konsul ose e mbështetur në tra konsul. Marka e betonit M200 deri në M250. Punimet realizohen duke përfshirë kallëpet, perforcimet, skelat e shërbimit, gërmimet për themelet, hekurin e armaturës, si dhe çdo detyrim tjetër për të përfunduar punën.

4.2.8 Struktura prej b/a

Pjesë godine me strukturë mbajtëse beton arme, ndërtuar e ndarë nga muratura, duke parashikuar një fugë teknike për gjatësi mbi 40 m. Struktura beton/arme duhet të formohet nga skelet me trarë, kolona, plinta, shkallë të lidhura ndërmjet tyre; dhe e realizuar: në mënyrë monolite me beton M200 deri M250. Këto struktura realizohen duke filluar që nga themelet.

4.3 KALLËPET DHE FINITURAT E BETONIT

4.3.1 Përgatitja e kallëpeve

Kallëpet përgatiten prej druri ose prej metali dhe janë të gatshme ose përgatiten në objekt. Sipërfaqet e kallëpeve që do të jenë në kontakt me betonin, do të trajtohen në mënyrë të tillë, që të sigurojnë shkëputje të lehtë dhe mosngjitjen e betonit në kallëp gjatë heqjes. Para ripërdorimit, të gjitha kallëpet dhe sipërfaqet e tyre që do të jenë në kontakt me betonin, duhet të pastrohen me kujdes pa shkaktuar ndonjë dëmtim në sipërfaqen e kallëpit.

4.3.2 Depozitimi në kantier

Kallëpi nuk duhet hequr para se betoni të ketë krijuar forcën e duhur, që të mbajë masën e tij dhe të durojë ngarkesa të tjera që mund të ushtrohen mbi të. Ky kusht duhet marrë parasysh në mënyrë që kallëpi të mbetet në vend pas heqjes së betonit, për një periudhë të përshtatshme minimale kohore, e treguar në tabelën e mëposhtme, nëse kontraktori mund t'i provojë supervizorit që kjo punë mund të kryhet edhe në një periudhë më të shkurtër kohore.

Periudha minimale para heqjes së kallëpit nga elementet e beton/armë me Çimento Portlandi

Tipi i kallëpit	Temperatura e sipërfaqes së betonit	16°C	7°C
Kallëp vertikal në kolona		3 ditë	5 ditë
Mure dhe trarë të mëdhenj (anësorë)		2 ditë	3 ditë
Kallëpe të butë në soleta		4 ditë	7 ditë
Shtyllë nën soleta		11 ditë	14 ditë
Kallëpe të butë nën trarë		8 ditë	14 ditë
Shtyllë nën trarë		15 ditë	21 ditë

Shënim:

Kur përdoret solucion i ngrirjes së shpejtë të çimentos, kallëpet mund të hiqen brenda një periudhe më të shkurtër, por kjo duhet të lejohet nga Supervizori. Për periudha të ftohta duhet të rritet periudha me gjysmë dite për çdo ditë kur temperatura bie ndërmjet 7°C dhe 2°C, dhe me një ditë shtesë për çdo ditë kur temperatura bie nën 2°C. Kallëpi duhet hequr me kujdes, në mënyrë që të shmangen dëmtime të betonit.

4.3.3 Klasifikimi i sipërfaqeve të elementeve prej betoni

Rifiniturat e betonit i ndajmë në dy grupe:

Lënia e sipërfaqes së betonit pas heqjes së kallëpeve në gjendjen pas betonimit. Përpunimi i sipërfaqes së betonit me suvatim ose me veshje. Në grupin e parë duhet pasur parasysh që gjatë procesit të vendosjes së kallëpeve, ato duhet të jenë me sipërfaqe të lëmuar dhe të rrafshët, si dhe të lyhen me vaj kallëpesh, në mënyrë që, kur të hiqen kallëpet, të dalë një sipërfaqe e lëmuar e betonit. Po ashtu, gjatë hedhjes së betonit në veprë duhet të vibrohet në mënyrë uniforme. Sa i përket grupit të dytë, mund të vepohet njësoj si për sipërfaqet e mureve.

4.4 HEKURI

4.4.1 Materialet

Përgatitja e çelikut për të gjitha strukturat e betonit dhe komponentët e metalit, që duhen prodhuar në kantier, duke konsideruar çelikun që plotëson të gjitha kërkesat e projektit dhe pa prezencën e ndryshkut, në format dhe përmasat sipas vizatimeve dhe standarteve tekniko-legale për bashkimin, lidhjen, dhe duke e shoqëruar me çertifikatën e prodhuesit për të verifikuar që çeliku plotëson kushtet e kërkuara që nevojiten për punë të tilla, dhe duke përfshirë të gjitha kërkesat e tjera jo të specifikuar.

4.4.2 Depozitimi në kantier

Depozitimi i hekurit në kantier duhet të bëhet i tillë që të mos dëmtohet (shtrembërohet, pasi kjo gjë do të shtonte procesin e punës së parandërsjes) si dhe të mos pengojë punimet ose materialet e tjera të ndërtimit.

4.4.3 Kthimi i hekurit

- Hekurat duhet të kthehen sipas dimensioneve të treguara në projekt.
- Përveç pjesës së lejuar më poshtë, të gjitha shufrat duhet të kthehen dhe kthimi duhet bërë ngadalë, drejt dhe pa ushtrim force. Bashkimet e nxehta nuk lejohen.
- Prerja me oksigjen e shufrave shumë të tendosura do të lejohet vetëm me aprovimin e Supervizorit. Shufrat e ambalazhimit nuk mund të drejtohen dhe përdoren.

4.4.4 Vendosja dhe fiksimi

Hekurat do të pozicionohen siç janë paraqitur në projekt dhe do të ruajnë këtë pozicion edhe gjatë betonimeve. Për të siguruar pozicionin e projektit, ata lidhen me tel 1,25 mm ose kapëse të përshtatshme.

4.4.5 Mbulimi i hekurit

Termi “mbulimi” në këtë rast do të thotë minimumi i pastër i shtresës mbrojtëse ndërmjet sipërfaqes së hekurave dhe faqes së betonit. Mbulimi minimal do të bëhet sipas normave të KTZ.

4.4.6 Ngjitja e hekurave

Paranderja ose bashkimi i shufrave të hekurit do të bëhet vetëm sipas vizatimeve të treguara dhe të aprovuara nga Investitori. Gjatësia e mbivendosjes në një lidhje nuk duhet të jetë më e vogël se ajo e treguar në vizatimet e punës.

4.4.7 Drejtimi i hekurit dhe paranderja

Një pjesë e hekurit (me diametër më të vogël se 8 mm) transportohet në formë rrotullash. Për këtë, duhet që ai të drejtohet në kantierin e ndërtimit. Drejtimi i tij kryhet me metoda praktike, si p.sh. lidhja e njërës anë në një pikë fikse dhe tërheqja e anës tjetër me mekanizma të ndryshëm. Gjithashtu, në poligone realizohet edhe paranderja për elemente të ndryshme, sipas kërkesave të projektit. Ky proces pune duhet të kryhet me kujdes dhe nën vëzhgimin e drejtuesit të punimeve.

SEKSIONI 5 : STRUKTURA E NDËRTIMIT

5.1 MURET DHE NDARJET

5.1.1 Llaç për muret

Për 1 m³ llaç realizohet me këto përbërje:

5.1.1.1 → Llaç bastard me rërë natyrale lumi (me lagështi, shtesë në volum 20% dhe porozitet 40%) e formuar me rërë në raportet 1 : 0,8 : 8.

Gëlqere e shtuar: 110 lt

Çimento: 300,150 kg

Rërë: 1,29 m³

5.1.1.2 → Llaç bastard marka 25 me rërë natyrale lumi (me lagështi, shtesë në volum 20%) me çimento : gëlqere : rërë në raportet 1 : 0,5 : 5,5.

Gëlqere e shuar: 92 lt

Çimento: 300,212 kg

Rërë: 1,22 m³

5.1.1.3 → Llaç bastard marka 15 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me çimento, gëlqere, rërë në raport 1 : 0,8 : 8.

Gëlqere e shuar: 105 lt

Çimento: 300,144 kg

Rërë: 1,03 m³

5.1.1.4 → Llaç bastard marka 25 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me çimento : gëlqere : rërë në raport 1 : 0,5 : 5,5.

Gëlqere e shuar: 87 lt

Çimento: 300,206 kg

Rërë: 1,01 m³

5.1.1.5 → Llaç çimento marka 1:2 me rërë të larë, e formuar me çimento dhe rërë në raport 1 : 2.

Çimento: 400,527 kg

Rërë: 0,89 m³

5.1.2 Specifikimi i përgjithshëm për tullat

Tulla si element i ndërtimit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme për ndërtimet antisizmike:

Rezistenca në shtypje, e cila duhet të jetë:

Për tullën e plotë: 75 kg/cm²

Për tullat me vrima: 80 kg/cm²

Për sapet: 150 kg/cm²

Rezistenca në prerje, e cila duhet të jetë për të gjitha tullat me vrima: 20 kg/cm²

Përçindja e boshllëqeve, e cila duhet të jetë:

Për tullën e plotë: 0–25%

Për të gjitha tullat me vrima: 25–45%

Trashësia e mishit perimetral dhe të brendshëm për tullat e plota të mos jetë më e vogël se 20 mm; dhe për të gjitha tullat me vrima, trashësia e mishit perimetral të mos jetë më e vogël se 15 mm dhe e mishit të brendshëm jo më e vogël se 9 mm.

Sipërfaqja e një vrime të mos jetë më e madhe se 4.5 cm².

Ujëthithja në përçindje duhet të jetë nga 15 – 20 %.

5.1.3 Mur me tulla të plota 25 cm

Muraturë me tulla të plota mbajtëse në lartësi deri në 3 m, realizohet me llaç bastard M-25, sipas pikës 5.1.1 me përmbajtje për 1 m³: tulla të plota nr. 400, llaç bastard 0.25 m³, çimento 400 kg, për çdo trashësi muri, duke përfshirë çdo detaj dhe kërkesë për dhembet e lidhjes, qoshet, parmakët, skelat e shërbimit ose skelëritë, si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj. Për muraturën e katit përdhe, sipërfaqja e xhokulit duhet të jetë e niveluar me një shtresë llaçi çimento 1:2 me trashësi jo më të vogël se 2 cm.

5.1.4 Mur ndarës 12 cm

Muraturë me tulla të plota me trashësi 12 cm dhe llaç bastard M-25 sipas pikës 5.1.1, me përmbajtje për 1 m³: tulla të plota 424 copë, llaç 0.19 m³, çimento 400 kg dhe ujë.

5.2 MBULESAT

5.2.1 Taraca

Termoizolimi

Termoizolimi realizohet duke përdorur materiale termoizoluese (penobeton ose polisterol) të vendosura në formë të pjerrët në zonat e shtresave hidroizoluese. Mbulimi me shtresa llaçi i pjerrësisë së kërkuar me një minimum trashësie prej 3 cm, e realizuar me llaç çimento (tipi 1:2), e niveluar për instalimin e shtresës izoluese.

Hidroizolimi

Hidroizolimi duhet shtrirë në një sipërfaqe të thatë, të niveluar më parë, duke përfshirë sipërfaqe vertikale, të trajtuara me shtresë të parë bituminoze si veshje e parë. Mbi këtë vendosen dy fletë bituminoze, me fiber minerale, secila me trashësi min. 3 mm, e ngjitur me flakë, me membrana të vendosura në këndet e dhura mbi njëra-tjetrën, në sipërfaqe të pjerrëta ose vertikale, duke u siguruar se mbulesa e elementeve të bashkuara të jetë 12 cm.

Mbrojtja e membranës izoluese me plan vertikal ose të pjerrët do të realizohet me shtresë llaçi ose pllaka çimentoje me trashësi 3 cm (tipi i llaçit 1:2), pllakat ose shtresa e llaçit do të realizohet në formë kuadrati 2 x 2 m, me fuga nga 2 cm, të cilat do të mbushen me bitum sipas kërkesave të dhëna në vizatime.

Instalimi i parapeteve betoni me kanale kulluese të inkuorporuara, në beton të forcuara, të parafabrikuara ose të derdhura në vend sipas të dhënave në skica, beton (tipi 200) në dozim m³ siç është treguar në 4.1.4, duke përfshirë kallëpet në përputhje me të gjitha kërkesat për të siguruar taracën, me një punë me cilësi.

Në rastet kur hidroizolimi i taracës bëhet kur nuk ka lluster çimentoje mbi shtresat e katramave, atëherë vendoset një shtresë prej 5 cm, me zhavor të rrumbullakët me dimension 32 mm – 64 mm, e cila shërben për mbrojtjen e katramasë.

5.2.2 Ulluqet vertikale dhe horizontale

Ulluqet horizontale

Realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujërave. Ulluqet horizontale prodhohen me material plastik ose me llamarinë xingato. Ulluku me llamarinë prej çeliku të xinguar me trashësi jo më të vogël se 0,8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët se bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale për grykën e hyrjes. Ulluku horizontal, i modeluar sipas udhëzimeve në projekt, duhet të jetë i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vëna maksimumi në 70 cm. Në objektet me taracë përdoren edhe ulluqe betoni. Të gjitha ulluqet prej betoni duhet të hidroizolohen me guainë nga ana e brendshme e tyre. Ulluqet e vendosura ndërmjet çatisë dhe parapetit do të jenë prej llamarine të xinguar, sipas detajeve të vizatimit.

Ulluqet vertikale

Janë për shkarkimin e ujërave të çatave dhe taracave, dhe kur janë në gjendje jo të mirë duhet të çmontohen dhe të zëvendësohen me ulluqe të rinj. Ulluqet vertikale për shkarkimin e ujërave të çatave dhe taracave që përgatiten me llamarinë prej çeliku të xinguar, duhet të kenë trashësi jo më të vogël se 0.6 mm dhe diametër 10 cm, kurse ulluqet vertikale prej PVC kanë dimensione nga 8 deri në 12 cm dhe mbulojnë një sipërfaqe çatie nga 30 deri në 60 m². Në çdo ulluk duhet të mblidhen ujërat e një sipërfaqe çatie ose tarace jo më të madhe se 60 m². Ullukët duhet të vendosen në pjesën e jashtme të ndërtesës, me anë të qaforeve përkatëse prej çeliku të xinguar, të fiksuar çdo 2 m. Ujërat e taracës që do të kalojnë në tubat vertikale duhet të mblidhen nëpërmjet një pjate prej llmarine të xinguar, e riveshur me guainë të vendosur në flakë, me trashësi 3 mm, e vendosur në mënyrë tërthore, ndërmjet muraturës dhe parapetit, me pjerrësi 1%, e cila lidhet me kasetën e shkarkimit sipas udhëzimeve në projekt. Pjesa fundore e ullukëve, për lartësinë 2 m, duhet të jetë PVC dhe e mbërthyer fort me ganxha hekuri, si dhe poshtë duhet të kthehet me bërryl 90 gradë.



SEKSIONI 6: RIFINITURAT


6.1 RIFINITURAT E MUREVE

6.1.1 Veshje fasade me polisterol t=8cm + rrjete + suva

Per fasaden do te perdoret veshje fasade me polisterol kompakt me trashesi t=8cm. Bashkangjitur eshte rrjeta dhe me pas suvaja. Fasada termike përbëhet nga shtresat e mëposhtme:

- Polisteroli
- Ngjitësi kollë
- Upat
- Rrjeta
- Suva

Paneli termoizolues ka përbërje polisteroli, i parashikuar në projekt me trashësi 8cm dhe dendesi 30kg/m³. Pozicionimi sipas trashesise perkatese eshet pasqyruar ne projekt. Për ngjitjen e paneleve termoizolues përdoret ngjitësi/kolla. Përzjerja e ngjitësit duhet të përgatitet gjithmonë duke ndjekur me përpikmëri specifikat e treguara nga prodhuesi në termat e dozës dhe përbërjes. Fiksimi i polisterolit me suportin realizohet me anë të upave plastikë. Madhësia e upave duhet të jetë 8 cm më shumë se trashësia e panelit termoizolues. Vendosja e upave është parashikuar të jetë 9 copë/m². Një upë vendoset në qendër të cdo paneli termoizolues dhe të tjerat vendosen në pikat e takimit të kontureve horizontale dhe atyre vertikale të paneleve termoizolues. Pas fiksimit të paneleve termoizolues aplikohet shtresa e nivelimit e cila është e përbërë nga dy elemente bazë:



-Ngjitësi nivelues (suvaja) është produkti që duhet të mbrojë panelin izolues nga veprimet atmosferike.

- Rrjeta plastike eviton plasaritjet (tkurrjen, bymimin) e suvasë gjatë tharjes si dhe lëvizjet e transmetuara nga izoluesi tek suvaja, të formuara këto nga oshilacionet e temperaturës dhe lagështisë

Kërkesa teknike të përgjithshme për sistemin KAPOT

Aplikimi do të bëhet mbi muraturën e tullësdhe elementeve brej b/a sipas projektit të arkitekturës dhe pas miratimit të inxhinierit të kantierit dhe të investitorit. Përpara fillimit të punës të gjitha sipërfaqet kuaplikohet sistemi do të pastrohen nga pluhurat dhe do të spëkaten më ujë për të përgatitur sipërfaqen për montimin e polisterolit

Puna për aplikimin e sistemit do të nisë pasi tëjete pastruar muratura e tullës nga papastërtitë dhe nga llacrat e fugave që mund të dalin jashtë muraturës. Aplikimi i sistemit do të filloje vetëm pasi të jetë verifikuar që muratura ku do të aplikohet është brenda kërkesave dhe standartit të kërkuar. Nuk lejohet që të fillojë aplikimi nëse në muraturë ka zgavra, papastërti,shtrëngime me pyka druri ose tulle. Skelëria dotë montohet në distancën e duhur për lejimin e punës. Materiali që do të aplikohet do të jetë i miratuar sipas procedurës sëinvestitorit.

Montimi i pllakave të polisterolit do të bëhet mekollë në të gjithë gjerësinë dhe gjatësinë e tyre dhe jo me disa pika. Pllakat e polisterolitdo të montohen në mënyrë të tillë që të mbështeten tek njëra-tjetra në1/3 e gjatësisë në formë muri tulle dhe do të nisin nga poshtë-lartë duke u mbështetur në elementin fundortë sistemit. Pas montimit të pllakave sipas rradhës së mësipërme duhet të kalohet shtresa eparë me kollë sëbashkume rrjetën me fibra xhami dhe 24 orë më pas duhet të kalohet shtresa e dytë e kollës.24 orë pas kalimit të shtresës së dytë të kollës fillon montimi i vidave (upa-ve) plastike të përshtashme si për tulla argjile si për elemente betoni jo më pak se6 copë/m². Pikat ku do të montohen vidat (upat)duhet të stukohen që të mos jenë në kontakt tëdrejtpërdrejtë me shtresat e tjera. Në cdo kënd ose thyerje duhet të realizohet duke vendosur këndoren e sistemit. Këndorja duhet të montohet në mënyrë të tillë që të mos dallojë sinë horizontalitet dhe vertikalitet nga pjesa tjetër e sistemit.

Pasi të thahen edhe stukimet duhet të aplikohet një shtresë prajmer (ngjitës astar) përpara aplikimit të grafiatos. Grafiato aplikohet 24 orë pas aplikimit të astarit ose sipas specifikave të prodhuesit. Grafiato do të jetë akrilike dhe me ngjyrë sipas kërkesave të investitorit. Në rastet kur skelëria e montuar për këtë sistem është fiksuar në brendësi të sistemit, kur të nisë cmontimi i skelës duhet të merren masa që të bëhen riparimet e nevojshme në sistem duke aplikuar materialet e dhura dhe radhën e punës e cila dotë miratohet më pare nga inxhinieri dhe nga investitori.

Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori dhe inxhinieri i UNDP per nje aprovim paraprak.

6.1.2 Suva grafiato

Suva grafiato gjen përdorim si rifiniturë e fasadave. Mundëson ngjitje të mire dhe rezistencë ndaj ujit, elasticitet të lartë dhe lejon transpirimin e elementëve strukturor. Suvaja grafiato është rezistente ndaj algave dhe baktereve si dhe ka koeficient tepër të ulët të përthithjes së ujit. Qëndrueshmëri të ngjyrës në procesin e tharjes dhe mundësi pa limit për ngjyrë dhe teksturë. Punohet lehtësisht, dhe është rezistente ndaj goditjeve mekanike



Konsumi : 2,0mm \approx 3,0kg/m²

Granulometria: 4 mm

Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori dhe inxhinieri i UNDP per nje aprovim paraprak.

6.1.3 Suvatim i brendshem ne ndertime te reja

Sprucim i mureve dhe tavaneve me llaç çimentoje te lenget, per permiresimin e ngjitjes se suvase dhe rforcimin e sipërfaqeve te muratures, duke perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta perfunduar plotesisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga nje shtrese me trashesi 2 cm llaçi bastard m-25 me permbajtje per m²: rere e lare 0,005 m³; llaç gelqereje m- 1: 2, 0.03 m³; çimento 400, 6.6 kg; uje, i aplikuar me paravendosje te drejtuesve ne mure (shirtit me llaç me trashesi 15 cm çdo 1 deri ne 1,5 m), dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta perfunduar plotesisht suvatimin.

6.1.4 Suvatim i jashtëm në ndërtime të reja

Sforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard M-25 me dozimin për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç bastard 0,03 m³; çimento 400, 7.7 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistrinë e berdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

6.1.5 Hidroizolimi me nje shtese llaci me baze cemento pergatitur me dy komponente A+ B

Procesi i hidroizolimit është një ndër proceset më të rëndësishme në punimet e ndërtimit pasi realizon mbrojtjen e ambjenteve nga lagështira. Hidroizolimet kryhen në sipërfaqe të rrafshta horizontale dhe vertikale ku është e pranishme një sasi e konsiderueshme uji. Hidroizolimi në tualete dhe ambjente me prani të ujit

Për hidroizolimet në tualete do të përdoret materiali hidroizolues bikomponent ITC HD2 ITC HD2 është një material hidroizolues me dy komponente, me fleksibilitet të lartë e bazë cimentoje , formuluar për të krijuar një shtresë mbrojtëse , hidroizoluese dhe niveluese.

Materiali është i paketuar në thaës 25 kg dhe bidona për komponentin B me një shtresë mbrojtëse nga lagështira.

Përgatitja e sipërfaqes përpara aplikimit të bikomponentit.

Përpara se të bëhet aplikimi i materialit bikomponent duhet të merren këto masa :

-Sipërfaqja e llacrave dhe e betonit duhet të jetë e pastër nga mbetjet e inerteve.

-Poret në llac dhe “kanalet” në beton duhet të pastrohen me ujë e më pas të bllokohen.

-E gjithë zona ku do të aplikohet materiali do të pastrohet me ujë. Të gjitha riparimet e nevojshme para përdorimit të ITC HD2 duhet të bëhen disa ditë para përdorimit të materialit.

6.1.5.1 Aplikimi i materialit dhe realizimi i hidroizolimi

Pasi përgatitet sipërfaqja e punës sipas rregullova të përmëndura mësipër , fillon procesi i përgatitjes së materialit. Për këtë në një kovë , thesi 25kg me material nga komponenti A përzihet me rreth 8-10 litra material nga komponenti B , duke i shtuar komponentit B materialin e thatë.

Përzjerja e materialit bëhet me anë të një përzjerësi mekanik me numër të ulët xhirosh, deri sa të arrihet një masë homogjene. Është shumë e rëndësishme që materiali të përdoret menjëherë pas përzjerjes , sepse përdryshe mund të thahet e të bëhet i papërdorshëm.

Në mënyrë që të shmangen lindja e plasaritjeve sëbashku me materialin bikomponent do të përdoret edhe rrjeta me fibra xhami. Për këtë, në sipërfaqen që do të hidroizolohet specialisti fillon shtrirjen e rrjetës, duke pasur kujdes që ta shtrihe atë në përputhje me konfiguracionin e sipërfaqes. Rrjeta do të ngrihet minimalisht 20cm në mure, ose më shumë sipas specifikimeve teknike të projektit. Në rastin e kabinave të dushit, faqet anësore të kabinës do të vishen në të gjithë lartësinë me rrjetë xhami.

Gjatë vendosjes së rrjetës fillon dhe aplikimi i dorës së parë të materialit hidroizolues bikomponent, i cili mbulon rrjetën e vendosur në dysheme dhe në mure.

Ky proces konsumon 2kg/m² të materialit.

6.1.5.2 Aplikimi i materialit bëhet me mallë metalike, furce ose rul

Pas përfundimit të shtresës së dytë sipërfaqja lihet të thahet për kohën e nevojshme dhe ndalohet hyrja dhe kalimi i cdo kujt deri sat ë ketë arritur tharja e duhur.

6.1.5.3 Sigurimi në punë

Në mjedisin e punës do të jetë kutia e ndihmës së shpejtë e pajisur rregullisht me materialet dhe barnat e nevojshme. Punëtorët dhe specialistat do të pajisen me mjetet mbrojtëse kolektive. Specialistët do të pajisen me dorashka dhe këpucë të posacme.

6.1.5.4 Mbajtja pastër e ambjentit

Në ambjentin e punës do të vendosen kosha për hedhjen e mbeturinave , paketimeve të materialit bikomponent dhe mbetjeve të rrjetës së xhamit

Veglat e punës: malla, furcat, përzjersi mekanikë dhe të gjitha pajisjet e përdorura do të pastrohen mirë me ujë pa u tharë ITC HD2.

Punëtorët do të bëjnë pastrimin e ambjentit, grumbullimin e veglave të punës si edhe grumbullimin dhe magazinimin e paketimeve të ngelura të materialit bikomponent. Konservimi i materialit do të bëhet në vënde të thata.

Lyerje me boje vaji sintetik per siperfaqe metalike, me dozim per m²: boje vaji 0.2 kg dhe me shume duar per te patur nje mbulim te plote dhe perfekt te siperfaqeve si dhe çdo gje te nevojshme per mbarimin e plote te lyerjes me boje vaji ne menyre perfekte.

6.1.6 Lyerje me boje ECO plastike

Perpara fillimit te punimeve, kontraktori duhet t'i paraqese per aprovim Supervizorit, marken, cilesine dhe katalogun e nuancave te ngjyrave te bojës, qe ai mendon te perdure.

Te gjitha bojrat qe do te perdoren duhet te zgjidhen nga nje prodhues qe ka eksperience ne kete fushe dhe duhet te jene cilesi e pare. Nuk lejohet perzierja e dy llojeve te ndryshme markash boje gjate procesit te punes. Hollimi i bojës duhet te behet vetem sipas udhezimeve te prodhuesit dhe aprovimit te Supervizorit. Perpara fillimit te lyerjes duhet qe te gjitha pajisjet, mobiljet ose objekte te tjera qe ndodhen ne objekt te mbulohen ne menyre qe te mos behen me boje. Eshte e domosdoshme, qe pajisjet ose mobilje qe jane te mbeshtetura ose te varura ne mur te largohen ne menyre qe te behet nje lyerje komplet e objektit. Materiali i pastrimit te njollave duhet te jete me permbajtje te ulet toksikimi. Pastrimi dhe lyerja duhet te kordinohen ne ate menyre qe gjate pastrimit te mos ngrihet pluhur ose papasterti dhe te bjere mbi siperfaqen e sapolyer. Furçat, kovat dhe enet e tjera ku mbahet boja duhet te jene te pastra. Ato duhet te pastrohen shume mire perpara çdo perdorimi sidomos kur duhet te punohet me nje ngjyre tjeter. Gjithashtu, duhet te pastrohen kur mbaron lyerja ne çdo dite.

Personeli qe do te kryeje lyerjen, duhet te jete me eksperience ne kete fushe dhe duhet te zbatoje te gjitha kushtet teknike te lyerjes sipas KTZ dhe STASH.

Ne ndertime te reja para lysterjes duhet te behet pastrimi i siperfaqes qe do te lyhet nga pluhurat dhe te shikohen demtimet e vogla te saj, te behet mbushja e gropave te vogla apo demtimeve te siperfaqes se murit me ane te stukimit me material sintetik dhe berja gati per lysterje.

Para lysterjes duhet te behet mbrojtja e siperfaqeve qe nuk do te lyhen (dyer, dritare, etj) me ane te vendosjes se letrave mbrojtese.

Ne fillim te procesit te lysterjes behet paralysterja e siperfaqeve te pastruara mire me gelqere te holluar (Astari). Ne fillim behet pergatitja e astarit duke perzier 1 kg gelqere me 1 liter uje. Me perzierjen e pergatitur behet paralysterja e siperfaqes vetem me nje dore.

Norma e perdorimit eshte 1 liter gelqere e holluar duhet te perdoret per 2 m² siperfaqe. Me pas vazhdohet me lysterjen me boje si me poshte:

-Behet pergatitja e perzierjes se bojes hidromat te lengshem me uje. Lengu i bojes hollohet me uje ne masen 20 – 30 %. Kesaj perzierje i hidhet pigment derisa te merret ngjyra e deshruar.

- Behet lysterja e siperfaqes. Lysterja behet me dy duar. Norma e perdorimit eshte 1 liter boje hidromat i holluar ne 2.7 – 3 m² siperfaqe (ne varesi te ashpersise se siperfaqes se lyster).

Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori dhe inxhinieri i UNDP per nje aprovim paraprak.

6.1.7 Lysterje me boje vaji

Stukim dhe zmerilim te dritareve prej druri, patinimeve dhe elementeve prej druri, duke perdorur stuko te pershtatshme per pergatitjen e siperfaqeve per lysterjen me boje vaji.

Lysterje me boje vaji sintetik per siperfaqe druri dhe patinime, me dozim per m²: boje vaji 0.2 kg dhe me shume duar per te patur nje mbulim te plote dhe perfekt te siperfaqeve si dhe çdo gje te nevojshme per mbarimin e plote te lysterjes me boje vaji.

Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori dhe inxhinieri i UNDP per nje aprovim paraprak.

6.1.8 Lysterja e siperfaqeve metalike

Stukim dhe zmerilim te elementeve prej hekuri duke perdorur stuko te pershtatshme per pergatitjen e siperfaqeve per lysterjen me boje vaji.

Lysterje e elementeve prej hekuri, me boje te pergatitur fillimisht me nje dore minio plumbi ose antiruxho ose ne formen e vajit sintetik, me dozim per m², 0.080 kg.

Lysterje me boje vaji sintetik per siperfaqe metalike, me dozim per m²: boje vaji 0.2 kg dhe me shume duar per te patur nje mbulim te plote dhe perfekt te siperfaqeve si dhe çdo gje te nevojshme per mbarimin e plote te lysterjes me boje vaji ne menyre perfekte.

Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori dhe inxhinieri i UNDP per nje aprovim paraprak.

6.1.9 Veshja e mureve me pllaka, granil, mermer, gure etj.

Kur flitet per veshjen e mureve me pllaka prej materialeve te ndryshme duhet menduar se per çfare muri behet fjale. Muret duhet te ndahen ne mure te brendshme dhe te jashtme.

Po ashtu, duhet marre parasysh materiali prej se ciles eshte ndertuar muri (kartongips, betoni, mure me tulla, etj.) Sipas materialeve ndertimore te murit dhe siperfaqes se tij metodat e veshjes se murit mund te ndahen po ashtu dy klasa.

Ngjitja e pllakave me llaç (per siperfaqe jo te drejta)

Ngjitja e pllakave me kolle (per siperfaqe te drejta)

Persa i takon ngjitjes te pllakave te tipeve te ndryshme me llaç, duhet qe punimet t'u permbahen ketyre kushteve:

Baza ne te cilen ngjiten pllakat e tipeve te ndryshme, duhet te jete e paster nga pluhuri dhe te jete e qendrueshme.

Perberja e llaçit eshte e njejta siç eshte e pershkruar me lart ne piken 6.2.1. Trashesia e llaçit duhet te jete jo me pak se 15 mm. Llaçi ne raste se perdoret per veshjen e mureve te jashtme duhet te jete rezistent ndaj ngrices dhe koeficienti i marrjes se ujit ne % te jete < 3 %. Po ashtu, llaçi duhet t'i plotesoje kriteret e ruajtjes se ngrohjes dhe te rezistences kunder zerit.

Ngjitja e pllakave me kolle, behet kur siperfaqja e bazes mbajttese eshte e drejte. Kolli vendoset sipas nevojës me nje trashesi prej 3 mm deri ne 15 mm. Te gjitha kriteret e lartpermendura, te cilat duhet t'i plotesoje llaçi, vlejne edhe per kollin.

Mbasi te thahet llaçi ose kolli, duhet qe fugat e planifikuara, te mbushen me nje material te posaçem (bojak).


Fugat neper qoshe dhe lidhje te mureve duhet te mbushen me ndonje mase elastike (si psh silikon).

Per secilen siperfaqe 30 m² te veshur me pllaka te ndryshme, eshte e nevojshme vendosja e fugave levizese.

Kushtet e punimeve me pllaka gres duhet t'u permbahen kushteve te permendura ne pikat 6.2.4 dhe 6.2.5.

Te gjitha pllakat duhet te jene rezistente kunder ngrices si dhe te kene nje durueshmeri te larte.

Ne fotografite e meposhtme mund te shihet se si duhet te vendosen pllakat ne mure.



6.2 RIFINITURAT E DYSHEMEVE

6.2.1 Dysheme me pllaka gres

Klasifikimi i pllakave behet sipas ketyre kriterëve:

- Menyra e dhenies se formes te pllakes
- Marrja e ujit
- Dimensionet e pllakave
- Vetite e siperfaqes
- Veçorite kimike
- Veçorite fizike
- Siguria kunder ngrices
- Pesha/ngarkesa e siperfaqes
- Koefficienti i rreshqitjes

Tabelat e meposhtme pershkruajne disa prej ketyre kriterëve.

Marrja e Ujit ne % te mases se pllakes	
Klasa	Marrja e ujit (E)
I	$E < 3 \%$
II a	$3 \% < E < 6 \%$
II b	$6 \% < E < 10 \%$
III	$E > 10 \%$

Klasat e kerkesave/ngarkimit		
Klasa	Ngarkesa	Zona e perdorimit, psh
I	shume lehte	Dhoma fjetese, Banjo
II	e lehte	Dhoma banuese perveç kuzhines dhe paradhomes
III	e mesme	Dhoma banuese, ballkone, banjo hotelesh
IV	rende	Zyra, paradhoma, dyqane
V	shume e rende	Gastronomi, ndertesa publike

Pllakat duhen zgjedhur per secilin ambient, duke marre parasysh nevojat dhe kriteret, qe ato duhet t'i permbushin. Kriteret dhe tabelat e lartpermendura mund te ndihmojne ne zgjedhjen e tyre.

Per shkolla dhe kopshte, duhet qe pllakat te jene te Klases V , me siperfaqe te ashper, ne menyre qe te sigurojne nje ecje te sigurte pa rreshqitje.

Ne ambientet me lageshtire (WC, banjo e dushe) duhet te vendosen pllaka te klases I, qe e kane koeficientin e marrjes se ujit < 3 %.

Per kete duhet qe perpara fillimit te punes, kontraktori te paraqese tek Supervizori disa shembuj pllakash, se bashku me çertifikaten e tyre te prodhimit dhe vetem pas aprovimit nga ana e tij per shtrimin e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve te dhena nga prodhuesi.

6.2.2 Bordurat vertikale dhe aksesore te tjere

Bordurat vertikale (plintuesat) sipas llojit te shtrimit te dyshemese i kemi:

-Me qeramike, per dysheme me pllaka qeramike. Ato jane me ngjyre te erret ose me te njejten si pllaka qe eshte shtruar dyshemeja, me lartesi 8 cm dhe trashesi 1.5 cm, i vendosur ne veper me llaç ose me kolle. Llaçi per plintuesat duhet te jete me dozim per m²: rere e lare 0.005 m³; çimento 400, 4 kg dhe uje duke perfshire stukimin, pastrimin si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te punes ne menyre te perkryer.

-Me riste druri per dyshemete me parket. Ristelat e drurit jane prej te njejtit material si ai i parketit, montimi duhet te behet me kujdes dhe pas vendosjes, behet lemimi, stukimi dhe llustrimi i derrasave duke perdorur vernik special transparent.

-Me riste PVC per dyshemete me PVC ose linoleum. Menyra e vendosjes duhet te behet sipas rekomandimeve te prodhuesit dhe nga personel me eksperience.

6.2.3 Hidroizilimi i dysHEMEVE ne nderkate

Hidroizilimi i dysHEMEVE ne nderkate behet me shtrese hidro izoluese, mbi sipërfaqe te thare dhe te niveluar mire, duke perfshire pjesen vertikale, trajtuar me nje dore praimer, e perbere nga dy membrana guaine te formuar nga nje shtrese fibre prej leshi xhami e bitumi, me trashesi 3 mm secila, te vendosura ne veper me flake, te kryqezuara mbi sipërfaqe te ashper, te pjerret ose vertikale, duke realizuar mbivendosjen e shtresave (minimumi prej 12 cm) si dhe te ngrihet ne drejtimin vertikal ne muret anesore me min. 10 cm.

6.2.4 DysHEME me parket laminat

DysHEME me parket laminat me karakteristikat si me poshte:

Dimensionet e pllakës së laminatit (mm) : 14 x 192 x 2200 mm

-Materiali : HDF

-Sistemi i montimit : Me Klik

-Klasi : 1-strip

-Modeli I pllakës : Me relief

-Ngjyra e Families : Lis

-Ngjyra e përfunduar : Lis

-Dendësia : HDF

-Me fugë : Po

-I llakuar, në ngjyrë të bardhë

Perfshihet nenshtresa me karakteristikat si me poshte:

-Gjerësia (cm) : 100cm

-Trashësia : 5mm

-Materiali : EPE(Polietilen I ekspanduar)

-Ngjyra : Bardhe

-Funksionalitete : Hidroizolim dhe amortizim zhurme

Perfshihen plintusat me karakteristikat si me poshte:

-Lloji artikullit : Plintus (Batiskop)


-Materiali : MDF

Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori dhe inxhinieri i UNDP per nje aprovim paraprak.

6.3 RIFINITURAT E SHKALLËVE

6.3.1 Shkallë betoni veshur me mermer

Kontraktuesi përpara fillimit të punimeve duhet të paraqesë tek Supervizori një shembull të materialit, që ai do të përdorë dhe çertifikatën e prodhimit, e cila duhet të përmbajë kushtet e mesiperme dhe pas aprovimit të fillojë nga puna.



Vendosja dhe veshja e shkallëve bazamake mermeri duhet të bëhet nga një personel i specializuar dhe konform kushteve teknike.

Përpara fillimit të vendosjes së bazamakeve të mermerit duhet që dyshemeja të pastrohet shumë mirë me ujë me presion, dhe të thahet shumë mirë. Për tu lidhur nevojitet kolla. Kolla duhet të përdoret në masën 400 kg/m^2 .

Trashësia e mermerit në shkallje është 2 cm edhe në pjesën ballore në ngjitje është 2 cm.

6.3.2 Korimanot metalike

Korimanot në ndërtime kanë funksione të ndryshme për t'u plotësuar. Ata duhet të ofrojnë mbrojtje dhe siguri gjatë të ecurit në shkallë. Po ashtu, korimanot luajnë një rol të veçantë në pamjen dhe bukurinë arkitekturore të një ndërtimi.

Duhet që korimanat të jenë të larta 100 cm. Në raste kur gjatësia e shkallëve është më e madhe se 12 m, korimanat duhet të jenë 110 cm të larta. Masa prej 100/110 cm varet edhe prej sipërfaqes së sheshpushimit.

Korimanot montohen në shkallë ose anash shkallëve, të fiksuara mirë që të garantohet stabiliteti dhe qëndrueshmëria e tyre.

Korimanot ose duhen mbuluar me elemente druri, mund të sigurohen me ristela prej druri ose metali. Listelat ndërmjet tyre duhet të jenë me pak se 12 cm.

Në rastet kur shkallët janë më të gjera se 100 cm, atëherë duhet që përveç korimaneve, vendosen në muret e anës tjetër të shkallëve, parmakë për të siguruar një ecje të sigurt. Parmakët nëpër shkallë nuk duhet të jenë më të ulëta se 75 cm dhe jo më të larta se 110 cm. Kur flitet për shkollë, ata të vendosen në një lartësi prej 80 cm. Parmakët duhen larguar nga muret min. 4 cm. Parmakët, preferohet të vendosen prej një materiali dhe forme të tillë, që prekja e tyre të jetë e lehtë

dhe pa dëmtime. Preferohet që parrmakët të prodhohen prej druri, sepse parrmakët prej çeliku të lënë një përshtypje të ftohtë.

Ne fotot e mëposhtme mund të shihet një shembull korimanosh prej metali



6.3.3 Bordurat vertikale dhe aksesore të tjerë

Bordurat vertikale (plintuesat) sipas llojit të shtrimit të shkallëve i kemi:

-Me qeramikë, për shkallë me pllaka qeramike. Ato janë me ngjyrë të errët ose me të njëjtën siç janë pllakat që është veshur shkalla, me lartësi 8 cm dhe trashësi 1.5 cm, i vendosur në vepër me llaç çimento 1 : 2 ose me kollë. Ky proces përfshin stukimin, pastrimin si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e plotë të punës.

-Për shkallët me parket, plintuesat e drurit janë me të njëjtin material si ai i parketit. Montimi duhet të bëhet në mënyrë perfekte dhe pas vendosjes bëhet lemimi, stukimi dhe ilustrimi i dërrasave duke përdorur vernik special transparent.

-Plintuesa PVC për shkallët me PVC ose linoleum. Mënyra e vendosjes duhet të bëhet sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe nga personel me eksperiencë.

-Me mermer, për shkallë me mermer. Plintuesi i mermerit duhet të jetë 8 cm i lartë dhe 2 cm i trashë dhe vendoset në vepër me llaç çimento 1 : 2 ose me kollë.

6.3.4 Shkallet metalike te emergjencës

Sipas normativave, shkallet metalike te emergjences realizohen ne nje distance prej 30 m, duke plotesuar kerkesat per fluksin e njerezve ne rast evakuimi. Gjithashtu vishet me rrjete teli per sigurine e perdoruesve.

Shenime:

Elementet metalik te llogaritur jane s275 (en 1993-1-1)

Ankorimi i kolones ne elementet b/a do te jete me bulona me diameter 20mm bulonat do te vendosen ne elementet b/a vetem me rezine e cila te realizoje lidhjen e tyre me betonin. nuk lejohet vendosja e tyre pa rezine ne asnje menyre.

3. Te gjitha detajet duhet te realizohen sipas vizatimeve

Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori dhe inxhinieri i UNDP per nje aprovim paraprak.

6.3.5 Mbulesa e shkalleve metalike

-Konstruksioni metalik i shkallesdo te realizohet me tuba metalike katerkendore

pa palosje (i derdhur) me spesor 5mm me çelik 275s me karbon dhe i saldueshem

-Bashkimet e profilave metalike (ne forme tubash katerkendore) do te behen gjate gjithë siperfaqes se kontaktit

-Elektodat qe do te perdoren duhet te jene me rezistence te perkoheshme te keputjes >4200kg/cm².(ose elektroda te tipit ti-viis dhe te ngjashme me to.

-Saldimet e elementeve te shkalles te kryhen me gjenerator qe te mos digjen paretet e profilave.lartesia e tegelit te saldimit ne te gjitha rastet duhet te jete 5mm dhe gjatesia e tegelit duhet te jete 80mm.

te gjitha elementet e shkalles pasi te pastrohen nga ndryshku lyhen me nje dore boje kunder ndryshkut dhe dy duar boje vaji, ngjyren e se ciles e percakton arkitekti.

Elementet metalik te llogaritur jane s275 (en 1993-1-1)

Ankorimi i kolones ne elementet b/a do te jete me bulona me diameter 20mm

Bulonat do te vendosen ne elementet b/a vetem me rezine e cila te realizoje lidhjen e tyre me betonin. nuk lejohet vendosja e tyre pa rezine ne asnje menyre.

Te gjitha detajet duhet te realizohen sipas vizatimeve

Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori dhe inxhinieri i UNDP per nje aprovim paraprak.

6.3.6 Zingimi (Galvanizimi)

Zingimi apo galvanizimi i elementeve prej celiku per konstruksione metalike te galvanizuara(zinguara)

Zingimi (galvanizimi) ne te nxehte i elementeve prej celiku eshte i rendesishme te behet sipas standartit ISO.Procesi i zignimit (galvanizimit) duhet te broje konstruksionin metalik nga kushtet atmosferike, kryesisht nga korrezioni , per nje kohe te gjate , me garanci 25 deri 30 vite.

Teknologjia e zingimit ne te nxehte duhet te kete jetegjatesine mbi 25 deri 30 vite,

Te rrise jetegjatesine e konstruksionit , per te mos patur shpenzime ne mirembajtje. Ai duhet te permbushe scilesine e veshjes dhe te jete material pa efekte anesore, kundrejt njerezve.

Galvanizimi duhet te jete material plotesht jo toksik. Siperfaqja e galvanizuar duhet te jete plte dge uniforme, pa te meta, apo pa pjese te pambuluara me zink.

Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori dhe inxhinieri i UNDP per nje aprovim paraprak.

6.4 DYER DHE DRITARE

6.4.1 Dritaret/informacion i pergjithshem/kerkesat

Dritaret janë pjesë e rëndësishme arkitekturore dhe funksionale e ndërtesës. Ato sigurojnë ndriçimin për pjesët e sipërfaqes së brendshme të tyre. Madhësia (kupto dimensionet) e tyre varion, varet nga kompozimi arkitektonik, nga madhësia e sipërfaqes së brendshme dhe kërkesat e tjera të projektuesit. Dritaret duhet të jenë në kuotë 80-90 cm mbi nivelin e dyshemesë; kjo varet edhe nga kërkesat e projektuesit. Dritaret mund të jenë të prodhuara me dru, alumin ose PVC. Pjesët kryesore të dritareve janë: Kasa e dritares që fiksohet në mur me elemente prej hekuri përpara suvatimit. Korniza e dritares do të vidhohet me kasën e saj mbas suvatimit dhe bojatisjes. Në bazë të vizatimit të dritares së treguar në vizatimin teknik, korniza do të pajiset në kasë me mentesha dhe bllokues të tipeve të ndryshme të instaluar në të. Kanatë me xhama të hapësirë, të pajisur me mentesha, doreza të fiksuara dhe me ngjitës transparent silikoni, si dhe me kanata fikse.

6.4.2 Komponentët

Dritare prej druri pishe, të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjtë, do të përbëhen nga: një kasë druri që fiksohet në mur me anë të kunjave prej çeliku përpara suvatimit (gjerësia e kornizës është 4 cm, kurse madhësia sipas kasës së dritares), një kornizë druri (seksion 7x4 cm) që do të vidhohet te kasa e drurit të dhënë më sipër, mbas suvatimit dhe bojatisjes të mureve. Për dritaret e dhëna në vizatimet teknike, korniza do të jetë me mentesha dhe bllokues të ancoruar në të për: dritare me kanatë, dritare me kornizë, dritare për papafingo, dritare për ndriçim. Kanatë me xham të një ose dopio, të hapësirë, të pajisur me mentesha, doreza të fiksuara, panele xhami (4 mm të trashë kur janë transparent, 6 mm kur janë të përforcuar me rrjet teli), të fiksuara me listela të plota druri dhe ngjitës transparent silikoni, bllokues dritarësh me zinxhir ose kompas. Shirita druri të plotë rreth perimetrit të brendshëm të dritares, kur realizohen me paturë nga brenda dhe jashtë, në mungesë të paturës. Bojatisje me bojë vaji ose llak. Dritaret e përbëra me profil duralumini i kemi me: hapje vertikale, hapje horizontale, me rrëshqitje dhe janë të përbëra nga korniza e fiksuar e aluminit (me përmasa 61-90 mm) e cila do të jetë e fiksuar në mur me telajo hekuri të montuara përpara suvatimit. Dritaret janë të pajisura me elemente, që shërbejnë për ancorimin dhe fiksimin e tyre në mur si dhe pjesët e dala, që shërbejnë për rrëshqitjen e kanatit të dritares. Kanati i dritares do të vidhohet në kornizën e dritares mbas punimeve të suvatimit dhe bojatisjes. Ulluqet e mbledhjes së ujit.

Aksesoret:

-Rrota për rrëshqitjen e tyre dhe korniza e grilave

- Përforcues hekuri
- Ulluk prej gome
- Doreza dhe bllokues të ankoruar në të
- Panel me xham të hapësirë (4 mm të trashë kur është transparent, 6 mm kur janë të përforcuar me rrjet teli ose dopio xham). Ato do të fiksohen në kornizat metalike nga listela alumini dhe ngjitës transparent silikoni
- Dritaret PVC do të përbëhen nga:
 - Kasë PVC (me gjerësi 58 mm) do të jetë e fiksuar në mur me fasheta hekuri të përshtatshëm përpara suvatimit. Kornizat PVC do të jenë të pajisura me mentesha dhe bllokuesit e ankoruar. Korniza e dritares PVC do të vidhohet me kasën mbas punimeve të suvatimit dhe bojatisjes
 - Kanatë me xham të hapësirë (4 mm e trashë kur është transparent dhe 6 mm të trashë kur janë të përforcuar me rrjet teli ose dopio xham) do të fiksohen me dritaren në tre pika të ankoruara doreza dhe bllokues.
- Ulluqe të mbledhjes së ujit
- Rrota për rrëshqitjen e tyre dhe korniza e grilave
- Përforcues hekuri i galvanizuar
- Ulluk prej gome
- Doreza dhe bllokues të ankoruar në të
- Ngjitës special leshi për izolimin

6.4.3 Dritare PVC

Furnizimi dhe vendosja e dritareve, siç përshkruhet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori, përbëhen nga material PVC, profilët e të cilit janë sipas standarteve Europiane ISO EN 9002. Ngjyra e dritares do të jetë sipas kërkesës së investitorit. Dritaret rrëshqitëse të PVC duhet të sigurojnë izolim me anë të një gome dhe adaptues në lidhje me kornizën. Seleksionimi i hapësirave të ndryshme lejon përdorim xhami tek ose dopio. Boshllëku brenda xhamit dopio duhet të jetë 20-24 mm.


Sistemet e dritareve PVC duhet të sigurojnë në mënyrë perfekte izolimin nga ajri dhe uji. Ato duhet të sigurojnë një rezistencë nga uji nën 500Pa (të barazvlefshme me shpejtësinë e erës prej 150 km/orë). Testet për këtë duhet të jenë në përputhje me DIN 18055. Koeficienti i konduktivitetit termal duhet të jetë 2.0 W/(m²K), e cila konfirmon standardet Europiane. Në lidhje me izolimin e zërit, dritaret prej PVC duhet të sigurojnë izolim ndaj tingujve deri në shkallën 4 (>40 dB).

Korniza fikse e dritares (ndarjet) do të ketë një dimension 74-116 mm. Ato janë të siguruara me elemente, që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të dritares. Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesoret e saj. Profili i skeletit të dritares do të jetë me përmasën 25 mm, e cila do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur.

Të dyja korniza, fikse ose të lëvizshme, janë projektuar dhe janë ndërtuar me fugë ajri që shërben si thyerje termike. Ato duhet të ofrojnë zbatim të standardeve Europiane të vendosjes së xhamit (xham tek 4-6 mm, xham dopio 20-24 mm, xham tresh 24-28 mm), me kullues uji me mbledhës uji, me inklinim 2 gradë për të siguruar kullim uji perfekt, mbyllje perfekte nga mbyllësit qendror, trashësi muri që arrin EN (t-3.1 mm), izolim për erën dhe shiun, ulluk unik i projektuar për të ndihmuar instalimin e materialeve të gomuar, që shërbejnë për këtë qëllim. Karakteristikat e ngjitësit kundër agjenteve atmosferike duhet të jenë të provuara nga një testim i çertifikuar i bërë nga prodhuesit e kornizës së dritares ose nga prodhuesit e profileve.

Panelet e xhamit (4 mm të trasha kur xhami është transparent dhe 6 mm të trasha kur janë të përforcuara me rrjet teli). Sipas kërkesës së investitorit, dritaret prej PVC mund të jenë me xham dopio (20-24 mm) ose xham tresh (24-28 mm).

Të gjitha punët e lidhura me muraturën dhe të gjitha kërkesat e tjera për kompletimin e punës duhet të bëhen me kujdes. Një model i materialeve të propozuara do të shqyrtohet nga supervizori për një aprovim paraprak.



6.4.4 Dyert - Komponentet

Pjesët përbërëse të çdo lloj dere janë në varësi të llojit të derës dhe materialit që përdoret për prodhimin e tyre. Për secilën prej llojeve të dyerve pjesët përbërëse do të jenë si më poshtë:

Dyert e brendshme prej druri pishe, të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjtë do të përbëhen nga:

-Një kasë e bërë me dru pishe të stazhionuar (me trashësi 4 cm) e trajtuar me një mbulesë mbrojtëse të drunjtë, e dimensionuar sipas gjerësisë së murit, (duke marrë parasysh edhe rritjen prej mbulesës së murit) mbërthehet fuqishëm në mur me vida hekuri dhe me llaç çimento

-Një kasë me binarë pishe, kur dyert janë me dhembë, me përmasa 7 x 5 cm, që mbërthehet në mur me ganxha e me llaç çimento.

-Një kornizë e kasës së drurit që fiksohet tek kasa e drurit e dhënë më sipër pas suvatimit dhe lyerjes. Për dyert e dhëna në Vizatimet Teknike, korniza do të sigurohet me mentesha dhe ankerat e braves për të gjitha llojet e dyerve (Dyër me kasë binarë, dyer pa kasë, me dritë në pjesën e sipërme, etj). Kanatet hapëse me kornizë të drunjtë (tamburate) të bëra me një kornizë druri të fortë (janë me përmasa minimalisht 10 x 4 cm), pjesë horizontale dhe vertikale me të njëjtin seksion çdo 40 cm. Në pjesën e poshtme, paneli më i ulët horizontal do të jetë në një lartësi prej 20 cm nga fundi. Kanatet me dru pishe të stazhionuar (me trashësi 3 cm) dhe të trajtuar me mbulesë mbrojtëse të drunjtë dhe të përforcuar në pjesët e brendshme me struktura druri, të cilat duhet të sigurohen të paktën nga 3 mentesha me gjerësi minimale 16 cm. Një bravë metalike sekrete dhe tre kopje çelësash, doreza dyersh dhe dorezë shtytëse të derës.

Dyert e brendshme prej duralumini do të përbëhen nga:

Kasë fikse në formë profilesh tubolare prej duralumini me thellësi 61-90 mm, të cilat sigurohen me elemente të posaçëm për fiksimin dhe mbërthimin në strukturat e mureve. Profilet fikse të kasës do të jenë me një mbulesë jo më e vogël 25 mm larg murit.

Kanata lëvizëse në formë profili duralumini me një thellësi prej 32 mm dhe një lartësi prej 75 mm i rrafshët ose me zgjidhje ornamentale. Profili duhet të jetë me një hapësirë qendrore që nevojitet për futjen e bashkuesve të qosheve (me hapësirë prej 18 mm për vendosjen e xhamit) dhe rrulat për rrëshqitjet e tyre. Panelet e xhamit të cilat mund të jenë transparente (4 mm trashësia minimale) dhe me rrjete të përforcuar (6 mm trashësia minimale). Gjithashtu mund të përdoren edhe mbulesa prej druri të laminuar MTP me trashësi minimale prej 1 cm.

Një bravë metalike dhe tre kopje çelësash tip sekret, doreza dyersh dhe dorezë shtytëse të derës duhet të vendosen si pjesë përbërëse e derës. Gjithashtu dyert e blinduara mund të jenë të pajisura me një lente xhami për pamje nga të dy anët e derës (syri magjik).

Dyert e jashtme prej druri të fortë pishe, të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjtë do të përbëhen nga:

-Një kasë druri që fiksohet në mur me anë të ganxhave në formë thikë prej çeliku para suvatimit. (Gjerësia e kasës është 3 cm kurse gjerësia e saj sipas madhësisë së murit).
-Kasë binare për dyer me dhembe kur dyert janë me dhembe, me përmasa 7 x 5 cm, që mberthehet në mur me ganxha dhe me llaç çimentoje.


-Një kornizë e kasës së drurit që fiksohet tek kasa e drurit të dhënë më sipër pas suvatimit dhe lyerjes. Për dyert e dhëna në Vizatimet Teknike, korniza do të sigurohet me mentesha dhe ankerat e çelësit gjatë instalimit të pjesëve hapëse të derës.

-Kanatat hapëse me kornizë të drunjtë (tamburate) janë me përmasa minimalisht 10 x 3 cm, pjesë horizontale dhe vertikale me të njëjtin seksion dhe me një lartësi të fundit prej 25 cm e cila është e ndarë me panele prej druri të trajtuara me mbulesa mbrojtëse të drunjtë. Ajo është e kompletuar me mentesha (të paktën 3 për çdo pjesë hapëse).


-Dy mbulesa të drunjta me trashësi 2-3 mm (një nga çdo anë). Përmasat do të jenë në varësi të madhësisë së derës së përcaktuar në projekt. Mbulesat mund të jenë të rrafshëta ose me gdhendje.
-Bravat e sigurisë së lartë së bashku me tre kopje çelësi tip sekret si dhe aksesoret e nevojshëm për instalimin e tyre. Bravat duhet të jenë tip cilindrike, me shasi prej çeliku dhe kasë të fishekut të kyçjes në platë zinku, me cilindra tip kunjash. Bravat duhet të jenë të kyçshme në grup dhe të zbatueshme për çelësat sipas standardit.

-Menteshat (të paktën 3 për çdo pjesë hapëse) në tre pika ankorimi.

-Dorezat përkatëse, me butonin shtytës në dorezën e brendshme që kyç dorezën e jashtme. Dorezat duhet të jenë plotësisht të kthyeshme nga ana e djathtë ose e majtë e derës. Doreza e jashtme duhet të jetë gjithmonë aktive, ndërsa kthimi i dorezës së brendshme ose çelësit të bëjë çkyçjen e fishekut.



6.4.5 Dyert e jashtme metalike zjarrduruere



-Dyert kundra zjarrit jane rezistente ndaj temperaturave dhe tymerave, pjesa e brendshme eshte e perbere nga materiali izolues me mbrojtje te ndryshme dhe me aksesore ne varesi te nevojave te konstruktorit.

-Fleta e deres eshte e perbere nga llamarine e galvanizuar 8/10 me trashesi 60mm. Kasa eshte e perbere nga trashesi llamarine 15/10 e perforcuar ne te katerta anet nga nje element metalike

-Brave standarte me cilinder e pajisur me kapak mbrojtës dhe shtrese celiku

-Dera eshte e pajisur me system antipanik I cili realizohet nga nje doreze me ulje e ngritje vetembyllese.

Aksesoret e deres:

-Mentesha vendosen dy cope per secilen flete.

-Mentesha perbehet: pjesa e poshte me nje vide te regjistrueshme, pjesa e sipërme vjen ne forme sferike e cila ka aftesi mbajtese deri ne 160kg dhe me nje numer rrotullimesh 2000 cikle e pershtatshme per dera kunder zjarrit.

-Kunja e sigurise vendoset ne pjesen anesore vertikale te deres.

-Brave me cilinder dhe kycje qendrore sipas standarteve europiane CE EN12209 Doreza eshte rezistente ndaj zjarrit me mbulesa celiku.

-Pjastrine metalike e patentuar sipas cilindrit.

-Mbulesa e dorezes eshte e perbere me veshje plastike.

-Shul per mbylljen e kanatit fiks funksionon me ane ten je ganxhe nepermjet se ciles kryejme hapje dhe mbylljen e kanatit fiks.

-Udhezuesi i siperm I kunjit te shulit ndihmon per futjen e shulit ne Kasen e deres.

Udhezuesi I poshtem I kunjit te shulit ndihmon per futjen e shulit ne dysHEME e cila ndihmohet nga nje kapak bronxi I vendosur ne dysHEME

Amortizatori I deres eshte nje pajisje qe sherben per rimbylljen e deres. Pajisja permban dy rregullatore, njera sherben per rregullimin e fuqise dhe tjetri per rregullimin e shpejtesise.

Doreza antipanik ka keto karakteristika:

Mundesohet I kombinuar me celik inoksi me leve alumini te kromuar

Mundesit kycje nga nje ane dhe hapje nga doreza antipanik nga ana tjeter

E pershtatshme per dere me hapje majtas ose djathtas

Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori dhe inxhinieri i UNDP per nje aprovim paraprak.

6.4.6 Dyert - Vendosja në vepër

Vendosja e dyerve në vepër duhet të bëhet sipas kushteve teknike për montimin e tyre të dhëna në standardet shtetërore. Mënyra e vendosjes së tyre është në varësi të llojit të derës dhe materialit që përdoret për prodhimin e tyre. Për secilin prej llojeve të dyerve vendosja në vepër duhet të bëhet si më poshtë.

Dyert e brendshme prej druri pishe, të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjte do të instalohen sipas kësaj rradhe pune:

-Një kasë dërrase e bërë me dru pishe të stazhionuar (me trashësi 4 cm) ose kasë binare 7 x 5 cm, e dimensionuar sipas gjerësisë së murit, (duke marrë parasysh edhe rritjen prej mbulesës së murit) mbyrthehet fuqishëm në mur me ganxha ose me vida hekuri (çdo një metër) dhe me llaç çimento;

-Një kornizë e kasës së drurit fiksohet tek kasa e drurit pas suvatimit dhe lyerjes. Korniza do të sigurohet me mentesha dhe ankerat e çelësit për të gjitha llojet e dyerve (dyer me kasë dërrase, binare me dyer pa kasë, me dritë në pjesën e sipërme, etj). Në këtë kornizë do të fiksohen mbulesat mbrojtëse të drunjta dhe shiritat e sigurisë me dru të fortë të siguruar nga një bravë sigurie. Trashësia totale e dyerve do të jetë 4,5 cm minimalisht.

-Një bravë metalike dhe tre kopje çelësash tip sekret si dhe doreza e dyerve.

Instalimi i Dyerve te brendshme prej duralumini:

Instalimi i dyerve të brendshme prej duralumini të dhëna në Vizatimet Teknike, dimensionet e të cilave jepen nga Porositesi, do të bëhen me anë të montimit të profileve të duralumin (korniza fikse dhe korniza lëvizëse) sipas standartit European EN 573 - 3 dhe të lyer, kur të jenë përfunduar suvatimet e shpatullave ose vendosur veshjet me pllaka mermer etj. Të dyja pjesët (fikse dhe lëvizëse) duhet të jenë të projektuara për të bërë dyer që thyejnë nxehtësinë dhe të jenë me dy profile duralumini, të cilat bashkohen me një tjetër me anë të dy shiritave hidroizolues gome ose me material plastik.

Një kasë solide duhet të fiksohet me kujdes me anë të vidave të hekurit në mur dhe në brendësi të llaçit të çimentos. Fiksimi duhet të ketë një distancë prej qosheve jo më tepër se 150 mm dhe ndërmjet pjesëve fiksuese jo më tepër se 800 mm. Kasat fikse të dyerve do të bashkohen me kornizat pasi të ketë përfunduar suvatimi dhe lyerja. Mbushja e boshllëqeve bëhet me material plastik elastik dhe pastaj bëhet patinimi i tyre duke përdorur fino patinimi.

Kanatat e xhamit do të vendosen tek korniza e dyerve dhe do të mbyrthehen në tre pika ankorimi me mentesha. Gjithashtu do të vendosen edhe bravat dhe dorezat metalike ose duralumini. Mbushja ndërmjet kasës dhe murit të ndërtesës do të bëhet duke përdorur material plastiko-elastik pasi të jetë mbushur me materialin e duhur hidroizolues. Ndërmjet mbështetjes së kasës të brendshme dhe pjesës së jashtme prej duralumini është e preferueshme të mbahet një tolerancë e instalimit prej 6 mm, duke e konsideruar hapësirën e fiksimit rreth 2 mm.

Dyert e jashtme metalike të blinduara do të instalohen në përputhje me kërkesat e standartit shtetëror për montimin e tyre si më poshtë:

Një kasë metalike fiksohet në mur me anë të ganxhave të çelikut ose me anë të betonimit në mur para suvatimit. Kasë metalike duhet të lyhet me bojë metalike kundra korrozionit para se të montohet në objekt. Madhësia e saj është në varësi të trashësisë së murit ku do të vendoset. Trashësia e fletëve të çelikut të kasës duhet të jetë minimalisht 1,5 mm. Gjerësia e pjesëve anësore të kasës duhet të jetë minimalisht 10 cm kurse gjerësia e pjesës qendrore është në varësi të gjerësisë së murit dhe llojit të derës. Fletët e çelikut të kasës duhet të kthehen ose të saldohen sipas Kushteve Teknike të Zbatimit.

Kanati i derës së blinduar fiksohet tek kasa pas suvatimit dhe lyerjes. Kanati do të sigurohet me mentesha dhe ankerat e çelësit gjatë instalimit të pjesëve hapëse të derës. Në këtë kanat do të vendosen elementët e sigurisë si dhe të gjithë aksesorët e nevojshëm të saj.

Kanati i derës ka në brendësi (ndërmjet fletëve të llamarinës) shufrat metalike të sigurisë me diametër minimal prej 16 mm të cilat vendosen në distancë midis tyre minimalisht 30 cm. Ato duhet të saldohen në kornizën metalike të kanatit të derës së blinduar.

Ndërmjet shufrave vendosen materiale mbrojtëse termoizoluese polisteroli me trashësi minimale $t = 3$ cm. Vendosja e termoizoluesit duhet të bëhet pas saldimit të shufrave metalike dhe përfundimit të punimeve të prodhimit të kornizës metalike të derës.

Dera metalike mund të jetë veshur me llamarinë me trashësi jo më të vogël se 2 mm si dhe mund të vendosen mbi të edhe mbulesa të drunjtë me trashësi 2-3 mm (një nga çdo anë), që vendosen mbi secilën prej faqeve prej llamarinë çeliku, e cila është salduar tek shufrat e sigurisë me përmasa të madhësisë së derës.

Bravat e sigurisë së lartë së bashku me çelësat sekret montohen në kornizën e derës me anë të vidave prej çeliku.

Dyert e blinduara duhet të jenë të kompletuara me mentesha (të paktën 3 për çdo pjesë hapëse) në tre pika ankorimi.

Kasa e derës duhet të lyhet me bojë të emaluar, transparente para fiksimit të derës.

Kur është veshur me fletë druri mbyllja bëhet me shirita solide druri të cilat vendosen përreth perimetrit të derës, punë e cila duhet të bëhet me cilësi të lartë sipas të gjitha kërkesave.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e dyerve në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike.

6.4.7 Kasat e dyerve

Kasat e dyerve janë në varësi të llojit të derës dhe materialit që përdoret për prodhimin e tyre. Ato mund të jenë metalike, druri ose alumini. Për secilin prej llojeve të dyerve kasat përkatëse do jenë si më poshtë:

Në dyert e brendshme prej druri pishe, të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjte vendosen në kasa të bëra me dru pishe binare 7 x 5 cm dhe dërrase të stazhionuar (me trashësi 4 cm), e dimensionuar sipas gjerësisë së murit, (duke marrë parasysh edhe rritjen prej mbulesës së murit). Kasa mbërthehet fuqishëm në mur me vida ose ganxha hekuri dhe mbulohen me llaç çimento.

Në dyert e brendshme prej alumini montohen në kasa fikse në formë profilesh tubolare prej duralumini me përmasa 61-90 mm, të cilat sigurohen me elemente të posaçëm për fiksimin dhe mbërthimin në strukturat e mureve. Profilet fikse të kasës do të jenë me një mbulesë që është 25 mm brenda murit.

Në dyert e jashtme metalike do të montohen në një kasë metalike që fiksohet në mur me anë të ganxhave të çelikut të betonimit në mur para suvatimit. Kasa metalike duhet të jetë e lyer me bojë metalike kundra korrozionit para se të montohet në objekt. Madhësia e saj është në varësi të trashësisë së murit ku do të vendoset. Trashësia e fletëve të çelikut të kasës duhet të jetë minimalisht 1,5 mm. Gjerësia e pjesëve anësore të kasës duhet të jetë minimalisht 10 cm kurse gjerësia është në varësi të gjerësisë së murit dhe llojit të derës. Fletët e çelikut të kasës duhet të kthehen ose të saldohen sipas Kushteve Teknike të Zbatimit. Kasa duhet të lyhet me bojë të emaluar transparente para fiksimit të derës.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e kasave të dyerve në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit.

6.4.8 Dyer te brendshme

Dyer të brendshme me dru të fortë

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme prej druri pishe dhe të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjte, dimensionet e të cilave jepen nga Porositësi, përbëhet nga:

-Një kasë e bërë me dru pishe të stazhionuar (me trashësi 4 cm) e trajtuar me një mbulesë mbrojtëse të drunjte, e dimensionuar sipas gjerësisë së murit, (duke marrë parasysh edhe rritjen prej mbulesës së murit) mbërthehet fuqishëm në mur me vida hekuri dhe me llaç çimento;

-Një kornizë e kasës së drurit që fiksohet tek kasa e drurit e dhënë më sipër pas suvatimit dhe lyerjes. Për dyert e dhëna në Vizatimet Teknike, korniza do të sigurohet me mentesha dhe ankerat e çelësit për të gjitha llojet e dyerve (dyer me kasë, dyer pa kasë, me dritë në pjesën e sipërme, etj).

Pjesët hapëse të dyerve i kemi disa tipe: tamburate dhe me dru masiv. Ato me tamburato kanë kornizë druri të fortë (me përmasa minimalisht 10 x 4 cm), pjesë të vendosura horizontalisht dhe vertikalisht me të njëjtin seksion çdo 40 cm. Në pjesën e poshtme, paneli më i ulët horizontal do të jetë në një lartësi 20 cm nga fundi. Pjesët me dru masiv pishe të stazhionuar (me trashësi 3 cm) dhe e trajtuar me mbulesë mbrojtëse të drunjtë dhe të përforcuar në pjesët e brendshme me struktura druri, të cilat duhet të sigurohen të paktën nga 3 mentesha me gjatësi minimale prej 16 cm.

-Një bravë metalike dhe tre kopje çelësash tip sekrete, doreza dyersh dhe dorezë shtytëse të derës.

Mbyllja bëhet me shirita solide druri, të cilat vendosen përreth perimetrit të derës me anë të thumbave, punë që duhet të bëhet me cilësi, sipas të gjitha kërkesave të duhura teknike që duhen për kompletimin e kësaj pune.

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme prej druri pishe me panel xhami është njëlloj si më sipër dhe sipas përshkrimeve të dhëna në Vizatimet Teknike, por me ndryshimin se në vend të paneleve të drunjtë vendosen panele xhami. Kanatat e xhamit mund të jenë transparente (4 mm trashësia minimale) dhe me rrjetë të përforcuar (6 mm trashësia minimale). Kanatat e xhamit do të instalohen pas lyerjes së derës me bojë.

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme prej druri pishe pranë e kondicionerit është njëlloj si më sipër, por me ndryshimin se në pjesën e poshtme të panelit të drunjtë vendoset një pjesë duralumini, sipas kërkesave të punës të sistemit të kondicionimit.

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme prej druri pishe me dritë në lartësi është njëlloj si më sipër, por me ndryshimin se në vend të kanatave të drunjtë apo të xhamta në pjesën e sipërme të derës, sipas Vizatimit Teknik, vendosen pjesë xhami me hapje dhe me xham me rrjetë të përforcuar.

Një model i zërave të mësipërm të propozuar, duhet t'i jepet Supervizorit për aprovim paraprak.

Dyer të brendshme "Me palcë ndriçuese"

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme prej druri pishë me "palcë ndriçuese", dimensionet e të cilave jepen nga Porositësi, përbëhet nga:

-Një kasë e bërë me dru pishë të stazhionuar (me trashësi 4 cm) e trajtuar me një mbulesë mbrojtëse të drunjtë, e dimensionuar sipas gjerësisë së murit (duke marrë parasysh edhe rritjen prej mbulesës së murit), mbërthehet fuqishëm në mur me vida hekuri (çdo një metër) dhe me llaç çimento;

-Një kornizë e kasës së drurit që fiksohet, tek kasa e drurit e dhënë më sipër, pas suvatimit dhe lyerjes. Për dyert e dhëna në Vizatimet Teknike, korniza do të sigurohet me mente sha dhe ankerat e çelësit për të gjitha llojet e dyerve (dyer me kasë, dyer pa kasë, me dritë në pjesën e sipërme, etj).

-Kanatat hapëse të dyerve të bëra me melaminë të laminuar dhe shirita ndërmjet druri të fortë, të siguruar nga një bravë sigurie. Dy panelet e melaminës do të jenë 8 mm të trasha dhe të gjitha kufijtë e derës do të mbrohen nga një shirit druri i fortë. Trashësia totale e dyerve do të jetë 4,5 cm minimalisht.

-Një bravë metalike dhe tre kopje çelësash tip sekrete, doreza dyersh dhe dorezë shtytëse të derës.

Mbyllja bëhet me shirita solide druri, të cilat vendosen përreth perimetrit të derës me anë të thumbave, punë që duhet të bëhet me cilësi, sipas të gjitha kërkesave të dhura teknike që duhen për kompletimin e kësaj pune.

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme "me palcë ndriçuese" me panel xhami është njëloj si më sipër dhe sipas përshkrimeve të dhëna në Vizatimet Teknike, por me ndryshimin se në vend të paneleve të drunjta vendosen panele xhami. Panelet e xhamit mund të jenë transparente (4 mm trashësia minimale) dhe me rrjetë të përforcuar (6 mm trashësia minimale). Kanatet e xhamit do të instalohen pas lysterjes së derës me bojë të emaluar dhe vendosjes së tyre.

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme "me palcë ndriçuese" me pjesët e kondicionerit është njëloj si më sipër, por me ndryshimin se në pjesën e poshtme të panelit vendoset një pjesë duralumini, sipas kërkesave të punës të sistemit të kondicionimit.

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme të mësipërme, por me dritë në lartësi, ka ndryshimin se në vend të paneleve të mësipërme në pjesën e sipërme të derës, sipas Vizatimit Teknik, vendosen pjesë xhami me hapje dhe me xham me rrjetë të përforcuar. Një shembull i zërave të mësipërm të propozuar duhet t'i jepet Supervizorit për aprovim paraprak.

Dyer të brendshme me profile duralumini

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme prej duralumini të dhëna në Vizatimet Teknike, dimensionet e të cilave jepen nga Porositësi, do të bëhen nga profile duralumini sipas standardit European EN 573 - 3 dhe të lyster më parë. Ngjyra do të jetë sipas kërkesës së Investitorit.

Profilet e kornizave fikse do të kenë përmasa 61-90 mm. Ato sigurohen me elementë të posaçëm për fiksimin dhe mbërthimin në strukturat e mureve, mure të përshtatshme për këto mbërthime, duke lejuar rrëshqitjen e këtyre pjesëve. Profili është tubolar me qëllim që të mbledhë të gjithë aksesorët e duhur. Profilet e kasës do të jenë me një mbulesë që është 25 mm në mur. Profili lëvizës i kasës ka një thellësi prej 32 mm dhe një lartësi prej 75 mm, i rrafshët ose me zgjidhje ornamentale.

Të dyja pjesët (fikse dhe lëvizëse) duhet të jenë të projektuara për të bërë dyer që thyejnë nxehtësinë dhe të jenë me dy profile duralumini të cilat bashkohen me një tjetër me anë të dy shiritave hidroizolues të bërë me materiale plastikë. Thyerja e nxehtësisë bëhet me anë të futjes së shiritave poliamidi me trashësi 2 mm dhe gjatësi 15 mm të përforcuar me fiber xhami. Profili duhet të jetë me një pjesë qendrore që nevojitet për futjen e bashkuesve të qosheve (me hapësirë prej 18 mm për vendosjen e xhamit) dhe trollet për rrëshqitjet e tyre.

Mbushja e boshllëqeve bëhet me furçë duke përdorur fino patinimi. Karakteristikat e kësaj mbushjeje për mbrojtjen nga agjentë atmosferikë duhet të jenë të vërtetuara me anë të certifikatave të testimi të dhëna nga prodhuesit e profileve të dritareve të duraluminit. Profilet e duraluminit duhet të lyhen gjatë një procesi me pjekje. Temperatura e pjekjes nuk duhet të jetë më tepër se 180 gradë Celsius, koha e pjekjes jo më pak se 15 minuta. Trashësia e shtresës së lyster

duhet të jetë të paktën 45 µm. Boja e përdorur duhet të jetë e përbërë nga rrëzinë akrilike me cilësi ose poliestër lineare.

Një kasë solide duhet të fiksohet me kujdes me anë të vidave të hekurit në mur dhe në brendësi të llaçit të çimentos. Fiksimi duhet të ketë një distancë prej qosheve jo më tepër se 150 mm dhe ndërmjet pjesëve fiksuese jo më tepër se 800 mm. Kasat fikse të dyerve do të bashkohen me kornizat pasi të ketë përfunduar suvatimi dhe lyerja. Kanatat e xhamit do të vendosen tek korniza e dyerve dhe do të mbërthehen në tre pika ankorimi. Gjithashtu do të vendosen edhe bravat dhe dorezat. Mbushja ndërmjet kasës dhe murit të ndërtesës do të bëhet duke përdorur material plastiko-elastik, pasi të jetë mbushur me materialin e duhur hidroizolues. Ndërmjet mbështetjes të kasës së brendshme prej hekuri dhe pjesës së jashtme prej duralumini, është e preferueshme të mbahet një tolerancë e instalimit prej 6 mm, duke e konsideruar hapësirën e fiksimit rreth 2 mm. Toleranca e trashësisë duhet të jetë sipas EN 755 – 9.

Dyert hapëse bëhen me profile standard duralumini dhe me pjesë të brendshme prej druri të laminuar me trashësi minimale prej 100 mm.

Një bravë metalike dhe tre kopje çelësash tip sekrete, doreza dyersh dhe dorezë shtytëse të derës duhet të vendosen si pjesë përbërëse e derës.

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme prej duralumini me kanat xhami është njëlloj si më sipër dhe sipas përshkrimeve të dhëna në Vizatimet Teknike, por me ndryshimin se në vend të paneleve melamine vendosen panele xhami. Panelet e xhamit mund të jenë transparente (4 mm trashësia minimale) dhe me rrjetë të perforuar (6 mm trashësia minimale).

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme prej duralumini pranë kondicionerit është njëlloj si më sipër, por me ndryshimin se në pjesën e poshtme të panelit të derës vendoset një pjesë duralumini, sipas kërkesave të punës të sistemit të kondicionimit.

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme duralumini me dritë në lartësi është njëlloj si më sipër, por me ndryshimin në pjesën e sipërme të derës, sipas Vizatimit Teknik, vendosen pjesë xhami me hapje dhe me xham me rrjetë të perforuar.

Një model të zërave të mësipërm të propozuar, duhet t'i jepet Supervizorit për aprovimin paraprak.

6.4.9 Dyer te jashtme

Dyer të jashtme druri

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të jashtme prej druri pishe dhe të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjte përbëhet nga:

-Një kasë druri që fiksohet në mur me anë të kunjave çeliku përpara suvatimit. (Gjerësia e kornizës është 4 cm, kurse madhësia sipas kasës së derës)

-Panelet hapëse me kornizë të drunjte (tamburate) janë me përmasa minimalisht 10 x 5 cm, pjesë horizontale dhe vertikale me të njëjtin seksion dhe me një lartësi të fundit prej 25 cm, e cila është e

ndarë me panele prej druri të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjtë. Ajo është e kompletuar me mentesha (të paktën 3 për çdo pjesë hapëse), tre pika ankorimi, si dhe tre kopje të çelësit të hapje-mbylljes. Gjithashtu, është e pajisur edhe me dorezën përkatëse.

-Mbyllja bëhet me shirita solide druri, të cilat vendosen përreth perimetrit të derës me anë të thumbave, punë e cila duhet të bëhet me cilësi, sipas të gjitha kërkesave të duhura teknike që duhen për kompletimin e kësaj pune.

Kasa ku vendosen panelet hapëse duhet të lyhet me bojë të emaluar transparente përpara fiksimit të derës. Një model i zërit të propozuar, duhet t'i jepet Supervizorit për aprovim paraprak.

Dyer të jashtme druri me panel xhami

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të jashtme prej druri pishe me panel xhami është njëlloj si më sipër, por me ndryshimin se në vend të paneleve të drunjtë vendosen panele xhami sipas kërkesës (4 mm trashësi kur duhet transparencë dhe 6 mm trashësi kur kërkohet me rrjetë të forcuar). Ajo fiksohet me kunjat druri të fortë dhe me mastiç silikoni transparent. Panelet e xhamit do të instalohen pas lyerjes së derës me bojë të emaluar dhe vendosjes së tyre. Një model i zërit të propozuar, duhet t'i jepet Supervizorit për aprovim paraprak.

Dyer të jashtme druri me dritë në lartësi

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të jashtme prej druri pishe me dritë në lartësi është njëlloj si më sipër, por me ndryshimin se në vend të paneleve të drunjtë apo të xhamit në pjesën e sipërme të derës vendosen pjesë fikse xhami, në kornizë të drunjtë, duke përfshirë mentesha, kunjat dhe të gjitha punimet e tjera që kërkohen për përfundimin e vendosjes së dyerve, sipas kërkesave të duhura për të kompletuar një punë me cilësi të lartë. Pjesa fikse e xhamit do të instalohet pas lyerjes së derës me bojë të emaluar dhe vendosjes së tyre. Një model i zërit të propozuar duhet t'i jepet Supervizorit për aprovim paraprak.

6.4.10 Dorezat

Të përgjithshme

Dorezat e dyerve / dritareve duhet të jenë të njëjta në të gjitha ambientet e shkollës. Në mënyrë që të plotësohet ky kusht duhet që këto doreza të jenë të tilla, që mund të përdoren si në ambientet e thata ashtu edhe në ato me lagështirë.

Kriteret që duhet të plotësojnë

Dorezat e dyerve dhe të dritareve duhet të jenë:

Të kenë shkallë të lartë sigurie në përdorim (jetëgjatësi gjatë përdorimit të shpeshtë)


Jetëgjatësia e dorezave varet kryesisht nga materialet me të cilat janë prodhuar ato, si dhe nga mënyra e lidhjes së dorezës me elementët e tjerë (cilindrit, braves etj.)

Për këtë sugjerohet që të zgjidhen doreza, të cilat janë prodhuar me material të fortë dhe rezistent p.sh. Çelik jo i ndryshkshëm

Të garantojnë rezistencë momentale ndaj ngarkesave (të sigurojë qëndrueshmëri në rastet e keq-përdorimit: varjet, goditjet, përplasjet)

Duke patur parasysh përdoruesit e këtyre dorezave, duhet që ato të kenë koeficientë të lartë qëndrueshmërie në ngarkesë, pra duhet t'i rezistojnë peshës së fëmijëve tek doreza. Sipas normave Evropiane (DIN) ekzistojnë dy klasa qëndrueshmërie. Tabela e mëposhtme paraqet ngarkesat për këto dy klasa nga të cilat për rastin tonë do të sugjerohet klasën ES2.

Veçorite	Kerkesat	
	ES1	ES2
Ngarkesa ne qender	25 kN	40 kN
Ngarkesa ne Cilinder	15 kN	17 kN
Ngarkesa e njeanshme	15 kN	20 kN



Të mos shkaktojnë dëmtime fizike gjatë përdorimit.

Përsa i takon kësaj pike duhet të themi se meqëse këto doreza do të montohen në dyert dhe dritaret e kopshteve, shkolla fillore, tetëvjeçare e të mesme, pra do të përdoren nga fëmijë duhet që dorezat të zgjidhen të tilla, që të mos shkaktojnë dëme fizike tek fëmijët. Në rast modeli i dorezës i paraqitur në tabelën e mëposhtme i plotëson të gjitha kushtet, meqëse ajo përdoret më shumë në ambientet e brendshme dhe është më e sigurtë, për rastet e largimit të emergjencës, pasi është në formë rrethore.

Montimi

Përpara se të bëhet montimi i dorezave ato duhet t'i tregohen supervizorit dhe vetëm pas miratimit të tij të bëhet montimi. Montimi i dorezave duhet të bëhet i tillë që të plotësojë kriteret e lartpërmendura. Në montimin e dorezës duhet të zbatohen me korrektësi të plotë udhëzimet e dhëna nga ana e prodhuesit të saj.

6.5 RIFINITURAT E TAVANEVE

6.5.1 Tavan i varur me pllaka gipsi

-Specifikimi i tavaneve:

Tavanet e varur zakonisht janë të ndarë me panele dhe perimetri është i barabartë ose më i madh në gjerësi sesa $\frac{1}{2}$ e modulit të pllakës së plotë. Këto panele duhet të priten në madhësi të përshtatshme me skeletin përbërës të tavanit të varur. Drejtimi i instalimit duhet të jetë i treguar mbi planet e tavanit.

-Kushtet e montimit:

Kërkesa stabile për instalimin e tavanit të varur në objekt është vetëm nëse ndërtesa është plotësisht e thatë (nuk ka lagështi), kushtet e motit janë të mira, ndërtesa ka ndriçim të plotë, si dhe gjatë muajve të stinës së dimrit është siguruar tharja nga ngrohtësia. Ajrosja e mirë duhet të bëhet për të reduktuar ngrohjen e tepërt, të krijuar gjatë ditës nga nxehtësia e solarit. Kontrolli i ajrosjes duhet të përdoret për të shpërndarë lagështinë në ajër. Tharësi mekanik i ajrit është projektuar për të reduktuar përmbajtjen e lagështisë në ajër brenda ndërtesës. Djegia direkte e lëndëve djegëse fosile si gazi butan ose propan nuk është e rekomanduar, sepse këto lëshojnë afërsisht 2.2 litra ujë për çdo 500 gram djegie të lëndës djegëse. Është më mirë të përdoret ngrohës elektrik ose sistem indirekt me ajër të ngrohtë. Tharësi duhet të përdoret vetëm për të reduktuar përqindjen e RH të krijuar nga lagështia e emetuar nga struktura.

-Mirëmbajtja dhe pastrimi:

Mirëmbajtja e tavanit të varur duhet të kryhet vetëm pas efektit të krijuar nga defektet që shfaqen gjatë punimeve të tilla instalimi, si dhe dëmtimet (në veçanti zjarri dhe performanca akustike), të jenë plotësisht të vlerësuara. Në raste të tilla, bëhet konsultimi me teknikët.

Sidoqoftë, kur mirëmbajtja është e nevojshme, duhet të sigurohet vazhdimësi e lartë në funksionim.

-Pastrimi:

Së pari hiqet pluhuri nga tavani duke përdorur një furçë të butë. Njollat, shkrimet, etj., duhet të hiqen me një gomë fshirëse të zakonshme. Një metodë tjetër alternative pastrimi është me rrobë të lagur ose sfungjer të futur në ujë me përbërje sapuni ose detergjent të holluar. Sfungjeri duhet të përmbajë sa më pak ujë që të jetë e mundur. Tavani nuk duhet të jetë i lagur.

Pas larjes, pjesët e tavanit me sapun duhet të fshihen me një copë ose sfungjer të lagur në ujë të pastër.

Pastrues abrazivë nuk duhet të përdoren.

Rekomandohen këto kimikate:

-*Ceramaguard ceilings* nuk janë të ndikuar nga lagështia.

-*Parafon Hygien dhe ML Bio Board* mund të lahen shpejt dhe janë rezistentë ndaj detergjentëve për myk dhe kimikateve germicide.

Specialisti duhet të kontraktojë me shërbimin e pastrimit për zgjedhjen e kimikateve të përshtatshme për përdorim. Në vendet ku përdoren këto metoda pastrimi, është e rekomandueshme që të bëhet një provë paraprake.

Është në të mirë të punës që kontakti për kryerjen e këtyre provave të bëhet në një zonë jo-kritike të ndërtesës.

6.6 RIFINITURAT E TAVANEVE

6.6.1 Mbrojtëset e këndeve të mureve

Furnizimi dhe vendosja e mbrojtëseve të këndeve të mureve përshkruhet në specifikimet teknike të dhëna nga kontraktori. Ato përbëhen nga material alumini, profil L, të cilat janë sipas standardeve evropiane dhe janë profile të lyera përpara se të vendosen në objekt. Ngjyra e tyre do të jetë sipas kërkesës së investitorit (zakonisht përdoret ngjyra e bardhë e emaluar).

Mbrojtëset e këndeve të mureve kanë përmasa: gjatësi 150 cm x 2 cm x 2 cm dhe janë në formën e profilit L të zgjedhur.

Trashësia e profilit është 2 mm. Profili, në të dy anët e tij, mund të jetë me vrima me $d = 6-8$ mm, të cilat duhen për fiksimin sa më të mirë të mbrojtëses në mur. Në këtë rast, mbrojtësja vendoset në mur përpara se të bëhet patinimi. Gjatë patinimit, të dy anët e profilit të saj mbulohen.

Seksionet e profilit të aluminit do të jenë të lyera me anë të procesit të pjekjes lacquering.

Ngjitja ndërmjet mbrojtëses dhe murit do të bëhet duke përdorur materiale elastiko-plastike të posaçëm për këto lloj profilesh alumini. Ngjitja bëhet me anë të një furçe të ashpër, pasi të jetë bërë mbyllja dhe suvatimi i çdo të çare të murit. Karakteristikat e ngjitësit kundër agjentëve atmosferikë duhet të jenë të provuara dhe të çertifikuara nga testimi që prodhuesit kryejnë për këto mbrojtëse.

Për mbrojtjen e këndeve të mureve mund të përdoren edhe mbrojtëse prej druri pishe, të mbrojtura me një mbrojtëse speciale druri (llak për materiale druri). Në këtë rast, trashësia e profilit të tyre duhet të jetë 3–5 mm, kurse përmasat do të jenë 150 x 3 x 3 cm. Bashkimi i dy shiritave prej druri bëhet me anë të thumbave të vegjël, vendi i të cilëve stukohet më pas. Në pjesën e bashkimit të tyre, shiritat prej druri duhet të priten me kënd 45 gradë.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit. Një model i mbrojtëses së këndeve të mureve do t'i jepet për shqyrtim supervisorit për një aprovim, përpara se të vendoset në objekt. Me kërkesë të veçantë të Supervisorit, mbrojtëset këndore mund të jenë edhe me lartësi deri në 2 m.

6.6.2 Vetrata dopio xham me skelet PVC

Vetrata:

Furnizimi dhe vendosja e vetratave prej xhami, siç përshkruhet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori, përbëhen nga material alumini, profilet e të cilit janë sipas standardeve Evropiane dhe janë profile të lyera përpara se të vendosen në objekt. Ngjyra e tyre do të jetë sipas kërkesës së investitorit.

Korniza fikse e vetratave do të ketë një dimension që do të përcaktohet nga vizatimet teknike. Ato kanë elemente që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin e vetratave në strukturat e murit. Forma e profilit të vetratave është tubolare, me qëllim që të mbajë gjithë aksesoret e saj. Profili i skeletit të vetratës do të jetë me dimensione jo më pak se 25 mm, në mënyrë që profili kryesor që do të fiksohet në mur të jetë i zbuluar.

Profilet e kornizave të lëvizshme kanë dimension: thellësia 32 mm dhe lartësia 75 mm, të sheshta ose me zgjedhje ornamentale. Të dyja, si kornizat fikse ashtu edhe ato të lëvizshme, janë projektuar dhe prodhuar me dy profile alumini, të cilat janë bashkuar me njëra-tjetrën dhe kanë një fugë ajri që shërben si thyerje termike. Ato janë të izoluar me një material plastik me trashësi 15 mm.

Fiksimi i vetratave me kontrotelajo solide do të bëhet me kujdes, me fashat e hekurit për tek muri me llaç (me tapa me fileto). Vendosja (fiksimi i vetratës) duhet të ketë një distancë të preferueshme nga qosheja e kornizës, jo më shumë se 150 mm, dhe midis tyre jo më shumë se 800 mm. Skeleti i fiksuar i vetratës do të vidhohet me telajon pas përfundimit të suvatimit dhe bojatisjes. Kanate të hapshëm me xhama do të vendosen me mentesha në skeletin e vetratës dhe do të pajisen me bravë mbyllëse dhe dorezë.

Ngjitja dhe mbushja midis kasave dhe përbërjes së ndërtesës do të kryhet duke përdorur materiale elastiko-plastike, mbas mbylljes së çdo të çare me materiale izoluese. Midis brendësisë së kornizës suportuese të hekurit dhe kornizës së jashtme fikse të aluminit është e preferueshme të ruhet një tolerancë instalimi prej 6 mm, duke konsideruar një dalje të hapësirës fiksuese prej rreth 2 mm. Toleranca dimensionale dhe trashësia do të jenë sipas standardeve Evropiane.

Panelet e xhamit do të jenë të fiksuara në skeletin metalik me anë të listelave të aluminit në profilet metalike të vetratës dhe të shoqëruara me gomina.

Të gjitha punët e lidhura me muraturën dhe të gjitha kërkesat e tjera për kompletimin e punës duhet të bëhen me cilësi të lartë.

6.6.3 Mbrojtëse horizontale te mureve (shiritat)

Furnizimi dhe vendosja e mbrojtëseve horizontale të mureve në klasa e korridore, përshkruhet në specifikimet teknike të dhëna nga kontraktori. Ato përbëhen nga material dërrase të lyera para se të vendosen në objekt. Ngjyra e tyre do të jetë sipas kërkesës së investitorit. Mbrojtëset e mureve kanë përmasa 10 -15 cm x 2 cm dhe gjatësia është sipas përmasave të dhomave. Fiksimi bëhet me profil në formë shiriti me trashësi 2 cm, me vrima me $d = 6-8$ mm të cilat duhen për

fiksion në mur. Profili i fiksohet në mur para se të bëhet patinimi. Gjatë patinimit të dy anët e profilit të saj mbuloohen.

Mbrojtëset janë të siguruar me elemente që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit.

Lartësia e vendosjes së mbrojtëseve duhet të jetë në funksion të lartësisë së karrigeve. Ngjitja ndërmjet mbrojtëses dhe murit do të bëhet duke përdorur materiale, vida dhe elastiko-plastike për profilet PVC.

Për mbrojtjen e mureve mund të përdoren edhe mbrojtëse prej druri pishe të mbrojtura me një shtresë speciale (llak për materiale druri). Në këtë rast trashësia e profilit fiksues të shiritave mbrojtës duhet të jetë 3-5 mm. Bashkimi i shiritit prej druri bëhet me anë të thumbave të vegjël, vendi i të cilëve stukohet më pas. Në pjesën e bashkimit të tyre profili prej druri dhe PVC duhet të priten me kënd 45 gradë.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit. Një model i mbrojtëses së mureve do t'i jepet për shqyrtim supervisorit për një aprovim para se të vendoset në objekt.

SEKSION 7: PUNIME TERRITORI

7.1 RRUGË

7.1.1 Nën-baza dhe baza

Nën-baza nënkupton truallin mbi të cilën do të vendoset baza dhe shtrimi i rrugës. Baza duhet t'i plotësojë nevojat dhe kushtet e punimeve të dheut si janë të përshkruara në zërin 6 (3.1). Nën-baza duhet të rrafshohet dhe të ngjeshet me një tolerancë maksimale prej +/- 3 cm. Duke e punuar nën-bazën duhet marrë parasysh edhe pjerrësia.

Baza është shtresa mbajtëse e rrugës. Ajo duhet të punohet në këtë mënyrë: Pasi të hiqet dheu me një thellësi përafërsisht prej 30 cm (deri në nën-bazën), ai duhet mbushur me një material zhavor 0/32 mm deri në 0/56 mm. Materiali do të vendoset në shtresa dhe do të ngjeshet mirë. Pjerrësia prej më së paku 1 % duhet të mbahet edhe gjatë vendosjes së bazës.

7.1.2 Shtrimi


Shtrimi i rrugëve nëpër oborrin e shkollës preferohet të bëhet me pllaka guri, beton si dhe beton monolit. Këto punë do të behen në këtë mënyrë:

Përmbi bazën do të vendoset një shtresë re në me një trashësi maksimale prej 5 cm mbi të cilën do të vendosen pllakat e gurit. Shtresa e rërës duhet të jetë me kokriza 2/5 mm deri 0/4 mm. Ajo do të rrafshohet dhe mbi atë duhet të vendosen pllakat e gurit ose betonit.

Mbas vendosjes së pllakave ata me një makinë të posaçme do të tunden në atë mënyrë që të arrihet një rrafshesi perfekte. Më në fund fugat e pllakave do të mbushen me një rërë të imët 0/1 mm në atë mënyrë që pllakat të lidhen më së miri njera me tjetrën dhe të përforcohet/stabilizohet shtresa e pllakave të gurit ose betonit.

Karakteristikat e pllakave të gurit dhe betonit duhen marrë prej prodhuesve. Ato variojnë si në trashësi ashtu edhe në dimensionet e tjera. Po ashtu edhe ngjyrat e tyre janë të ndryshme.

Arkitekti/Supervizori së bashku me klientin duhet të bien në marrëveshje ndaj modelit, dimensioneve dhe ngjyrës së pllakave. Ne figurën e mëposhtme paraqiten shtresat e një rruge të këtij tipi.




7.1.3 Kullimet dhe drenazhimi

Në rast të përdorjes të sistemit të rrugës të lartpërmendur (me pllaka guri, betoni), nevojat për planifikimin e kullimeve dhe drenazhimeve janë minimale. Pllakat e gurit, betonit me sistemin e lartë të fugave nuk kanë nevojë për ndonjë kullim ose drenazh. Shi u do të depërtojë nëpër fuga. Në raste se shi u është shumë i fuqishëm, për ato raste rrugët duhet të vendosen me një pjerrtësi prej më së paku 1 %. Pjerrtësia e rrugëve bëhet prej një rreze anë të rrugës deri në anën tjetër.

7.1.4 Shenjat rrugore dhe tabelat

Shenjat rrugore si dhe tabelat e nevojshme duhet të vendosen në një mënyrë të qëndrueshme që të mos rrezohen nga era ose nga forca të tjera (në rast se fëmijët varen tek ato). Ata duhet vendosur në një grope me dimensionet më së paku 30 x 30 x 40 cm, në të cilën futet tubë prej metali dhe gropa mbushet me beton. Shenjat ose tabelat, të cilët ngjiten në tub, duhet të jenë më së paku 2,25 m lartësi nga sipërfaqja. Se cilat shenja/tabela duhet të vendosen, varet prej nevojave dhe arkitekti duhet të vendosë për ato si dhe nga rregullorja e qarkullimit rrugor.

Ne fotografinë e mëposhtme janë dimensionet në cm të cilat duhen paraparë për rrugët.



7.1.5 Bordura betoni per trotuare

Trotuaret, rrugët si dhe pjesët e tjera të shtruara prej asfalti, pllakave të betonit ose prej ndonjë materiali tjetër duhet që të mbrohen në atë mënyrë, që anëve t'u vendoset nga një mbështetëse. Bordura mbështetëse duhet të plotësojë kërkesat e lartpërmendura për të mbajtur sipërfaqen e shtruar prej forcave horizontale, të cilat shkaktohen nga lëvizja e forcave vertikale, prej makinave, njerëzve, etj.

Një funksion tjetër që u shtohet atyre, është që të drejtojnë ujrat e rrugës.

Bordurat mund të vendosen në të njëjtën lartësi me sipërfaqen e shtruar ose të jenë nga 10 cm deri në 30 cm më lartë nga rruga sipas nevojës.

Materiali i bordurave duhet të jetë prej betoni ose prej guri. Zgjedhja e tij duhet bërë nga arkitekti/Supervizori së bashku me klientin dhe duhet pasur parasysh se materiali i zgjedhur luan një rol të veçantë në dekorimin e sipërfaqeve.

Materiallet që i ofron tregu janë të këtij lloji:

Bordura prej betoni në dimensionet e ndryshme. Ata janë pjesë të parapërgatitura prej betoni dhe duhet të instalohen sipas mënyrës së përshkruar më poshtë. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa lloje të bordurave prej betoni me karakteristikat e tyre.

Nr.	Bordurat ne cm (gjatesi/trashesi/lartesi)	Pesha kg/Stk	Nevoja per 1 m
1	Permasat 100/8/20	36	1
	Permasat 1/3 e gurit 33/8/ 20	12	3
2	Permasat 100/10/20	46	1
	Permasat 1/3 e gurit 33/10/ 20	15	3
3	Permasat 100/12/20	50	1
	Permasat 1/3 e gurit 33/12/20	17	3
4	Permasat 100/18/20	80	1
	Permasat 1/3 e gurit 33/18/20	26	3
5	Permasat 100/18/25	95	1
	Permasat 1/3 e gurit 33/18/25	31	3
6	Permasat 100/20/15	64	1
	Permasat 1/3 e gurit 33/20/15	21	3

Një lloj tjetër guri që mund të përdoret në të njëjtën mënyrë si bordurat e lartpërmendura, janë tipi i „gurë bordurave“ prej betoni. Me ata mund të realizohen kthesa e harqe të ndryshme. Në fotografimin e mëposhtme janë paraqitur dy lloje të atij tipi. Montimi i tyre bëhet në të njëjtën mënyrë si bordurat e betonit të lartpërmendur.



Gure bordure

Format 120 x 180 mm
Lartesia 600 mm, 800 mm,
1000 mm 1300 mm



Gure bordure


Format 120 x 120 mm
Lartesia 400 mm

Të njëjtat bordura që janë të lartpërmendura ekzistojnë edhe prej guri sipas granitit. Ata i plotësojnë të njëjtat funksione si bordurat prej betoni. Dimensionet e atyre varen prej tregut ofrues dhe duhet pyetur. Por si zakonisht ata i kanë pothuajse të njëjtat dimensione si ata prej betoni.

Montimi i bordurave bëhet në këtë mënyrë:

Bordurat duhet të vendosen para se të bëhet shtrimi i sipërfaqes. Për të bërë atë duhet hapur një kanal në dhe me dimensionet sipas nevojës. Kanali duhet të jetë të paktën në secilën anë nga 10 cm më i madh se bordurat. Në atë futet beton i thatë (i lagur pakë) dhe bordurat vendosen mbi atë. Nevoja e betonit është rreth 0,05 m³ beton. Në secilën anë të bordurave duhet vendosur beton në atë mënyrë që ai të fiksohet mirë dhe fortë.

Në fotografitë e mëposhtme është paraqitur skema e montimit të bordurave si dhe një shembull i një rruge me bordura guri prej graniti.



7.2 PEJZAZHI (SISTEMIMI I TERRENIT)

7.2.1 Nivelimi dhe përgatitja e terrenit

Për punimet e pejsazhit duhet të kontaktohet një specialist i posaçëm, i cili do të bëjë planet dhe do të japë instruksionet për punimet. Megjithatë është e nevojshme edhe për disa kërkesa, të cilave duhet të kemi parasysh.

Nivelimi dhe përgatitja e terrenit

Nivelimi i terrenit duhet të bëhet sipas nevojës, formës së tij dhe mjeteve financiare. Në rast se ka vetëm detyrën e dekorimit, atëherë ai mund të lihet në atë formë që ekziston.

Pa marrë parasysh nivelimin e terrenit, ai duhet të përgatitet në atë mënyrë, që të garantohet mirëmbajtja e pejsazhit. Në rast të mungesës së tokës së mirë (humus), duhet sjellë humus nga ndonjë vend tjetër dhe të shtrohet me një shtresë min. 20 cm ose sipas projektit. Në rast se terreni ka shumë gurë, atëherë mund të ketë nevojë për një shtresë më të madhe të shtresës së humusit.

7.2.2 Mbjellja dhe pleherimi

Për mbjelljen dhe mirëmbajtjen e pejsazhit duhet të konsultohet me një specialist të fushës. Për tipin e drurëve dhe të barit që do të mbillet duhet lënë hapësira për rritjen e atyre. Normalisht për mbjelljen e drurëve duhet planifikuar dhe projektuar edhe me perspektivë, që gjatë rritjes të drurëve të mos pengojnë apo dëmtojnë pamjen e ndërtesës ose të terrenit. Sidomos duhen patur kujdes vendet që do të ndodhen në hijen e vetë pemëve.

Bari i terrenit duhet të zgjidhet sipas përdorimit të shkeljes të tij. Lloji i barit duhet zgjedhur i tillë që plotëson kërkesat e ambientit. Rëndësi të madhe ka mirëmbajtja dhe kujdesi i pejsazhit. Ai duhet të ujitet vazhdimisht, të pritët dhe punët e tjera që nevojiten për mirëmbajtjen e tij.

Në tabelën e mëposhtme është bërë një klasifikim i pejsazhit në 4 kategori, varësisht nga përdorimi i tij. Aty mund të shihen edhe kriteret e ujitjes si dhe të plehërimit.

Perdorimi/tipi	Kerkesat e vendit dhe te mirembajtjes			
	Vendi	Ujitje/Prerje	Nderhyrje fizik	Pleherimi
Mundime/strapacime te pakta Shkelje njerezish	Trualli ekzistues	Pa ujitje, Prerja ne 3-8cm, 2-6 Prerje ne sezon	Ska nevojte	Ska nevojte ose pleherim te lehte
Mundime/strapacime te mesme. Lojera me top (Shkolla, Vende qe perdoren,...)	Truall i permiresuar ose truall ekzistues me veçori te mjaftueshme	Ujitje e nevojshme, Prerja ne 3 – 5 cm, Lartesia/Rritja e barit 6 – 8 cm	Rrafshim, hedhje rere nganjehere (sipas nevojtes)	2-3 here ne sezon. Gjithsej 15-20 g N per m2.
Mundime/strapacime te mesme – forta Vende sportive etj	Ndriçim natyral nga dielli, truall i permiresuar, drenazhimi ne perputhje me depertueshmerine e truallit ekzistues	Ujitje e nevojshme, Prerja ne 4 cm Lartesia/Rritja e barit deri ne 8 cm	Rrafshim, hedhje rere nganjehere (sipas nevojtes), Ajrosje	3-4 here ne sezon. Gjithsej 18-25 g N per m2.
Mundim/Strapacim shume i forte (Stadiume, etj)	Ndriçim natyral nga dielli, Shtresa bajtесе e barit duhet te ketе 40-50% pore, 1,45 – 1,55 kg/dm ³ , jo e ngjeshur) Drenazhim	Ujitje e nevojshme, Prerja ne 4 cm Lartesia/Rritja e barit deri ne 8 cm	Vertikutim, hedhje rere nganjehere (sipas nevojtes) Ajrosje	3-5 here ne sezon. Gjithsej 22-32 g N per m2.

Me sheshim kuptohet ky punim: Me një makinë të posaçme për atë punë, e cila ka thika rrotulluese, bëhet një prerje e shtresës së barit me një thellësi 1 – 3 cm në intervale të shkurtra prej 2-3 cm. Vertikulimi rekomandohet të bëhet në fillim të rritjes së barit (Mars/Prill) mbasi të bëhet prerja e barit. Ky proces e largon plisën e barit që është rritur dhe nuk e lejon depërtimin e ujrave. Ajrosja: Prurja e oksigjenit me mjete mekanike deri te rrënjët e barit.

7.2.3 Sistemi ujites

Ujitja e pejsazhit luan një rol kryesor në mirëmbajtjen e tij. Ajo duhet kryer sipas nevojës, në kohë të duhur dhe në masë të mjaftueshme.

Për çdo ujitje duhet të përdoret afro 15 – 25 l/m² dhe duhet të arrihet një lagështi deri në rrënjët e barit.


Sistemi ujitës rekomandohet të bëhet me sistem automatik. Në rastet kur nuk garantohej një ujitje e tillë, bëhet edhe në mënyrë të thjeshtë. Sistemi automatik ka përparësi përkundër një ujitje me dorë. Në rast se ky sistem lidhet me një ose me më shumë sensora, atëherë sistemi punon vetë dhe ujimi bëhet sipas nevojës së tokës. Kështu mundet të kursehet ujë dhe ujitja bëhet më e mirë, përveç kësaj, elementët që e hedhin ujën, dalin mbi tokë vetëm gjatë procesit të ujitjes. Në raste se ata nuk janë aktivë, ata futen në kanale nën nivelin e tokës.

Sisteme të këtij lloji aplikohen shumë në Evropë.

Montimi i këtyre sistemeve automatike është i thjeshtë dhe mund të bëhet pa patur njohuri të veçanta. Vetëm projektimi i elementeve të sistemit duhet të bëhet nga një specialisti. Prodhuesit e këtyre sistemeve ofrojnë skemat e montimit gratis, në rast se blihen impiante në këto firma. Po ashtu me blerjen e impiantit, shumëherë dorëzohet edhe skema ose software për projektimin e tyre. Në tabelën e mëposhtme jepen disa prej llojeve të „ujëhedhësve“ të paraqitura. Projektuesi duhet të zgjedhë tipin e nevojshëm për projektin e tij.

Modell	Shtypja maks (bar)	Hedhja e ujit Radius (m)	Konsum i ujit (m ³ /h)
PK50-AP	3,6 - 7,8	12,5 - 14,3	0,82 - 1,77
PK60-AP	3,6 - 7,8	13,4 - 15,5	1,52 - 3,13
PK70-AP	3,5 - 6,2	16,2 - 19,2	2,39 - 4,72
PK50-AF	3,6 - 7,8	12,5 - 14,3	0,82 - 1,77
PK60-AF	3,6 - 7,8	13,4 - 15,5	1,52 - 3,13
PK70-AF	3,5 - 6,2	16,2 - 19,2	2,39 - 4,72
PK80-AF	3,5 - 6,2	17,3 - 22,4	5,00 - 9,24
K90-P	4,2 - 6,9	25,9 - 30,8	8,4 - 17,78
K90-F	4,2 - 6,9	25,9 - 30,8	8,4 - 17,78

Ne fotografitë e mëposhtme janë disa detaje të një sistemi të tillë të paraqitura



Ku: numri 1 është pjesa vertikale e impiantit
numri 2 është niveli i tokës
numri 3 është berryli i bashkimit të pjesës vertikale me atë horizontale
numri 4 është një pjesë T-je
numri 5 është tub polietileni

7.3 GARDHI DHE PORTAT

7.3.1 Gardh (rrethimi) me mur dhe kangjella

Gardhi përbëhet prej 3 elementeve:

Muri:

Gërmime seksion të caktuar për themele deri në thellësinë 60 cm nga rrafshi i tokës, në terren të çfaredolloj natyre dhe konsistence, të lagur ose të thatë duke përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjëve, trungjeve, gurëve dhe pjesëve me volum deri në 0,3 m³, plotësimin etj. Përforcimin e çfaredolloj marke dhe rezistence, mbushjen e pjesëve të mbetura bosh pas realizimit të themeleve, me materialin e gërmimit me dorë, duke përfshirë zhvendosjen brenda ambientit të kantierit. Muri i themeleve mund të realizohet me butobeton, me blloqe çimentoje ose me gurë duke përfshirë çdo mjeshtëri për dhembët e lidhjes si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj më së miri.

Xokolatura duhet të bëhet në lartësi deri 60 cm prej sipërfaqes të dheut ose rrugës. Lartësia e mureve pa kangjella shkon deri në 1,8 m, me kangjella shkon deri në 80 cm.

Kolonat:

Në distancën maksimale prej 3 m duhet të vendosen kolona prej metali në dimensionet me gjerësi sa muret. Ata duhet në majë të mbulohen duke salduar pllaka metalike me dimensionet e njëjta si kolonat. Kolonat duhet ankoruar mirë në murin e ndërtuar më parë. Në vend të kolonave metalike mund të vendosen kolona prej betoni ose prej materiali si i murit. Ato duhet të jenë të trasha sa është muri mbi të cilën vendosen ata, me gjerësi minimale 30 cm, që realizojnë qëndrueshmëri statike. Në raste se shtyllat bëhen prej guri, betoni, ose materiali tjetër, ai duhet të suvatohet me një shtresë me trashësi prej 2 cm me llac bsatard m-25. Muri i lartpërmendur duhet po ashtu të suvatohet me të njëjtën mënyrë si kolonat.

Kangjellat:

Kangjellat duhet të jenë të bëra prej metali dhe të saldohen/ngjiten mirë me kolonat. Ata duhet të lyhen të paktën dy herë me bojë kundër korrozionit. Format dhe pamja e kangjellave do të vendoset së bashku me arkitektin/inxhinierin dhe klientin.

Hapësirat e kangjellave nuk duhet të jenë më shumë se 12 cm, që të mos mundet të kalojë njeri ndërmjet atyre.

Lartësia minimale e gardhit duhet të jetë 1.8 m (muri + kangjellat).

Ne fotografinë e mëposhtme është një shembull i një gardhi të tillë.



7.3.2 Dera metalike


Duhet të vendosen dy dyer ose porta të jashtme metalike. Njëra duhet të plotësojë kërkesat e kalimit të makinave, kurse tjetra duhet të plotësojë kërkesat e kalimit të njerëzve.

Dera e jashtme mundet të bëhet në këtë mënyrë:


Furnizim dhe vendosje e një porte metalike rrëshqitëse, që hapet me dorë, e instaluar në hyrjen kryesore, e formuar nga një kasë kryesore me profil metalik p.sh. 50 x 50 mm të mbështetur në fund me profil 200 x 50 mm.

Kasa e dytë do të përbëhet nga hekur me diametër 16 mm, të vendosur dhe të salduar siç tregohet në projekt. Në pjesën më të ulët të kasës kryesore metalike do të instalohen min. 2 rrota metalike për

rrëshqitjen e portës me profil në formë L të fiksuar në të njëjtën bazë betoni, në të cilën janë fiksuar 2 kolonat e hekurit që mbajnë të gjithë strukturën e portës rrëshqitëse. Baza e betonit, në të cilën do të vendoset porta, varet nga pesha e asaj, por duhet më së paku të ketë këto dimensione: një thellësi prej min. 40 cm dhe një gjerësi prej min. 40 cm. Inxhinieri do të vendosë për dimensionet e themelit varësisht nga dimensionet e derës dhe peshës që ai do të mbajë. Porta do të pajiset me brave sigurie me çelësa në tre kopje, dorëzë stabile hekuri dhe me të gjithë pjesët e tjera speciale për mbylljen e portës si dhe aksesorë të tjerë, si dhe çdo gjë tjetër për ta konsideruar portën të përfunduar dhe funksionuese më së miri.



Dera e kalimtarëve duhet t'i plotësojë kushtet e lartpërmendura. Por rekomandohet që dera e kalimtarëve të jetë e një sistemi si në fotografinë e mëposhtme. Dimensionet e kësaj dera duhen caktuar prej arkitektit/inxhinierit në bashkëpunim me klientin.



Ne fotografite e mëposhtme jepen disa detaje të kësaj dore.




7.3.3 SPECIFIKIME/NORMA PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Njësitë e mjedisit dhe përbërësit e tyre:


Dyert, hapësirat e dyerve të hyrjes së çdo ndërtese dhe të çdo njësie të patundshme duhet të jenë të paktën 80 cm. Hapësira e dyerve të tjera duhet të jetë të paktën 75 cm. Hapësirat para dhe pas derës duhet të jenë në përputhje me minimumin e parashikuar në skemat grafike të dhëna si më poshtë. Lartësia e dorezave duhet të jetë midis 85 dhe 95 cm (e këshillueshme 90 cm) dhe për dritare në lartësinë 90~120 cm. Duhet t'u jepet përparësi zgjidhjeve me një kanat të vetme për dyert që nuk kanë gjerësi më të madhe se 120 cm dhe xhamat të jenë vendosur në një lartësi 40 cm nga plani i ecjes. Elementët për pastrimin e këpucëve duhet të vendosen në nivelin e dyshemesë.

Zgjidhjet e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara: hapësirat përpara dhe pas dyerve


HAPJA NË DREJTIM TË KUNDËRT ME LËVIZIEN – HAPJA NGA E MAJTA




HAPJA NË DREJTIM TË KUNDËRT ME LËVIZIEN – HAPJA NGA E DJATHTA



HAPJA NË DREJTIM ME LËVIZJEN – HAPJA NGA E DJATHTA




HAPJA NË DREJTIM ME LËVIZJEN – HAPJA NGA E MAJTA



Dorezat në dyer dhe dritare.



Vendosja e instalimeve.




Dyshemetë, disnivelet e mundshme të tyre nuk duhet t'i kalojnë 2,5 cm. Aty ku janë parashikuar shtrime të rrugëve kundër rrëshqitjes.

Sipërfaqja relievore

Struktura me lugje; Struktura me thepa



Hapësira e hyrjes.



INSTALIMET ELEKTRIKE


Instalimet elektrike duhet të kenë:

- interfon të vendosur në lartësi deri 120 cm nga dyshemeja me indikacione drite;
- ndërprerës i dritës dhe ziles i vendosur në lartësi prej 90 deri 120 cm nga dyshemeja;
- prizat në kuzhinë vendosen mbi sipërfaqen e punës;
- prizat e tjera të vendosura në lartësi prej 90 deri 120 cm nga dyshemeja;
- kuadër elektrik vendosur në lartësi prej 90 deri 120 cm;
- të gjitha pajisjet e instalimeve elektrike të kenë ngjyrë në kontrast me sipërfaqen ku montohen.

Terminalet e impianteve ku hyjnë pajisjet elektrike, kuadrot e përgjithshme, valvulat dhe rubinetet, e bllokimit të përdorimeve të ndryshme, rregullatorët e impianteve të ngrohjes dhe të kondicionimit, zilet e alarmit, citofoni, duhet të vendosen në një lartësi midis 40 dhe 140 cm. Shenjat treguese që përdoren janë si me poshte.

Komunikimi (hapësirat e komunikimit).

Montimi i instalimeve, praku.



Platforma levizese

- 340 kg kapacitet
- Maksimumi i distances vertikale of 3,000 mm
- Shpejtesia e levizjes perafersisht 0.13 m/s
- 900 x 1,400 mm dimensioned standart te kabines
- 115 VAC levizje (115 VAC levizje siper dhe 12 VDC bateri poshte)
- Bateria e emergjences ne ulje
- Raportim defekti ne ulje
- Sistem levizjeje 2:1me zinxhir hidraulik
- Pompe hidraulike e tipit me ingranazh
- 2.5 m gjatesia e udhezuesit te tipit shine
- Udhezues cilinder
- 1.5 hp (1.119kW)
- Kontroll elektronik pa rele
- Sistem automatik i karikimit te baterise (115 VAC)
- Kombinim i bllokimit mekanik dhe kontaktit elektrik
- Ndryshim normal limit
- Butona kontrolli ne platforme
- Stacion telefonie
- 6,067 mm lartesia e paneleve mbrojtese anesore
- Siperfaqja e dyshemese se kabines jo e rreshqiteshme
- Pluhur veshes elektrostatik ne ngjyre bezhe mbi gjithe siperfaqen e hekurit dhe
- Nuk nevojitet dhome makinerie



Shërbimet higjienike duhet të garantojnë manovrimin dhe përdorimin e pajisjeve të personave me aftësi të kufizuara motorike, duhet të parashikojnë në lidhje me hapësirat e manovrimit, afrim anësor te WC-ja, bideja, vaska, dushi, lavatrica dhe afrim ballor te lavamani. Kështu duhen respektuar përmasat minimale të mëposhtme:

Hapsira e nevojshme e afrimit dhe e lëvizjes anësore e karriges me rrota te WC-ja dhe bideja, nëse është e parashikuar, duhet të jenë minimumi 100 cm, e matur nga boshti i pa isjes sanitare.

Hapsira e nevojshme e afrimit anësor e karriges me rrota te vaska, duhet të jetë minimumi 140 cm përgjatë vaskës me një thellësi minimale 90 cm.

Hapsira e lirë për lëvizjen me karrocë duhet të jetë me sipërfaqe rrethore me diametër të paktën 150 cm.

Hapsira e nevojshme e afrimit ballor e karriges me rrota te lavamani, duhet të jetë minimumi 80 cm e matur nga ana e përparme e lavamanit. Për sa i përket karakteristikave të pajisjeve sanitare përveç të tjerash lavamanët duhet ta kenë pjesën e sipërme të vendosur në 80 cm nga dyshemeja dhe të jenë pa kolonë me sifonin mundësisht gjysmë të mbyllur ose të futura në mur.

WC-të dhe bidetë të jenë të tipit të varura, në mënyrë të veçantë boshti i WC-së ose i bidesë duhet të vendoset në një distancë minimale 40 cm nga muri anësor, pjesa e përparme duhet të jetë më e madhe se 65 cm nga muri mbrapa dhe pjesa e sipërme duhet të jetë 45-50 cm nga dyshemeja. Në rast se aksi i WC-së ose i bidesë është më shumë se 40 cm largë nga muri, duhet parashikuar një hallkë ose parrmak për të lejuar lëvizjen në një distancë 40 cm nga aksi i paisjes sanitare. Paisja e lëshimit të ujit në WC të vendoset në lartësinë prej 70 cm mbi sipërfaqen e dyshemesë.

Dushi duhet të vendoset poshtë, i paisur me një karrige që ulet dhe ngrihet dhe me telefonin e dushit; Varsja e rrobave duhet të vendoset në lartësinë prej 120 cm nga dyshemeja.

Të gjitha paisjet duhet të kenë kontrast të theksuar në ngjyrë nga dyshemeja dhe muret.

Instalim i mekanizmit të hapjes së derës nga jashtë në rast dhënie të ndihmës së shpejtë.

Instalim i sistemit të alarmit brënda banjos për t'u përdorur nga PAK në raste nevojë.

Në banesat e arritshme të banuara, të dhënat në nenin 3 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje, përveç të tjerash, duhen vendosur paisje me hallka dhe parrmakë horizontale dhe/ose vertikale pranë paisjeve.

Në shërbimet higjienike të vendeve publike është e nevojshme instalimi i parrmakëve pranë WC-ve, të vendosur me një lartësi prej 80 cm nga dyshemeja dhe me diametër baras me 3-4 cm; nëse është i fiksuar në mur duhet vendosur 5 cm larg nga vetë ai.

Në rastin e përshtatshmërisë lejohet heqja e bideve dhe zëvendësimi i vaskës me një dush të vendosur poshtë, me qëllim që të përfitohet një hapësirë anësore për afrimin te WC-ja dhe për të përcaktuar hapësirat e mjaftueshme të manovrimit.

Në banesat e ndërtesave rezidenciale, në të cilat është parashikuar kërkesa e mundësisë së shfrytëzimit, shërbimi higjienik do të quhej i arritshëm nëse do të mundësohej të paktën arritja e një WC-je dhe e një lavamani nga ana e personit në karrige me rrota. Me arritje të pajisjeve sanitare kuptohet mundësia për të arritur deri afër saj edhe pa afrimin anësor për WC-në dhe afrimin ballor për lavamanin.




Shenjat për mundësinë e shfrytëzimit të ambjenteve të shërbimit higjienik jepen si me poshte.

WC.


Mekanizmi për lëshimin e ujit.

$v = 70$ cm.

Instalimi i alarmimit.



Banjo-ja




Kuzhinat, në të cilat garantohej manovrimi dhe përdorimi me lehtësi i lavamanit dhe të paisjes së gatimit, duke vendosur poshtë tyre hapësira të lira 50 cm në thellësi dhe në një lartësi të paktën 70 cm nga dyshemeja. Për hapësirat e kufizuara preferohen dyert me rrëshqitje ose ato në formë libri. Sipërfaqja e përdorimit të hapsirës, për shfrytëzimin e elementëve të kuzhinës dhe kthimin me karrocë për PAK-në, të paktën të jetë me një sipërfaqje e rrethi me diametër 150 cm. Hapësira për lëvizje rreth mobiljeve me gjërësi të paktën 120 cm.

Menca.

Banaku i arritshëm.

Kuzhina.



Rrugët horizontale dhe korridoret duhet të kenë një gjerësi minimale 100 cm, dhe zgjerime të përshtatshme për të lejuar ndryshimin e drejtimit të lëvizjes nga ana e personit në karrige me rrota. Këto zgjerime duhet të realizohen në pjesët fundore të korridoreve dhe gjithashtu të parashikuara për t'u realizuara çdo 10 m në zhvillim linear. Për pjesët e korridorit ose të sheshpushimeve ku hapen dyert duhen përshtatur zgjidhje teknike në përputhje me mënyrat e hapjes së dyerve dhe të hapësirave të lira të nevojshme për kalimin, si dhe zgjidhjet teknike:

Hapësira neto e portës e barabartë me 75 ~ 80 cm kur:

-Kalimi në hapësirën e portës të vendosur në faqe muri është perpendikulare me kahun e drejtimit të karriges me rrota për:

a-1. Nevojat e lëvizjes mbrapa gjatë hapjes, bazen e sipërfaqes së lirë të nevojshme është 190 cm ndërsa gjerësia nga korridori 100 cm.

a-2. Manovër të thjeshtë, pa lëvizur mbrapa, hapësira anësore që duhet respektuar është 45 cm ndërsa sipërfaqia e lirë e bazës duhet të jetë 135 cm.

a-3. gjerësi të lirë 100 cm, sipërfaqia e lirë e bazës duhet të jetë 120 cm.

-Kalimi në hapësirën e portës të vendosur në një faqe muri është paralel me kahun e drejtimit të karriges me rrota për:

b-1. Gjerësi të korridorit 100 cm, hapësirë e nevojshme përtej portës duhet të jetë 20 cm, hapësira për fillimin e manovrimit përpara portës duhet të jetë 100 cm dhe hapja e portës më shumë se 90°. E njëjta gjë vlen dhe për hyrjen në kah të kundërt.

b-2. Gjerësi të korridorit 100 cm hapësira e nevojshme përtej portës duhet të jetë 110 cm për të lejuar hapjen dhe hapësira e nevojshme përpara portës duhet të jetë aq sa vend zë karroca.. E njëjta gjë për hyrjen në krah të kundërt.

b-3. Gjerësi të korridorit 100 cm hapja e portës është përtej 90°, hapësira e nevojshme përtej portës në korridor është 10 cm, hapësira e nevojshme përtej portës në hapësirën e hyrjes është 20 cm dhe hapësira e nevojshme përpara portës, në korridor të paktën 90 cm, për të garantuar kthimin.

-Kalimet në holle dhe nëpërmjet portave vendosur në linjë të drejtë mes tyre dhe në faqe muri perpendikulare me kahun e lëvizjes së karriges me rrota për:

c-1. Nevoja lëvizjeje mbrapa gjatë hapjes së portës hapësira bazë e nevojshme është 190 cm, hapësira bazë e nevojshme përpara hollit është 120 cm dhe gjerësia e hollit 100 cm.

c-2. Manovrim të thjeshta, pa qenë i detyruar të kryesh lëvizje mbrapa hapësirë në anë të portës së dytë është 45 cm, hapësira bazë e nevojshme është 180 cm dhe gjerësia e nevojshme është 135 cm.

c-3. Nevoja lëvizjeje mbrapa gjatë hapjes së portës gjerësia e hollit është 100 cm dhe hapësira e nevojshme e bazës është 190 cm.

c-4. Manovrim të thjeshtë pa qenë nevoja për lëvizje mbrapa hapësira bosh në anë të portës së dytë është 45 cm dhe hapësira e nevojshme bazë është 210 cm..

c-5. Manovrim të thjeshtë pa qenë nevoja të lëvizje mbrapa hapësira e nevojshme bazë është 170 cm dhe hapësira e nevojshme bazë përpara hollit është 135 cm.

- Udhëkalimet që ndodhen në holle dhe kalojnë nëpërmjet portave perpendikulare mes tyre janë me:
- d-1.** Gjerësia të hollëve 100 cm dhe kanë hapësirat e nevojshme përtej portës 20 cm, si dhe hapësirë e nevojshme mes dy portave 110 cm.
- d-2.** Gjerësi të hollit 100 cm, hapje të portave në 90° dhe hapsira e bazës së hollit 140 cm.

Zgjidhjet a-1, c-1, c-3 janë të pranueshme vetëm në rast përshtatjeje.

Platformat e pjerrëta (rampat)

Konsiderohet i arritshëm kalimi i një disnivele deri në 320 cm nëpërmjet platformave të pjerrëta të vendosura njëra pas tjetrës. Rampa duhet të plotësoj kushtet:



- Pjerrtësi të lejuar deri në 1:20 (5%);
- Gjerësi së paku 120 cm në hapësirat e jashtme, gjegjësisht më së paku 90 cm në hapësirat e brendëshme;
- Shesh pushime horizontale me dimensione minimale prej 150 x 150 cm ose 140 x 170 cm në drejtim të tërthortë dhe 170 cm në drejtim gjatësor nga ana e kundërt e lëvizjes, e vendosur në çdo 10 m të gjatësisë së rampës,
- Sipërfaqe relievore kundër rrëshqitëse;
- Rrethim të ndërtuar me dorëza mbajtëse në pjesën e pambrojtur, ose në pamundësi një bordurë të paktën me 10 cm lartësi;
- Dorezë mbajtëse me diametër 4 cm, e formatuar në mënyrë që mund të kapet me pëllëmbë, e vendosur në dy lartësi - prej 60 cm dhe 90 cm;
- Rrethim i rampës i cili gjendet në hapësirat e jashtme, doreza mbajtëse e tij e realizuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e ndjeshme nga ndryshimet termike ;
- Rrethim me sipërfaqe prej qelqi i shënuar dukshëm;
- Përdorim i shenjave të përshtatjes.

Pjerrësia e platformave nuk duhet t'i kalojë 8%. Janë të pranueshme pjerrësi më të larta, në rastet e përshtatshmërisë, të lidhura me zhvillimin linear efektiv të platformës.

Rampa


≥ 120 cm në hapsirat e jashtme

≥ 90 cm në hapsirat e brendëshme



Mbështetësi i dorës (koromano)

Dorezat rrethore



Dhoma, klasa dhe hapësira e punës

Dhoma, klasa dhe hapësira e punës duhet të kenë hapësirë komunikimi të lirë për lëvizje me karrocë për PAK, me sipërfaqe minimale rrethore me diametër 150 cm, hapësirë komunikimi për lëvizje rreth mobilieve (orendive) me gjerësi të paktën 120 cm; tavolinë pune e realizuar në formë konsoli ku distanca e sipërfaqes së sipërme nga dyshemeja të jetë 85 cm, ndërsa gjërësia në të paktën 70 cm me thellësi afrimi 50 cm.

Pajisjet e palëvizshme

Në ndërtesat e banuara kutitë për postën nuk duhet të vendosen në një lartësi më shumë se 140 cm. Në vendet e hapura për publikun, ku kontakti me njerëzit bëhet nëpërmjet tavolinave, duhet parashikuar një hapësirë e përshtatshme e lirë, mundësisht në një ambient të ndarë, që të bëhet një pritje normale, ku përveç të tjerash mund të vendosen një numër vendesh të mjaftueshëm për t'u ulur (preferohen karriget e ndara).

Distanca përpara çdo tavoline duhet të jetë të paktën 150 cm dhe anash të paktën 120 cm me qëllim kalimin me lehtësi mes tavolinave.

Në vendet e hapura për publikun, në të cilat kontakti me njerëzit bëhet nëpërmjet sportelit të banakut të zgjatur ose në mure, duhet mundësuar një pritje e përshtatshme për publikun, me qëllim që të evitohet shfaqja e situatave patologjike të nervozizmit dhe të lodhjes. Sidoqoftë në vende të tilla duhen krijuar hapësira të lira, mundësisht në ambiente të ndara, ku mund të bëhet një pritje normale, në të cilën përveç të tjerash mund të vendosen një numër i caktuar vendesh për t'u ulur (preferohen karriget e ndara).

Për sa u përket flukseve të veçanta të njerëzve, duhet të parashikohen barrierat ndarëse udhërrëfyese, të cilat duhet të jenë me një gjatësi të njëjtë me atë të radhës së njerëzve dhe që konsiderohet si mesatarja e flukseve të mëdha dhe me një gjerësi minimale prej 70 cm. Barrierat që ndan rrugën e afrimit të sportelit nga ai i daljes duhet të ndërpritet nga një distancë prej 120 cm në përfundim të pengesave të banakut të zgjatur ose të planit të punës së sportelit në mur. Në çdo rast barrierat ndarëse udhërrëfyese nuk duhet të kenë një gjatësi më të madhe se 400 cm. Barrierat ndarëse udhërrëfyese duhet të jenë të fiksuara fort në dysheme dhe të kenë një lartësi në nivelin e një bordure prej 90 cm.

Të paktën një sportel duhet të ketë planin e përdorimit për personat në karrige me rrota, i vendosur në një lartësi baras me 90 cm nga toka në vendin e rezervuar për publikun.

Në vendet e hapura për publikun ku kontakti me njerëzit bëhet nëpërmjet banakut të zgjatur, të paktën një pjesë e tyre duhet të kenë një plan përdorimi për njerëzit, i vendosur në një lartësi baras me 85cm nga toka.

Pajisjet automatike të çdo lloji për përdorim publik, të vendosura në brendësi ose jashtë njësive të patundëshme të hapura për publikun, duhen që për nga pozicioni, lartësia dhe komandat të mund të përdoren nga personat në karrige me rrota.

GARDEROBA


Garderoba duhet të ketë:



- dimensionet e bazës jo më të vogla se 160 x 210 cm;
- derë me dorëz sipas standarteve të pikës 2.1 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje, me hapsirë të paktën 90 cm me hapje nga jashtë ose rrëshqitëse;
- varëse për rroba e vendosur në lartësi prej 120 cm nga dyshemeja;
- ndënjëse palosëse e vendosur në lartësi prej 45 deri në 50 cm nga dyshemeja;

Në ndërtesën e cila ka garderobë është e nevojshme që 10% e tyre të realizohen të përshtatura nga numri i përgjithshëm, por jo më pak se një.

Garderoba.

Varëset.





Plani orientues për lëvizje në ndërtesa

Plani orientues për lëvizje në ndërtesë duhet të jetë i realizuar në formë relievore dhe të plotësoj kushtet në vijim:

- të jetë i vendosur horizontalisht deri në 90 cm lartësi dhe vertikalisht deri në 180 cm lartësi nga kuota e dyshemesë.
- të jetë i vendosur pranë hyrjes së ndërtesës;
- të përmbajë informacion në shkrimin Braille;
- prej derës hyrëse të ndërtesës deri te plani të ketë vij relievore drejtuese në kahje të lëvizjes;
- të tregohet drejtimi për t'a arritur


Shenjat e përshtatjes për PAK-në

Në vijim paraqiten shenjat e përshtatjes. Dimensionet dhe ngjyra e të gjitha shenjave të arritshmërisë, si dhe lloji i materialit nga i cili është punuar përcaktohen në raport me:

- planin në të cilën vendoset shenja;
- forma e hapësirave të jashtme dhe/ose të brendshme;
- distanca nga e cila PAK duhet të vërejë shenjën.



Paraqitja grafike për kushtet e përdorimit të elementeve ndihmëse për arritshmërinë
 Kushtet e përdorimit të ndihmesës në hapsira për lëvizje me karroca të personave me aftësi të kufizuara – PAK



- Gjerësia e rrugës të levizjes në hapsira të mbyllura.
- Gjerësia e rrugës të levizjes në hapsirat e jashtme.
- Pamja anësore, pamja ballore, pamja ballore e karrocës së palosur.
- Dimensionet në gjerësi të karrocës me shfrytëzues.
- Dimensionet mesatare të karrocës së personave me aftësi të kufizuara.

BASHKIMI OPERATORËVE

“TAULANT’ sh.p.k & “ARKIMADE” sh.p.k & ALTEA GEOSTUDIO sh.p.k.

Përfaqësuese me prokurë:

Ditika QATIPI

SPECIFIKIME TEKNIKE

EMERTIMI I PROJEKTIT:

INVESTIME PËR TRANSFORMIMIN E ASETVEVE PUBLIKE ME
POTENCIAL ZHVILLIMI NË MODELE TË STANDARDIT MË TË LARTË TË ZHVILLIMIT:
PËRMIRËSIMI I SHËRBIMIT NË KOPSHTIN NR.4,
RRUGA "ADEM SHEME", SARANDË

Hartuesi i projektit : B.O.E "Taulant" sh.p.k,
"Arkimade" sh.p.k &
"A.L.T.E.A Geostudio 2000" sh.p.k

Porositësi: Fondi Shqiptar I Zhvillimit



ALTEA
GEOSTUDIO



PËRMBAJTJA

1.	PARATHËNIE	1
2.	PRISHJA E THEMELIT EKZISTUES DHE PASTRIMI I INERTEVE.....	1
3.	PUNIME DHEU	8
4.	STRUKTURA BETONI TE DERDHURA NE VEND.....	16
5.	PUNIMET STRUKTURA METALIKE.....	27
6.	MURATURA.....	30
7.	TARRACAT DHE TARRACAT ME STRUKTURE METALIKE.....	39
8.	HIDROIZOLIMI.....	48
9.	RIFINITURA E MURATURES.....	57
10.	VESHJET E DYSHEMEVE DHE MUREVE (punime shtresa)	74
11.	RIFINITURA E TAVANEVE.....	91
12.	LYERJA DHE VESHJET.....	96
13.	DYERT	101
14.	DRITARET.....	116
15.	PUNIME SISTEMIMI Të JASHTME.....	125



1. PARATHËNIE

Ky dokument, titulluar Specifikime Teknike, të cilave do t'u referohemi "ST" janë hartuar si pjesë për realizimin e projektit: INVESTIME PËR TRANSFORMIMIN E ASETVEVE PUBLIKE ME POTENCIAL ZHVILLIMI NË MODELE TË STANDARDIT MË TË LARTË TË ZHVILLIMIT: PËRMIRËSIMI I SHËRBIMIT NË KOPSHTIN NR.4, RRUGA "ADEM SHEME", SARANDË.

Ky dokument të konsiderohet si pjesë perberese e Dokumentacionit të Projektit Zbatimit dhe Preventivit Perfundimtar për objektin e mesiperm.

Informacioni i dhënë ka për qëllim specifikimin e punimeve dhe instalimeve, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me standardet për të përmbushur objektivat e projektit. Kontraktoret e Punimeve të Ndertimit duhet t'u referohen specifikimeve teknike të atyre zerave të punimeve të cilat përfshihen në pershkrimet e Vizatimeve, në Preventivin Perfundimtar si dhe në Pershkrimin e Punimeve.

Kapitulli 1 _ këto SPT duhet të lexohen së bashku me çdo detaj shtesë të përmendur në:

Kapitulli 2	Specifikimet Teknike për punimet Elektrike (STE)
Kapitulli 3	Specifikimet Teknike për punimet Mekanike (STM) Preventivat e Punimeve (P) Vizatimet në bazë të Listës së Vizatimeve Raportet Teknike

1.1 SPECIFIKIMET TEKNIKE

Çdo kapitull kryesor përbëhet nga maksimumi TRE seksione për kapitull:

(Pjesa 1) E Përgjithshme:

Specifikimet e referencave të përgjithshme dhe procedurat.

(Pjesa 2) Produktet:

Specifikimet e të dhënave dhe kërkesave në lidhje me produktin.

(Pjesa 3) Ekzekutimi:

Specifikimi i proceseve të instalimit dhe ekzekutimit.

Të gjitha seksionet në një kapitull janë të lidhura me njëra-tjetrën .

Këto specifikime SPT janë të vlefshme, si për punimet e prishjeve, rikonstruksionin dhe ndertimin e ri.

2. PRISHJA E OBJEKTEVE EKZISTUESE DHE PASTRIMI I INERTEVE

2.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

2.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi deri në sasinë e marrë në reference. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin e tyre bazë.

2.1.1.1 Rregullat dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare

2.1.1.2 Deklaratat

Të paraqiten procedurat e prishjeve dhe të heqjes dhe largimit para se puna të fillojë. Duhet të parashikojne heqjen e kujdesshme, hedhjen e materialeve dhe koordinim me punë të tjera që vazhdojnë, një plan të nderprerjes së shërbimeve komunale, të gjitha lejet nga shërbimet komunale, një përshkrim të detajuar të metodave dhe pajisjeve që duhet të përdoren për secilin operacion dhe pasojat e operacioneve.

2.1.2 KËRKESAT

Puna përfshin pastrimin dhe heqjen e inerteve të treguara apo të specifikuara. I gjithë materiali që rezulton nga puna e prishjeve, përveç i asaj që është treguar/specifikuar ndryshe, duhet të largohet nga kantieri çdo ditë. Plehrat dhe mbetjet do të largohen nga kantieri çdo ditë, akumulimi i një materiali të tillë është i ndaluar si brenda edhe jashtë godinave. Materialet të cilat nuk mund të hiqen nga kantieri çdo ditë duhet të ruhen në mënyrë të duhur në zonat e përcaktuara. Duhet të jepen kontenierë të duhur për heqjen dhe largimin e mbetjeve të ndryshme të ndërtimit dhe duhet ti zbrazë këto sa më shpesh të jetë e mundur. Të gjithë kontenierët duhet të mbulohen gjatë të gjithë kohës në mënyrë që të parandalohet ngritja nga era e pluhurit dhe mbetjeve. Nëse identifikohen kalbësi në dru apo azbestos gjatë punimeve të prishjeve ai duhet të ndërmarrë masat e duhura parandaluese për shëndetin dhe sigurinë, te propozohen masat e duhura të eliminimit .

2.2 PRODUKTI

2.3 PJESA 3 - EKZEKUTIMI

2.3.1 GODINAT EKZISTUESE

2.3.1.1 Nënstacionet

Nënstacionet ekzistuese duhet të prishen përveç rasteve kur nuk kërkohet ndryshe. Të prishet çdo sipërfaqe betoni përveçse kur thuhet ndryshe.

2.3.1.2 Kanalizimet dhe paisjet e nevojshme

Me kujdes të largohen shërbimet komunale ekzistuese të zbuluara nga puna siç është treguar dhe të përfundohet në një mënyrë të përputhje me rregulloret/udhëzimeve Evropiane të cilat mbulojnë shërbimet specifike dhe siç janë të udhëzuara nga Mbikëqyrësi. Nëse kanalizimet e shërbimeve komunale nuk tregohen në skica, të kontaktohet Mbikëqyrësi për udhëzime të mëtejshme.

2.3.1.3 Kanalizimet /shkarkimet e brendshme

Para se të fillojnë punimet e prishjes së objekteve ekzistuese, kanalizimet në zonën përkatëse duhet të hiqen nga funksioni në mënyrë që të parandalohet rivendosi në punë në mënyrë të paqëllimshme.

2.3.1.4 Prishja e suvatimeve

Gjatë shkatërrimit të elementëve të suvatar si mure, suvaja duhet të pritet në mënyrë të pastër në limitet e seksionit të shkatërruar.

2.3.1.5 Shtrimet dhe soletat

Shtresat e betonit, asfaltit ose bitumi te priten në një thellësi prej 5 centimetrash poshtë nivelit ekzistues. Të mundësohen prerje të drejta dhe të rregullta në kufijtë e heqjes së shtresave. Matrapikët duhet të përdoren vetëm deri tek prerja e sharrës dhe nuk duhet të përdoren në vend të prerjes.

2.3.1.6 Betoni

Të kryen prerjet e betoni gjatesore të drejta në një thellësi prej jo më pak se 5cm.

2.3.1.7 Kunjat prej Druri

Gjatë punimeve te prishjes të gjitha kunjat prej druri duhet të hiqen nga muret dhe tavanet.

2.3.1.8 Muret

Gjatë prishjes të mureve dhe/ose modifikimeve për të hapur mure ose hapësira kujdes duhet treguar për të siguruar një përfundim të pastër në sasinë e seksioneve të prishura. Kujdes i duhet treguar që dyshemetë të mos mbartin goditje të shtuar që vjen si rezultat i mbetjeve që bien mbi të.

2.3.2 GËRMIMET

Të mbushen të gjitha gërmimet, kanalet e hapura dhe gropat, dhe hapësirat e tjera të rrezikshme në përputhje me masat e dhëna në kapitujt pasardhës.

2.3.3 RREGULLIMET

Kurdoherë që sipërfaqet ekzistuese të punimeve permanente dëmtohen nga kontraktori gjatë kryerjes së punimeve, Kontraktori duhet të riparojë, rregullojë dhe përfundojë sipërfaqe të tilla për ti ngjarë sipërfaqeve të tjera ngjitur të cilat janë të padëmtuara.

2.3.4 LARGIMI DHE E DREJTA E MATERIALEVE

2.3.4.1 Largimi i materialeve Ekzistuese dhe Pajisjeve

Përveç se aty ku tregohet ose specifikohet ndryshe në seksionet e tjera, të gjitha materialet dhe pajisjet e hequra dhe të mos ripërdorura, duhet të largohen nga kantieri.

Materialet dhe pajisjet nuk duhet të shihen nga blerësit perspektiv dhe as t'u shiten atyre në kantier.

2.3.5 KONTROLLI I ZHURMAVE DHE VIBRIMEVE

Në rastet kur prishjet ndodhin në godina që janë ende në funksionim; punimet intensive me zhurmë dhe tronditje nuk do të lejohen gjatë orarit normal të punës në mënyrë që shqetësimi mbi veprimet të ruhet në minimum. Koordinimi i punimeve të tilla do të kryhet me Mbikëqyrësin.

2.3.6 KONTROLLI I NDOTJES

Duhen ndermarre veprimet e duhura për të kontrolluar shpërndarjen e pluhurit dhe për të shmangur krijimin e papastërtive në zonën përreth. Te përmbushen të gjitha rregulloret mbi ndotjet të vendosura në kantier nga agjencitë vendore të ndotjes së ajrit. Gjatë prishjes së godinave që janë ende në përdorim, duhen përdorur rrjeta pluhuri për të mbrojtur nga pluhuri ne ajer, ato zona që ende do te jene ne perdorim. Kur prishen elementë të cilët përmbajnë materiale fibre, kujdes i veçantë duhet ndërmarrë për të

shmangur zhvendosjen e fibrave dhe në këtë mënyrë thithjen e tyre në rrugët e frymëmarrjes. Lagia e materialeve të tilla dhe përdorimi i maskave kundër pluhurit do të konsiderohet si masë minimale mbrojtëse. Ndalohet shpimi i materialeve fibroze.

2.3.7 MBROJTJA

2.3.7.1 Punimet Ekzistuese

Para fillimit të punimeve duhet inspektuar dhe identifikuar gjithë elementët ekzistues të cilët duhen ruajtur ose ripërdorur. Punime të tilla ekzistuese e cila është: (a) për të qëndruar në vend, (b), për tu ripërdorur, ose (c) të mbetet në kantier si pronë e Përfituesit, do të ruhet duke përdorur mbulesa të përkohshme, mbështetjen dhe ankorimin. Artikujt të cilat do të qëndrojnë dhe të cilat dëmtohen gjatë kryerjes së punimeve do të riparohen në kushtet e tyre fillestare ose të zëvendësohen me të reja me shpenzimet e kontraktorit. Të mos mbingarkohen elementët strukturorë. Të mundësohen mbështetje të reja dhe përf forcime për ndërtimet ekzistuese të dobësuara nga punimet e prishjes së ndërtesave. Nëse vërehet humbje e stabilitetit strukturor (shmangie të tepërta, kolaps, etj.), atëherë Kontraktori duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të siguruar punimet dhe të largojë dhe bllokujë zonën dhe të informojë Mbikëqyrësin.

2.3.7.2 Ulja e Materialeve

Kur materialet ose mbetjet ulen nga lartësitë, duhet pasur kujdes për të parandaluar tundjen e tyre, rënien ose projektimin e tyre në të tillë mënyrë tillë që të krijojnë rrezik për sigurinë e personelit ose pronës publike të çdo lloji.

2.3.7.3 Hinke Mbetjesh

Hinka e Mbetjeve për të transferuar mbetjet nga katet e sipërme të një godine për në kontenierë, duhet të jenë të lidhura në mënyrën e duhur dhe të instalohen nga personel me eksperiencë dhe duhet të jenë të izoluar tek puthitjet. Kontenieri pritës duhet të jetë i mbuluar me materialet e duhura, i cili në mënyrë respektive duhet të jetë i mbyllur rreth hinkes ndërsa futet në kontenier në mënyrë që të parandalojë pluhur të tepërt dalë nga kontenieri. Akses i sigurt dhe i duhur duhet të mundësohet në majë të hinkes për të siguruar kushte të sigurt pune gjate depozitimit të mbetjeve në rrëpirë.

2.3.7.4 Shërbimet Ekzistuese

Kabllo të elektrikë ekzistues dhe përcjellësit të cilët duhet të mbeten duhet të shkëputen me kujdes nga lidhësit/ ankorimet e tyre (pa i shkëputur), të rivendosen larg rrugëkalimeve të operacioneve ndërtimore, dhe të ruhen nga dëmtimet. Para punimeve prishese Kontraktori do të kontrollojë vendndodhjen e shërbimeve të fshehura.

2.3.7.5 Dëmtimet gjate stines se Dimrit

E gjithë godina duhet të ruhet nga kushtet atmosferike dimërore, si për shembull ngrirja e tubacioneve të ujit etj., gjatë punimeve të prishjes së godinave ekzistuese.

2.3.7.6 Zëvendësimi i Dyerve dhe Dritareve

Gjatë zëvendësimit të dyerve dhe dritareve duhet të sigurohet se artikujt ekzistues hiqen dhe zëvendësohen në të njëjtën ditë në mënyrë që godina të jetë e sigurt gjatë natës.

2.3.7.7 Punimet në Tarraca

Gjatë punimeve në tarraca, duhet të sigurohet që godina të mbetet e izoluar ndaj motit gjatë të gjithë kohës. Materiale të përkohshme për tarracat duhet të mundësohen kur dhe ku të jetë e nevojshme. Në përgjithësi heqja e shtresave të tarracës do të kryhet me faza në bashkëveprim me punimet e tarracës, në mënyrë që kërkesa për tarracë të përkohshme të mbahet në minimum.

2.3.7.8 Periudhat e Mbylljeve

Gjatë periudhave të mos paraqitjes në kantier duhet të sigurohet që të gjitha punimet e përkohshme dhe të përhershme të jenë të sigurta.

2.3.8 SIGURIA DHE SHËNDETI NE KANTIER

2.3.8.1 Mbikëqyrja me Eksperiencë

Të gjitha punimet e prishjeve të godinave ekzistuese do të jenë nën një mbikëqyrje të përhershme nga një përgjegjës i kualifikuar dhe me eksperiencë.

2.3.8.2 Ruajtja e Këmbësorëve

Aty ku rrezikohet siguria e këmbësorëve dhe shoferëve nga punimet e prishjeve të godinave ekzistuese, përdorimi i barrikadave të trafikut me drita sinjalizuese (gjatë orëve të natës) dhe sinjalistika e duhur për të ridrejtuar trafikun larg zonës së prishjes së objekteve ekzistuese. Mundësoni mbulesa të rrugë kalimeve të përkohshme për të ruajtur kalimtarët.

2.3.8.3 Punimet me materiale të Nxehta

Ruajtja e cilindrave të gazit nën presion në depo, shkallë, korridore dhe rrugë shpëtimi është e ndaluar.

2.3.8.4 Veshjet e Sigurisë

Gjatë punimeve të prishjes së godinave ekzistuese, të gjithë punëtorët duhet të veshin rrobat e duhura të sigurisë duke përfshirë minimalisht mbrojtjen e syve, maskat e pluhurit, këpucët e sigurisë doreza të rënda pune dhe kapele sigurie.

2.3.8.5 Prerja e Metaleve

Gjatë punimeve prerëse përdorimi i trapanëve ose saldatriçeve dhe metodave të ngjashme veçanërisht në tunelet e shërbimeve Kontraktori duhet të sigurohet që shkëndijat dhe metali i shkrirë të mos bie në zonat e pakontrolluara.

2.3.9 SHËRBIMET E JASHTME

Të mbrohen të gjitha shërbimet elektrike dhe ato komunale. Duhet verifikuar rrjeti nëntokësor në kantier para fillimit të gërmimeve. Lejet për gërmime duhet të merren nga furnizuesit e shërbimeve Aty ku specifikohet apo tregohet spostimi i shërbimeve apo shtresave ekzistuese, të mundësohen barrikada, mbulesa të përkohshme të zonave të ekspozuara dhe shërbime të përkohshme dhe lidhje për sistemin energjik apo atë komunal. Nqs për prishjen e godinave ekzistuese përdoren pajisje mekanike si vinça, ekskavatorë apo pajisje hidraulike dhe thërrmues dheu, duhet pasur kujdes për tu siguruar që asnjë pjesë e

makinerive të tilla të mos bjerë në kontakt me kabllot elektrike ose telefonike nëntokësore ose mbitokësore ose në afërsi të tyre.

Në përgjithësi linjat ajrore të cilat kalojnë rrugët automobilistike ose shtigjet do të jenë qartësisht të shënuara duke përdorur shiritin e kuq/bardhë dhe me paralajmërimin “lartësia maksimale x,xxm” me tabelat e ngritura 5m në secilën anë të linjës.

2.3.10 SKELERIA

Të gjitha skelat do të jenë të përcaktuara dhe të ngritura në përputhje me standardet e duhura. Vetëm ngritësit e skelave me eksperiencë dhe kompetentë do të kryejnë ngritjen e skelave. Punimet në skelat e pa miratuara janë tërësisht të ndaluara.

Kujdes duhet ndërmarrë që ngarkesa e mbetjeve që qëndron në skela të mos tejkalojë ngarkesën maksimale të skelës. Ngarkesat maksimale të lejuara të skelës duhet të jenë qartësisht të dukshme në të gjitha pikat hyrëse në nivelin tokësor. Të gjitha masat e nevojshme duhen ndërmarrë për të parandaluar që mbetjet aksidentalisht të shkëputen nga platforma.

Skelat prej hekuri të tipit me këmbalec, në përputhje me standardet dhe rregullat vendase, duke përfshirë furnizimin e mbështetësve, mirëmbajtjen, montimin, ankorimin, çmontimin, etj., shtroje 15cm duhet të mundësohen në të gjitha nivelet. Shtresat ndaj motit ose të paktën një rrjetë mbrojtëse duhet të mundësohet nga jashtë skelës.

2.3.11 SHPËRTHIMET

Përdorimi i eksplozivit nuk lejohet.

2.3.12 DJEGJA

Djegia nuk lejohet.

2.3.13 PASTRIMI

2.3.13.1 Mbetjet dhe Plehrat

Nuk duhet të përdoren qese apo kazanë për plehra shtëpiake për të hequr mbetjet e ndërtimit ose materialin e shpërbërë, por duhet të përdoren materialet e duhura për largimin e materialeve të hedhshme ose mbetjeve dhe duhet ti transportojë këto materiale jashtë kantierit sa më shpesh të jetë e nevojshme. Largimi dhe transportimi i mbetjeve dhe plehrave në një mënyrë që do të parandalojë derdhjen e tyre në rrugë apo në zonat përreth.

2.3.13.2 Pastrimi

Godina duhet të pastrohet nga i gjithë pluhuri dhe mbetjet pas përfundimit të prishjes së objekteve ekzistuese.

2.3.13.3 Rregulloret

Të pajtohet në mënyrë strikte me të gjitha rregullat Shqiptare në fuqi për sa i përket eliminimit dhe hedhjes së mbetjeve të kantierit.

2.3.14 PUNIMET PËR PASTRIMIN E KANTIERIT

2.3.14.1 Heqja e pemëve dhe e shkurreve më të larta se 1,5m

Në përgjithësi duhet kushtuar kujdes gjatë punimeve të pastrimit për të mos dëmtuar ato pemë të cilat nuk pengojnë në rivendosje dhe në ndërtimin e një godine të re. Në rastet kur heqja e tyre është e nevojshme ose e specifikuar atëherë masat e duhura parandaluese duhen marrë për të mos dëmtuar personelin dhe objektet rreth zonës së shembjes së objektit. Për pemë më të larta se sa 10m, prerja e tyre duhet kryer më ndarje prej 3m. Pjesa e prerë duhet lidhur me litarë ose e një kabull të balancuar dhe duhet ulur me litar ose me kabull të balancuar nga pjesa ku personeli ose godinat janë të sigurta.

2.3.14.2 Heqja e strukturave, rrethimeve

Duhet të ulen me kujdes dhe të pastrohen vetëm ato struktura që janë udhëzuar. Pjesët përbërëse duhet të çmontohen, pastrohen, stivohen në grumbuj të veçantë. Materialet të cilat nuk janë për ripërdorim duhet të largohen nga kantieri në një vend grumbullimi.

2.3.15 PUNIMET E PRISHJES SË OBJEKTEVE EKZISTUESE

2.3.15.1 Çmontimi i çative

Çmontimi i çative dhe tjegullave ose mbulesave me fletë metalike dhe strukturave të tyre ndihmuese si trarë e të tilla, duke përfshirë materialet izoluese ose skeletet e përbëra nga trarë dhe ulluqe si dhe pjesët lidhëse duke përfshirë edhe oxhaqet.

Shkatërrimi i izolimit të tarracave e çative duke përfshirë trarët mbajtës dhe nyje me suvatim si dhe punimet elektrike.

Heqja e shtresave hidroizoluese duke përfshirë dhe ato të kthyera, gjithashtu kur ato të kthyera gjenden pranë oxhaqeve, të përbëra prej shtresave bituminoze, ku përfshihet heqja e materialeve izoluese e fashat mbyllesë metalike pranë parapeteve.

Prishja e shtresave në sipërfaqet vertikale në një lartësi prej të paktën 30cm, për vendosjen e shtresave të reja izoluese kundër ujit.

2.3.15.2 Prishja e ndertimeve prej guri

Prishja totale ose pjesore e ndertimeve prej guri, duke përfshirë edhe punët deri në themele. Te merren të gjitha masat e nevojshme përforcuese për konsolidimin e strukturës dhe të godinave të tjera përreth (nëse ka).

2.3.15.3 Prishja e ndertimeve prej tulle

Prishja totale ose pjesore e punimeve prej tulle ose i elementëve prej tulle të parafabrikuara duke përfshirë edhe punimet me pllaka dhe themelet e tyre. Kontraktori duhet që gjithashtu të vë në dispozicion të gjitha masat e nevojshme përforcuese për konsolidimin e strukturës dhe të godinave të tjera përreth (nëse aplikohet).

2.3.15.4 Prishja e strukturave prej betonarmeje

Prishja totale ose e pjesshme dhe heqja e strukturave të përcaktuara prej betoni dhe elementëve duke përfshirë strukturat e tyre të themeleve.

2.3.15.5 Prishja dhe heqja e elementëve metalike dhe zgarave metalike

Heqja, prerja dhe ruajtja e zgarave metalike ose të elementëve të tjerë metalikë (p.sh. membranave strukturore) dhe zhvendosja e tyre brenda kantierit, duke përfshirë përzgjedhjen e tyre të mëvonshme dhe renditja e stivoja brenda kantierit në zonën e specifikuar për ripërdorim.

2.3.15.6 Struktura & elementët e ndotur

Duhet të hiqen të gjithë elementët dhe strukturat të cilat janë të identifikuar si të ndotura (nga vajra, kimike ose materiale të tjera të dëmshme para përdorimit) në një vend ndodhje të posaçme në bazë rregulloreve vendore dhe atyre Shqiptare.

2.3.15.7 Dheu i ndotur

Dheu nën këto struktura të ndotura duhet të emërohet si i rrezikshëm nga një specialist i licencuar në lidhje me nivelin e tij ndotës ose duhet të hidhet në mënyrë direkte në një vend grumbullimi të specializuar siç është nënvizuar më lart (minimumi i nivelit të germimit prej nën 0,5m nën nivelin më të ulët të strukturës së themelit të germuar.

3. PUNIME DHEU

Punimet tokësore do të përfshijnë Germimin, Mbushjen dhe Ngjeshjen.

3.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

3.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi deri në sasinë e marrë në reference. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin e tyre bazë.

3.1.1.1 Normat dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare

3.1.2 PËRCAKTIMET

3.1.2.1 Shtresa e punueshme

Germimi i materialeve të shtresës së punueshme ose i formacioneve të dheut të paprekur, me grimca të vogla, materialet që i kanë rezistuar motit mbi sipërfaqe ose në mënyrë të drejtpërdrejtë poshtë tij si dhe ndonjë lëndë organike pjesërisht e tretur. Shtresa e punueshme e dheut mund të jetë me ngjyrë të errët, e shkrifët, me kripë ose material ranor me një përqindje të lartë të lëndëve organike të mirë tretura, që shpesh herë përmbajnë gjurmë nga një material i ngurtë. Materiali duhet të jetë përfaqësues i dheut prodhues aty pranë.

3.1.2.2 Materiali i Fortë

Gurët e qëndruar jashtë për një kohë të gjatë, depozitimet e dendura dhe të bashkuara, ose materialet e përbëra të cilat nuk janë të përfshira në përcaktimin e “gurit” por të cilat zakonisht kërkojnë përdorimin e pajisjeve të rënda të gërmimit, dhembë të fortë shpërbërës, ose matrapikë për heqje.

3.1.2.3 Material i cili nuk Lëviz

Gurët ose dheu me gurë në fund të transhesë i cili mbulon një material me të shkrihet ose një shtresë e veçantë për të shmangur çarjen e tubacioneve.

3.1.2.4 Materiali i cili nuk përmbush standardet

Dheu apo materialet e tjera të identifikuar që nuk kanë fuqinë dhe stabilitetin e duhur për të mbajtur mbi to peshën e caktuar në mbushje të transheve pa një ngjeshje të madhe ose që krijojnë humbje të stabilitetit. Gjithashtu materiali i cili hidhet për mbushje që përmban mbetje, materiale të ngrira, gurë të mëdhenj, plehra dhe materiale të tjera që mund ti shkaktojë kësaj mbushjeje të mos kompaktësohet.

3.1.2.5 Materiali i Paqëndrueshëm

Materiali në fundin e transhesë i cili nuk ka forcën për të ruajtur rregullsinë dhe që të parandaloje fugat që mund të krijojnë ndarje në tub, ose lëvizje të strukturës gjatë mbushjes. Ky material, ndryshe i identifikuar si i përshtatshëm i cili ka qenë i ngacmuar ose i ngopur me ujë.

3.1.2.6 Mbushja

Material i përdorur në mbushjen e transhesë ose të ndonjë gërmimi tjetër, është gërmuar në këtë kantier dhe duhet të jete pa gurë, ose materiale të huaja të tretura ose me përmbajtje argjilore.

3.1.2.7 Ngritja

Një shtresë dheu e vendosur për një mbushje tjetër, sipër dheut të papërgatitur ose jo të cilësisë së kërkuar të përdorur më parë.

3.1.2.8 Ngjeshja

Çdo metodë stabilizimi mekanik të materialit duke shtuar dendësinë e tij në kushte të kontrolluara lagështie. “Shkalla e Ngjeshjes” është marrë si një përqindje dendësisë maksimale duke ndjekur procedurën e kërkuar të testimit.

3.1.3 RRJETI EKZISTUES

Vendndodhja e rrjetit ekzistuese tregohet si e përafërt. Duhet verifikuar vendndodhja dhe thellësinë /lartësinë e rrjetit ekzistues të treguar para fillimit të ndërtimit. Duhet të koordinohet përcaktimi i rrjetit /kanalizimeve ekzistuese.

3.1.4 MAGAZINIMI I MATERIALEVE

Materialet e gërmuara të klasifikuara si dhe i kënaqshëm duhet të ruhen aty ku udhëzohet, deri në momentin kur kërkohen për mbushje ose rimbushje. Këto duhet të vendosen, gradohen dhe formatohen për kullimin e duhur dhe të ruhen në mënyrë të tillë që të mos lejohet ndotja dhe ndarja.

Materialet kërkuara gjatë punës duhet të vendosen dhe të ruhen në një distancë të mjaftueshme nga cepi i gërmimeve për të parandaluar renien ose rreshkitjen gjatë gërmimit dhe të parandalojë shkarjet. Materialet e mbetura si për shembull materialet e gërmuara të klasifikuara si të pakënaqshme, plehra, mbetje dhe teprica duhet të largohen dhe eliminohen në baze të udhëzimeve të Mbikëqyrësit.

3.1.5 KËRKESAT E PËRGJITHSHME

Ekzekutimi duhet të kryhet si më poshtë:

Ngritjet /mbushjet në sipërfaqe duhet të jenë si të treguara.

Që asnjë tubacion ose pengesa të tjera artificiale përveç atyre të treguara do të shihen.

Që material i fortë nuk do të ndeshet.

Që uji nëntokësor është ai që në bazë të shpimeve dhe skicave, në kohën e investigimit të kryer nën sipërfaqe, nuk përfaqëson domosdoshmërisht rritje permanente të nivelit të ujit nëntokësor.

Në rast se kushtet aktuale ndryshojnë thellësisht nga ato të thëna ose treguara, pjesa e kontratës e cila tregon një rregullim për kushtet e ndryshuara aplikohet, në vartësi të kërkesave për lajmërim që jepen nga ai moment. Materiali i fortë duhet të përcaktohet si gur i palëvizshëm, masa jo të shtresëzuara por shumë të çimentuara të depozitave që përmbajnë karakteristikat e gurit solid jo zakonisht të hequra pa një shpim sistematik dhe shpërthim dhe çdo gur, tullë, ose beton përveç pllakave që i tejkalon 0.4 m³ në volum.

3.2 PJESA 2 – PRODUKTET

3.2.1 MATERIALET

3.2.1.1 MBUSHJA POROZE

Ku aplikohet një barrierë uji për kapilaritet (e treguar si mbushje poroze) nën pllakat e betonit, duhet të përmbajnë një gur të pastër të shtypur, zhavorr, ose çakell, 90-100 % duke kaluar në një sitë prej 20mm dhe me një kalim prej 0-5 % kalon një sitë 4,75mm me rërë të barabartë me jo më pak se 50. Mbushja me grimca mund të përbëhet me një kombinim të duhur të rërës dhe gurëve të shtypur për të përmbushur kërkesat për gradim si më sipër. Barrierat kapilare duhet të vendosen direkt mbi nënshtresë. Barrierat duhet të ndërtohet në shtresa që nuk kalojnë 10cm trashësi të ngjeshur, dhe secila shtresë duhet të jetë kompakte me një minimum të dy kalimeve të modelit të operimit me pllake.

3.2.1.2 MATERIALET E DHEUT

3.2.1.3 Shtresa e punueshme

Shtesa e punueshme duhet të jetë pa nënshtresa. Mbetje, trungje, gurë mbi 3cm, shkurre, barëra të këqij dhe materiale të tjera që parandalojnë rritjen e bimëve. Shtresa e punueshme do të merret nga një zonë e miratuar dhuruese e shtresës së punueshme.

3.2.1.4 Materiali i Kënaqshëm i Dheut

Materialet e kënaqshme të dheut të përdorura si rimbushje për transhetë, kullim dhe për strukturat duhet të përbëhen nga materiale vendase të klasifikuara si dhe nga rërë të mirë graduar, rërë me përmbajtje balte ose argjile të cilat janë të pastër nga mbetjet, rrënjët, drunjtë, materiale të tjera vegjetale si dhe plehra.

3.2.1.5 Mbushja Përzgjedhëse

Materiali i përzgjedhur për mbushje duhet të përbëhet nga rëra dhe gurët e shtypur. Rimbushja do të kryhet duke shtypur shtresat për të arritur nivelin e 96% të standardit Proctor në rastin e materialit të

ngjeshur, ose $Id > 0.67$ në rastin materialit jo të ngjeshur. Materiali që duhet të përdoret do të miratohet nga Mbikëqyrësi.

3.2.1.6 Rërë Lumi

Rëra duhet të jetë rërë natyrore lumi, e përbërë nga grimca të forta dhe të pastra, të qarta në ngjyrë dhe në formë sferike. Rëra duhet të jetë e pastër dhe pa substanca organike, baltë, apo papastërti të tera. Përbërja e granulimit të rërës duhet të jetë nga 0,5mm deri në 1,0mm.

3.2.1.7 Materialet e Shtratit

Duhet të jetë rërë e imët dhe me një granulim nga 0 mm deri në 3.0 mm.

3.3 PJESA 3 - ZBATIMI

3.3.1 PREGATITJA E SIPËRFAQES

3.3.1.1 Ruajtja e Shtresës së Punueshme

Dhe' i përshtatshëm për pastrim nga kantieri ku gërmimi kryhet dhe ndahet në mënyrë të veçantë nga materiali tjetër i gërmuar. Material i papërshtatshëm për tu përdorur si shtresë e punueshme do të largohet nga kantieri. Pozicionimi i shtresës së sipërme, në mënyrë që materiali të jete lehtësisht i lexueshem per shkallen e perfundimit. Kur të gërmohet shtresa e sipërme dhe ajo nuk përmbush standardet e kërkuara, duhet të mundësohen materiale të përshtatshme përdorimi te shtresës sipërme.

3.3.2 GËRMIMI

3.3.2.1 E përgjithshme

Gërmimi do të përfshijë heqjen dhe hedhjen e të gjithë materialit për të marrë të gjithë ngjitjet nën shkallë sipas specifikimeve.

3.3.2.2 Ruajtja e Personave dhe Pronës

Të gjitha gërmimet do të kryhen pas rrethimeve dhe të kenë shenja paralajmëruese gjatë orëve të natës. Strukturat, kanalizimet, trotuaret pllakat dhe ndërtimet e tjera menjëherë ngjitur me gërmimet do të ruhen ndaj dëmtimeve duke përfshirë zhvendosjen, lëvizjen anësore, heqjen e bazamentit dhe rrëshqitjet. Barrierat duhet të vendosen në mënyrë të tillë që ngarkimi i mjeteve pranëgërmimeve të shmanget. Trungje parandaluese duhet të vendosen në cepin e gërmimeve për të parandaluar që mjetet të mos kalojnë në zonën e gërmimit kur ecin mbrapsht.

3.3.2.3 Gërmimi për Struktura

Gërmimi për strukturat duhet të konfirmojë me dimensionet dhe mbushjet e treguara me një tolerancë plus minus 15cm dhe do të shkojnë në një distancë të mjaftueshme nga themelet për të lejuar mundësi të mjaftueshme punimi minimalisht 50cm për vendosjen e formave të betonit, instalimin e shërbimeve dhe të ndërtimeve të tjera të treguara, si dhe për inspektim. Në gërmimet për bazamentin e themeleve, të bëhet kujdes që të mos ngacmohet fundi i gërmimeve. Në përgjithësi 10cm e fundit të gërmimeve duhet të largohen pak para se të hidhet betoni.

3.3.2.4 Gërmimi i Transheve

Gërmimi do të përbëhet nga gërmimi për themelet ose kanalizimet dhe transhetë e vendosjes së bimëve. Të përgatiten transhe aq vertikale sa të jetë e mundur përveç se kur lejohet skarpata.

3.3.2.5 Gërmimi për Gropat e Ndërtimit dhe Themelet

Punimet e Gërmimit duhet të përfshijnë gërmime për thellesi gropash të pjerrta apo të drejta në varesi të godinave duke përfshirë përgatitjen themeleve, duke niveluar dhe ngjeshur. Për më tepër duhet të përfshijë gërmimet për thellesi gropash ndërtimi duke përfshirë transportin deri në 2km dhe të mbushë dheun duke e ngjeshur.

3.3.2.6 Gërmimi për Zonat e Shtruara

Gërmimet do të kenë në përbërje të tyre klasifikimin për zonat e shtruara; gërmimi dhe nxjerrja e të gjithë materialeve të përdorshme pavarësisht karakterit të tyre, nga nënshtresat; dhe hedhjen e të gjithë materialit të gërmuar, siç është specifikuar në përputhje me vijat, klasifikimet, seksionet dhe dimensionet e përcaktuara në skica, dhe për të zëvendësuar materialet e papershtatshme nga gërmime të tjera dhe operacione klasifikuese.

3.3.2.7 Gërmimet e Paautorizuara

Gërmimet e paautorizuara të cilat përmbajnë heqje materialesh përtej ngritjeve të treguara të nënshtresave ose të dimensioneve anësore pa miratimin specifik të Mbikëqyrësit do të rivendosen pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktues. Gërmimet e paautorizuara në bazamentin e themeleve prej betoni ose me një mbushje të përzgjedhur të mirëngjeshur, pa ndryshuar lartësinë maksimale të miratuar. Kudo që të kryhen gërmimet e paautorizuara do të rimbushen dhe ngjeshen në baze të klasifikimit të gërmimeve të autorizuara.

3.3.2.8 Qëndrueshmëria e Gërmimeve

Anët e gërmimeve mbi një thellësi prej 1,5m duhet të jenë me pjerresi, me kënd mbështetës për materialin e gërmuar, ose do të mbahen dhe lidhen aty ku animi nuk është i mundur ose sepse ka kufizime në hapësirë ose për arsye të materialeve të gërmuara. Anët dhe pjerresite e gërmimeve do të ruhen si të tilla deri në përfundim të mbushjeve apo vendosje në kushte të sigurta deri në sistemim ose lidhje. Kujdes i duhet kushtuar për të parandaluar rrezimin e aneve, kur gërmimet janë subjekt i lëkundjeve nga trafiku i mjeteve ose veprimet të makinerive apo nga ndonjë burim tjetër.

Materialet e gërmuara nuk duhet të jenë pranë buzeve të skarpates se perforcuar, por në largësinë jo më shumë se një e treta e thellësisë së transhesë. Për transhetë e pa perforcuara, kjo distancë do të varet nga thellësia e gërmimeve, përmbajtja e lagështisë dhe fuqia ngjitëse e materialit dhe profili i gërmimit. Në përgjithësi, materiali i gërmuar duhet të vendoset jashtë me një anim prej 45 gradësh që kalon nga fundi i gërmimit.

3.3.2.9 Perforcimet dhe Mbeshtetjet

Materialet e përdorura për perforcimin dhe mbështetje, si nyje e formave dhe madhësive të ndryshme duhet të jenë në kushte të mira shërbimi. I gjithë druri i përdorur duhet të jetë i mirë dhe pa nyje të mëdha e të hapura. Perforcimet dhe mbështetjet në gërmime duhet të ruhen pavarësisht kohëzgjatjes së gërmimeve ose kohës që gërmimi qëndron i hapur. Të gjitha perforcimet dhe mbështetjet duhen çuar në nivelin e gërmimeve. Kurdoherë që heqja e tyre mund të lejohet lëvizje anësore të dheut nën strukturat ngjitur, duhet të përdoret dru i presuar dhe platforma metalike si dhe të lihen e të priten në mënyrë permanente në vend, në bazë të kërkesës.

3.3.2.10 Largimet e Ujrave

Gërmimet duhet të kryhen në një mënyrë që të parandalojnë ujin sipërfaqësor ose nëntokësor, të përmbytë kantierin dhe zonën përreth. Uji nuk duhet lejuar që të grumbullohet në gërmim.

I gjithë uji duhet të largohet nga gërmimet në mënyrë që të mos ndodhe paqendrueshmeria e fundit të themeleve, animi i pilotave dhe ndryshimet në dhe që përkeqësojnë qendrueshmerinë e nënshtresave dhe të themeleve. Pompat thithëse dhe linjat e shkarkimit si dhe sistemet e tjera të largimit të ujit me gjithë përbërësit e tyre duhet të mundësohen dhe të mirëmbahen sipas nevojës për të çuar ujin larg gërmimeve. Operacionet e heqjes dhe largimit të ujit duhet të jenë të vazhdueshme deri në rimbushjen totale dhe deri në momentin kur ndërtimi i cili është subjekt i presionit të ujit, të ketë marrë fuqinë e nevojshme. Në të gjitha hapat, operacionet e largimit të ujit duhet të vazhdojnë sa kohë që uji mund të futet ose mblidhet në gërmime. Uji i larguar nga gërmimet dhe uji i shiut duhet larguar në kanalizimet ujëmbledhëse sipas miratimit të Mbikëqyrësit. Kanalet e përkohshme të tharjes dhe shmangiet e tjera duhet të jepen dhe ruhen jashtë kufijve të gërmimeve për secilën strukturë. Përdorimi i gërmimeve të skarpatave për shërbime në kantier si kanalizime të përkohshme të tharjes nuk do të lejohen.

3.3.3 RIMBUSHJE & MBUSHJE

3.3.3.1 E përgjithshme

Rimbushja do të konsistoje në vendosjen e materialit të specifikuar rimbushës, në shtresa, në gërmimet e nënshtresave të treguara. Mbushja duhet të përbëhet nga vendosja e materialeve të specifikuara në shtresa, mbi sipërfaqen e tokës për nivelin e treguar, për çdo zonë siç është klasifikuar më poshtë:

3.3.3.2 Rimbushje dhe Materialet Mbushes

Materialet e dheut për rimbushje duhet të jenë të pastra nga mbetjet e argjilës, gurë ose zhavorr më të mëdhenj se 6cm. Mbetjet dhe ndonjë material tjetër i dëmshëm i çdo madhësie duhet të hiqet. Mbushjet duhet të jenë me material të kënaqshëm.

3.3.3.3 Përgatitja e Sipërfaqes së Tokës për mbushje

Bimësia, mbetjet, materialet e dheut të cilat nuk janë të kënaqshme, pengesat dhe materialet e dëmshme duhet të largohen nga sipërfaqja e nivelit të tokës para vendosjes së mbushjes. Sipërfaqet e pjerrta me pjerrësi nga një vertikale në katër horizontale, duhet të plugohen, pastrohen ose tharmohen në të tillë mënyrë që materiali mbushës të lidhet me materialin ekzistues. Kur sipërfaqja e tokës ka një dendësi më pak se ajo e specifikuar për zonën e veçantë të klasifikuar, sipërfaqja e dheut duhet të copëtohet, kthehet në pluhur, dhe të përmbaje kushte lageshtie më të mirat e mundshme të materialit të dheut në thellësinë e kërkuar dhe përqindje dendësisë maksimale.

3.3.3.4 Rimbushja e Transheve

Transhetë duhet të rimbushen me kujdes me materialet e specifikuara dhe depozituar në shtresa maksimale prej 15 cm, në thellësi të lirë. Materiali i nevojshëm përreth (për sa i përket fundit) duhet të barazohet nga të gjitha anët e kanalizimeve në të gjithë gjatësinë, dhe duhet të ngjeshet tërësisht dhe me kujdes deri sa

kanalizimi të ketë një shtresë mbuluese prej jo më pak se 30cm. Duhet pasur kujdes që tubacioni ose kanalizimet të mos dëmtohen, apo lyerjet dhe bojërat speciale që rrethojnë kanalizimin ose tubacionin. Pasi të vendoset kjo shtresë, duhen vendosur shenja dalluese/treguese për kanalizimet përkatëse. Pjesa tjetër e materialit rimbushës duhet të depozitohet në transhe në shtresa të pangjitura prej 30cm dhe të ngjeshet me makineri ngjeshëse të operuara me dorë. Transhetë dhe gropat e gjermimit që nuk janë mbushur siç duhet aty ku ndodh sedimentimi, duhet të rihapen në thellësinë e kërkuar për të marrë ngjeshjen e duhur e më pas të rimbushen dhe ngjeshen me sipërfaqen e kthyer në shkallën e kërkuar të ngjeshjes.

Për të parandaluar humbjen e materialit nëpërmjet efekteve të drenazhimit në materialin e poshtëm dhe atë përreth në transhetë e pjerrta, barriera te papershkrueshme materiali si masa argjiroro, duhet të instalohen në të gjithë gjerësinë e gjermimit të paktën 30m me qendër të matur përgjatë vijës së transhesë.

3.3.3.5 Përgatitja nën Shtresore për Zonat e Shtruara

Pas perfundimit të fazes dhe menjëherë përpara depozitimit të materialit sipërfaqësor, nënshtresa duhet të sillet në trajta të duhura, sipas kategorise dhe prerjeve të duhura të dhena në përputhje me këto specifitime. Të gjitha gropat dhe shtypjet duhet të hiqen duke i tërhequr dhe me teh në mënyrë që të sigurohet njëtrajtshmëri në sipërfaqe. E gjithë nënshtresa duhet të sillet në një sipërfaqe të fortë dhe kompakte, në një vijë të drejtë duke rrotulluar mbi to rrulat e miratuar, deri sa të ngjeshet tërësisht. Ky veprim duhet të përfshijë lagjen dhe riformatimin e kërkuar për të marrë ngjeshjen e duhur. Të gjitha vendet e buta dhe jo kompakte duhet të hiqen tërësisht dhe hapësira të rimbushet me materialin e përshtatshëm dhe të ngjeshet tërësisht. Në ato zona duhet vendosur një shtresë stabilizuese, nga lart nën shtresa nuk duhet të tregojë një devijim më të madh se sa 12mm. Ngjeshja e nënshtresave duhet të shtrihet deri tek anët për një distance prej të paktën 30cm përtej skajit të shtresës stabilizuese apo shtrimit. Nënshtresa duhet të mirëmbahet në kushtet e përfunduara deri kur të jetë vendosur shtresa e pare e sipërfaqes.

3.3.3.6 Përgatitja për Zonat e Mbjella

Zonat e mbjella duhet të kategorizohen nga dimensionet, pamjet dhe prerjet e tyre sipas treguesve në skica. 10 cm e sipërm të këtyre zonave do të përbëhen nga dhe i punueshëm, i cili duhet të ngjeshet lehtësisht. I gjithë materiali poshtë shtresës së punueshme duhet të ngjeshet sipas specifitimeve për përgatitjen e nënshtresave. Shtresa e punueshme do të përhapet në mënyrë uniformë në zonat e përcaktuara dhe të përhapet në mënyrë të barabartë me një trashësi mesatare prej 10cm me një trashësi minimale prej 8cm. Para se të hidhet shtresa e punueshme, nënshtresa e ngjeshur nga trafiku mbi të apo shkaqe të tjera, duhet lehtësuar me përdorim të diskut ose plugës në një thellësi prej 6cm për të lejuar lidhjen e nënshtresës. Shpërndarja duhet të kryhet në të tillë mënyra që mbjellja të mund të vazhdojë me pak përgatitje të dheut ose plugim. Çdo rregullsi në sipërfaqe e cila rezulton nga hedhja e shtresës së punueshme ose e ndonjë veprimi tjetër do të korrigjohet në mënyrë që të parandalojë formimin e gropëzave ku mund të mblidhet uji. Shtresa e punueshme nuk do të vendoset kur nënshtresa është tepër e lagur, tepër e thatë ose në kushte të këqija për plugimin e duhur.

3.3.4 NGJESHJA

3.3.4.1 E Përgjithshme

Ngjeshja e materialeve të dheut për rimbushje dhe mbushje, do të kryhet me përdorimin e pajisjeve ngjeshëse të përshtatshme për materialin e dheut që ngjeshet për përdorim në zonën ku po punohet. Ngjeshja e dheut duhet të kontrollohet gjatë ndërtimit për përputhshmëri në përqindje të dendësisë maksimale për çdo klasifikim zonal sipas specifitimeve.

3.3.4.2 Vendosija dhe Ngjeshja

Materiali mbushës dhe rimbushës do të vendoset në shtresa prej jo më shumë se 15 cm në thellësi. Para ngjeshjeve, çdo shtresë mbushëse ose rimbushëse duhet të njomet ose ajroset sipas nevojës për të dhënë përqindjen optimale të lagështisë së materialit të dheut. Materiali mbushës dhe rimbushës do të jetë i ngjeshur me dendësi maksimale prej 95% në një thellësi prej jo më pak 25cm për çdo klasifikim zonal në bazë të specifikimeve. Asnjë material mbushës ose rimbushës nuk do të vendoset në sipërfaqet të cilat janë me baltë, të ngrira ose që përmbajnë ngrica apo akull. Materialet për mbushje dhe rimbushje pranë strukturave duhet të sillen në mënyrë të barabartë rreth strukturës në thellësinë e materialit të mbushjes ose të rimbushjes (të matur nga fundi i themeleve ose i mureve mbajtës) deri në nivelin përfundimtar, e duhet të ngjeshen me makineri ngjeshëse të operuara me dorë. Mbushjet poroze duhet të ngjeshen me minimumin dy kalime të një ngjeshësi lëkundës të operuar me dorë.

3.3.4.3 Ngjeshja

Dheu i nënshtresës në prerje duhet të ketë një dendësi prej ta paktën 95% në thellësinë 25cm nën sipërfaqen e nënshtresës. Mbushjet, anët dhe/ose rimbushjet poshte soletes se betonit dhe 30cm e sipërme në zonat e shtruara duhet të ngjeshen në jo më pak se 95% të dendësisë maksimale; rimbushjet e tjera pranë por që nuk mbështesin elementë strukturorë të paktën 90%. 30 cm e sipërm të transheve duhet të ngjeshen në të paktën 95% si dendësi maksimale.

3.3.5 GRADIMI

3.3.5.1 E Përgjithshme

Të gjitha zonat brenda kufizimeve të shkalles nën këtë seksion, duke përfshirë zonat e kalimit do të jenë në shkallë uniforme. Sipërfaqet e përfunduara do të sheshohen me tolerancat e specifikuara.

3.3.5.2 Zonat me Bar

Zonat me sipërfaqe të përfunduara për të marrë shtresën finale nuk do të jetë më shumë se 3cm mbi ose nën pamjet e treguara nënshtresa.

Përqindja minimale me peshë të farës së gjallë do të jetë 88%.

Plehu do të jetë 12% nitrogjen, 18% fosfor dhe 12% potasium (12-18-12) dhe në përbërje uniforme, me derdhje të lirë dhe i përshtatshëm për përdorim

Nivelimi:

Parregullsitë në sipërfaqe nga plehërimi ose veprime të tjera duhet të nivelohen përpara se të hidhet fara.

Mbjellja e farave:

Të gjitha punimet e farave do të kryhen gjatë sezonit më të favorshëm të mbjelljes për speciet e përcaktuara.

3.3.5.3 Zonat e trotuareve

Sipërfaqja e zonës nën trotuare do të trajtohet në kufi, sipas shkalles, prerjeve dhe rifinitures sipërfaqja e përfunduara nuk do të jetë më shumë se 1-2cm poshte pamjeve të treguara.

3.3.6 PERPUNIMI I ZONAVE TË NGJESHURA

Ku është e duhur zonat e ngjeshura mund të preken nga ndërtimet e mëpasshme ose moti i keq, sipërfaqja duhet të riformulohet dhe ngjeshet siç specifikohet më lart, në dendësinë para se të kryhen ato ndërtime, ri- ngjeshja mbi kanalizimet nëntokësore duhet të kryhen me makineri të operuara me dorë.

3.3.7 MARRJA E KAMPIONEVE DHE TESTIMET

3.3.7.1 Testimi

Të gjitha testimet duhet të kryhen siç specifikohet më poshtë:

3.3.7.2 Testimi i mbushjeve me grimca

Testi i gradimit duhet të kryhet në çdo shembull. Testet duhet të kryhen për çdo 100 m³ material të përdorur ose një pjesë e saj dhe kurdoherë që ndryshon burimi.

3.3.7.3 Testi i Ngjeshjes

Testet e ngjeshjes duhet të kryhen në vendndodhje si më poshtë:

Materialët	Frekuenca e Testeve
(1) Mbushje dhe rimbushjet	1 për ngritje për çdo 100m ²
(2) nënshtresa (dendësia që është në vend)	1 për ngritje për çdo 800m ²
(3) mbushja e transeve poshtë shtresave	1 për ngritje për çdo 200m transe

4. STRUKTURA BETONI TE DERDHURA NE VEND

4.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

4.1.1 REFERENCAT

Standartet e references janë standartet shqiptare dhe standartet e vendeve të bashkimit Evropian EEC si dhe ato të Shteteve të Bashkuara (AFNOR, ASTM, AASHTO etj) që konsiderohen si ekuivalente.

Sipërmarresi për standartet duhet paraprakisht të marrë miratimin e Supervizorit të punimeve përpara fillimit të punimeve.

4.1.2 Njesite

Dokumentat dhe specifikimet teknike janë hartuar duke përdorur sistemin metrik ndërkombëter (SI) të njesive. Në këtë specifikim përdoren shkurtime të mëposhtme:

Njesite	Shkurtime
Milimeter	mm
Meter (linear, katror, kub)	m, m ² , m ³
Diameter	D
Ore	h
Litra	L
Rezistenca	MPa
Rezistenca	N/mm ²

Ngarkesa	Ton, [kg]
----------	-----------

4.1.3 Ligjet dhe Normat e aplikueshme

a) Normat Shqiptare

b) Normat dhe standardet Evropiane

DIN EN 12350-1 : 2001	Kampionet e betonit të marra në kantier
DIN EN 12390-2	Përgatitja e testeve të betonit
DIN EN 12504-1	Kampionet e betonit të forcuar
DIN EN 12390-3	Testet ne shkatërim të betonit ne shtypje
DIN EN 934-2	Perzjeresit e betonit dhe metodat e kontrollit
DIN EN 206	Betoni, specifikimet, performanca, prodhimi dhe konformiteti
DIN EN 12350-2	Testimi i betonit te Freskët –Testi i konsistences se betonit te fresket
DIN 18331	Procedurat e kontratës së ndërtimit (VOB) Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike në kontratat e ndërtimit . Punimet me beton
DIN 18541-1	Rripat ngjitës termoplastik waterstop per mbylljen e nyjeve te strukturave te betonit. Format, dimensionet, standartet.
DIN 18541-2	Rripat ngjitës termoplastik waterstop per mbylljen e nyjeve te strukturave te betonit. Testimet dhe inspektimet ne kantjer.

4.1.4 DOKUMENTACIONI

a) Të dhënat e Prodhuesit

Per cdo material te perdorur ne kantjer duhet te mbahen dhe te paraqiten paraprakisht tek mbikqyesi i punimeve certifikatat dhe karakteristikat teknike. Per perdorimin e materialeve te ndertimit duhet te merret miratimi me shkrim nga supervizori i punimeve.

b) Vizatimet Teknike

Nga fillimi i punimeve ne kantjer inxhinieri i kantjerit dhe supervizori duhet te pajien me dokumentacionin teknik te projektit.

Dokumentacioni teknik permban te gjithë dosjjen e vizatimeve teknike te nderhyrjeve ne strukturat ekzistuese dhe ne ndertimet e reja.

Permasat dhe pozicionet e elementeve strukturale duhet te verifikohen ne vend. Kjo kerkese eshte shume e rendesishme ne rastin e nderhyrjeve ne strukturat ekzistuese pasi mund te kete nderhyrje te realizuara ne kohe te mevoneshme nga ndertimi fillestar dhe te pa dokumentuara.

Vizatimet teknike per strukturat betonarme paraqesin dimensionimin e kallepeve dhe detajimin e armatures se celikut per cdo element struktural.

Gjate zbatimit te merret parasysh fakti se gjatesite e xhuntimit te shufrave jane dhene ne vlerat minimale te tyre. Cdo ndryshim duhet te jete ne vlera me te medha se ato te percaktuara ne vizatimet teknike

Vizatimet teknike per strukturat metalike paraqesin dimensionimin per cdo element struktural.

Gjate zbatimit ne nderhyrjet e strukturave ekzistuese permasat duhet te verifikohen ne vend.

4.1.5 DORËZIMI DHE RUAJTJA E MATERIALEVE.

Materialet e pakeluar duhet të dorëzohen në vendndodhjen e projektit në kopje origjinale te tyre, te pakeluar te pako apo kontenier të pahapur. Pakot duhet të mbajnë emrin e prodhuesit qartësisht të identifikueshëm, emrin e markës, materialin, peshën ose volumin, dhe informacione të tjera identifikuese, të ruajtura në origjinalin e tyre, pako ose kontenier të pathyer në një vend të thate dhe padepërtueshëm nga agjentet atmosferike, deri sa të jenë gati për përdorim. Përbërësit e papakeluar duhet të ruhen në mënyrë që të evitohen ndotje nga materialet e tjera. Armatura e celikut duhet te depozitohet në grumbuj të veçante, mbi toke për të shmangur ndryshkjen, ndotjen nga ndotësit si graso, vaj, pluhur etj. Per cdo paketim te thyer apo te hapur duhet te behet identifikim i sakte. Betoni plastik i pergatitur duhet te jete i gatshëm per kantjer pasi te jene realizuar kallepet dhe te jete lidhur armatura e celikut per strukturat betonarme.

Soletat e parafabrikuara qe perdoren kryesisht ne mbulesen e depos se karburantit do të dorëzohen dhe ruhen në kantjer pa u dëmtuar.

4.1.6 CILËSIA E BETONIT

Betoni klasifikohet bazuar ne:

a) Rezistencen

b) Klasen e ekspozicionit

c) Klasen e konsistences se betonit plastik

a) Rezistenca e betonit identifikohet nepermjet klasave te rezistences se betonit sipas tabelës me poshte.

Përdorimi sipas Euronormave percaktohet per cdo element nese nuk percaktohet ndryshe ne projekt.

Klasat e rezistences se betonit	
C 8/10	Beton mbushes
C 12/15	Shtresa
C 16/20	
C 20/25	Themele, kolona, trare, soleta
C 25/30	Themele, kolona, trare, soleta
C 30/37	Themele, kolona, trare, soleta
C 35/45	Suporte, ura, vepra te rendesise te vecante
C 40/50	
....
C 100/115	Ultra performance

b) Klasa e ekspozicionit përcaktohet sipas pozicionimit të elementit në strukturë.

Klasa e ekspozicionit	Veprimi
XC	Karbonatizim
XD	Kloride
XS	Uji i detit
XO	Korrozioni
XF	Ngricat
XA	Kimik

c) Klasa e konsistencës së betonit plastik

EN		
Klasa	Perdorimi	Masa e hapjes [mm]
S1	Cati, mbushje,	10 deri 40
S2	Themele, soleta, struktura të tjera	50 deri 90
S3	Themele, soleta, beton i pompueshem	100 deri 150
S4	Themele, soleta, shtresa, beton i pompueshem	160 deri 210
S5	Nivelim	>210

Klasat e rezistencës përcaktojnë paraprakisht përdorimin e betonit në elementet e vecante strukturale. Përcaktimi përfundimtar merr në konsideratë edhe faktorët e tjerë si klasën e ekspozicionit të elementit dhe klasën e konsistencës.

Për çdo element prej betoni ose betoni të armuar identifikimi i klasës së betonit të përzgjedhur duhet të plotësojë tre tabelat e mësipërme nëse nuk ka specifikim tjetër në projekt.

4.2 PJESA 2 - PRODUKTET

4.2.1 BETONI DHE BETONI I ARMUAR

4.2.2 Kërkesat e rezistencës

Rezistenca e betonit duhet të plotësojë kërkesat sipas projektit teknik për nderhyrjet strukturale në godinat ekzistuese dhe ndërtimin e elementeve apo strukturat e reja.

Referuar projektit teknik struktural klasa e betonit të kërkuar është C30/37.

Për punimet e tjera si shtresa, mbushje punime jo strukturale kërkesat për punime betoni i referohen tabelave të seksionit 1.6.

4.2.3 Cilësitë e betonit

Të përgjithshme

Betoni duhet të ketë një shtangesi minimale ngjeshjeje siç është treguar, në tabelën e paragrafit 6.2.1.1 vetëm nëse përcaktohet ndryshe.

Betoni duhet të plotësojë testet e rezistencës për mostrat standarte kubike me brinjë 15cm ose cilindrike me lartësi 30cm dhe diametër 15cm pas 28 ditësh i trajtuar në kushte temperaturë dhe lagështie standarte.

Betoni i gatshëm

Sipas DIN EN 206-1. Betoni i gatshëm është përcaktuar në specifikime si beton i prodhuar nga ndërmarrje tregtare dhe të dërguara tek blerësi në gjendje plastike. Betoni i gatshëm duhet përdorur nëse:

Fabrika ka kapacitete të mjaftueshme dhe pajisje transportimi për të dërguar betonin në normën e dëshiruar.

Intervali ndërmjet ngarkesave për zbrazje nuk i kalon 30 minuta.

Koha e shkuar ndërmjet hedhjes së ujit në përpëzierje me çimenton dhe agregatet, ose çimentos me përbërësit, dhe vendosjes së betonit në pozicionin përfundimtar në forma, nuk duhet të kalojë më shumë se një orë.

Betoni i gatshëm duhet të përzihet dhe dërgohet sipas një nga mënyrat e mëposhtme:

Përzierje qendrore

Përzierja qendrore duhet bërë duke përzier betonin plotësisht në një mikser të palëvizshëm në fabrikë dhe betoni i përzier të transportohet në vendndodhjen e punës me një betoniere ose me një mjet përzierës që punon gjatë transportit.

Përzierje tranzite

Përzierja transite duhet bërë në një betoniere. Përzierësit dhe tundësit duhen drejtuar brenda limiteve të kapacitetit dhe shpejtësisë së rrotullimit të përcaktuar nga prodhuesi, dhe duhet të jenë të aftë të prodhojnë një përzierje homogjene dhe me ngjyrë uniforme.

Çimento

Në përgjithësi duhet të jetë çimento Portland, nëse nuk është përcaktuar ndryshe. Çimento Portland duhet të jetë në përputhje me (DIN 1164) ose (EN-2). Kontraktuesi është i detyruar që për çdo ngarkesë çimentoje të sjellë në objekt, të paraqesë faturën e blerjes e cila të përmbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe çertifikatën e prodhuesit dhe shërben për të treguar që çimentoja e secilës ngarkesë është e kontrolluar dhe me analiza sipas standardeve.

Uji

Uji duhet të jetë i freskët, i pastër jo agresiv ndaj perberesve të betonit. Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë i pastër nga substancat që demtojnë atë si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe substanca të tjera organike. Në përgjithësi, uji i tubacioneve të furnizimit të popullsisë (uji i pishem) rekomandohet për përdorim në prodhimin e betonit.

Agregatet

Agregatet për betonin duhet të jenë në përputhje me standardet ISO apo standarde të barasvlefshme. Klasa duhet të jetë e tillë që të prodhojë beton me përmasa dhe dendësi të caktuara sipas kërkesave të projektit dhe që të jetë i gatshëm për tu përdorur. Madhësia e agregateve të hollë dhe të trashë përcaktohet në varesi të klases së përzgjedhur të betonit. Për rastet e betonit të kërkuar në projekt nuk duhet të kalojë madhësia 22mm.

4.2.4 Depozitimi i materialeve

Depozitimi i materialeve që do të përdoren për prodhimin e betonit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- çimentoja dhe perberesit duhet te depozitohen ne ate menyre qe te ruhen nga perzierja me materiale te tjera, te cilat nuk jane te pershtatshme per prodhimin e betonit dhe e demtojne cilesine e tij.
- çimentoja duhet te depozitohet ne ambjente pa lageshtire dhe qe nuk lejojne lagien e saj nga uji dhe shirat.

Aditivet

Përzierësit shtese për betonin duhet të jenë sipas DIN EN 206-1. Supplementet shtese per përzierje duhet të jenë nga i njëjti prodhues i përzierësve shtese, ose duhet të jenë certifikuar për të qenë të pajtueshëm me të gjithë elementet perberes te betonit per te arritur rezistencat e kerkuara.

Armatura

Sipas ENV 10080 armatura duhet të jetë çelik i vjaskuar me rezistence 500 N/mm² dhe me diametër minimumi 6mm. (BSt 500 S gjermane sipas DIN 488).

Karakteristikat dhe perberja e celikut te armatures per strukturat betonarme duhet te kontrollohen paraprakisht sipas certifikates se prodhimit.

Testet e provave ne terheqje dhe perkulje duhet te realizohen paraprakisht per te kontrolluar cilesine e celikut e krahasuar me certifikaten e prodhimit.

4.3 PJESA 3 - ZBATIMI

4.3.1 Kallepet

Kallepet realizohen prej druri ose ne raste te vecanta metalike.

Duhet te kushtohet kujdes ne percaktimin dhe projektimin e elementeve te kallepeve sipas pozicionit. Kallepet standart per realizimin e strukturave jane elementet me gjatesi 0.9, 2.70m etj. per elementet vertikale te brendshem dhe te jashtem.

Perforcuesit e kallepeve duhet te pozicionohen dhe te percaktohen lidhjet midis tyre sipas standarteve evropiane ne lidhje universale ose jo universale, cepat e brendshem dhe te jashtem me permasa minimale 0.3m, pajantimet dhe konsolat.

Kallepet duhet te jene në vijë të drejtë dhe te niveluara. Para derdhjes së betonit, kallepet të lyhen ne sipërfaqet e kontaktit të formave me një përbërës që formon një shtresë e cila siguron heqjen e kallepeve pa demtuar betonin. Betoni për themelet dhe kolonat fundore mund të vendoset në gjermime pa kallepe, pas inspektimeve dhe miratimit të Mbikëqyrësit. Gjërësia e gjermimit do të jetë një minimum prej 30cm më e madhe se permasimi i kallepeve.

Kontraktori duhet të jetë përgjegjës për projektimin e kallëpeve dhe duhet të furnizojë dhe të rregullojë të gjithë kallëpet, bashkë me skelat shoqëruese, lëndë druri, mbështetjen, përforcimin, etj., që kërkohen për vendosjen e betonit. Gjate perdorimit te skelerise se drurit, sipërfaqja e kallëpit, kur vjen në kontakt me betonin e njomë duhet bërë me dru të vjetruar në mënyrën e duhur, me trashësi të mjaftueshme që ti rezistojë betonit të njomë ndërkohë që ai vendoset dhe derdhet, pa asnjë keqformim.

4.3.2 Armatura

Armatura duhet të pozicionohet në kallepe dhe të vendoset ne menyre qe te krijoje mundesine e realizimit te shtreses mbrojtese te betonit.

Shufrat e armatures do te mbeshteten ne distancatore metalike. Për soletat ne nivelin e mbeshtetjes ne toke shufrat ose rrjeta metalike duhet të mbështetet mbi blloqe betoni të parafabrikuar, të vendosura në

intervale të kërkuar nga madhësia e armatures që do të përdoret, për të ruajtur armaturen dhe për të realizuar shtresën mbrojtëse në lartësinë minimale të specifikuar mbi nënshtresën e themeleve. Armatura duhet të pozicionohet duke përdorur tela lidhës dhe duhet të vendoset në mënyrë të sigurt dhe të lidhet në çdo bashkim me tela bari me diametër 1,6mm. Fundet e telave lidhës duhet të jenë larg formës. Saldimi i shufrave të kryqëzuara nuk do të lejohet por vetëm nëse nuk autorizohet në mënyrë specifike nga Mbikëqyrësi.

4.3.3 Ankorimi i armatures

Ankorimi i armatures duhet të jetë 40_50 here diametrin e shufres nëse nuk ka një përcaktim ndryshe në projekt.

Sipas ENV 10080 armatura duhet të jetë çelik i vjaskuar me rezistencë 500 N/mm² dhe me diametër minimumi 6mm. (BSt 500 S gjermane sipas DIN 488).

4.3.4 Shtresa mbrojtëse e betonit

Minimumi i shtresës përforcuese të betonit duhet të jetë:

Themelet pllake dhe plinta	50mm
Elementet strukturale trare kolona	30mm
Soleta	20mm
Mure	25_30mm

Vendosja e Materialeve të Ndryshme

Të vendosen dhe ankorohen në vend bulonat, "kemishat" e tubave, tuba dhe materialet të tjera para se të derdhet betoni. Të lidhen bulonat ankorues dhe të kontrollohet vendndodhja dhe lartësia.

4.3.5 Betonimi

Betoni duhet të derdhet në mënyrë monolite. Betoni i gatshëm në betoniera ose makineri do të jetë i pranueshëm nëse përmbushen kërkesat e mëposhtme:

Betoni i parapërgatitur që vjen nga nyjet e betonit do të furnizohet nga prodhuesi me fatura dublikate në çdo dërgesë betoni për në kantier, një për Mbikëqyrësin dhe një për Kontraktorin. Në fatura shenohen: Lloji dhe klasa e çimentos

Sasia e çimentos për metër kub të betonit

Madhësia maksimale e përbërësve

Përmbajtja totale e ujit e shprehur me raportin Ujë/Çimento

Identifikimi i Kamionit

Volumi i kamionit të betonit

Koha e ngarkesës

Betoni duhet të derdhet në vend brenda 90 minutave të prodhimit nëse temperatura e ajrit është më pak se 30 gradë Celsius, të ulët koha e derdhjes në vend në 60 minuta nëse temperatura e ajrit është më e lartë se 30 gradë Celsius. Uji shtesë mund të hidhet tek betoni nëse raporti maksimal ujë-çimento nuk kalohet.

Të mos derdhet betoni nëse:

(a) kushtet atmosferike nuk janë të pershtatshme, në rastet e temperaturave ekstreme të larta ose të ulta

(b) në zona të pambuluara gjatë periudhës së reshjeve

Para se të derdhet betoni në vend, të hiqen papastërtitë, mbetjet e ndërtimit, uji, dëborë dhe akulli brenda kallepeve. Betoni nuk duhet të lejohet të bjerë i lirë nga sillosa, nëse betonimi bëhet i tillë, nga një lartësi më e madhe se 3m.

Rekomandohet që prodhimi dhe hedhja e betonit në objekt të mos realizohet në kushte të vështira atmosferike. Të mundësohet betonimi deri në 10 gradë Celsius si minimum i temperaturës së ambientit gjatë betonimit. Ndalohet prodhimi dhe hedhja e betonit në rast se bie shi i rrembyshëm, pasi ndikon në klasën e rezistencës së betonit. Në rastet e temperaturave të ulta nën 4°C rekomandohet të mos kryhet betonimi por në qofte se kjo është e domosdoshme, atëherë duhet të merren masa që gjatë procesit të prodhimit të betonit, të shtohet solucioni ndaj ngjicave në masën e nevojshme që rekomandohet nga prodhuesi i solucionit. Prodhimi dhe perpunimi i betonit në temperatura të larta mund të ndikojë negativisht në procesin e ngurtësimit të betonit.

Të mundësohet temperatura 32 gradë Celsius si temperaturë maksimale motit gjatë betonimit.

Trajtimi i betonit të freskët

Trajtimi i betonit në veper fillon në momentin që betoni hidhet nga betonpumpa ose sillosi me vibrimin në pozicione të vibratorit që rrezja e mbulimit të mbivendoset në zonat e trajtuara të strukturës.

Betoni duhet të trajtohet gjatë hedhjes në veper në mënyrë që të krijojnë kushte për ngurtësim pa të plasura për efekt të tkurrjes së hershme të betonit. Për këtë, gjatë fillimit të ngurtësimit e në vazhdim betoni i freskët duhet të laget në mënyrë që reaksionet kimike të ngurtësimit të zhvillohen në prezencën e ujit dhe nxehtësia që ato clirojnë gjatë ngurtësimit të betonit të mos krijojë fenomenin e gjakrrjedhës së betonit të shoqëruar me plasaritje që në fazën e hershme të jetesë së tij.

Betoni i freskët nuk duhet të ekspozohet ndaj goditjeve, dridhjeve dhe temperaturave shumë të ulta ose të larta. Menjëherë pas vendosjes, shtresat e betonit duhet të vibrohen duke përdorur vibratorë të brendshëm betoni të mundësuar dhe të lëvizshëm me dorë, shufra dhe ngjeshje. Goditjet nga jashtë ose forma të tjera të lëkundjes nga jashtë të formave nuk lejohen. Vibratorët nuk duhet të përdoren për të transportuar betonin brenda formave. Vibratorët e brendshëm të zhytur në beton duhet të ruajnë një frekuencë minimale prej jo më pak se 8000 lëkundjesh në minutë. Zgjatja e lëkundjeve do të jetë nga 5 deri në 15 sekonda. Vibratorët duhet të aplikohen në pikat e baraslarguara prej 45cm të vendosur në forme shahu.

Nëse fugat janë të nevojshme, pozicioni i tyre duhet të diskutohet me Mbikëqyrësin.

Pas betonimit të mundësohet aplikimi i vazhdueshëm dhe i njëtrajtshëm i spërkatjes me ujë në të gjithë periudhën e trajtimit. Trajtimi duhet të jetë aplikimi i drejtë për drejtë i ujit.

Të përmblytet sipërfaqja me ujë pasi betoni të jetë forcuar mjaftueshëm në mënyrë që të mos dëmtohet sipërfaqja e elementeve. Të aplikohet spërkatja me ujë për një minimum prej dy ose tre herë në ditë dhe aq herë sa diktojnë kushtet atmosferike të ambientit dhe të lejohet trajtimi i betonit me këtë metodë për një periudhë minimale shtatë ditore.

Defektet

Të riparohen sipërfaqet pas hejes së kallepeve duke shmangur gërryerjet dhe gropëzat, më të mëdha se 2cm² ose 6mm në thellësi, ose zona të tjera të tilla të zbuluara. Të realizohen cepat pingul me sipërfaqen dhe të riparohen me llac cemento që nuk tkurret. Të riparohen brimat e lidhjeve dhe defekte kur hiqen kallepet. Deformimet nuk duhet të ndryshojnë më shumë se tolerancat e lejueshme që janë përcaktuar. Sipërfaqet e ekspozuara duhet të jenë të njëtrajtshme

Trajtimi dhe ruajtja

Të ruhet betoni nga veprimi dëmtues i diellit, shiut, ujit që rrjedh, ngricave, dëmtimeve mekanike, shenjave të gomave dhe njollave të vajit.

Kallepet mund të hiqen deri 48 orë pas derdhjes së betonit.

Të parandalohet trafiku më këmbë ose me makina me makineri gërryese për jo më pak se 72 orë pasi të kenë përfunduar betonimi.

Kontrolli i cilesise se betonimit, testimi i betonit

Kontraktori duhet të bëjë marrëveshjet e nevojshme për testimin e betonit të forcuar dhe të freskët në përputhje me dispozitat e EN 206 dhe duhet të furnizojë me gjithë aparateturat, fuqinë punëtore, materialet dhe transportin e nevojshëm.

Të realizohen kampionet e betonit të freskët ne forma kubike standarte për të kryer testet e rezistences se betonit. Te kontrollohet konsistenca e betonit para hedhjes ne veper.

Testet e konsistences se betonit duhet te kryhen:

- (a) Ne fillimin e hedhjes së betonit,
- (b) Kur pergatiten mostrat e testimit
- (c) Për çdo grup ose çdo 10m³ beton.

Të bëhen një minimum prej pesë kubesh për testim me përmasat 150/150/150mm për testimin ne shtypje te betonit. Mostrat duhet te jene te zhytura ne uje. Të testohen kubat fillimisht pas 8 ditësh dhe të rruhen kuba rezervë.

Kubat e betonit për testet e shtypjes duhet te merren jo më pak se njëherë për cdo 30 m³ betoni. Jo më shumë se 10% të kubave të testuar lejohet te tregojnë se betoni i derdhur nuk përmbush kërkesat për specifikim ose aty ku është faktuar se cilësia është nën kerkesat e duhura duhet te raportohet. Kosto e testeve të tilla duhet të mbartet nga Kontraktori.

Betoni duhet te plotesoje kerkesat per rezistencen e nese kjo nuk duhet te zevendesohet me beton të ri pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktues.

Rezultatet e Testeve

Të paraqiten rezultatet e testeve si pjesë e “Raportimeve Ditore të Mbikëqyrësit” përveç se rezultati i Testeve në shtypje duhet të raportohet.

Heqja e kallepeve

Kallepet nuk duhet të hiqen para se betoni të jete ngurtesuar mjaftueshëm për të mbajtur peshën e vet dhe ndonjë ngarkesë tjetër që vendoset mbi të. Ky kusht duhet kerkon që kallepet të qëndrojnë në vend, pas hedhjes së betonit si me poshte.

Alikimi i “epoxy resina“ per lidhjen e betonit te vjeter me betonin e ri

Eproxy resina eshte materiali kimik qe mundeson lidhjen e betonit të ri me atë ekzistues.

Sipërfaqja e kontaktit duhet të ashpersohët. Duhet të hiqet pjesa sipërfaqesore e elementeve ekzistues.

Sipërfaqja e kontaktit të betonit të ri, me atë ekzistues, lyhet me penel me “Eproxy resina”. Lyerja duhet të jetë e kujdesshme dhe e njëtrajtshme. Nuk lejohet lënia e zonave pa lyer me lidhes. Kujdes i veçantë duhet të tregohet për të mbushur mirë me lidhës zonat e poreve. Lyerja mund të bëhet edhe me sprucim, me anët e pajisjet e posaçme.

Pas lyerjes së sipërfaqes së kontaktit duhet që brenda disa minutave te percaktuara ne instruksionin e perdorimit, bëhet derdhja e betonit të ri.

Jashtë kohes se kerkuar nuk lejohet betonimi pasi lidhësi është mpiksur dhe ai jo vetëm që nuk ndihmon procesin e lidhjes së betonit të ri me atë ekzistues, por e pengon atë.

4.3.6 Muratura

Muratura realizohet me tulla te plota per muret mbajtes dhe tulla me birra per muret ndares. Ne strukturat ekzistuese muratura ndarese do te realizohet me mure gipsi per te lehtesuar ngarkesen e strukturave.

Specifikimi per tullat

Tulla si element i ndertimit duhet te plotesoje kushtet e meposhtme per ndertimet antisizmike:

- Rezistenca ne shtypje duhet te jete: per tulle te plote $75\text{kg}/\text{cm}^2$; per tulle me vrime $80\text{kg}/\text{cm}^2$
- Rezistenca ne prerje e cila duhet te jete per te gjitha tullat me vrime $20\text{kg}/\text{cm}^2$.
- Perqindja e boshlleqeve e cila duhet te jete: per tullen e plote 0-25%; per te gjitha tullat me vrime 25-45%.
- Trashesia e pareteve perimetrare dhe te brendshem per tullat e plota te mos jete me e vogel se 20mm dhe per te gjitha tullat me vrime, trashesia e pareteve perimetrare te mos jete me e vogel se 15mm dhe e pareteve te brendshem jo me e vogel se 9mm.
- Siperfaqja e nje vrime te mos jete me e madhe se 4.5cm^2 .
- Ujethithja ne perqindje duhet te jete nga 15-20%.

Specifikimi per llacin e muratures

Tipet e llaçeve

Llaçi per muret per 1m^3 llaç realizohen me keto perberje:

- Llaç bastard me rere natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% dhe porozitet 40% e formuar me rere ne raporte 1:0.8:8. Gelqere e shuar ne 110lt, çimento 300, 150 kg, rere 1.29m^3 .
- Llaç bastard marka 25 me rere natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% me çimento: gelqere: rere ne raporte 1:0.5:5.5. Gelqere e shuar ne 92lt, çimento 300, 212 kg, rere 1.22m^3 .
- Llaç bastard marka 15 me rere te lare (porozitet 35%) e formuar me çimento: gelqere: rere ne raporte 1:0.8:8. Gelqere e shuar ne 105lt, çimento 300, 144 kg, rere 1.03m^3 .
- Llaç bastard marka 25 me rere te lare (porozitet 35%) e formuar me çimento: gelqere: rere ne raporte 1:0.5:5.5. Gelqere e shuar ne 87lt, çimento 300, 206 kg, rere 1.01m^3 .
- Llaç-çimento marka 1:2 me rere te lare e formuar me çimento, rere ne raport 1:2 çimento 400, 527kg, rere 0.89kg.

Specifikimi per muraturen

Mur me tulla te plota 25cm / 40 cm / 55 cm

Muratura me tulla te plota mbajtese ne lartesi deri 3m, realizohet me llaç bastard

M-25 sipas receptures te sipermendur me permbajtje per m^3 : tulla te plota, llaç bastard 0.25m^3 , çimento 400 dhe uje per çdo trashesi muri duke perfshire çdo detaj dhe kerkese per qoshet, parmaket, skelat e sherbimit, si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muratures dhe realizimin e saj. Per muraturen e katit perdhe, siperfaqja e xokolit duhet te jete e niveluar me nje shtrese llaç çimento 1:2 me trashesi jo me te vogel se 2cm.

Mur me tulla te lehtesuara

Murature me tulla te lehtesuara ne lartesi deri 3m, realizohen me llaç bastard M-25 me permbajtje per m^3 : tulla te lehtesuara, llaç bastard 0.29m^3 , çimento 400 dhe uje per çdo trashesi duke perfshire çdo detaj dhe kerkese per dhembet e lidhjes, qoshet, hapjet ne parapetet e dritareve, skelat e sherbimit ose skelerine, si

dhe çdo gje tjetër të nevojshme për mbarimin e muratës dhe realizimin e saj. Për muratën e katit përdhe sipërfaqja e xokolatës duhet të jetë e niveluar me një shtresë llaç çimento 1:2 me trashësi jo më të vogël se 2cm.

Mur ndares 12cm

Murature me tullë të plotë me trashësi 12cm dhe llaç bastard m-25 me përmbajtje për m³: tulla të plotë, llaç bastard 0.19m³, çimento 400 dhe ujë

4.3.7 Strukturat metalike

Prodhimi i çelikut duhet të jetë bërë nga kompani të licencuara që duhet të garantojnë cilësinë si dhe të dhënat e tjera të çelikut (përberja kimike, karakteristikat fizikomekanike, etj).

Çeliku që përdoret për konstruksionet mbajtëse duhet t'u përgjigjet kërkesave të standarteve dhe kushteve teknike dhe të kete garanci përse i përket kufirit të rrjedhshmerisë dhe përmbajtjes maksimale të squfurit dhe fosforit; kurse për konstruksionet e salduara ka kërkesa për përmbajtjen maksimale të karbonit.

Prerja, saldimit si dhe lidhje e elementeve prej çeliku bëhet në kanierin e firmës kontraktuese dhe ata transportohen në kantier ose këtu punime mund të bëhen në vendin e punës (në objekt).

Sidoqoftë, duhet që punimet para montimit të elementeve të kontrollohen nga supervizori dhe duhet të protokollohen.

Përgatitja për saldimit përfshin atë që detajet para se të saldohen, të kenë marrë formën e tyre përfundimtare. Po ashtu, buzet dhe sipërfaqet e pjeseve që do të saldohen duhet të përgatiten sipas kërkesave të procedurës së saldimit dhe formave që jepen në pasqyrat 6, 7, 8 të KTZ 206-80 ose në normat përkatëse europiane.

Pas saldimit, detajet duhet të trajtohen termikisht për të zvogëluar nderjet e brendshme, për të menjanuar të plasurat dhe për të permisuar vetitë fizikomekanike. Gjate zbatimit të punimeve për saldimitin e çelikeve duhet të mbahet dokumentacioni teknik me të dhëna për çertifikatën e materialeve të përdorura, ditarin e punimeve, etj.

Lidhja me bullona

Elementet prej çeliku mund të lidhen/bashkohen edhe me ane të bulonave.

Lidhja me bulona duhet t'u përgjigjet normave dhe standardeve bashkohore (EC3 ose ndonjë standardi ekuivalent).

Kualiteti i bulonave luan gjithashtu një rol të rëndësishëm dhe këtu të fundit po ashtu, duhet t'u përgjigjen normave të sipërper mendura. Është më e rëndësishme që bulonat t'i plotësojnë kushtet e rezistencës së llogaritjes të bashkimeve me bulona. Lloji i gjendjes së tensionuar dhe grupi i bashkimit, të cilat duhet të përmbushin kushtet e nevojshme të kërkuara nga normat/ standardet për:

- Terheqja
- Prerja
- Shtypja

Gjate zbatimit të punimeve për lidhjen me bulona të çelikeve duhet të mbahet dokumentacioni teknik me të dhëna për çertifikatat e materialeve të përdorura, ditarin e punimeve, etj.

Ngritja

Ngritja e elementeve prej çeliku bëhet sipas planeve të përgatitura nga arkitekti/ inxhinieri. Inxhinieri duhet të supervizoje punën e ngritjes së elementeve metalike ose konstruksioneve metalike.

Mbrojtja nga agjentet atmosferike
Mbrojtja e çelikut bëhet në dy mënyra:

- Duke e lyer çelikon me disa shtresa, të cilat e mbrojnë atë prej korrozionit. Kjo bëhet duke e lyer, zhytur ose sperkatur me shtresa. Njëra shtresë është baza, kurse shtresa tjetër përdoret edhe si dekorim i elementit

dhe mund të ketë ngjyra të ndryshme. Siperfaqet në të cilat do të vendosen këto shtresa, duhet që me parë të përpunohen dhe të jenë të lira nga vaji, pluhuri apo ndryshku.

Shtresa prej metali. Kjo mbrojtje është e përhershme. Çeliku duhet zhytet në zink të nxehtë (450°C) dhe sipërfaqja e tij të jetë e lirë prej pluhurit, vajit si dhe ndryshkut. Përmbi të, mund vendoset ndonjë shtresë tjetër si dekorim i elementit prej çeliku.

Ndalohet rreptesisht lyerja e çelikeve për betonim me vajra.

4.3.8 Punimet e ndertimit

Punimet e ndertimit që do të kryhen duhet të monitorohen nga Mbikqyresi i punimeve. Konkretisht duhet të monitorohen punimet e mëposhtme:

1. Prishja dhe ndertimi i mureve në godinen ekzistuese.
2. Realizimi i arkitrareve në muret mbajtëse që mundesojnë hapjen e çarjeve për të realizuar skemën e shfrytëzimit të spitalit. Në projekt janë dhënë dy mundësi për realizimin e tyre si arkitrare metalike dhe arkitrare betonarme të parapergatitur. Kontraktori mund të përdorë secilin tip. Arkitraret metalike janë më të lehtë për montim dhe vendosje por duhet të realizohen e të kontrollohen me rigozitet nga inxhinieri i kantjerit dhe Mbikqyresi i punimeve.
3. Ndertimi i maternitetit të ri. Struktura është realizuar prej betoni të armuar.
4. Ambjentet teknike realizohen me struktura betonarme.
5. Soleta e ambjenteve teknike të gazit medikal realizohet me konstruksion me trare metalike dhe betonarme.
6. Ura lidhëse midis ambjenteve me struktura metalike.
7. Realizimi i struktureve të ashensorit panoramik.

Të gjitha punimet e përmendura janë punime thelbësore që lidhen me strukturën mbajtëse të secilit objekt konkret. Monitorimi nga ana e inxhinierit të zbatimit dhe Mbikqyresit të punimeve duhet të kryhet në kërkesa të forta të zbatimit të projektit dhe kushteve teknike.

5. PUNIMET STRUKTURA METALIKE

5.1 PJESA I – E PËRGJITHSHME

5.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtyre specifikimeve në sasinë e marrë si referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin bazë.

5.1.1.1 Normat dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare

5.1.1.2 Normat dhe Standardet Evropiane

DIN V ENV 1993 Përcaktimi i Strukturave Metalike

DIN EN 10025 Produktet e kthyer me të nxehtë të strukturave metalike

5.1.2 PARAQITJET

Paraqisni si më poshtë:

5.1.2.1 Vizatimet Teknike

Para se të ngrihen strukturat metalike paraqitni vizatimet teknike për miratim. Riprodhimet e skicave të kontratave si vizatime teknike nuk janë të pranueshme.

Mundësoni, llojin, shkallën, përmasat dhe detajet e trarëve dhe arkitrarëve horizontalë, duke përfshirë përforsimin, aksesorët dhe ankorimet. Për më tepër mundësoni diagramet e mbledhjeve, prerjet dhe format e llojet e hekurave. Të mos shkallëzohen dimensionet nga vizatimet strukturore për të përcaktuar gjatësitë e hekurave përforsues.

5.1.2.2 Certifikatat e Përputhshmërisë

Paraqitni certifikimet e mëposhtme të prodhuesit:

Punimet e Çelikut

Dadot dhe vidat

Materiali i Lyerjes së Sipërfaqes

Elektrodat dhe

5.1.2.3 Kontrolli i Cilësisë

- a) Inspektorët e saldimeve duhet të jenë të certifikuar nga Standardet e duhura Shqiptare ose baraz vlefte e tyre në normat e BE në bazë të miratimit nga Mbikëqyrës ose përfaqësues të tij.
- b) Te kryhet inspektimin dhe testimi i prerjeve të vëna nga prodhuesi në se seksionet e çelikut në vendndodhje të ndryshme.
- c) Testime jo shkatërruese të lidhjeve me saldime:
Te kryhen testime jo shkatërruese të lidhjeve me saldime si më poshtë:
 - 1.10% të lidhjeve të momentit që përshijnë saldimet filetë, me inspektime magnetike.
 - Të gjitha lidhjet e momentit dhe të gjitha lidhjet nën presion të drejt për drejtë duke përdorur saldime me depërtim të thellë, nëpërmjet testimeve me ultrasound.
 - Kur momentet transferohen ose me saldime filetë ose me ato me depërtim në pllakat fundore në bashkimet "T", "U" dhe "L", të shikohet metali bazë për çarjet laminarie ose me thyerje, me testime me ultrasound.
 - Për instalimin e tolerancave duhet të aplikohen standardet Shqiptare dhe ato të BE.

5.2 PJESA 2 - PRODUKTET

5.2.1.1 MATERIALET E ÇELIKUT

- Materialet e reja duhet të jepen në përputhje me standardet e referuara, të fuqisë dhe cilësisë së shënuar në skicat strukturore.
- Kanalet e formuara me të ftohte:
- Të prodhohen në bazë të normave Shqiptare dhe atyre të BE.
- Bulonat ankorues: në standardet Shqiptare dhe normat e BE.
- Kunjat e salduar për pllakat e vendosura duhet të jenë në përputhje me standardet Shqiptare dhe Normat e BE.
- Kontraktori duhet të sigurojë përputhshmëri për mbrojtjen ndaj zjarrit me spërkatje para se të aplikohet mbushësi.
- Bulonat e fuqishëm duhet të përdoren në bazë të kodeve Shqiptare dhe atyre të BE dhe gjithashtu në bazë të shënimeve në skica.

5.2.1.2 LYERJA

I gjithë çeliku strukturor duhet të jetë i galvanizuar në thellësi e nxehtësi siç tregohet kurdoherë në skica.

5.2.1.3 MBROJTJA NDAJ ZJARRIT

I gjithë çeliku strukturor duhet të jetë i mbrojtur ndaj zjarrit për të arritur gamën e mbrojtjes ndaj zjarri prej 1 ore. Metoda e mbrojtjes ndaj zjarrit duhet të jetë e përputhshme me atë përfundimtar të miratuar nga Mbikëqyrësi ose përfaqësuesi i tij.

5.2.1.4 Çeliku Strukturor

Çeliku strukturor (për trarët, arkitrarët dhe trarët horizontal) duhet të përzgjidhet në bazë të EN 10025

5.2.2 DADOT, VIDAT DHE RONDELAT

5.2.2.1 Dadot

EN 24014, EN 24016, EN 24017 dhe EN 24018

5.2.2.2 Vidat

EN 24032, EN 24034, ISO 7413

5.2.2.3 Rondelat

ISO 7089, ISO 7090, ISO 7091

GALVANIZIMI: Galvanizimi pas prodhimit duke përdorur një shtresë zinku me spërkatje termale (metalizimi)

5.3 PJESA 3 - ZBATIMI

5.3.1 INSTALIMI

Pas pozicionimit fundor të pjesëve të çelikut, të mundësohet mbështetja fundore të trarëve të çelikut, të mundësohet mbështetje e plotë nën pllakat baze dhe ato fundore duke përdorur fino që nuk shtypet. Të vendoset nën çelikon strukturor siç tregohet në skica një lloj spesor i miratuar, i cili i ka dimensionet në skica. Pas pozicionimit përfundimtar të shtyllave të çelikut, të mundësohet mbështetje e plotë nën bazament dhe pllakat bazë duke përdorur fino e cila nuk shtypet. Të vendoset fino e cila nuk shtypet në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

5.3.2 LIDHJET

Të mos shtrëngohen bulonat ankorues të vendosur në beton me trapan. Të shtypen, ose shtrembërohen ose të shpohen brima për bulonat. Bulonat, dadot, dhe rondelat duhet të jenë të pastra dhe të lubrifikohen menjëherë para instalimit.

5.3.2.1 Bulonat

Bulonat duhet të shtrëngohen deri sa të jenë "shtrënguar mjaft". "Shtrënguar mjaft" është shtrëngimi i cili ekziston kur elementët në një bashkim janë tërësisht në kontakt. Nëse kontakti i sigurt i nyjave dhe pllakave

nuk mund të arrihet me disa shtrëngime e rrotullime të çelësave, ose me përpjekje e plotë të një punëtori i cili përdor veglat për shtrëngim, të kontaktohet Mbikëqyrësi për udhëzime të mëtejshme. Të testohen një minimum prej 3 lidhjesh bulona vidë dhe rondele.

5.3.3 SALDIMI

Të përdoret saldimi me hark dhe me çelik me elektrodë me pak hidrogjen. Të mos lehtësohet tensioni nga saldimet e ekspozuara por të pastrohen siç tregohet. Të mundësohen saldatorë me eksperiencë, e operatorë saldatricesh. Heqja e saldimeve të përkohshme, pjatave të cilat kalojnë saldimin dhe rripat mbështetës e testet e tyre duhet të përzgjidhen nga Mbikëqyrësi. Nëse më shumë se 20% i saldimeve të bëra nga një saldator përmbajnë defekte të treguara nga testimet, atëherë të gjitha saldimet e kryera nga ai saldator duhet të testohen nga testimet ultrasonike ose radiografike në bazë të miratimit të Mbikëqyrësit.

6. ASHENSORËT

6.3.1 Ligjet dhe Normat e Aplikueshme Shqiptare

Ndërtimi i kullës së ashensorit duhet të jetë në përputhje me Specifikimet:

TIPI	Ecospace
Përdorimi	Për lëvizje njerëzish
Kapaciteti	1250 kg
Shpejtësia	1 m/sec
Ndalesa	4/2 ndalesa
Nr portave	4/2 porta
Rruga aktive	13.6 [m]
Tipi mekanizmit ngritës	Ecodisk® Gearless
Sistemi i nisjes	KDL16L
Tipi i makinës	MX06
Fuqia	3.7 kW
Nr. I rrotullimeve	95 rpm
Nr. I nisjeve në orë	Maximum 180/hour
Kabina	
Përmasat	1200 x 2350 x 2075 [mm]
Veshja e kabinës	Inoks i tipit me pore kunder gerrvishtjes
Ndriçimi	Tavan inoksi me LED spote dritash
	Tipi i tavanit: CL80 Asturias Satin
Dritë emergjence	Po
Ventilimi	Po
Pasqyra	½ Pasqyre perballe deres se kabines (Ana C)
Parmaku	Inoks i tipit HR53 (Ana C)
Dyshemeja	Granit
Opsione	Extra izolim i zhurmave
Porta e kabinës	
Tipi	KES 201
Përmasat	1100 x 2000 [mm]
Lloji materialit	Inoks
Opsion shtesë	Fotokurtine

Materiali	Portat e katit	
	Tipi	KES 201
		2 automatic gates
	Përmasat	1100 x 2000 [mm]
		Inoks
	Opsione	Door Map – MAP Inoksi tek dera në katin e fundit
	Butoneria e Kabinës	KSS 370
	Display	7 segmente
	Treguesat e kateve	KSI 370 - Display në të gjitha katet
	Butonat e kateve	KSL 420
	Operime	Full Collective Simplex
	Operime speciale	ABE M, Zile alarmi në katin kryesor EBD, funksionim në ndërprerje të korrentit me bateri emergjence; ADO/ACL B, Hapje e avancuar e derës dhe nivelim i saktë i hapjes së derës; DOE B, Hapje e derës me kohë të avancuar; DCB, Buton i mbylljes së shpejte të derës Emergency Intercom Car-MAP;
	Furnizimi	220 / 380V – 50Hz
	Vendosja e makinerisë	Hapje në anën e djathtë
	Direktivat	Direktivat Europiane të Ashensoreve EN81-20
Përmasat e oxhakut	Gjerësi x thellësi 1950 x 2980 [mm]	
Lartësia nga dyshemeja e katit më të sipërm deri në tavanin e pusit (OH)	3300 [mm]	
Thellësia e gropës së pusit	1100 [mm]	

7. MURATURA

7.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

7.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi në masën që janë marrë si referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin bazë.

7.1.1.1 Ligjet dhe Rregullat e Aplikueshme Shqiptare

7.1.1.2 Normat dhe Standardet Evropiane

Puna me Blloqe/Tulla

DIN EN 771-1	Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 1: Murature me njësi tulle Argjile
DIN EN 771-2	Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 2: Murature me njësi tulle Silikate prej kalciumi
DIN EN 771-3	Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 3: Murature me njësi me Përbërës Betoni (me agregat të dendur dhe të lehtë)
DIN EN 771-5	Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 5: Murature me njësi guresh te fabrikuar
DIN EN 771-6	Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 6: Murature me njësi gurësh natyrorë
DIN EN 998-1	Specifikimet për llaçin ne ndertim - Pjesa 1: suvatimi dhe shtresa finale e llaçit
DIN EN 998-2	Specifikimet për Llaçin ne ndertim- Pjesa 2: Llaçi ne murature
DIN EN 1015-1	Metodat për testimin e llaçit ne ndërtim - Pjesa 1: Përcaktimi i madhësisë së shpërndarjes së grimcave (nëpërmjet analizës me sitë)

DIN EN 1015-11 Metodatat për testimin e llaçit në ndërtim - Pjesa 11: Përcaktimi i forcës në perkulje dhe shtypje të llaçit të forcuar

Elemente ndihmes

DIN EN 845-1 Specifikim për përbërësit lidhës në ndërtim - Pjesa 1: Lidhjet, brezat, varëset dhe kllapat

DIN EN 845-2 Specifikimet për përbërësit lidhës në ndërtim - Pjesa 2: Arkitrarët

DIN EN 845-3 Specifikimet për përbërësit lidhës në ndërtim - Pjesa 3: rrjete metalike për përforcim

7.1.2 SIGURIMI I CILËSISË

7.1.2.1 Paraqitja

Mos ndryshoni burimin ose furnitorin e materialeve pasi ka filluar fabrikimi i tullave. Tullat duhet të prodhohen njëherësh dhe nga i njëjti grup. Të përzihen të gjitha tullat për të prodhuar një pamje uniforme kur të instalohen. Një shtresëzim ose lidhje e dukshme e ngjyrave të shkaktuara nga miksimi i gabuar i tullave nuk është i pranueshëm.

7.1.3 DËRGIMI, MAGAZINIMI DHE TRAJTIMI

Të dërgohen materialet e çimentuara në kantier duke përdorur kontenerët e pacopëzuar, qartësisht i shënuar me emrat dhe marka e prodhuesve. Të ruhen materialet e çimentos në godina të thata ku nuk ka ndërhyrje të motit dhe të tregohet kujdes që të mos lejohen materialet të huaja që të futen aty dhe të parandalohet dëmtimi nga uji dhe lagështira. Të ruhen materialet ndërtimore nga dëmtimet dhe përveç rërës të mbahen të thatë deri në momentin e përdorimit. Të mbulohet rëra për të parandaluar futjen e ujit dhe të materialeve të cilat përmbajnë ngrica apo akulli. Të ruhen materialet që janë të dëmtueshëm nga lagështia nga shiu dhe uji në tokë.

7.1.4 PLANIFIKIMI

Të koordinohet puna në ndërtim me punën e punimet e tjera për të mundësuar artikujt e ndërtuar dhe për të shmangur prerjet dhe rregullimet /firot.

7.1.5 LIDHJA

Të parashikohet mbështetja dhe skelat e nevojshme për ndërtimin e muraturës. Të ndërtohen lidhëset për të rezistuar presionin e erës siç kërkohet nga kode vendore të ndërtimit.

7.1.6 KËRKESAT SIZMIKE

Të parashikohet përforcim sizmik. Përqindja minimale totale për muret konstruktive duhet të jetë 0.20% dhe muret ndarëse /jo-strukturore të jenë 0.15%. Trarët lidhës kërkohen në shtresën shkelëse, në pjesën e sipërme dhe të poshtme të hapjeve në tarraca dhe nivele katesh, si dhe mbi muret e parapeteve.

7.2 PJESA 2 – PRODUKTET

7.2.1 TULLAT

7.2.1.1 Specifikime të Tullave Prej Argjile

Tulla si element ndërtues duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme për ndërtimet kundër lëkundjeve sizmike: Rezistenca gjatë shtypjes, që do të jetë për tullat 75 kg/cm²; për tullat me brima 80 kg/cm²; për tullat e kuqe për tavane 150 kg/cm²

Rezistenca gjatë prerjes, e cila duhet të jetë: për tullat me brima 20 kg/cm².

Përqindjet ndër hapësirat të cilat duhet të jenë: për tullat 0-25%; dhe për tullat me brime 25-45%

Trashësia e perimetrit dhe e parapetit të brendshëm për tullat nuk do të jetë më e ulët se 20mm dhe për të gjitha tullat me brima; trashësia e parametrit të parapetit nuk do të jetë më e ulët se 15mm dhe e brumit të brendshëm jo më e ulët se 9mm.

Sipërfaqja e një brime duhet të jetë maksimumi 4.5 cm².

Hygrofiliteti në përqindje do të jetë nga 15-20%.

7.2.1.2 Tullat me brima - Mure Të Brendshme

Dimensionet mesatare të tullës do të jenë si të treguara në skica. Tullat me brima do të jenë në përputhje me DIN EN 771

7.2.1.3 Tullat me brima – Mure Të Jashtme

Dimensionet mesatare të tullës do të jenë si të treguara në skica. Tullat me brima do të jenë në përputhje me DIN EN 771

7.2.1.4 Blloqe Betoni Autoklave /Me Peshë Të Lehtë

Tullat prej betoni: njësitë me peshë të lehtë me dimensione modulare dhe të trajtuara me ajër ujë ose avull. Tullat prej betoni duhet të përputhen me muraturat prej betoni, në karakteristika ngjyre dhe sipërfaqeje.

7.2.2 LLAÇI

7.2.2.1 Cilësitë e Llaçit

Llaçi për ndërtim: Në doza për 1 M³ do të kryhet me :

Llaç gëlqeror të llojit 15 me rërë lumi (me porozitet 40% dhe përmbajtje uji të duhur që ngrihet në volum deri në 20%) të përzier në proporcion me çimenton: gëlqere: rërë = 1: 0,8: 8. 110 lt gëlqere të hidratuar, 150 kg çimento (lloji 300), 1,29 m³ rërë.

Llaç gëlqeror të llojit 25 me rërë lumi (me porozitet 40% dhe përmbajtje uji të duhur që ngrihet në volum deri në 20%) të përzier në proporcion me çimenton: gëlqere: rërë = 1: 0,5: 5,5. 92 lt gëlqere të hidratuar, 212 kg çimento (lloji 300), 1,22 m³ rërë.

Llaç gëlqeror të llojit 15 me rërë të pastër (që ka një porozitet prej 35%) të përzierë në marrëdhënie me çimenton: gëlqeren: rërën = 1: 0,8: 8. 105 lt gëlqere të hidratuar, 144 kg çimento (lloji 300), 1,03m³ rërë.

Llaçi gëlqeror i llojit 25 me rërë lumi (të ketë një porozitet prej 35%) të përzierë në proporcion me çimenton: gëlqeren: rërën = 1:0,5:5,5. 87 lt gëlqere të hidratuar, 206 kg çimento (lloji 300), 1,01m³ rërë.

Llaçi gëlqeror i llojit 1:2 me rërë të pastër (të ketë një porozitet prej 35%) të përzierë në proporcion me çimenton: rërën = 1:2. 527 kg çimento (lloji 400), 0,89m³ rërë.

Uji: i pastër, i pijshëm dhe pa substanca të cilat mund të prekin në mënyrë që të dëmtojnë llaçin.

7.2.3 FINO (LLAÇI I HOLLË)

Rënia ndërmjet 200 dhe 280 mm. Të parashikohet fuqia minimale e finos prej 13,800 kPa 2000 psi në 28 ditë.

7.2.3.1 Përzierjet

Të mos përdoret ngjitja me ajër, materialet kundër ngrirjes, ose ngjitjet me klorin (përbërës klorine).

7.2.4 AKSESORËT E MURATURES

7.2.4.1 Përforcimi i Fugave Horizontal

DIN EN 845-3 prodhuar nga tel hekuri të tërhequr në të ftohtë. Teli nuk duhet të jetë galvanizuar me të nxehtë pas prodhimit. Përforcimi në këtë mënyrë do të jetë me lidhje me dy ose me shumë tela në gjatësi që saldohen me një tel diagonal, ose me llojin e shkallëzimit me tela perpendikular prej jo më shumë se 400mm. Të mundësohen seksione të sheshta me gjatësi prej 3m dhe cepa të paraformuar dhe kthesa në formë T prej përreth 800mm gjatësi. Gjerësia totale do të jetë përreth 50mm më pak se sa trashësia formale e murit.

7.2.4.2 Ankorimet dhe Lidhjet e Mureve

Të mundësohen përcaktimet e miratuara të çelikut, ankorave në formë nyje, të sheshta, bisht dallëndysheje jo më të lehta se sa 16 gjerësi dhe 22mm, me fundet kthyer lart deri në 6mm. Teli: jo me i lehtë se sa 6 gjerësi, 22mm me telin e lidhur dhe të mbyllur si lidhje.

7.2.4.3 Shufrat Përforcuese

Të mundësohen kllapat të cilat parandalojnë zhvendosjen e përforcimit gjatë ndërtimit.

7.2.4.4 Qoshet Metalike të Mureve

Të mundësohet një nga llojet e mëposhtme

Qoshet metalike të veshura me bakër: 0.2kg 7 ouns, me një fletë bakri elektrolitike, të lyer në mënyrë të njëjtë nga të dyja anët me acid, dhe kundër alkalineve, dhe me përbërës bitumoni. Të aplikohet veshja e për një peshë prej jo më pak se 1.8 kg për metër katror 6 auns për këmbë katrore (përreth 0.9 kg për metër katror 3 auns për këmbë katrore nësecilën anë).

Bakri mbi çelik për qoshet metalike: Bakri, minimumi 450 g për një peshë prej 16 auns; çeliku me trashësinë 4 mm. Të mundësohet me deformimet e fabrikës të cilat në mënyrë mekanike lidhin qoshet ndaj lëvizjeve horizontale në të gjitha drejtimet.

Qoshet metalike me membranë të përforcuar: një element prej poliestre në thelb me një shtresë fibre prej xhami e ngjitur në njërën anë. Membrana duhet të jetë e pa kalueshme nga lagështia, përkulshëm, dhe të mos preket nga alkaline kaustike.

7.2.5 KONTROLLI I BURIMIT TE CILESISE

7.2.5.1 Testet Fluoreshente

Të kryhen testes fluoreshente në njësitë e ndërtimit të cilat do të ekspozohen ndaj kushteve atmosferike. Të vendosen teste mjaftueshëm larg përpara se të fillohet puna ndërtimore për të lejuar ritestimet nëse është e nevojshme.

7.2.5.2 Përlllogaritja e Fuqisë

Të përlllogariten fuqitë përbërëse të sistemeve të ndërtimit. Të vihen në dispozicion llogaritjet dhe njësitë e certifikimit dhe fuqia e llaçit.

7.3 PJESA 3 -ZBATIMI

7.3.1 PËRGATITJA

Para se të fillohet puna, duhet të verifikohen kushtet e aplikuara.

7.3.1.1 Ruajtja

Njollat ruajnë sipërfaqet e ekspozuara nga llaçi dhe njollat e tjera. Kur të vendosen fugat e llaçit, të hiqet llaçi nga sipërfaqet e ekspozuara me furça fibroze dhe lopata druri. Të ruhet baza e mureve nga njollat e spërkatjes duke mbuluar tokën aty pranë me rërë, tallash ose polietilen.

Ngarkesat: të mos aplikohet ngarkesa të njëllojta për të paktën 12 orë ose ngarkesa të përqendruara për të paktën 72 orë pasi ndërtimi me tulla të ketë mbaruar.

Të mundësohet mbështetja e përkohshme sipas nevojës.

7.3.1.2 Përgatitja e Sipërfaqes

Sipërfaqet në çdo murature duhet të jenë të drejta, të pastra dhe të mos kenë substanca të huaja në momentin kur aplikohet llaçi.

7.3.2 KONTROLLI I CILËSISË NË TERREN

7.3.2.1 Fuqia Dhe Cilësitë e Llaçit

DINEN 1015-11, për 3 ditë radhazi, dhe çdo ditë të tretë nga ai moment.

7.3.3 CILËSIA E PUNËS

Të mbahet plumbçi i ndërtimit dhe niveli. Të sigurohet dhe përdoret matësi gjatë të gjithë punës. Ndryshimet në ngjitjen apo mbështetjen pasi ka filluar puna nuk do të lejohen. Të mos ngrihet një pjesë e murit para një pjese tjetër. Të shpejtohet puna e pambaruar për të arritur nivelimin e mureve. Dhëmbëzimi nuk do të lejohet. Mos merrni përsipër një seksion muri para të tjerëve. Të ndërtohen strukturat e dyerve dhe dritareve, hapjet, ancorimet, tubacionet ndërsa vazhdon ndërtimi me tulla. Ti kushtohet kujdes ndërtimit me tulla në mënyrë që të shmangen thyerjet, copëzimet dhe ciftimet e anëve ose të pjesëve ballore. Shpimi, prerja, mbushja për të mundësuar punën e të tjerëve duhet të kryhet nga mekanikët e ndërtimit me tulla. Të priten tullat me sharrat e tyre për punën e ekspozuar. Punimet strukturore me çelik, vida, futje të ndryshme metalike të specifikuar diku tjetër duhet të vendoset në pozicionin e duhur ndërsa

vazhdon puna. Të jepen ndjekësit e dimensioneve të miratuara dhe të qëllimeve të tjera ku tregohet dhe aty ku është e nevojshme.

Mbulimet e mureve të ekspozuara dhe ndarjet të cilat nuk punohen me membranë rezistente ndaj ujit të siguruar në vend dhe të shtrirë poshtë të paktën 600mm në të dyja anët.

7.3.4 PËRZIERJA E LLAÇIT

Të maten materialet e llaçit në kontenierë prej 0,0283 m³ për të ruajtur kontrollin dhe saktësinë e proporcioneve. Përzierja e llaçit në përzierës mekanik për jo më pak se 3 ose jo më shumë se 5 minuta pasi të gjithë përbërësit janë vendosur në mënyrë që të prodhohet një përzierje e njëtrajtshme. Të shtohet uji në mënyrë graduale për të prodhuar një përmbajtje të punueshme.

Të mos mbushet përzierësi përtej kapacitetit të dhënë. Të ripunohet llaçi i cili është ngurtësuar për arsye të tharjes së ujit duke shtuar ujë për të marrë një dendësi të punueshme. Të mos ripërdoret llaçi i cili nuk është vendosur në pozicionin përfundimtar brenda afatit kohor prej 2.5 orësh nga përzierja.

Të mos përdoren përbërësit kundër ngrirjes, kripërat dhe ose substancat e tjera për të ulur pikën e ngrirjes së llaçit.

Llaçi: të përzihet llaçi në përputhje me DIN EN 998-2 për të pasur llojin e llaçit të kërkuar. Kur çimento e ndërtimit mundësohet, ti përmbahet udhëzimeve të printuara të prodhuesit të çimentos.

Fino: të mundësohet fino në hapësirat e finos më pak se 50mm në çdo dimension horizontal ose në të cilën hapësira ndërmjet përforcuesit dhe ndërtimit me tulla është më pak se 20mm.

7.3.5 FUGAT E LLAÇIT

Fugat e llaçit duhet të aplikohen në trashësi të njëtrajtshme prej 10mm vetëm nëse nuk tregohet ndryshe. Lidhjet e ekspozuara pak të futura të rrumbullakëta ose me një bashkues tjetër të përshtatshëm kur llaçi është forcuar. Për bashkimet horizontale, bashkuesit duhet të jenë të paktën 300mm të gjatë për punën me tulla dhe 600mm të gjatë për punën me beton. Bashkuesit do të jenë pak më të mëdhenj se sa gjerësia e bashkimit në mënyrë që kontakti total të kryhet nëpërmjet cepave të njësisë, duke shtypur dhe mbyllur sipërfaqen e bashkimeve. Të pastrohen bashkimet për të hequr llaçin e tepërt dhe të lirë. Bashkimet horizontale duhet të jenë të niveluara; bashkimet vertikale duhet të maten me plumbç dhe të rregullohen nga lart poshtë murit me një tolerancë plus minus 10mm në 10m.

7.3.6 TOLERANCAT

Muratura duhet të jetë brenda kufizimeve të mëposhtme:

Faqja ballore e tullave : 1mm nga faqja e tullës më të afërt.

Faqja ballore muraturës së betonit: 2mm nga faqja e njësisë më të afërt.

Ndryshimet në trashësinë e murit: Plus ose minus 6mm.

7.3.7 PUNIMET ME TULLA

Të përzgjidhet dhe vendosen tullat në të tillë mënyrë që të ekspozohet ana më e mirë.

7.3.7.1 Testimi

Përveçse në kohë të ftohtë, të testohet argjila ose tullat në kantier, para se të vendosen në mënyrë të tillë: Dukë përdorur një laps prej dylli, të vizatohet një rreth në madhësinë e një monedhe në pesë tulla të përzgjedhura rastësisht.

Hidhni 20 pika uji nga një pikatore në sipërfaqe brenda rrethit tek secila tullë. Nëse koha mesatare që uji është tërësisht përthithur në të pestat tulla është më pak se 1-1.5 minuta, tullat e lagura të përfaqësuara nga pesë tullat e testuara.

Të sigurohet që çdo tullë është e njomë, por sipërfaqja të jetë e thatë kur të vendosen. Gjatë kohës së ftohtë, të mbahen materialet e ndërtimit të thata deri sa të vendosen.

Bashkimet e thata ose të ngjitura nuk do të lejohen.

7.3.7.2 Përdorimi

Nëse nuk tregohet ose specifikohet ndryshe, të vendosen tullat në rresht dhe në lidhje të një pas njëshme. Të mbushen tërësisht bashkimet ndërmjet tullave me llaç. Të formohen bashkime të shtratis të trasha me llaç të cilat janë më pak se trashësia e murit; të vendoset llaçi në këtë shtrat në formë piramide ose brazde. Të formohen bashkimet në fillim duke aplikuar një trashësi të plotë llaçi në tullat që do të vendosen. Lëvizja e bashkimeve kryesore nuk do të lejohet. Të vendosen tullat me llaçin në secilin bashkim të njëjësive për tu vendosur në vend. Të vendosen tullat me kujdes pa shqetësuar ato të cilat janë vendosur më parë.

7.3.7.3 Murature e Jashtme Me Tulla me Brima (38 Cm)

Të vendoset muratura me tulla me mbrima me një trashësi konstante ose të ndryshme në lartësinë prej 3m. Për punime të jashtme, në tullat e parafabrikuara duke përfshirë materialin për hapjet vertikale, cepat, skelat dhe të gjitha kërkesat për të përfunduar punën në mënyrë të saktë. Në shtratin e katit të poshtëm duhet të vendoset një shtresë llaci çimentoje (e llojit 1:2), 2 cm trashësi minimale. Përzgjidhni njësitë për njëtrajtshmëri madhësie, cilësie dhe me cepa të pa dëmtuar dhe funde me sipërfaqe të ekspozuar. Të vendosen njësitë e plumbces, paralele dhe me fugat e duhura me trashësi maksimale 10 mm. Te mirembahen sipërfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

Tulla me bira per murature te jashme 38 cm

Tulle prej argjile me bira, me trashësi 38 cm; duke përfshirë, arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skeleri

7.3.7.4 Murature e Jashtme Me Tulla me Brima (25 Cm)

Të vendoset muratura me tulla me mbrima me një trashësi konstante ose të ndryshme në lartësinë prej 3m. Për punime të jashtme, në tullat e parafabrikuara duke përfshirë materialin për hapjet vertikale, cepat, skelat dhe të gjitha kërkesat për të përfunduar punën në mënyrë të saktë. Në shtratin e katit të poshtëm duhet të vendoset një shtresë llaci çimentoje (e llojit 1:2), 2 cm trashësi minimale. Përzgjidhni njësitë për njëtrajtshmëri madhësie, cilësie dhe me cepa të pa dëmtuar dhe funde me sipërfaqe të ekspozuar. Të vendosen njësitë e plumbces, paralele dhe me fugat e duhura me trashësi maksimale 10 mm. Te mirembahen sipërfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

Tulla me bira per murature te jashme 25 cm

Tulle prej argjile me bira, me trashësi 25 cm; duke përfshirë, arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skeleri.

7.3.7.5 Tulle me Bira (20 Cm) per Murature te Brendshme dhe te Jashtme

Muratura me tulle me bira (6 ndarje) me një trashësi prej 20 cm dhe llaci gëlqeror duke përfshirë hapjet vertikale, cepat, skelat dhe ndonjë gjë tjetër për të përfunduar ndërtimin me tulla. Në shtratin e katit perdue duhet të jetë i niveluar me një shtresë llac çimentoje 1:2, 2cm trashësia minimale. Të përzgjidhen njësitë për njëtrajtshmëri dhe madhësi, përmbajtjen, barazimin dhe cepat e pa dëmtuar dhe fundet e sipërfaqeve të pa

eksponuara. Të vendosen njësite e plumbces në mënyrë paralele me fugat e duhura me trashësi maksimale 10 mm. Te mirembahen sipërfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

Murature me tulla me brima 20 cm

Parapet me tulla me brima me një trashësi prej 20 cm

7.3.7.6 Murature e Brendshme Me Tulla me Brima (25 Cm)

Të vendoset muratura me tulle me bira 25cm duke përfshirë materialin për hapjet vertikale, cepat, skelat dhe të gjitha kërkesat e tjera për të përfunduar punën në një mënyrë të duhur. Në shtratin e katit të parë duhet të nivelohet një shtresë llac çimentoje 1:2, me 2cm trashësi minimale. Zgjidhni njësitë për njëtrajtshmëri, madhësi, pastërti dhe me cepa të pa dëmtuara, e me bashkime të duhura me njëtrashësi maksimale prej 10mm. Të ruhen sipërfaqet e ekspozuara të pastra dhe pa defekte.

Tulla me bira per murature te brendshme 25 cm

Tulle argjile me brima, me trashësi 25cm; duke përfshirë arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skelat

7.3.7.7 Murature e Brendshme Me Tulla me Brima (12 cm)

Të vendosen muratura me tulle me brima me trashësi prej 12cm dhe duke përfshirë materialin për cepat, hapjet vertikale, skelat dhe ndonjë kërkesë tjetër për të përfunduar punën në mënyrën e duhur. Në shtratin e katit të poshtëm, duhet të nivelohet një shtresë llaci çimentoje 1:2, me trashësi minimale prej 2cm. Të përzgjidhen njësitë për njëtrajtshmëri madhësie, përmbajtjeje dhe me cepa të pa dëmtuara per sipërfaqe të ekspozuara. Të vendosen njësite e plumbces në mënyrë paralele me fugat e duhura me trashësi maksimale 10 mm. Te mirembahen sipërfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

Tulla me bira per murature te brendshme 12 cm

Tulle argjile me brima, me trashësinë 12cm; duke përfshirë arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skelat

7.3.8 BASHKIMI DHE ANKORIMI

Nëse nuk tregohet ndryshe, ndarjet te shtrihen ne drejtimin dysHEME-tavan. Te lidhen ose ankorohen strukturalisht muret dhe ndarjet nga njëri tjetri. Në mënyrë të sigurt të ankorohen muret e jashtëm jo mbajtës dhe ndarjet e brendshme me strukturat e betonit në një mënyrë që të jepet qëndrueshmëria laterale ndërsa lejohet shmangia e pa kushtëzuar e ndërtimit mbi të. Të vendosen tërësisht ankorimet në bashkimet me llac.

Ndërthurjet e mureve të cilët nuk mbajnë peshën e godinës dhe mureve ndarës me ndarje ose mure të tjera: të lidhen me rrjete teli lidhese ne intervalet vertikale prej jo me shumë se 60cm ose me tulla që ndërthuren.

Muret të cilat perballin elemente betoni: të lidhet muratura me betonin me ankora të llojit rrjetë të vendosura ose futura në beton. Të pozicionohen ankorime jo më shumë se 300mm Vertikalisht dhe jo më shumë se 600mm horizontalisht.

7.3.9 LLAMARINAT

Te behet zgjatimi i llamarines 6mm jashtë faqes së jashtme të mureve, lart në lidhje bashkuese jo më pak se 150 mm, të shtypet cepi i jashtëm për të formuar pikoren. Qoshet e siguruar krijojnë një lidhje permanente siç tregohet. Të mundësohen llamarinat në gjatësi sa më praktike. Fundet të mos mbarojnë jo më pak se 35mm nga nyja ndërthurëse dhe 100mm për llojet e tjera. Të izoloohen fundet në bazë të nevojës për të

siguruar mos depërtimin e ujit. Të parashikohen ndalesa në fund të qosheve të llamarinave, aty ku muratura me tulla bashkohet me betonin dhe aty ku qoshet e llamarinave përfundojnë brenda muratures.

7.3.10 VRIMAT PËR LARGIMIN E UJIT

Kurdoherë përgjate llamarinave në mure, të mundësohen vrimat për largimin e ujit nga llamarina, jashtë. Vrimat për largimin e ujit duhet të hapen 600mm përgjate fugave.

7.3.11 PËRFORCIMET E FUGAVE HORIZONTALE

Të mundësohen përforcimet në dy shtresat sipër dhe poshtë hapjeve në mure dhe ndarjeve të njësisive të betonit. Përforcimi duhet të jetë i vazhdueshëm përveç se në lidhjet e kontrollit dhe ato të zgjerimit. Përforcimi sipër dhe poshtë hapjeve duhet të shtrihet jo më pak se 600mm përtej secilës anë të hapjeve. Të jepen bashkësitë e salduara në formë L-je dhe në formë T-je për të përshtatur përforcimin e drejtë, tek cepat dhe bashkimet e mureve dhe ndarjeve. Të mundësohet mbulimi me llac për rrjeten të paktën 16mm për anët e jashtme të murit dhe 12mm për anën e brendshme të murit.

7.3.12 NJESI BETONI, ARKITRARËT DHE TRARË LIDHËS

Të mundësohen njësi të veçanta, të mbushen qelizat plotësisht me fino ose beton, dhe të jepen jo më pak se dy shufra përforcuese Nr5, vetëm nëse nuk tregohet ndryshe. Përforcimi do të ndërthurë një minimum prej 40 bar në prerjet e diametrit. Njësitë e ndërtuara me beton të dhëna për arkitrarët dhe trarët lidhes duhet të kenë sipërfaqe të ekspozuara të materialit të njëjtë dhe përmbajtje si njësitë ngjitur të ndërtimit. Arkitrarët duhet të jenë të drejta dhe të kenë të paktën 200mm aftesi mbajtëse në secilën anë. Njësi të tilla duhet të përdoren në zona ku të paktën tre radhë tullash mund të vendosen mbi njësi.

7.3.13 FUGAT E KONTROLLIT

Hekuri duhet të jetë i ndërprerë tek fugat për lidhje të ndermjetme të traresh . Hekuri duhet të vazhdojë përgjate fugës për të gjithë trarët lidhës strukturorë. Të jepet aty ku tregohet njësi murature betoni-njësi murature me tulla. Bashkimet duhet të ndodhin në mënyrë të drejtë për drejtë ose kundër njëri tjetrit në marrëdhënie me murin dhe duhet të mbushen sipas specifikimeve në norma dhe referenca ose nga një gomë sintetike ose ngjitës plastik.

7.3.14 FUGAT E EKSPANSIONIT

Të jepen aty ku tregohet në muret prej tulle. Të mbushen fugat në mënyrë permanente me mbushës fleksibel dhe ngjitës.

7.3.15 VENDOSA E FINOS

Të vendoset fino nga ana e brendshme e mureve, vetëm nëse nuk miratohet ndryshe. Të ruhen parvazet, cepat, daljet dhe ndonjë sipërfaqe tjetër nga fino e rënë në tokë. Të hiqet fino nga sipërfaqe të tilla menjëherë. Fino duhet të përzihet mirë për të parandaluar ndarjen dhe të jetë mjaftueshëm e lëngshme për të rrjedhur në fuga dhe përgjate përforcimeve pa lënë hapësira.

7.3.16 FORMAT DHE MBËSHTESET

Të ndërtohet në formën, drejtimin dhe dimensionet e elementeve të treguar. Të parandalohen shmangiet të cilat mund të rezultojnë në plasaritje, thyerje ose dëmtime të tjera për muraturen mbështetëse. Të mos hiqen derisa këto elemente të jenë trajtuar.

7.3.17 PASTRIMI

7.3.17.1 Ruajtja

Gjatë operacioneve të pastrimit, të ruhet puna e cila mund të jetë e dëmtuar, njollosur ose ti ketë dalë ngjyra.

7.3.17.2 Qëllimi

Me mbarimin e punës së ndërtimit dhe para pastrimit, të priten lidhjet me defekt të llacit dhe të futen brenda ato të dala dhe të mbushen të gjitha vrimat në mënyrë të plotë me llac të para hidratuar.

7.3.17.3 Pastrimi

Të pastrohen sipërfaqet e ndërtimit me ujë të pastër dhe furça fibroze të forta dhe të shpëlahet me ujë. Aty ku ka njolla, llaç ose pjesë të tjera dheu të vazhdohet pastrimi me ujë të ngrohtë dhe ilaçe pastruese. Aty ku mbete dheu në tulla, të vazhdohet pastrimi si më poshtë: të lagen tërësisht sipërfaqet e ekspozuara me ndërtim prej tulle me ujë të pastër dhe me furça si dhe me solucion prej jo më shumë se 1 pjesë acid muriatik (HCl) me 9 pjesë ujë të aplikuara në një sipërfaqe prej 1 deri në 2 metra katrorë njëherësh. Menjëherë të shpëlahet pasi të jetë pastruar një zonë e tillë. Të mos përdoren solucionet kaustike ose pastrimi me rërë për të pastruar sipërfaqet. Ndërtimi me tulla duhet të jetë pa njolla, fluoreshentë, llaç ose fino dhe mbetjet. Të rregullohet dëmtimi, njollat dhe puna e ç'ngjyrosur në kushtet original ose të japin punë të re.

8. TARRACAT DHE TARRACAT ME STRUKTURE METALIKE

8.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

8.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi në sasinë e referuar. Botimeve u referohen në tekst vetëm me përcaktimin e tyre bazë.

8.1.1.1 Ligjet Dhe Normat E Aplikueshme Shqiptare

8.1.1.2 Standardet dhe Normat Evropiane

DIN 52130	Shtresat e bituminoze për izolimin ndaj ujit të çative – konceptet, përcaktimet, kërkesat.
DIN 52131	izolimi me shtresa bitumii për saldimin me ngjitje - konceptet, përcaktimet, kërkesat
DIN 52132	Shtresat e bitumenit polimeri për izolimin ndaj ujit të çative- konceptet, përcaktimet, kërkesat
DIN 52133	Shtresat e bitumonit polimeri për saldimin me ngjitje–Termat dhe përkufizimet, përcaktimet, kërkesat
DIN 52143	Rripat e bitumonit të çative me baze rrjete xhami; termat dhe përkufizimet, përcaktimet, kërkesat
DIN EN 1253	Ulluqet për godinat
DIN 4102	Elementët dhe mbrojtja e materialeve të ndërtimit ndaj zjarrit
DIN 4109	Izolimi ndaj zhurmave në godina; kërkesat dhe testimi

DIN 18232	Sistemet e kontrollit të nxehtësisë dhe tymit
DIN EN 54	Sistemet e lajmërimit dhe dedektimit të zjarrit
DIN 18451	Procedurat kontraktuale për punimet e ndërtimeve - Pjesa C: specifikimet e përgjithshme teknike për punimet ndërtimore në godinë; skelera
DIN 18336	Procedurat kontraktuale për punimet e ndërtimeve– Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për punimet e ndërtimeve; punimet hidroizoluese
DIN 18339	Procedurat kontraktuale të ndërtimit - Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për punimet e ndërtimeve; punime per flete metalike mbuluese ne cati e mure.
DIN 18360	Procedurat kontraktuale për punimet e ndërtimeve - Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për punimet në godinë; Punime per ndërtime metalike
DIN EN 13163	Produktet e izolimit termik për godinat – Produktet industrial prej polistireni (EPS) – Specifikimet
DIN EN 13499	Produktet e izolimit termik për godinat – sistemet e përbëra të izolimit termik nga jashtë (ETICS) - Specifikimet
DIN EN 826	Produktet e izolimit termik për përdorim në godina – Përcaktimi i sjelljes në shtypje
DIN EN 1396	Alumini dhe përzierjet e aluminit – flete mbeshtjellese e lyer për aplikimet e përgjithshme
DIN EN 546	Alumini dhe përzierjet e aluminit - Letër
DIN 1748	Xhamat në godinë – Produkte të veçanta bazë - Pjesa 1: Xhama borosilikatë Xham në godinë – Produkte të veçanta bazë - Pjesa 2: Qeramika prej xhami
DIN 17440	Çelik i pandryshkshëm – kushtet e dërgesës teknike për rrjeten e tërhequr
DIN EN 573	Alumini dhe përzierjet e aluminit – Përbërja kimike dhe format e produkteve të punuara
DIN EN 1301	Alumini dhe përzierjet e aluminit – Rrjete e tërhequr
DIN EN 612	Ulluqet anësore dhe tubacioni për rrjedhjen e shiut prej fletëve metalike – Përcaktimet, klasifikimi dhe kërkesat
DIN EN 988	Zinku dhe përzierjet e zinkut– Specifikimet për produktet role për godinat;
DIN EN 1462	Menteshat për cepat e ulluqeve – Kërkesat dhe testimi
DIN EN 10147	Rripat e çelikut të zhytur në mënyrë të vazhdueshme në zink të nxehtë dhe fletët për formimin e flohtë – Kushtet teknike të dërgesave.
DIN EN 10214	Alumin-zink në mënyrë të vazhdueshme i zhytur dhe i lyer fletë e rrip prej çeliku. Kushtet teknike të dërgesave
DIN EN ISO 1461	Lyerjet e galvanizuara në zhytje të nxehta mbi artikujt e çelikut të fabrikuar – specifikimet dhe metodat e testimit
DIN ISO 4042	Lidhësit – lyerjet me pllakëza elektroni
DIN V ENV 1993	Vizatimi i Strukturave prej Çeliku
DIN EN 10025	Vizatimi i Strukturave prej Çeliku

8.1.1.3 Dërgesa

Të dërgohen materialet në sasi të mjaftueshme për të lejuar vazhdimësinë e punës.

8.1.1.4 Magazinimi dhe Trajtimi

Magazinimi dhe trajtimi i materialeve në një mënyrë për të ruajtur atë nga dëmtimet, ekspozimi ndaj flakës së hapur ose burime të tjera ndezëse, dhe nga lagështia, kondensimi ose thithja e lagështisë. Të ruhet në një godinë të mbyllur ose kontener i cili mundëson një mjedis të ventiluar të thatë dhe të përshtatshëm. Të zëvendësohen materialet e dëmtuara me materiale të reja. Rolet e materialit duhet të ruhen vertikalisht.

8.1.2 KUSHTET MJEDISORE

Të mos vendoset izolimi i tarraces gjatë motit të përkeqësuar ose kur temperatura e ajrit është nën 5 gradë celsius ose kur ka prani ngricash, akulli ose lagështi të dukshme nëçati ose kur ka shumë erë.

8.2 PJESA 2 – PRODUKTET DHE MATERIALET

8.2.1 BARRIERAT AVULLIZOLUESE

8.2.1.1 Barriera avullizoluese

Asfalt-i ngopur

Element bazë për aplikimet me një shtresë, që peshon jo më pak se 17.5 kilogram për 10 m²

8.2.1.2 Barriera avullizoluese

Fletët prej Polietileni

Barriera avullizoluese do të jetë një fletë polietileni me trashësi prej 0,50mm, dhe me pershkrueshmeri avulluese më të madhe se 2-100m, me dobësim në tërheqje 450%. Fletët merren nga grimca të pastra, neutrale ose me ngjyrë të bardhë, dendësia Kg/dm³ 0.95, vendosja në të thatë në bazë të njërës prej procedurave si më poshtë:

-me një kalim prej 20cm dhe kthim prej 10cm në pjesët vertikale,

-me një kalim prej 5cm, të puthitur me një bashkim të vetëm me gjerësi prej 8cm, 10cm kthim në pjesët vertikale.

Lidhjet me të gjitha pjesët që ngelen te dala me shiritin e fugave, gjithashtu të përdoren në muret vertikale.

Shtresa e ndarjes do të jetë një batanije artificiale e cila peshon 300 g/m².

Membrana e pershkrueshme e shtresës së varfer në nivelin tokësor do të jetë një fibër sintetike jo e thurur, e miratuar, në formë flete filtër.

8.2.2 IZOLIMI

Izolimi i tarraces do të bëhet me panele polistireni (XPS) me dendësi të lartë. Paneli i polistirenit do të shërbejë si shtresë mbështjellëse, i radhitur për utilizimin e gazrave në përputhje me rregulloret e BE dhe ato kombëtare (CO₂), përçueshmëri termike λ_0 0.033 W/mK, fuqi ngjeshëse ≥ 3.7 kg/cm², faktori i rezistencës ndaj difuzionit të avullit të ujit μ 160÷224. Panelet do të kenë profile si kapak të mbivendosur nga të 4 anët për eliminimin e urave termike, volumi i thithjes së ujit $\leq 0.10\%$, klasa e reagimit ndaj zjarrit duhet të jetë Euroclass E teknikisht i përshtatshëm për izolim të tarracave të lehta e të sheshta në përputhje me standardet DIN.

8.2.2.1 Llojet Izolimit

Instalimi

Panelet duhet të vendosen me kthina të përputhura

Shresa filtruese anësore të mbivendoset 75cm duke u kthyer vertikalisht, në mënyrë që të ruhet membrana nga dëmtimet që ndodhin poshte izolimit për shkak të mbetjeve shkaktuar nga depertimi i ujit;

Të vendosen vrimat e tubave të shkarkimit dhe zgarat e zhavorrit, për të siguruar vazhdimësinë e shtresës së izolimit, panelet e izolimit gjithashtu do të vendosen përgjatë ose mbi kanalet kulluese, e më vonë të jenë të mbuluara me pllaka betoni;

Të përdoren hapësirat/ shtresa e zhavorrit nën shtresë fundore të rrugëkalimit për kullim uji ose në rastin e tarracave të shfrytëzueshme, shtresa e duhur e betonit të varfer ose shtresa llaç çimento në përputhje me ngarkesat strukturore të llogaritura.

Izolimi i parapetit do të jetë me panele mineral me lesh guri, me përcjellje termike λ_0 0.035 W/mK, dhe koeficient rezistence për shpërndarjen e avullit μ 1, delaminimi > 10 kPa, 10% tensioni gjate shtypjes > 30 kPa, klasa e reagimit ndaj zjarrit: A1 - material jo i djegshem.

Instalimi

Është e rëndësishme që në raste zjarri, panelet, detajet fiksuese të jenë projektuar brenda normave në mënyrë që të jenë të qëndrueshme. Prandaj:

Të gjithë elementet fiksues do të jenë prej çeliku dhe jo alumini,

Kendoret /kanalet të jenë prej çeliku me një trashësi minimale prej 1,6mm. Të gjitha mbërthimet të jenë prej çeliku të pa oksidueshem.

8.2.2.2 Trashësia e Izolimit

Do të mundësohet në bazë të nevojës për të mundësuar rezistencën termike. Trashësia duhet të bazohet mbi vlerën e përcaktuar për izolimin "R" Izolimi mbi dyshemetë prej çeliku duhet të përmbushë si vlerën e përcaktuar R dhe trashësinë minimale për gjerësinë e valezimeve metalike në bazë të rekomandimeve të botuara të prodhuesit të izolimit. Trashësia nuk do të jetë më pak se 30mm. Trashësia tipike do të jetë 30, 50, 80 dhe 100mm për panelet me gurë mineral, 50, 80 dhe 100mm për panelet me polistiren.

8.2.3 MEMBRANA HIDROIZOLUESE

Dy membrana hidroizoluese kundra lageshtires të parafabrikuara në bitumen elastik-plastik-merik me një shtresë fibër xhami dhe ose shtresë poliestre, të aplikuar mbi shtresen bituminoze, në sipërfaqet e anuara dhe ato horizontale, me mbivendosje prej 10cm mbi njëra tjetrën. Materiali duhet të çertifikohet si i përputhshëm me materialin izolues për të parandaluar humbjen e plasticitetit.

Karakteristika:

Zgjatimi në fundet e përbërësve të papajisur (NFT46002) 2000%,

Rezistenca në tërheqje gjatësore 90 gradë transversale 80Kg/5cm,

Zgjatimi në këputjet gjatësore 50% transversale 50%

Rezistenca ndaj lodhjes në plasaritjet aktive në 0°C 10,000 cikle - në -10°C - 1,000 cikle,

Fleksibiliteti ndaj të ftohtit - 25°C.

8.2.4 GJEOTEKSTILI

Ndarja e shtresave do të arrihet nëpërmjet furnizimit të një shtrese të vetme jo të thurur, e përbërë nga fibrat e polipropilenës, me karakteristikat si më poshtë:

Fuqia në tërheqje 12kN/m (ISO EN 10319),

Zgjatimi në këputje prej jo më pak se ose e barabartë me 42% (EN ISO 10319), Rezistenca

ndaj goditjeve të paktën 24mm (EN ISO 13433),

Efikasiteti ruajtës i barabartë me 124N (EN ISO 14574).

8.2.5 LLAÇI I ÇIMENTOS DHE RËRËS

Mastar prej çimentoje dhe rërë i vendosur për të arritur ngjitjen e shtresave të terraces. Nënshtrësja e llacit të çimentos, doza 3.00 kuintal deri në 1.00 m³ rërë, 30mm trashësia mesatare (e mirë niveluar) për betonin dhe pllakat qeramike të dyshemesë, të cilat duhet të aplikohen me ngjitës, të përfunduara me fuge ekspansioni perimetrale (pllakat me materiale të forta).

8.2.6 SHTRESAT E TARRACAVE

Shtrimi i terracave për terraca teknike, terraca të shkëlshme, shkallët dhe terracat e kafazit të ashensorëve. Shtresë beton granili t=4cm, me zgare të elektrosalduar Ø=6mm, çdo 20 x 20 cm.

8.2.7 FUGAT E SHTRIMIT

Fugat e shtrimit duhet të kryhet duke përdorur gjatë cepave 2x50x50mm material izolues nga secila anë e fugës. Një rrip ndarës do të vendoset nga të dyja anët e fugës me gjerësi minimale prej 33cm për të parandaluar ngjitjen dhe për të lejuar lëvizjen e fugave nën mbulim. Fuga duhet të mbulohet duke përdorur një rrip 75cm të gjatë të fletëve të përdorura të terracave. Ky rrip duhet të fiksohet nga të dyja anët e fugave mbi një minimum prej 25cm.

8.2.7.1 Mbulesat metalike e paralyera për parapetet e terracave (t=0.5mm kthimi i fletës) duke përfshirë të gjitha aksesorët

Montimi e furnizimi për mbulesat e parapeteve, llamarinat bashkimet dhe ndonjë material tjetër ose element metalik mbylles përgjatë mureve të terracës, të gjatësive të ndryshme, së bashku me ngjitjet, fugat, bulonat dhe vidat e kapëset me dado, duke përfshirë edhe puntorinë për instalim; Elementët do të kryhen në fletë të paralyera të galvanizuara.

Fletët do të jenë të llojit Fe Z3; trashësia prej jo më pak se 6/10mm, me galvanizim të nxehtë e të vazhdueshëm të llojit të mesëm-rëndë të llojit 350g/m² lysterje me zink. Materialet do të jenë të ruajtura në sipërfaqes sipas specifikimeve si më poshtë: elementët të cilët mund të kenë vuajtur prerje, ngjitje ose ndonjë lloj punimi tjetër bashkues gjatë punimeve ose instalimit, në mënyrë që të shkaktojnë dëmtim tek shtresja me zink, duhet të jenë të mbuluara me kujdes me bojën e bazuar në bojë zinku joorganik të përbërë nga polimeri zinku joorganik me shtimin e zinkut metalik.

Aty ku përshkruhet në skicimet ekzekutive, materialet do të dorëzohen në kantier të paralyera në përputhje me procedurat e mëposhtme:

- një shtresë boje ngjitëse me dy përbërës (40-50 mikron) si shtresë fillestare për shtresat e tjera,
- një shtresë e ndërmjetme me shtresë ngjitëse me dy përbërës (60/80 mikron),
- një shtresë fundore prej poliuretani që nuk zverdhet, dhe mos bëhet si shkumës (30-40 mikron).

8.2.8 GOZHDIMI I IZOLIMIT

Fiksueset/ mberthesat duhet të jenë të përshtatshme për materialin e terracës. Nuk duhet të demtojnë çatinë në mënyrë që të shmangin shtrembërimin. Nëse soleta e terracës nuk ka aftësi mbajtëse të përshtatshme atëherë duhet të përdoren ankora injektuese.

8.2.9 ULLUQET E TARRACES

Ulluqet e terracës duhet të kenë flanga shtrenguese në përputhje me DIN EN 1253. Zgavrat mbuluese duhet të jenë të lëvizshme.

Fletët duhet të jenë të llojit Fe Z3; me një trashësi prej jo më pak se 6/10 mm, me galvanizim të vazhdueshëm të nxehtë të llojit të mesëm-rëndë 350g/m² me lyerje me zink. Materialet e sipërfaqes duhet të jenë të ruajtura si më poshtë:

Elementët të cilët mund të vuajnë prerje, ngjitje ose punime të tjera mbuluese gjatë bashkimit ose instalimit, në mënyrë të tillë që të dëmtojnë shtresën e zinkut, duhet të mbulohen me kujdes me bojëra me bazë zinku jo organik të përbërë nga polimeri jo organikë me shtimin e zinkut metalik.

Aty ku përshkruhet në skicat e zbatimit, materialet duhet të dërgohen në kantier të para lyera në përputhje me procedurën e mëposhtme:

- një dorë boje me ngjitës me dy përbërës (40-50 mikron) si një bazë për strehët e mëvonshme,
- një shtresë e ndërmjetme më rrëshirëngjitëse prej dy përbërësish (60/80 mikron),
- një bojë e sipërme prej dy përbërësish prej poliuretene e cila nuk zverdhet, dhe nuk kthehet në shkumës (30-40 mikron).

8.3 PJESA 3 - ZBATIMI

8.3.1 EKZAMINIMI DHE PËRGATITJA

8.3.1.1 Inspektimi i Sipërfaqes

Sipërfaqet duhet të jenë të pastra, të sheshta dhe të thata. Të kontrollohet shtresa e tarracës duke përfshirë dhe pjerrësite deri tek kanalizimet kulluese, për defekte para se të fillohet puna. Para se të instalohet barriera avullizoluese dhe izolimi tek shtresat, te kryheti si më poshtë:

Ekzaminimin e sipërfaqes për tu siguruar që fugat janë mbushur dhe nivelimi mundëson sipërfaqe të përshtatshme për instalim të barrierës avullizoluese

8.3.1.2 Përgatitja e Sipërfaqes

Të riparohen defektet e duhura dhe pasaktësitë në sipërfaqet e tarracës për të eliminuar kullimin e paket dhe pikat.

8.3.2 INSTALIMI I BARRIERAVE AVULLIZOLUESE

8.3.2.1 Barriera Avullizoluese Tek Shtresat E Betonit Të Parafabrikuara

Të instalohet barriera e avullit në kontakt të drejtpërdrejtë me sipërfaqen e tarracës. Barriera e avullit duhet të konsistoje në një brez asfalti të ngopur. Të shtrohet barriera avullizoluese në drejtim të pjerrësive të tarracës. Shtresa të vendoset brenda plus minus 15 gradë celcius. Barriera e avullit duhet të jetë pa shtrembërime ose përthyerje. Të shtyhen fluskat e ajrit për të arritur ngjitje të plotë ndërmjet sipërfaqeve. Tek cepat e mureve dhe tek të daljet e tjera vertikale, të zgjatet barriera e avujve 150mm për të formuar një kthine e cila më vonë do të përthyeret mbi anet e izolimit të barrierës avullizoluese

8.3.3 INSTALIMI I IZOLIMIT

8.3.3.1 Polistiren /Panelet Me Lesh Guri

Të instalohen panele jo kopozite polistireni. Të ngushtohen dhe ngjeshen fugat e ndërthurjeve në fushë. Aty ku tregohet, të mundësohen rripat e ngushta në ndërthurjet e tarracës me muret, parapetet dhe të shtrihen përtej dhe mbi tarracë.

8.3.3.2 Izolimet e Tarracave Me Funde Të Kthyera

Për tarracat e pjerrta ose tarracat e sheshta me pak pjerresi për ujin e shiut, izolimi duhet të përshtatet me animin prej jo më pak se 2% në një thellësi mesatare prej 70mm. Në përgjithësi izolimi duhet të instalohet në mënyrë që të shmangen urat termike.

8.3.3.3 Rripat Dhe Përkuljet e Kthyera

Të mundësohen përthyerjet e cepave të njëjtimit material si izolimi i tarracës. Përthyerja e aneve kthyer duhet të ketë një inklinim prej 45 gradësh dhe një lartësi vertikale prej 100mm.

8.3.3.4 Instalimi i Ulluqeve Të Tarracave

Tek ulluqet e tarracave izolimi duhet të jetë me kënde të vogla (përreth 20mm)

8.3.4 INSTALIMI I MEMBRANËS HIDROIZOLUESE

Membranat e kundër lagështisë të parafabrikuara në bitumen polimerolast-plastik-merik, të aplikuara tek shtresa e ngjitesit të bitumenit në sipërfaqet horizontale dhe ato të pjerrta, anët e kalueshme prej 10cm, duke përfshirë punën dhe operacionet e përkohshme; me një shtresë fibër xhami dhe ose fletë poliestre përforcuese. Etiketimi i prodhuesit të topave nuk duhet të hiqet deri në momentin e përdorimit.

Për çdo dy shtresa ngjitëse ku aplikohet nxehtësia. Të hapen fletët, të vendosen në vend me 100mm anime dhe funde prej 150mm. Të aplikohet nxehtësia tek pjesa e poshtme e topit dhe në 75mm në anën e poshtme në mënyrë që membrana të ngjitet plotësisht me nënshtresën. Të sigurohet një rrjedhje e plotë bitumen prej të paktën 10mm, për të mos kaluar 25mm, në ane dhe në funde ndërsa membrana rrotullohet përpara dhe ngjitet me nënshtresën. Duhet kushtuar kujdes në mënyrë që sipërfaqja të mos tejnxehet. Pasi membrana të jetë ngjitur me nënshtresën, të kontrollohen anët me një mistri të nxehtë për të siguruar që anët janë plotësisht të ngjitura. Në anët kur ngjitja e plotë nuk arrihet, të ri ngrohen dhe të kalohet përsëri mistria. Bashkimet e membranës duhet të jenë të shkallëzuara me të paktën 50cm.

Të aplikohet ngjitja e fletëve të bitumenit në këndet e krijuara aty ku çatia ngjitet me muret, animet, ventilatorët dhe tubat dhe sipërfaqet e tjera vertikale (minimumi 150mm), në përputhje me udhëzimet e printuara të aplikimit nga prodhuesi dhe aty ku është e nevojshme të bëhet puna në mënyrë që të jetë e izoluar ndaj ujit. Këto ngjitje duhet të jenë të pozicionuara ndërmjet dy shtresave me shtresën e sipërme në mënyrë uniforme të lidhur me të. Bashkimi duhet të marrë një shtresë bitumen të lëngshëm të nxehtë. Fletët e çatisë/tarracës duhet të vendosen në cepa 100x100 mm (rripa të anuar) prej materiali izolues në cepin ndërmjet sipërfaqeve horizontale dhe atyre vertikale.

8.3.5 ULLUQET E TARRACAVE

Membrana izoluese ndaj ujit duhet të futet në pjesën që del përpara dhe të sigurohet. Ulluqet me kthesa në formë S për të parandaluar daljen e erërave duhet të mbushen me ujë. Të gjitha ulluqet duhet të jenë të zhytura në mënyrë që plotësisht të tarracën përreth dhe duhet të instalohen në mënyrë që të parandalojnë urat termike.

8.3.6 INSTALIMI I SHTRRESËS SË PA THURUR

Të aplikohet rrip i tendosur i jashtëm në përputhje me udhëzimet e printuara të prodhuesit. Të zgjaten daljet e tarracave, deri tek sipërfaqet vertikale.

8.3.7 LLAÇI I ÇIMENTOS DHE RËRËS

Para se të mbulohet me shtresë izoluese, shtresa e llaçit të çimentos dhe rërës duhet të vendoset në dyshemenë e tarracës. Trashësia 50mm.

8.3.8 MBULIMI I FUGAVE

Duhet të përdoren në çati/tarracë fugat e ekspansionit. Të mos kufizohet kullimi i ujit nga çatia/tarraca.

8.3.9 MBERTHIMI I IZOLIMIT

Mbërthimi do të kryhet tek bashkimet e fletëve të çatisë/tarracës 10cm nga cepi i fletës. Të paktën 3 mbërthesa për m² duhet të mundësohen për godinat deri në 20m gjeresi me një minimum prej 6 mbërthimesh për metër në cepat dhe 9 mberthime për metër në cepa.

8.3.10 FIKSIMET

Fiksimet për punime metalike (vidat, ankorat dhe upat, etj.) duhet të jene të përshtatshem për materialet në të cilat ata instalohen. Duhet të shmanget ushtrimi i një force të pa nevojshme gjatë instalimit të përbërësve.

8.3.11 MBULIMET E PARAPETEVE

Veshja që mbulon parapetet e murit duhet të jenë me çelik në ngjyrën e rënë dakord me Mbikëqyrësin. Fugat në veshje duhet të nënvendosen me fletë bashkuese.

8.3.12 PËRBËRËSIT E GALVANIZUAR NË TË NXEHTË

Përbërësit e galvanizuar me të nxehtë duhet të formohen para se të zhyten. Nëse shpimi i materialeve të galvanizuara është i nevojshëm pasi ato të jenë zhytur atëherë brima e shpimit duhet të trajtohet me lyerje galvanizuese të ftohtë menjëherë pas shpimit.

8.3.13 ULLUQET

Ulluqet duhen vendosur me një gradim prej të paktën 3mm për metër linear vetëm nëse nuk tregohet ndryshe. Ulluqet prej PVC nuk janë të lejuara.

8.3.14 TUBAT E SHKARKIMIT

Tubat vertikale të shkarkimit duhet të jenë çelik i galvanizuar. Lidhjet duhet të jenë të dukshme dhe tapat duhet të zgjaten të paktën 5cm brenda foleve. Nëse bashkimi ruhet në skaj i atëherë ngjitja nuk do të jetë e nevojshme.

8.3.15 BASHKIMET ME NGJITJE

Mbivendosjet duhet të jenë të paktën 10mm. Për njësitë horizontale dhe pak të pjerrta ngjitjet kërkohet një saldim me gjerësi 10 mm. Hapësira e ngjitjes/saldimit nuk do të jetë më e madhe se 0,5mm për të siguruar veprim të duhur të kapilaritetit.

8.3.16 ANET E MPREHTA METALIKË

Cepat e mprehtë të fletëve metalike do të gërryhen. Për fletët deri në 1mm në trashësi, duhet përdorur një thep mbrojtës.

8.3.17 HEQJA E PRERJEVE DHE SHPIMEVE

Prerjet dhe shpimet metalike si edhe pluhuri metalik i prodhuar gjatë aktiviteteve gërryese duhet të pastrohet nga punimet permanente menjëherë pas përfundimit të punimeve prerëse.

8.3.18 RUAJTJA

8.3.18.1 Ruajtja E Izolimit Tashmë Të Aplikuar Dhe Hidroizolimit

Te mos lejohet ndërtimin me faza. Të ruhen fundet e hapura të secilës ditë pune membulesa dhe nderprerjen e perkohshme të ujit, të hiqen kur puna rifillon. Të ruhen hapësirat e lëna të hapura ndërmjet izolimit dhe parapeteve ose mureve të tjera, hapësirat në trotuare, dhe fugat e ekspansionit, deri sa të aplikohen llamarina të perkohshme. Të mos lejohet magazinimi, kalimi, me mjete me rrota ose transportimi me kamionë në mënyrë të drejt për drejtë në izolim ose në sipërfaqet me çati tarracë.

8.3.18.2 Materialet Dhe Puna E Dëmtuar

Të kthehet puna dhe materialet të cilat dëmtohen gjatë ndërtimit në kushtet origjinale ose të zëvendësohen me materiale të reja.

8.3.18.3 Punimi Me Materiale Të Nxehta

Ruajtja e cilindrave prej gazi në depo nëntokësore, në shkallë, korridore dhe hapësirat e shpëtimit është e ndaluar. Gjatë punës me materialet prej gazi të nxehta pajisjet e mbrojtjes ndaj zjarrit të mbajtura në dorë në përputhje DIN EN 3 duhet të jenë të gjindshme në mënyrë të menjëhershme ngjitur me zonën e punës.

8.3.18.4 Ruajtja e Punimeve Metalike

Të gjitha punimet metalike në nivelin e tarracave duhet të mbrohen kundër gërryerjes së bitumenit dhe ndryshkut të bardhë duke aplikuar një shtresë mbrojtëse në përputhje me materialin e çatisë/ tarracës deri në 2mm përmbi nivelin e çatisë së përfunduar.

8.3.18.5 Pastrimi

Me përfundimin e punimeve të gjitha mbetjet duhet të hiqen nga kantieri duke përfshirë edhe mbetjet të cilat kanë rënë në parvaze, ulluqe dhe përgjatë godines apo në nivelin e katit përdhe.

8.4 PANELET SANDWICH

8.4.1 TË PËRGJITHSHME

8.4.1.1 Referenca

Ky specifikim zbatohet për të gjitha veçoritë në ndërtimin dhe fabrikimin e paneleve duke përdorur panel sandwich të izoluar me lesh xhami, dhe rregullimet në produkt të lidhura me standardet dhe ligjet e mëposhtme.

Publikimet e renditura më poshtë formojnë pjesë të këtij specifikimi deri në atë masë që është referuar. Publikimet e referuara në këtë tekst vetëm në përcaktimin bazë.

8.4.1.2 Produktet

Miratimi i produktit të ofruar jepet në kantierin e ndërtimit vetëm pas paraqitjes së një kampioni të pranueshëm për secilin lloj.

8.4.1.3 Karakteristikat e Panelit me Lesh Xhami

Mbulimi me panele sandwich;
Panele të përbëra me dy fletë mbuluese alumini dhe një bërthamë minerale;
Panele muri sandwich;
Panele të përbëra me dy fletë mbuluese alumini dhe një bërthamë minerale.

8.4.2 EKZEKUTIMI

8.4.2.1 Të përgjithshme

Për të gjitha materialet që janë përdorur për instalim do të duhet të kushtohet vëmendje për të parandaluar, dëmtime apo gërvishtje.

Instalimi i paneleve sanduic me lesh xhami do të bëhet nga një specialist i instalimit të paneleve me aftësi të mjaftueshme.

Kornizat mbështetëse do të përdoren si materiale të galvanizuara apo materiale të lyera me antindryshk. Do të përdoret një shtresë me material të papërshkueshëm pas palosjes për pjesën e prerë e cila nuk është e mbuluar me bojë ose do të lyhet me antindryshk.

Në rast të gërvishtjeve të vogla, do të lyhet me bojë spray.

9. HIDROIZOLIMI

9.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

9.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi deri në masën e marrë për referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin e tyre bazë.

9.1.1.1 Normat Dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare

9.1.1.2 Normat dhe Standardet Evropiane

DIN 18195 – 1	Hidroizolimi i godinave - Pjesa 1: Parimet, përcaktimet, atributet e llojeve të izolimeve ndaj ujit.
DIN 18195 – 2	Hidroizolimi i godinave - Pjesa 2: Materialet.
DIN 18195 – 3	Hidroizolimi i godinave - Pjesa 3: kërkesat për materialet e tokës dhe të punës e karakteristikat e tyre.
DIN 18195 – 4	Hidroizolimi i godinave - Pjesa 4: izolimi ndaj ujit dhe lagështirës së terrenit (kapilaritetit, uji i mbetur) dhe mos akumulimi i ujit të mbetur nën shtresat e dyshemesë dhe në mure, skicimi dhe ekzekutimi.
DIN 18195 – 5	Hidroizolimi i godinave - Pjesa 5: izolimi ndaj ujit kundër ujit që nuk ka presion në dysheme dhe në zonat e lagështa; skicimi dhe ekzekutimi.
DIN 18195 – 6	Hidroizolimi i godinave dhe strukturave; fletët izoluese të nënshtruara ndaj presionit hidrostatik nga brenda; skicimi dhe puna.

9.1.2 PARAQITJET

Duhet te paraqiten:

Të dhënat e kataloguara të Prodhuesit

Panele Izoluese

Fleta e bitumenit të modifikuar me polimer

Bitum prajmer

Ngjitjet e kryera me shtypje

Ngjitjet e bashkimeve

Udhëzimet

Panele Izoluese

Fleta e bitumenit të modifikuar me polimer

Bitum prajmer

Ngjitjet e kryera me shtypje

Ngjitjet e bashkimeve

Të përfshihen udhëzime të detajuara aplikimi dhe skicat standarde të ndryshuara në bazë të këtyre kërkesave specifike. Në mënyrë specifike të identifikohet me shkrim, ndryshimet ndërmjet udhëzimeve të prodhuesit dhe kërkesave të specifikuara.

9.1.2.1 Deklarimet

Cilësimi i prodhuesit;

Cilësimi i veglës;

Certifikoni që prodhuesi i membranës së modifikuar me bitumen përmbush kërkesat e specifikuara.

9.1.3 DËRGIMI, MAGAZINIMI DHE TRAJTIMI

9.1.3.1 Dërgimi

Të sigurohet shpërndarja e materialeve në kontenierët dhe roleve të pahapura origjinale të ardhura nga prodhuesi me etiketa qartësisht të lexueshme. Shënoni si të tilla dhe hiqni materialet e lageshta nga kantieri. Aty ku materialet janë të mbuluara nga një specifikim i dhënë, kontenieri duhet të ketë numrin e specifikimit, llojin dhe klasën sipas aplikimit. Të dorëzohen materialet në sasi të mjaftueshme për të lejuar që puna të vazhdojë pa ndërprerje.

9.1.3.2 Magazinimi

Të ruhen materialet ndaj thithjes së lagështisë. Të ruhen vertikalisht materialet e rrotulluara në role dhe në platforma të ngritura ose paleta një nivel më lartë në vendndodhje të thata me ventilim të duhur, si psh godinë ose kontenier i mbyllur. Rolete nuk duhet te ruhen në godina në ndërtim deri sa betoni, llaci dhe fino të ketë përfunduar dhe të jetë i tharë. Rolete te ruhen në temperatura mbi 10 gradë Celsius për 24 orë menjëherë pas aplikimit. Të mos ruhen materialet jashtë vetëm nëse nuk miratohen nga Mbikëqyrësi.

9.1.3.3 Trajtimi

Të zgjidhet dhe operohet marrja e materialeve në mënyrë që të mos dëmtohet membrana e aplikuar. Të parandalohet dëmtimi tek anet dhe fundet e materialeve në forme rolesh.

9.1.4 KËRKESAT MJEDISORE

Të mos instalohet membrana kur temperatura e ajrit është nën 4 gradë Celsius, gjatë çdo forme lagështie, shiu, mjegulle, ose kur ka akull, ngricë, lagështi të dukshme në çati/tarracë.

9.2 PJESA 2 - PRODUKTET

9.2.1 IZOLIMI

9.2.1.1 Paneli izolues

Panet izoluese për soletat e kateve përdhe, të jenë polistiren (XPS) të një trashësie siç tregohet në vizatimet teknike.

9.2.1.2 Përbërësit

9.2.1.2.1 Ngjitësi

Sipas rekomandimit të prodhuesit të izolimit.

9.2.2 HIDROIZOLIMI

9.2.2.1 Membranë e Papërshkueshme

Në polimer bitumen elastik-plastik-merik, me një shtresë prej fibër xhami ose përforcim të fletëve prej poliestre, të cilat peshojnë 3Kg/m² si minimum. Materiali duhet të çertifikohet si i përputhshëm me materialin izolues për të parandaluar humbjen e plasticitetit. Tiparet:

Zgjatimi në fundet e përbërësve të papajisur (NFT46002) 2,000%,

Rezistenca në tërheqje gjatësore 90 gradë transversale 80Kg/5cm,

Zgjatimi në këputjet gjatesore 50% transversale 50%

Rezistenca ndaj lodhjes në plasaritjet aktive në 0°C 10,000 cikle - në -10°C - 1,000 cikle,

Fleksibiliteti ndaj të ftohtit - 25°C.

Për muret

Membranat kundra lagështisë për muret, 4mm trashësi, në bitumen polimer elastomerik, të aplikuar mbi shtresën e parë të bitumenit

Për themelet

Membranat kundër lagështirës për themelet, 4mm trashësi, në bitumen polimer elastomerik, të aplikuar në shtresën e parë të bitumenit

Për soletat

Membranat kundër lagështirës për pllakat, 4mm të trashanë bitumen polimeri elastomerik, ta aplikuar në shtresën e parë të bitumenit

9.2.2.2 Bitum i cilësisë së parë

Në një shtresë bitumi ose emulsion

9.2.2.3 Fletë Polietileni (PE)

Fletë PE e stabilizuar me UV të shtresës së parë të PE dhe në përputhje me EN 13984:2013 me karakteristikat e mëposhtme: vlera në SD > 100m, trashësia min 100µ, rezistenca e temperaturës +70°C, temperatura e aplikueshme -10°C deri në +40°C

9.2.3 FUGAT

9.2.3.1 Mbushjet e fugave

9.2.3.1.1 Fugat e ekspansionit

Mbushësi duhet të jetë i përputhshëm me materialin ngjitës të fugave. Fugat e ndalimit të ujit duhet të jenë prej fugave të ekspansionit 225mm në gjerësi, materiali: gomine. Të gjitha fugat ndërtimore dhe ato të ekspansionit janë të përfshira në çmimet e betonit.

9.2.3.2 Lidhja e ndërprerjeve

9.2.3.2.1 Materialet bllokuese

I shtypshëm, i pa zvogëlueshëm, jo reagues me ngjitës të bashkuar dhe të llojit jo absorbues si shufrat plastike, pa vajra ose bitumen. Materialet bllokues duhet të kenë një përthithje uji prej jo më shumë se 5% të peshës pas testimit. Materialet bllokuese duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e instalimit të prodhuesit të ngjitësit të fugave dhe të jenë të paktën 25% më të mëdhenj në diametër se sa gjerësia e bashkimeve si të treguara.

9.2.3.2.2 Shiriti Ndarës

Shiriti prej poliestre ose polietilene, 0,08mm 3mm trashësi minimale, ose shirit maskues, jo reagues, jo thithës, e ngjitës me gjerësinë të barabartë të fugave siç tregohet. Shiriti ndarës duhet të jetë në përputhje me udhëzimet e instalimit të prodhuesit të ngjitësit të fugave.

9.2.3.3 Mbylljet e fugave

Silikon me përbërës i veçantë i Aplikuar në të ftohtë. Ngjitësi prej silikoni duhet të jetë vetë nivelues, që nuk trajtohet nga acidi

9.2.3.4 Lidhjet me kunjat

Shufrat duhet të përmbushin madhësitë dhe gjatësitë e treguara për shufrat metalike.

9.2.4 GJEOTEKSTILI PER STRUKTURAT

9.2.4.1 E përgjithshme

Aty ku përcaktohet në vizatimet teknike ose sipas drejtimit të Mbikëqyrësit (mure fasade, tarraca, etj.), te mundesohet pëlhurë filtruese plastike (Gjeotekstil). Gjeotekstili do të jetë i përbërë nga polipropileni ose poliestra pa përdorimin e ngjitësve. Do të kryhet në përputhje me njërin si më poshtë vijon:

- me fibra të vazhdueshme,
- me fibra të ndërthurura ("përkulura e ndërthurura" me sistem thurjeje industriale),
- me fibra të duhura të ndërthurura me gjatësinë e arritur nga gjilpërat mekanike.

Te jepen detajet, me një çertifikatë e cila përcakton emrin e prodhuesit, emrin e produktit, numrin e stilit, përbërjen kimike të filamentit ose thurjeve dhe ndonjë informacion të duhur, dhe shembujt e materialit të propozuar për rishikim dhe miratim.

Gjeotekstilet e etiketuar, transportimi dhe magazinimi duhet të jenë sipas ASTM D 4873. Emërtimet e produkteve duhet të tregojnë qartësisht prodhuesin ose emrin e furnizuesit, emërtimin e stilit dhe numrin e rolese. Çdo dokument transportues duhet të përfshijë një informacion i cili certifikon se materiali është në përputhje me çertifikatën e prodhuesit.

Çdo role' gjeotekstili duhet të mbështillet me një material i cili do të mbrojë gjeotekstilin nga dëmtimet e mundshme gjatë transportit, uji, drita e diellit dhe ndotësve. Mbështjellja mbrojtëse duhet të ruhet gjatë periudhës së transportit dhe magazinimit. Gjatë magazinimit, rolete e gjeotekstileve duhet të ngrihen nga toka dhe të mbulohen siç duhet për ti ruajtur ato nga dëmtimi i karakteristikave fizike të vetive të gjeotekstilit.

9.3 PJESA 3 - EKZEKUTIMI

9.3.1 IZOLIMI

9.3.1.1 Verifikimi i Kushteve

Para instalimit të izolimit, të siguroheni se zonat të cilat do të jenë në kontakt me izolimin të jenë të thata dhe pa dalje të cilat mund të shkaktojnë hapësira, shtypje izolimi, apo shpime. Nëse ndodh izolimi poshtë soletave ose në perimetër, të kontrollohet që mbushja të jetë e sheshtë, e thatë dhe e ngjeshur mirë. Nëse krijohet lagështi ose kushte të tjera, të cilat nuk lejojnë instalimin e duhur të izolimit, të mos vazhdohet por të lajmërohet Mbikëqyrësi për kushtet e tilla.

9.3.1.2 Instalimi i Paneleve të Izolimit

Të instalohet dhe përdoret izolimi në përputhje me udhëzimet e instalimit të prodhuesit. Të ruhet materiali i thatë dhe pa materiale të huaja. Të ruhen praktikatat e sigurta të punës.

9.3.1.3 Instalimi në Murature

Të aplikohet shtresa përmbi murature me ngjitëse ose lidhëse siç rekomandohet nga prodhuesi i izolimit. Të vendosen pengesat pa ngulur shtresat në lidhëse ose ankorime. Të aplikohen në shtresa paralele fugat e shkeputjes në gjysmë të shtresave si më poshtë. Të vendosen fundet në kontakt të mjaftueshëm me izolimin ngjitur pa e sforcuar. Të priten dhe formatohen në bazë të kërkesës për ti vendosur rreth daljeve të mureve, projekteve ose hapjeve për të akomoduar shërbime të ndryshme. Të ngjiten prerjet me ngjitëse. Të instalohen shtresat në zgavrat e mureve në mënyrë që të lejojë një hapësirë nominale ajrosjeje prej 25mm jashtë izolimit për të lejuar drenazhim të zones.

9.3.1.4 Instalimi nën soletat e Betonit

Të matet izolimi për të mbuluar sipërfaqen e soletës. Të aplikohet ngjitësi në soletë dhe të vendosen lidhesit tek ngjitësi sipas rekomandimeve të prodhuesit. Pas trajtimit të ngjitësit, të instalohet izolimi mbi lidhes, të shtrembërohen derisa të sheshohen me izolimin kapëset prej çeliku, të gjithë anët e izolimit dhe të mbyllet shiriti.

9.3.1.5 Ruajtja e Izolimit

Të ruhet izolimi nga demtimet mbi sipërfaqet vertikale gjatë ndërtimit dhe mbushja duke përdorur polistiren me trashesi prej 5cm. Të mos lejohet izolimi vertikal i pambrojtur gjatë natës. Të instalohet mbrojtës gjatë të gjithë periudhës së ekspozimit të paneleve izoluese.

9.3.2 HIDROIZOLIMI

9.3.2.1 Verifikimi i Kushteve

Të siguroheni që kushtet e mëposhtme ekzistojnë para aplikimit të materialeve të membranës:

Kullimet, pjerresite, thellimet dhe pajisjet mbështetëse janë të pozicionuara.

Sipërfaqet janë të ngurta, të thata, të sheshta dhe pa çarje, brima, dhe ndryshime të forta në lartësi. Nënshtrësia është e përsosur siç tregohet për të mundësuar kullim efektiv.

Nënshtrësat e fabrikuar në vend janë lejuar të kurohen dhe thatësia e sipërfaqes me kërkesat e specifikuar të jenë përmbushur. Kurimi i nënshtrësive duhet të jenë në përputhje me sistemin e membranave.

Të gjitha këndet do të rumbullakosen duke përdorur material izolues ose llaç për të parandaluar palosjen e materialit.

9.3.2.2 Prajmer i Sipërfaqeve Me Beton

Pasi të jenë përmbushur kërkesat për thatësi, sipërfaqet e betonit të cilat do të mbulohen me fletën e membranës në mënyrë uniforme të lyhen me një shtresë prajmer bitumeni. Kjo shtresë duhet të aplikohet në gamën 130gr/m² dhe të kenë një minimum trashësie prej 3mm (në të thatë). Të lejohet kjo shtresë të thahet para se të aplikohet fleta e membranës.

9.3.2.3 Aplikimi

Të aplikohet membrane në bazë të specifikimeve të botuara të prodhuesit. Të ruhen materialet të thata para dhe gjatë aplikimit. Të mos lejohet ndërtimi me faza. Aplikimi i plotë i membranës në një veprim të vazhdueshëm. Të ruhen temperaturat e specifikuar për bitumen.

9.3.2.3.1 Fletët e Bitumenit Prej Polimerit Të Modifikuar

Këto fletë duhet të jenë të izoluar dhe pa vrima të vogla, grimcat e materialeve të huaja të pandara, ose të defekteve të tjera të prodhimit të cilat mund të prekin mundësinë e shërbimit. Cepat e bashkimit duhet të jenë të drejta dhe të sheshta në mënyrë që ato të lidhen me njëra tjetrën pa formuar ngrehina ose rrudha.

9.3.2.3.2 Fletët e Modifikuara të Polimerit të Bitumenit

Te aplikohet në menyre të plote në xhtësia elektrike ose me pishtar të nxehtë tek fletët e ngjitura. Të shpalosen fletët, vendosen në vend me anime anësore prej 250mm dhe fundore 250mm. Apliko nxehtësinë nga poshtë topit dhe 100mm tek ana e topit të mëparshëm dhe të ngjitet plotësisht membrana tek nënshtrësia duke ç'rrotulluar pjesën e nxehur të topit në nënshtrësë. Të sigurohet një minimum rrjedhjeje të bitumenit të modifikuar prej të paktën 10mm, për të mos kaluar 25mm, tek anët dhe fundet ndërsa membrana rrotullohet përpara dhe ngjitet me nënshtrësën. Kujdes duhet kushtuar në mënyrë që të mos tejnxehet sipërfaqja e sipërme e topit. Pasi membrane të jetë ngjitur me nënshtrësën, të kontrollohen anët me një mistri të nxehtë për të siguruar që anët të jenë plotësisht të ngjitura. Në zonën kur ngjitja e plotë e anëve të mos arrihet, të rinxehet dhe të vendoset me mistri në vend në mënyrë që ngjitja totale të arrihet.

Nëse elementët e parafabrikuar duhet të puthiten me sipërfaqen e izoluar ndaj ujit (si për shembull dritaret e bodrumeve) izolimi ndaj ujit duhet të zgjatet të paktën brenda anës së njësisë para instalimit.

9.3.2.3.3 Pastrimi

Të hiqen mbetjet, copëzat dhe ndonjë mbeturinë tjetër i cili del si rezultat i instalimit të sistemit të mbulimit nga kantieri çdo ditë.

9.3.2.3.4 Ruajtja e Membranës së Aplikuar ndaj Lagështisë

Në fund të ditës së punës dhe kur priten reshje, të ruhet sistemi i membranës së bitumenit të aplikuar. Të aplikohet ruajtja e membranës nga drita e diellit të fortë dhe të drejt për drejtë.

9.3.2.4 Kontrolli i Cilësisë në Terren

Të kryhen teste në terren.

9.3.2.4.1 Testi për Thatësinë e Sipërfaqes

Para se të aplikohen fletët e membranës dhe të fillohet puna në zonën që do të mbulohet me çati/ tarracë. Thatësira duhet të jetë më e madhe se 0.03%.

9.3.3 FUGAT

Fugat e ekspansionit duhet të kenë dimensione dhe hapësirën e treguar, dhe të mbushen me ngjitës e bashkues të parambushur. Të mbahet mbushësi në vend në mënyrë të sigurt gjatë vendosjes dhe përfundimit të betonit. Të përdoren mbështetëset metalike për të mbështetur mbushësin dhe për të ruajtur materialin nga dëmtim gjatë veprimeve me betonin. Një mur ndarës kur ai përdoret, duhet të ketë fuqinë e mjaftueshme për të qëndruar drejt nga njëra anë tek tjetra e copës së betonit kur ai vendoset mbi të. Të lidhen këto mure në vend në mënyrë të sigurt me kënde të drejta për akset në gjatësi dhe transversale dhe sipërfaqet e betonit. Të vendosen kunjat metalike për të mbajtur mbushësin plotësisht në pozicion. Të depozitohet betoni dhe ngjeshet para se muri të hiqet. Të mos hiqen kunjat deri sa betoni të ketë përfunduar. Në asnjë rrethanë nuk duhet lënë betoni mbi materialin zgjerues ose bashkime të përtëjshme në ndonjë pikë. Të pritet betoni me kujdes i cili kapercen anet e fugave pranë kallepeve pas heqjes se kallepeve.

Të vendosen seksionet e materialit ngjitës ngushtësisht së bashku për të parandaluar që betoni të futet në hapësirën e bashkimeve.

9.3.4 Puna në të Nxehtë

Ruajtja e cilindrave prej gazi në depo nëntokësore, në shkallë, korridore dhe hapësirat e shpëtimit është e ndaluar. Gjatë punës me materialet prej gazi të nxehta pajisjet e mbrojtjes ndaj zjarrit të mbajtura në dorë në përputhje DIN EN 3 duhet të jenë të gjindshme në mënyrë të menjëhershme ngjitur me zonën e punës.

9.3.5 Gjeotekstil për Strukturat

9.3.5.1 Pëlhura me Filtër Plastik (Gjeotekstil)

Pëlhura me filtër plastik do të vendoset në ose kundrejt një sipërfaqeje të përgatitur me kujdes, pa ngrëhina, mbetje ose të dala të cilat mund të dëmtojnë pëlhurën. Pëlhura duhet të vendoset lehtëazi dhe jo

të përhapet me palosje ose ngrahina. Materiali i dëmtuar do të riparohet ose zëvendësuar nga një copë gjeotekstil i cili është mjaftueshëm i madh për të mbuluar zonën e dëmtuar dhe për të përmbushur kërkesat për tejkalim. Pëlhura duhet të mbivendoset nga një minimum prej 450mm tek të gjitha bashkimet, palosjet dhe ngjitjet.

Materiali i përçueshëm duhet të vendoset në shtresa horizontale dhe tërësisht të konsoliduar.

Pëlhura me filtër plastik mund të jetë një pëlhurë jo e thurur e cila përbëhet nga të paktën 95% filamente polimerike të pëlhurës jo të thurur si me polipropilene, polietilen, poliestër, poliamide ose polivinil dine kloridi të formuar në një rrjet stabil në mënyrë që filamentet ose thurjet të ruajnë pozicionin relativ ndaj njëri tjetrit, duke përfshirë tegelat. Plastika bazë duhet të përmbajë stabilizues dhe/ose parandalues për ti bërë filamentet rezistente për përkeqësimin nga drita ultra-vjollcë (për kushtet e ekspozuara) nxehtësia, dhe kimikate mundësisht të dëmtueshme në mjedisin përreth.

Pesha e pëlhurave do të klasifikohet jo më pak se 140g/m² (0.46 ons për këmbë katrore) dhe të kenë një trashësi minimale prej 0,5mm (1/50"). Klasa e pëlhurës do të jetë 1 me material të ngjeshur rimbushës në më shumë se dendësi të thatë prej 95% MDD (AASHTO T 99). Për kushte më pak të vështira ose kushte të vështira instalimi, mund të përdoret Gjeotekstil i klasit 2. Të paraqiten kushtet e instalimit për pëlhurë para se të prodhohet Gjeotekstil.

Pëlhura duhet të rezistojë presion prej 70,5kN/m² (10.,PSI) dhe stres elastik të shkaktuar nga ky presion me një maksimum prej 25mm bashkimi betoni të parafabrikuar dhe njësi të zhytura. Koeficienti i tejçueshmërisë për filtrimin transversal duhet të jetë 10-3 dhe 10-1 cm/sek (të matet në kushte të njëjta me ato në kantier). Fuqia elastike e matur në rripat e gjerë prej 5cm nuk do të jetë më pak se 600 N/5cm, me 10-85% zgjatim nëçarje. Në rastin e pëlhurës së transheve gjithashtu duhet të jetë në gjendje të mbështesë shtresat e sipërme të rrugëkalimit, me një fuqi elastike jo më pak se 1,200 N/5cm ose 1,500 N/5cm.

Karakteristikat e kërkuara të Gjeotekstil-it (pëlhura) listuar si më poshtë:

9.3.5.2 Mbështjellja

Kërkesat Gjeotekstile	Klasi Gjeotekstil			
	Klasi 1		Klasi 2	
	Zgjatimi <50%	Zgjatimi >50%	Zgjatimi <50%	Zgjatimi >50%
Fuqia Kapëse (min)	1,400N	900N	1100N	700N
Fuqia e tegelit të qepur (min)	1,260N	810N	990N	630N
Fuqia e grisjes(min)	500N	350N	400N	250N
Fuqia e shpimit (min)	500N	350N	400N	250N
Tejçueshmëria (maks)	0,5/sek			
Madhësia e dukshme e hapjes (maks)	0.160 mm			
Qëndrueshmëria ultra vjollce (Fuqia e Ruajtur) (maks)	50% pas 500 orë ekspozimi			

9.3.5.3 Përforcimi

	Zgjatimi <50%	Zgjatimi >50%		
Fuqia Kapëse(min)	300kN/m	160kN/m		
Fuqia e tegelit të qepur (min)	220kN	140kN		

Fuqia e grisjes(min)	40kN	25kN		
Fuqia e shpimit (min)	10kN	5kN		
Tejcueshmëria (maks)	0,25/sek			
Madhësia e dukshme e hapjes (maks)	0.250 mm			
Qëndrueshmëria ultra vjollce (Fuqia e Ruajtur) (maks)	50% pas 500 orë ekspozim			

Gjeotekstilet duhet të jenë subjekt të marrjes shembull dhe testimit për të verifikuar përputhjen me këtë specifikim.

9.3.6 Drenazhimi

9.3.6.1 Gërmimi i tokës për kanalin e kullimit

Pas gërmimit është e nevojshme të verifikohet nëse ka tuba infrastrukture dhe riparimi i tyre nëse është e nevojshme. Gjatë procesit, përgjatë perimetrit të ndërtesës në shesh ndërtimi, do të vendoset tub plastik Ø 200 mm, i mbuluar me shtresë gjeotekstile.

Kanali i kullimit do të jetë i mbushur me zhavorr dhe materiale të tjera specifike, të cilat janë të nevojshme për të përfunduar punimet në kantier.

9.3.6.2 Membrana e papërshkueshme

Në bitumin polimer elasto-plasto-merik, me një shtresë të fibrave të qelqit ose përforcimit të fletëve të poliesterës, me peshë minimale 3kg/m². Materiali duhet të certifikohet si kompatibël me materialin izolues për të parandaluar humbjen e plastifikatorit. Karakteristikat:

- zgjatje në thyerjen e përbërësit të paarmuar (NFT46002) 2000%,
- rezistenca ndaj tërheqjes gjatësore 90 transversale 80 Kg / 5cm,
- zgjatje në thyerje gjatësore 50% transversale 50%
- rezistenca ndaj lodhjes në plasjen aktive në 0°C për 10.000 cikle - në -10°C për 1.000 cikle,
- fleksibilitet i të ftohtit - 25 ° C.

Membranë me rezistencë ndaj lagështirë për themelet, me trashësi 4mm, me bitum elastomerik të polimerit të aplikuar në shtresën e betonit bituminoz.

9.3.6.3 Pëlhurë Plastike me Filtër (gjeotekstil) në mur në bodrum vertikal

Gjeotekstili duhet të vendoset në ose kundrejt një shtrati ose sipërfaqeje të përgatitur me kujdes, pa kokrriza, mbetje apo teprica që mund të dëmtojnë strukturën. Pëlhura duhet të shtrihet lirshëm, jo e shtrirë me ndonjë rrudhë ose palosje. Materiali i dëmtuar duhet të riparohet ose të zëvendësohet me një copë gjeotekstili që është i madh mjaftueshëm për të mbuluar zonën e dëmtuar dhe për të përmbushur kërkesat e mbivendosjes. Gjeotekstili duhet të mbivendoset me një minimum prej 450mm (18") në të gjitha nyjet, shtresat dhe skajet.

Materiali i depërtueshëm duhet të vendoset në shtresa vertikale dhe të konsolidohet tërësisht.

10. RIFINITURA E MURATURES

10.1 PJESA 1 –E PËRGJITHSHME

10.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi deri në masën e marrë si referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm nga përcaktimi i tyre bazë.

10.1.1.1 Normat dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare

10.1.1.2 Standardet dhe Normat Evropiane

DIN 18550-3	Suvatimi - Izolimi termik i sistemeve të suvatimit të kryera prej llaci me ngjitës mineral dhe duke përdorur polistiren (EPS).
DIN V 18559	Sistemet e përbëra për izolimin termik; konceptet, përshkrimi i përgjithshëm
DIN 4102	Sjellja ndaj zjarrit e materialeve dhe elementëve të ndërtimit – Klasifikimi i materialeve të ndërtimit – Kërkesat dhe testimi
EN 12667	Performancë termike e materialeve dhe produkteve të ndërtimit – përcaktimi i rezistencës termike duke përdorur një pllakë të nxehtë dhe metodat me rrjedhje të nxehtësisë – produktet e rezistencës termike të lartë dhe të mesme

10.1.2 PARAQITJET

Paraqit si më poshtë:

Shembujt

Suvatimit: të paraqiten 4 panele me përmbajtje të ndryshme prej 900mm për miratimin e Mbikëqyrësit. Pas përzgjedhjes së një teksture të pranueshëm, të ndërtohet një shembull. Shembulli duhet të paraqesë murin dhe të gjitha aspektet e punës me fino, duke përfshirë por jo të kufizuara tek fugat e ekspansionit, fugat e kontrollit, dhe zgjatimet e kendore. Te ruhet nga demtimet kampioni i murit kryer si shembull.

Veshja me gurë natyror

Udhëzimet e Prodhuesit

Paraqit udhëzimet e printuara të përziera të prodhuesit për finon për përzierje të gatshme dhe përfundimin e finos akustike.

10.1.3 SHPERNDARJA , RUATJA DHE TRAJTIMI

Materialet e prodhuara të dergohen në paketimin origjinal të prodhuesit të cilat janë të etiketuara në mënyrë të qartë me emrat dhe markën nga prodhuesi. Të ruhen materialet e llacit dhe çimentos të thata dhe larg sipërfaqes së tokës, të mbuluara dhe larg mureve që kullojnë dhe sipërfaqeve të tjera të lagështa deri sa të jetë gati për përdorim.

10.1.4 KUSHTET MJEDISORE

10.1.4.1 Stukim me Allçi

Të ruhet një temperaturë ambiente prej jo më pak se 10 gradë C kur përdoret llac e fino në mënyrë të vazhdueshme dhe lejohet tharja.

10.1.4.2 Fino prej Çimentoje dhe Stuko

Të ruhet një temperaturë ambienti prej jo më pak se 5 gradë C në mënyrë të vazhdueshme ku fino e çimentos dhe punimet me stuko do të lejohen.

10.1.4.2.1 Ruajtja nga Dielli dhe Erërat e Thata

Gjatë aplikimit të dorës së fundit, dhe për një periudhë prej 48 orësh pas përfundimit të dorës përfundimtare për çdo zonë, të ruhet sipërfaqja e stukos dhe finos nga dielli dhe erërat e drejt për drejta. Përdorimi i mbulesave dhe materialeve të tjera të përkohshme është i pranueshem.

10.2 PJESA 2 – PRODUKTET DHE

MATERIALET MATERIALET

10.2.1 PARETE NDARES GIPSI

Furnizimi dhe instalimi i ndarjeve me gips me katër flete (dy për anë), me trashësi totale 150/200 mm (në bazë të skicave) të përbëra nga një strukturë metalike në profile çeliku të galvanizuar (6/10 në trashësi perimetrave “U” me guidën kryesore me trashësi 50/75/100mm dhe vertikalisht "C" me ndarjet në distancë të barabartë prej 60cm), mbi të cilat shtresat e gipsit vidhosen; çdo shtrese nuk do të jetë më pak se 12,5mm e trashë.

Instalimi në strukturat metalike

Rendi i aplikimit të operacioneve të mëposhtme:

Të vendosen ndarjet dhe të shënohen në dysheme dhe tavan me një vijë shkumësi dhe nivelues magnetik të aplikohet materiali jo elastik izolues dhe mbylljet në profilin metalike (si në formë “U” dhe “C”) duke i ngulitur ato me vida, kapëse dhe gozhda;

Të kontrollohet pozicioni dhe drejtimi; nëse aplikimi i udhëzuesit të dyshemesë është në kuzhinë /banjë, vendosni një shtresë bitumeni ose fletë polietilene nën profilin metalik, me kllapa vertikale deri në 2cm për mbrojtjen totale të profileve dhe shtresave dhe depërtimi i ujit;

Vendosni profilet "C" (me një gjatësi prej rreth 1cm sesa më pak sesa distanca ndërmjet bazës dhe udhëzuesit "U"), të gjithë të orientuara në një drejtim, duke vendosur fillimisht ato të cilat janë ngjitur me dyert ose të vendosura tek ndërthurjet e mureve të tjera, që i lidhin ato me shinat duke përdorur vida në distancat e vendosura;

Të vendosen shtresat (me të njëjtën lartësi sa dhoma në të cilën janë minus 1cm nga toka) në mënyrë që të gjendet lidhja me shtresat ngjitur përgjatë kolonave metalike; bashkimet përgjatë njëres anë të murit ndarës duhet të jenë të shkallëzuara në respekt me anën tjetër, për sa i përket ndarjeve me dy shtresa në shtresën e parë duhet të jenë të ndërthurura përkundrejt të parës; bashkimet horizontale duhet të jenë të shkallëzuara nga të dyja anët;

Shtresat e gipsit duhet të vendosen me vida në një distancë jo më pak se 1cm nga cepat e gjatësisë dhe 1,cm nga cepat/anët transversale/përkundrejt; Distanca ndërmjet vidave duhet të jetë rreth 30cm me një shtresë nga secila anë e kornizës; për ndarjet me dy shtresa, shtresa e parë e brendshme do të vendoset me vida në përreth 80 cm distancë të barazlartuar, kurse shtresa e dytë e jashtme do të vendoset me vida në përreth 25cm distancë të barazlartuar;

Te vendoset material izolues mes paneleve (pambuk mineral);

Bashkimi i finos dhe llaçit përgjatë fundeve të shtresave dhe bashkimeve; një shirit përforcues duhet të aplikohet përgjatë të gjithë gjatësisë së bashkimit në finon akoma të freskët, dhe një shtresë tjetër fino duhet të vendoset për të mbuluar shiritin dhe të gjitha gozhdët ose kokat e vidave;

Pas tharjes totale bashkimi duhet të mbulohet me shtresën përfundimtare, me të paktën 5cm tejkalim në secilën anë; më pas një shtresë e dytë duhet të vendoset për të mbuluar shtresën e parë më një gjerësi më të madhe prej përreth 30cm;

Pas tharjes së shtresës së fundit, sipërfaqja duhet të trajtohet më gërryes.

Aksesorët e instalimit

Në bazë të llojeve të ndryshme të bashkimeve, vida të ndryshme duhet të aplikohen: "C"

strukturë + profil – kapëset e vidave (upat),

Shtresë + kapëse metalike – vida fosfati me koka shpimi të kryera dhe majë të filetuar, të gjatësive të ndryshme,

shtresë+shtresë – vidat me koka tëkundërfiletuar dhe maje vendosëse si dhe me kokë heliktike,

aksesorët metalikë – vidat vetë fletuese me kokë të rrumbullakët.

Ruajtja e anëve të brendshme dhe kendeve

Të gjithë kendet dhe anët e brendshme duhet të përforcohen dhe ruhen me shirit përforcues ose me kënde metalike përgjatë gjithë gjatësisë së tyre.

Fugat

Aty ku ndarjet me mure gipsi bashkohen me muret e ndërtuar me tulla ose me elementë të tjerë, ose për ndarje me dimensione të mëdha/ndarje me mure gipsi jo të vazhdueshëm (> 15m², prezenca e hapjeve të dyerve dhe të dritareve) bashkimet e ndarjeve duhet të realizohen, 1/1,5 cm të gjera, përgjatë të gjithë gjatësisë e trashësisë së ndarjes. Fundi i bashkimit duhet të jetë i mbyllur mirë në thellësi (i padukshëm) me një material të përshtatshëm elastik.

Ekzekutimi i fugave mund të nënkuptojë:

Pudër allçie e cila ngjitet shpejt, thahet shpejt,

Mbushës baze gati për tu përdorur.

Sistemet e ankorimit të duhur duhet të përfshihen për mbajtjen e orendive të banjës.

Izolimi akustik

Performancat e materialeve të parandalimit të ndotjes akustike duhet të garantohen për çdo lloj ndarjeje në përputhje me treguesit ekzekutiv. Vlerat e përcaktuara nga eksperimente duhet të jenë më të larta se sa ato të përshkruara me tolerancat e mëposhtme: shumica e nivelit të ndryshimeve ndërmjet vlerave të kërkuara dhe atyre të matura nuk duhet të kalojë 12dB dhe gjithashtu shmangia maksimale për secilën frekuencë nuk duhet të jetë më e lartë se sa 5dB

Performanca e hidroizolimit

Për hapësirat e lagura/njoma shtresa e izoluesit të brendshëm duhet të aplikohet, certifikuar në bazë të kushteve të caktuara. Variacionet e lagështisë brenda hapësirave ku shtresat e izolimit nuk janë të instaluar nuk duhet të krijojë atyre shtresave ndryshime dimensionale, ose degradimin e materialit.

Rezistenca ndaj tronditjeve

Muret duhet të jenë në gjendje të rezistojnë 3 goditje trupore të buta me një impakt energjetik prej 250J (përreth 25kgm) dhe mpakte të forta trupore me një impakt energjetik prej 10J, duke ruajtur pas këtyre integritetin strukturor, duke parandaluar kalimin e trupit përtej shtresës, të mos kalojë nëpërmjet skeletit, duke mos mundësuar copëza të cilat shpëputen dhe mund të shkaktojnë plagosje aksidentale apo dëmtime tek njerëzit. Procedurat e testeve duhet të jenë në përputhje me standardet ICITE-UEATC.

Rezistenca ndaj pajisjeve që varen ose fiksohen

Vetë muri dhe pajisjet lidhëse duhet të jenë në gjendje të rezistojnë, pa deformime ndryshimeve permanente dhe pa dëmtime të dukshme, një ngarkese prej 100kg të aplikuar paralel me sipërfaqen e murit, në një distancë prej 30cm nga ai dhe i shpërndarë në një gjatësi prej 50cm në drejtimin e gjatësisë. Pajisja testuese dhe ngjitëse duhet të furnizohet nga prodhuesi.

Rezistenca ndaj ngrohtësisë rrezatuese

Muri i gipsit duhet të përballojë pa ndryshime të dukshme dhe deformime permanente, shkeputje, ndryshime në formë dhe dukje, apo thyerje nxehtësie të shkaktuara nga rrezatimi i një llambe 250W.

10.2.1.1 Panele standarte gipsi

Shtresat e gipsit standard (DIN 18180 GKB klasifikimi) për përdorim të brendshëm duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

Klasa e reagimit ndaj Zjarrit EN 13501-1: A2-s1, d0,

Faktori i rezistencës ndaj lagështisë μ : 10 (thatë), 4 (njomë),

Përçueshmëria termike λ : 0,20 W/mK,

Dendësia ≥ 680 kg/m³

Pesha e fletes së gipsit: $\geq 8,5$ kg/m² për 12,5mm trashësi, $\geq 13,3$ kg/m² për 15mm trashësi,

Ngarkesa në perkulje: ≥ 550 N në gjatësi dhe ≥ 210 N transversale për 12,5mm trashësi, ≥ 650 N në gjatësi dhe ≥ 250 N transversale për 15mm trashësi.

Performancë e lartë për fletet e gipsit të para përfunduara (DIN 18180 GKFI klasifikim), 12,5mm trashësi, për përdorim të brendshëm duhet të kenë karakteristikat si më poshtë:

Klasa e reagimit ndaj Zjarrit EN 13501-1: A2-s1, d0,

Rezistenca ndaj lagështisë μ : 10 (thate), 4 (njomë),

Përcjellshmëria termike λ : 0,25 W/mK,

Dendësia: ≥ 1000 kg/m³

Pesha e shtresës: përafërsisht 12,8 kg/m²,

Ngarkesa në perkulje: ≥ 725 N në gjatësi dhe ≥ 300 N transversale, Forca

e sipërfaqes: ≤ 15 mm Ø,

Kapaciteti thithës i ujit: $\leq 10\%$

10.2.1.2 Pllakat e gipsit REI

Shtresat e gipsit rezistente ndaj zjarrit (klasifikimi DIN 18180 GKF) për përdorim të brendshëm, me fiber mineral dhe përforcues të shtuar për një lidhje më të mirë atomike, duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

Klasa e reagimit ndaj zjarrit EN 13501-1: A2-s1, d0,

Faktori i rezistencës së avujve të ujit μ : 10 (thatë), 4 (njomë),

Tejçueshmëria termike λ : 0,20 W/mK,

Dendësia: ≥ 820 kg/m³

Pesha e shtresës: $\geq 10,5$ kg/m² për 12,5mm trashësi, $\geq 13,5$ kg/m² për 15mm trashësi,

Ngarkesa në perkulje: ≥ 550 N në gjatësi dhe ≥ 210 N transversale për 12,5mm trashësi, ≥ 650 N në gjatësi dhe ≥ 250 N transversale për 15mm trashësi

10.2.1.3 Pllake gipsi kundra lageshtires

Panele gipsi kundra lageshtires (klasifikimi DIN 18180 GKI) për përdorim të brendshëm me trashësi 12,5 mm, me përbërje $\text{CaSO}_4 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$ me absorbimin specifik ndaj lageshtires duhet të ketë parametrat e mëposhtme:
Reagimin ndaj zjarrit, klasa EN 13501-1: A2-s1, d0,
Rezistence ndaj faktorëve të avullit të ujit μ : 10 (thatë), 4 (njomë),
Përçim termik λ : 0,20 W/mK,
Densiteti: ≥ 760 kg/m³
Pesha e pllakës $\geq 9,5$ kg/m²,
Pesha e përkuljes ≥ 550 N për së gjati dhe ≥ 210 N transversale
Absorbimi i ujit pas dy orë zhytje totale të jetë jo më shumë se $< 10\%$ e peshës së pllakës.

10.2.1.4 Pllakë çimento e jashtme Akuapanel

Aquapanel Exterior është një pllakë e ashpër çimentoje, për përdorim të jashtëm. Ajo është e përbërë prej çimentos Portland dhe një rrjetë të përbërë prej fibre qelqi, të mbështjella në sipërfaqet e pasme dhe të përparme, me trajtim të veçantë të reduktimit të absorbimit të ujit. Fundet janë me seksion katror dhe skajet janë të përforcuara dhe rifuara pa probleme.

10.2.2 VEESHJE GIPSI DOPIO PANEL

Paisjet dhe instalimet e veshjes së murit me pllake gipsi dopiopanel trashësia totale nga 125/250 mm (sipas vizatimeve) e përbërë nga një strukturë metali të galvanizuar të profileve të çelikut me trashësi (6/10 në perimetër, udhëzuesi në formë "U" 50/70/100 mm trashësi dhe profilet vertikal "C" 60 cm distancë të dyaneshme), në të cilën vidhosen pllakat e gipsit; çdo pllakë/tabele do të jetë jo më pak se 12.5 mm.

Montimi në strukturën metalike

Te ndiqet renditja sipas veprimeve për aplikim:

Pjesët duhet të vendosen në një vend të rrafshët dhe të izoloohen me veshje termike dhe nivelin magnetik dhe aplikojë izolimin me materiale izoluese jo plastike në profilet metalike të perimetrit (në të dyja si në Profilet "U" dhe ato "C" duke i bashkuar ato me mentesha, vida, gozhdë;

Kontrolloni pozicionin e shtrirjes me ane të një spangoje; nëse sipërfaqja ku po montoni është e ashpër si pllaka/banje/kuzhine vendosni një shtresë bitumi ose polietileni nën profilet metalike me një lartësi vertikale 2 cm për mbrojtjen eplotëtë profileve dhe pllakës së gipsit nga depërtimi i ujit

Vendos profilet "C" (me një gjatësi rreth 1cm midis udhëzuesit në formë "U") të gjitha të orientohen në të njëjtin drejtim, fillimisht vendosni ato që pozicionohen në kornizat e dymëve ose ato që do të vendosen midis dy mureve, bashkoni ato në shina në distancën e paracaktuar;

Vendos pllakat (në të njëjtën lartësi me dhomën 1cm mbi dyshemë) me qëllim vendosjen dhe përputhjen midis pllakave të ngjitura përgjatë distancuesit metalik në forme kryqi (kryq metalik që vendoset midis dy shtresave të xhamit, gipsit përtë ofruar një distancëtë caktuar midis dy sipërfaqeve), bashkimi duhet të bëhet në respekt edhe të krahut tjetër, si një pllakat dopioshtërëngimet/saldimet duhet të bëhen njësoj në të dy pllakat; bashkimet/saldimet horizontale duhet të renditen në të dy krahët.

Pllakat duhet të shtrëngohen me vida jo më pak se 1 cm nga kulmet gjatësore dhe 1.5cm nga kulmet transversale, distanca midis vidave do të jetë 30 cm në çdo pllakë në të dy krahët e kornizës, për ndarëset dopio të pllakave, pllaka e parë (e brendshme) do të vidhohet me vida 80cm në distancë të përbashkët nga njëra tjetra dhe pllaka e jashtme do të vidhohet në distancën 25cm; Vendosni materialin izolues (pambuk mineral/xhami) duke suvatuar me fino te skajet dhe bordurat e kornizave izolantngjites duhet të vendoset mbi finon e freskëtnë shtresën e dymëve fine, (patinimi) duhet ti vendoset përtë mbuluar ngjitësin dhe vidat:

pas tharjes së plotëtë suvatimit një shtresëpërfundimtare patinimi duhet tëpërdoret si shtresëpërfundimtare me tëpaktën 5cm që rrjedh nëtë dy krahët, më pas një shtresëtjetërdytësore duhet të aplikohet shtesëpërtë mbuluar shtresën e parë me gjerësi rreth 30 cm, pas tharjes e gjithësipërfaqja duhet tërëshinohet me përdaf grafiti.

Aksesoret e instalimit

Në përputhje me llojet e ndryshme të ngjitjes, vida të ndryshme duhen përdorur: strukturë profilesh “C” kunja ose vida zgjatuese, distancues metalik të pllakave me vida fosfati me kokë kundra oksidimit dhe majë të trefishtë, të gjatësive të ndryshme bashkimi, pllake me anëtë vidave me kokë kundra ndryshkut me majë treshe dhe të drejtuara në forme spirale.

Aksesorët metalik, vide, kokë rrumbullake, vetmbushëse.

Mbrojtja e kulmeve dhe cepave të brendshëm.

Të gjithë kulmet dhe cepat e brendshëm duhet të përforcohen dhe mbrohen me shirit mbrojtës ose profile këndore, mbrojtës në cepat e shtresave dhe përgjatë aneve.

Fugat

Kur paretet e gipsit takohen me muratura dhe elemente të tjerë të ngjashëm ose ne rast përmasash të mëdha, me ndërprerje të pareteve të gipsit (>15 m², prezenca e dyerve dhe dritareve që duhen hapur) fugat duhet të realizohen nga, 1/1,5 cm të gjera, përgjatë gjithë gjatësisë dhe trashësisë së paretit. Fundi i fugave duhet të puthitet në thellesi në mënyrë që të mos jetë e dukshme me një material të përshtatshëm elastik.

Zbatimi i fugave mund të nënkuptojë:

Vendosjen e shpejtë të pluhurit të allcise/stuko, lehtësisht i thashem.

Sisteme të përshtatshme ankorimi duhet të përfshihen për fiksimin e paisjeve të banjës.

Reagimi ndaj ujit.

Për lagështinë dhe sipërfaqet e lagështa veshja kundra ujit duhet të përdoret dhe të jetë e certifikuar sipas kushteve tëcaktuara. Ndryshimi i lagështisë në hapësirat ku do të vendoset panelet e veshjes kundra lageshtires nuk duhet të ndikojë në degradimin e materialit dhe të vete veshjes.

Rezistenca ndaj tronditjeve

Muri duhet të rezistojë goditjeve të një serie treshe të një trupi me fuqi 250 J me një energji përplasjerreth (250 kilogram për metër) dhe të një trupi të fortë 10 J, energji përplasje, duke ruajtur formën e strukturës duke mos lejuar kalimin e trupit përtej veshjes dhe duke mos shkaktuar dëmtime dhe rrëzime copëzash që mund të shkaktojnë dëmtime aksidentale të ndonjë njeriu. Procedurat e testimit duhet të jenë konform standardeve të ICITE-UEATC.

Rezistencë ndaj fiksimit dhe varjes së pajisjeve

Pajisjet që duhet të varen dhe muri në vetvete duhet të jetë i aftët të rezistojë deformimeve dhe ndryshimeve të vazhdueshme, si dhe të mos ketë dëmtime të dukshme, për një ngarkesë 100 kg e cila vendoset në një paralel në një distancë prej 30 cm nga platforma dhe e shpërndarë në një sipërfaqe me drejtim lateral prej 50 cm. Pajisja testuese duhet të ofrohet nga fabrika që ofron materialet.

Rezistenca ndaj rrezatimit të ngrohjes.

Pllaka e gipsit duhet të jetë e qëndrueshme pa alterime dhe deformime të dukshme dhe të përhershme apo dëmtime të pjesshme në forme, pamje, si dhe plasaritje të shkaktuara nga energjia e rrezatimit të një llambe 250 W.

Veshje gipsi dopio panel

Pllakat standarde te gipsit, dopio panel (klasifikimi DIN 18180 GKB) për përdorim të brendshëm (në Godinë) duhet të kenë parametrat e mëposhtëm:

Klasa e reagimit ndaj zjarrit EN 13501-1: A2-s1, d0,

Rezistence ndaj faktorit avullues μ : 10 (thatë), 4 (lagështi),

Përçim termik λ : 0,20 W/mK,

Dendësi : $\geq 680 \text{ kg/m}^3$

Pesha e pllakës: $\geq 8,5 \text{ kg/m}^2$ për 12,5 mm trashësi, $\geq 13,3 \text{ kg/m}^2$ për 15 mm trashësi,

Perkulja nga ngarkesa $\geq 550 \text{ N}$ gjatësor dhe $\geq 210 \text{ N}$ transversal për 12,5 mm trashësi, $\geq 650 \text{ N}$ gjatësi dhe $\geq 250 \text{ N}$ transversal për 15 mm trashësi.

Pllake gipsi e parapergatitur me efikasitet te larte (klasifikimi DIN 18180 GKFI), 12,5 mm trashësi për përdorim të brendshëm (nëgodinë) duhet të kenë parametrat e mëposhtëm:

Klasa e reagimit ndaj zjarrit EN 13501-1: A2-s1, d0,

Rezistence ndaj faktorit avullues μ : 10 (thatë), 4 (njomë),

Përçim termal λ : 0,25 W/mK,

Dendësi $\geq 1000 \text{ kg/m}^3$

Pesha e pllakës: përrreth $12,8 \text{ kg/m}^2$,

Perkulja nga ngarkesa: $\geq 725 \text{ N}$ nëgjatësi dhe $\geq 300 \text{ N}$ transversal,

Fortësia e sipërfaqes $\leq 15 \text{ mm } \varnothing$,

Kapaciteti i përthithjes se ujit: $\leq 10\%$.

10.2.3 SHTRESAT E IZOLIMIT TERMIK

Izolimi termik i fasadave do të realizohet me panele me lesh guri mineral, me densitet të larte të fibrës minerale, me përçim termal λ_0 0.035 W/mK, koeficienti i shpërndarjes se avujve μ 1, shmangie $>10 \text{ kPa}$, delaminimi 10 %, forca ne ngjeshje $>30 \text{ kPa}$, Klasa e reagimit ndaj zjarrit A1 – material i padjegshëm.

Instalimi

Është e rëndësishme në rastet ku vendi ku do vendosen panelet cilësohet si i rrezikuar nga zjarri, panelet detajet e fiksimit/saldimit të këtyre paneleve për te rezistuar në raste zjarri për këtë qellim;

Të gjithë fiksuesit duhet të jenë prej çeliku dhe jo prej alumini.

Kënde çeliku/ kanalet të jenë minimumi 1.6 mm të trashë,

Të gjithë vidat të jenë prej çelikutë kalitur.

Izolimi termik i brendshem do të realizohet me panele mineral lesh guri, me densitet të larte të fibrës minerale, përçimi termal λ_0 0.035 W/mK, koeficienti i difuzionit μ 1, delaminimi 10 %, forca ne ngjeshje $>30 \text{ kPa}$, Klasa e reagimit ndaj zjarrit A1 – material i padjegshëm.

Instalimi

Është e rëndësishme në rastet ku vendi ku do vendosen panelet cilësohet si i rrezikuar nga zjarri, panelet detajet e fiksimit/saldimit të këtyre paneleve për te rezistuar në raste zjarri për këtë qellim;

Të gjithë fiksuesit duhet të jenë prej çeliku dhe jo prej alumini.

Kënde çeliku/ kanalet të jenë minimumi 1.6 mm të trashë,

Të gjithë vidat të jenë prej çeliku të provuar.

10.2.4 SUVATIMET

10.2.4.1 Produktet dhe materialet

Në përputhje me specifikimet, standardet dhe kërkesat e specifikuara këtu. Te sigurohen materiale pa përbërje asbesti. Në përgjithësi suvaja duhet të jete në përputhje me DIN 18550-2

10.2.4.1.1 Stukim

Stukimi

10.2.4.1.2 Patinimi

Shtrese kompakte patinimi

10.2.4.1.3 Suvatim me baze cimentoje

Suvatim me baze cimentoje

10.2.4.1.4 Fino me baze çimentoje

Fino me baze çimentoje

10.2.4.1.5 Gëlqere e hidratuar

10.2.4.1.6 Agregatet

Rërë për stukimin

Imtësia e rërës – maksimumi i kokrizes 1 mm.

Rërë për finon

Imtësia e rërës – maksimumi i kokrizes 1 mm.

Rërë për shtresen me baze cimentoje

Imtësia e rërës: maksimumi i kokrizes 2 mm.

10.2.4.1.7 Uji

Të jete i përshtatshëm për konsum shtëpiak pa minerale dhe substanca organike të cilat ndikojnë në fortësinë dhe qëndrueshmërinë e suvase ose stukos.

10.2.4.2 Përmasat e përzierjes

Nëse nuk specifikohet ndryshe, materialet janë të specifikuara në bazë volumi dhe duhet të maten në enë për tu siguruar që masa të specifikuara do të kontrollohen dhe përdoren me kujdesin e duhur gjatë procesit të punës. Te përgatitet perzjerja e allcise, cimentos gati per perdorim dhe te shohet uje.

10.2.4.2.1 Stukimi

Rëra është opsionale ne stukim

10.2.4.2.1.1 Rëre dhe stukim

Te perzihet shtresa e ashper me masen 45 kg allci e paster se bashku ne jo me shume se 56l rere te lagur, te perzihet shtresa me ngjyre kafe me masen 45 kg allci e paster se bashku ne jo me shume se 85l rere te lagur, ose shtresa e ashper dhe ajo kafe mund te perzihen bashke me masen 45 kg allci e paster ne jo me shume se 70l rere te lagur . Te perzihet baza e shtresave per dyfishin e sasise me masen 45 kg allci gipsi e paster ne jo me shume se 70 l rere te lagur ne paretet e gipsit dhe jo me shume se 85 l rere te lagur ne murature

10.2.4.2.2 Patinimi

Te pergatitet pluhuri i gelqeres në përputhje me udhëzimet e printuara nga prodhuesi. Te perdoret duke zbatuar sasite e duhura ose duke ndjekur periudhat e përdorimit që rekomandohen nga fabrika Shtresa per patinim (shtresa e bardhe) te perdoret mbi pllaken e gipsit. Te perzihet shtresa finale ne sasine e 1 porcioni allci e paster ne nje volum stuko te holluar. Kjo mase perzjerje duhet te jete ekuivalente me 1 thes 45 kg allci e paster ne: jo me shume se 4 thase 22.5 kg stuko ose jo me shume se 127l stuko e holluar.

10.2.4.2.3 Suvatim me baze çimentoje

10.2.4.2.3.1 Suvatim me baze cimentoje Portland

Shtresat baze janë dy llojesh para se të vendosim shtresën përfundimtare. Këto dy lloje përbëhen nga shtresa e ashpër dhe ajo në ngjyrë kafe. Përziej shtresën e ashpër me masën e një sasie volumore çimento Portland, 0 deri në $\frac{3}{4}$ e sasisë të volumit të përgjithshëm, të jete pluhur gelqere i hidratuar dhe 2 e 1/2 të katër pjesëve te jete rërë. Përziej shtresën ngjyre kafe me masën e një sasie volumore të çimentos Portland, 0 deri në $\frac{3}{4}$ e sasisë të volumit të përgjithshëm të jetë pluhur gelqere i lengshem dhe 3 nga 5 pjese rërë (volumi i rërës në raport me çimenton dhe trashësinë e llacit).

10.2.4.2.4 Fino me baze çimentoje

Përziej shtresën përfundimtare me masat e një pjese sasi volumore çimento Portland me jo më tepër se një pjesë gelqere të lëngshme dhe jo me tepër se katër pjesë volumore rëre të lagur Përdorimi gjatë punës do të jetë përcaktues i sasisë të gelqeres dhe rërës që përdoret në shtresën përfundimtare, brenda limiteve që përshkruhen me poshtë.

10.2.4.3 Ngjyra

Ngjyra e finos duhet të jetë e aprovuar nga prodhuesit e bojërave sipas kërkesës për ngjyrën e nevojshme.

10.2.4.4 Përzierja

10.2.4.4.1 Perzjerja e materialeve gjate punes

Përzierja e materialeve zakonisht bëhet me pajisje mekanike ndërsa në rastin e shtresës përfundimtare mund të bëhet me dorë. Përzierësit mekanik duhet të jenë të aprovuar në mënyrë të tillë që ta përziejnë ne menyre uniforme mirë masën që ndodhet brenda tyre me sasine e ujit. Kur perzjerja behet me dore, duhet të ketë ngjyrë uniforme në kovën e pergatitjes, te shtohet uje dhe te perzihet në mënyrë uniforme e të vazhdueshme.

10.2.4.4.2 Materiale të gatshme të përziera dhe të paketuara

Materialet e gatshme të përziera të suvase për gips suvase me çimento duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e printuara të fabrikës.

10.2.4.5 BOJRAT

10.2.4.1 Ngjyra dhe motivi

Ngjyrat e bojës dhe motivet duhet të zgjidhen sipas katalogut dhe standardeve të fabrikës. Ngjyrat dhe modelet referuar nga prodhuesi, janë për identifikimin e gjyres dhe motifit por nuk limitojnë zgjedhjen për produkte të ngjashme në ngjyrë dhe motiv nga prodhues të tjerë.

10.2.4.2 Boje plastike

Bojrat e përdorura për hapësira të brendshme duhet të jenë me baze terpentine dhe cilësi të lartë gome të pastër, kur treten me vajra lini ato duhet të paraqesin një sipërfaqe të shkelqyeshme. Përdorimi i produkteve të gomës nga distilimi është e ndaluar.

Vinil me baze uji për lyerje muresh.

Bojërat me baze uji - gjendje ujore të një substance jo organike, mundësisht mbartin ngjites ose emulsione substancash sintetike makro molekulare.

Temperat - gjendje ujore e pigmenteve dhe mbushësve (gelqere, qymyr, pluhur i hollë kalcium karbonati) mbartin ngjites natyrale ose sintetike të lidhësve (si ngjitës PVA, etj). Për tu përdorur vetëm në parete gipsi të hapësirave të brendshme. Muret duhet të jenë tërësisht të thatë në momentin e lyerjes. Temperat kanë aftësi të mira mbulimi të njollave dhe janë lehtësisht të lashme.

Tiparet e lyerjes me vinil

Për lyerje e muresh dhe tavanesh në suva, në suva të parapergatitur, panele gipsi dhe suvate zjarr durue. Bojërat mat akrilike me baze ujë bazohen në sezinat akrilike të shpërbëshme në ujë dhe pigmente të rezistueshme ndaj dritës, rezistente ndaj motit dhe agjenteve industriale, e pastrueshme e pa depërtueshme nga avujt e ujit:

Aplikimi: me furçe, me rryll ose spërkatje.

Holluesi: ujë,

Cikli i lyerjes (në mur të ri): 1 shtresë 40% e holluar me ujë, shtresa përfundimtare të hollëhet në masën 25%,

Përbërja: e bërë prej rezinës akrilike edhe pigmentet e tretshme në ujë,

Përbërja solide: 33%,

Pesha specifike mesatare : 1.70 kg/l,

Viskoziteti mesatar: 6750 cps në 20° C,

Sasia: 5-6 m²për 1 kg (dy duar),

Trashësia pas tharjes: 50 Me (dy duar),

Paraqitja e shtresës: satin,

Pershkrueshmeria nga avujt e ujit: 25 g/m² pas 24 orësh.

10.2.4.3 Veshja e korimanove metalike me PVC

Materialet dhe instalimet e korimanove duhet të përmbahen profileve të veçanta me aftësi të mirë amortizuese me bashkues të dyfishtë gome në çdo profil, rezistente ndaj goditjeve ku të jete aplikuar

material vinili (minimumi 120mm lartësi), vete-fiksues me sipërfaqe kundër gervishtjeve, e lyer në trup, rezistente ndaj disinfektiveve mekanike dhe kimike, zjarrdurues në përputhje me legjislacionin Evropian B- S1-dO. Trashësia në mm 2.0 mm. Vendosja në mure me mbështetjen e përshtatshme në polikarbonatin vete-fiksues si dhe vendosja e mbrojtësive (parakolpet) rreth 76 mm nga muri. E gjithë struktura ka funksion të dyfishtë për korimano dhe mbrojtese nga perplasjet dhe perfundon me kapak vet-fiksues polikarbonat.

10.2.4.4 Mbrojtëset e këndeve

Materialet dhe instalimet mbrojtëseve të këndeve konsiston në një profil alumini të përforcuar me një gjerësi prej 50 mm në çdo krah të cilit i është montuar material pvc rezistues ndaj goditjeve, me vete-fiksime me sipërfaqe kundërgervishtjeve, e lyer në trup, rezistente ndaj disinfektiveve mekanike dhe kimike, zjarrdurues në përputhje me legjislacionin Evropian B-S1-dO. Trashësia në mm 2.0 mm. të fiksohet në mure me dhe të perfundojë me kapak vet-fiksues polikarbonat.

10.2.5 BOJRAT SINTETIKE

Lyerja dhe motivi

Bojrat sintetike dhe motivet duhet të zgjidhen sipas katalogut dhe standardeve të fabrikës. Ngjyrat dhe modelet referuar nga prodhuesi, janë për identifikimin e gjyres dhe moivit por nuk limitojnë zgjedhjen për produkte të ngjashme në ngjyre dhe motiv nga prodhues të tjerë.

10.2.5.1 Bojrat sintetike

Enameli është i përbërë nga resine sintetike natyrale, vajra, mbushes mineral dhe disa pigmente oksidues. Ato duhet të kenë një aftësi të mirë fshehje të njollave, lehtësisht të aplikueshme, rezistente dhe me shkelqim. Bojrat të pajisura nga resine sinteike dhe llak, me pigmente dhe mbushes në solucion organik të resines sintetike, mund të përmbajnë dhe agjent thares (vaj, akrilik, oleo-alkid, chloro-vinil, epoksi, poloritane, poliestër, gome të klorinuar, silikoni). Tharja e shpejte e kthen sipërfaqen në një shtresë të fortë dhe rezistuese ndaj agjenteve atmosferik, drites dhe goditjeve.

Tiparet e bojës sintetike

E pastrueshme, me bazë uji me cilësi të lartë e me aftësi të mirë mbuluese. Prezenca e përbërësive shtesë mbron murin nga myku, karakteristikat kryesore:

Përbërja e lidhesave - bazohet në emulsionin e rezines akrilike

Pamja e shtresës – opake,

Specifika të gravitetit - 1.64 ± 0.05 kg L at 20 ° C,

Viskoziteti- 7000 ± 1000 cP Brookfield G6 V10 at 20 ° C,

Mbulimi praktik - 12-13 m²/L për shtresën,

Rezistence ndaj pastrimit – Klasi 2 sipas standardeve UNI EN 13300

ISO 11998, Tharje e murit – e ulët UNI 10792.

10.2.6 BOJRAT E TJERA

Bojra gelqerore -konsistojnë në emulsionin gelqeror ose puder gelqere e holluar në të cilën treten pigmente inorganike që cilat nuk veprojnë ndaj hidrosidit të kalciumit. Ngjytja me llacin përmirësohet nëpërmjet ngjytësit artificial ose natyral. Gjithashtu aplikohet në mure të sapo suvatuar duke përdorur pigmente natyrale.

Bojra silikate – përftohen nëpërmjet mbajtjes pezull të pigmenteve jo-organike ose pluhurave të kaolinit, solucioneve të pudrës ose shkumesit në ujë (silikat i sodiumit dhe potasiumit). Duhet të sigurohet një bashkim i qëndrueshëm me mbështetjen, të përgatitet nëpërmjet zhdukjes complete të bojërave paraardhëse. Ajo nuk duhet aplikuar në sipërfaqe të lyera me bojra gelqerore.

Lyerjet e çimentos gjendja ujore e çimentos se ngjyrosur që përmban ngjites. Ato duhet të përgatiten në sasi të vogla për shkak të kohës së shpejtë të mpiksjes. Duhet të aplikohet brenda 30 minutave para se të forcohet. Pas fazës së forcimit tretja në ujë për përdorime të metjeshme duhet të ndalohe.

Bojë anti-ruxho dhe anti gërryerjes duhet të ketë lidhje me llojin e materialit i cili duhet të ruhet ndaj kushteve mjedisore. Lloji i bojës do të diktohet nga supervisorët e punës.

Boje intumeshente ka aftësi të krijoj një shtresë që fryhet në rast zjarri duke prodhuar pore ajri dhe duke mbrojtur sipërfaqen ku aplikohet zjarr dhe nxehtësi. Duhet të jetë e cilësisë më të mirë dhe të sigurohet në ambalazhe të vullosura dhe të prodhuara në fundmi. Të përdoret vetëm me udhëzime të sakta të Mbikqyrësit të punimeve.

10.3 PJESA E 3 - ZBATIMI

10.3.1 Përgatitja e sipërfaqes për suvatim

Te pastrohet sipërfaqja nga pluhuri grimca të hedhura apo çdo materiali të jashtëm para vendosjes së paneleve të gipsit, suvase ose stukos. Te mos vendoset suvatimi direkt mbi sipërfaqet murale ose prej betoni që janë të veshura me bitumen ose me agjentë të tjerë kundër ujit, të lyera ose plastifikuar më parë. Para se të fillojë suvatimi të lagen me ujë të pastër sipërfaqet murale ose të betonit për të arritur kushtet e duhura të lagështisë. Te kontrollohen dyshemetë metalike, kthesat e këndeve dhe gjithçka tjetër të jetë e vendosur në vijën e duhur para se të fillohet puna. Te mbulohen të gjitha veglat dhe kovat të cilat mund të mpiksen gjatë suvatimit. Mbulimi i këndeve duhet të ofrohet në të gjithë këndet deri në lartësinë 2 m mbi nivelin e dyshemesë dhe duhet suvatuar në pozicionin ku ndodhen.

10.3.2 MJESHTERIA E SUVATIMIT

10.3.2.1 Testi i trashësisë së shtresë

Te vendoset suva manualisht ose me makineri. Gjate vendosjes së finos me makineri, te kontrollohet hollimi i pluhurit të gelqerës dhe te mos kalojë trashësinë 75mm gjatë testimit, suvaja e çimentos dhe fino duhet të kenë një trashësi jo më të lartë se 65 mm gjatë testimit, duke përdorur 50x100x150 mm.

10.3.2.2 Aplikimi

Te aplikohet vendosja e tre shtresave (dy shtresa baze suvatimi dhe një fino). Suvatimi nuk duhet të jetë i vazhdueshëm përgjatë fugave të ekspansionit dhe atyre të kontrollit, që ndodhen në mur, në pjesë të veçuara dhe tavane. Te përfundohet nivelimi, me plumbce, skuader dhe gjithçka tjetër me një tolerancë 3 mm në 2500 mm, pa valëzime, plasaritje apo rrudha, çngjyrosje, cepa apo çdo lloj tjetër mangësie. Suvatimi të vendoset me kujdes në cepa dhe konture dhe deri në bashkime. Te tregohet kujdes mos shkaktohen rrjedhje të vazhdueshme gjatë vendosjes së suvase. Nuk duhet të ketë shenja të dukshme në shtresën pas përfundimit të një ditë pune apo edhe të nesërmen.

10.3.2.3 Kontrolli dhe zgjerimi i bashkimeve

Te vendosen fugat e kontrollit ne vendet e percaktuara para se te aplikohet fino. Fugat vertikale duhet të jenë të vazhdueshme ndërsa ato horizontale në të kundërt të atyre vertikale. Te kontrollohen fugat e ekspansionit, kontrollit, si dhe aksesoret per te siguruar levizjet e papermbajtura, shiritat metalik te mos jene të vazhdueshëm pas fugave si dhe si dhe sipërfaqja mes fugave mos ti kaloje 14 m².

10.3.2.4 Trajtimi

10.3.2.4.1 Stukimi

Para stukimit, te sigurohet kontrolli i sipërfaqes per te parandaluar tharjen e shpejte. Pas vendosjes se suvase, te sigurohet tharje e shpejte e saj për te rritur fuqine.

10.3.2.4.2 Suva çimentoje dhe stukim

Te mundësohet trajtimi me lagie (spërkatja e shtreses baze) para vendosjes se finos. Te laget shtresa baze menjhere para aplikimit te finos. Ne kushte nxehtesie, thatesire apo ere, sipërfaqet e lagura te mbulohen me polietilen per te shmangur avullimin e ujit.

10.3.3 PUNIME SUVATIMI DHE STUKIMI

Ky sistem kerkon nje dore shtrese suva te ashper, pjesërisht të thate dhe një shtresë suvatim ngjyrë kafe.

10.3.3.1 Kriteret e trashesise te suvatimit dhe stukimit

Sipërfaqja vertikale;
Trashësia totale e suvatimit të jete nga 13 mm deri në 15 mm;
Sipërfaqja horizontale;
Trashësia totale e suvatimit të jetë 7 deri në 10 mm.

10.3.3.2 Punimet e shtresës bazë suva dhe stuko

Te vendoset shtresa e ashpër 5 deri në 6 mm për të mbuluar bazën me material të mjaftueshëm dhe për të krijuar presion dhe një lidhje të mirë mbi sipërfaqen e murit apo tavanit. Te ferkohet sipërfaqja ne menyre qe te perftohet sa me e forte dhe kompakte. Te aplikohet nje dore suva me shtrese kafe për të treguar shtresen e llacit, te ngjeshet dhe te peforcohet sipërfaqja pa aplikimin e ujit dhe te fërkohet ose kruhet për të perftuar shtresen finale.

10.3.3.3 Shtresa përfundimtare me fino

Te sperkatet dhe laget në mënyrë të moderuar shtresa bazë e cila është tharë para se të vendoset fino. Te përshpejtohet fino nëse është e nevojshme për të mundësuar kohën e qëndrimit të finos jo me tepër se katër orë nga koha e përzierjes së saj.

Te vendoset stuko ose perberes te bardhe mbi shtresën bazë, te fërkohet në mënyrë të njetrajtshme, te mbush boshllëqet dhe te ngjeshet mirë mbi sipërfaqe.

Te lihet te thahet për disa minuta dhe pastaj te spërkatjet me ujë. Te ushtrohet fuqi maksimale me qëllim të ngjeshjes së shtresës përfundimtare dhe duke mundësuar sipërfaqe te paster e te rregullt. Te aplikohet me mistri fino mbi shtresën bazë, sa më imët të jetë e mundur, 2-3 mm, vecanerisht aty ku jane krijuar krijuar plasaritje apo njolla.

10.3.4 PUNIME SUVATIMI ME BAZE ÇIMENTOJE

Te aplikohet suva me baze çimento ne sipërfaqet e brendshme dhe te jashtme te cilat mund të jene te ndjeshme ndaj gërryerjeve, lagështisë.

10.3.4.1 Kriteret e trashësisë se suvatimit me baze çimentoje

Sipërfaqja vertikale;
Trashësia totale nga 13mm deri në 15mm.

10.3.4.2 Punimet e suvatimit me baze cimentoje

Te vendoset shtresa e ashpër për të mbuluar bazën me material të mjaftueshëm dhe për të krijuar presion dhe një lidhje të mirë mbi sipërfaqen e murit apo tavanit.

Te fërkohet sipërfaqja horizontale. Te vendoset shtresa kafe pasi ka kaluar periudhën e nevojshme prej 24 orësh të spërkatjes dhe lagështisë. Te aplikohet me mistri fino mbi shtresën bazë, sa më imët të jetë e mundur, për te përfutur nje sipërfaqe te drejte dhe te paster

10.3.4.3 Punimet e shtreses fino

Pasi shtresa kafe te jete lagur për jo më pak se 24 orë dhe ka të paktën 5 ditë, te aplikohet shtresa përfundimtare me një trashësi jo më të madhe se 3 mm. Pasi te thahet shtresa e vendosur, te sperkatet me uje para aplikimit te shtreses finale.

10.3.5 KRITERE TE PËRGJITHSME TE SUVATIMIT TE BRENDSDHEM

10.3.5.1 Mbulimi i elementeve metalike (ne fasade)

Davancialet e dritareve, tubat dhe te gjitha paisjeve te varura ne mure duhet të mbulohen me suva me rrjete teli në mënyrë që të parandalohet zgjerimi i mundshëm i dëmtimit të shtresës të suvase.

10.3.5.2 Nivelimi i suvase se brendshme

Nivelimi i suvase te muret duhet të vazhdojë dhe të pastrohet deri në kufinjte e tavanit. Çdo mbetje suvaje që mund të prek tavanin duhet te eleminohet. E njëjta gjë duhet bërë me dysheme, perjashtohen rastet kur aplikohen sisteme te vecanta dyshemeje.

10.3.5.3 Suvatimi ne tavanet e parapergatitur

Minimumi i suvatimit 5mm, te gjitha fugat te lidhen me fashature. Suva me trashësi më pak se 3 mm nuk duhet të aplikohet në tavan.

10.3.5.4 Pastrimi dhe dorëzimi

Dhomat duhet të jenë të fshira dhe pastruara mirë para se te dorëzohen nga punimet e suvatimit.

10.3.5.5 Tharja e përsheptuar

Nëse programi i punës së kontraktorit kërkon që te aplikohen njësi dhe pajisje mekanike për nje tharje të përsheptuar te suvase, atëherë duhet të bihet dakord me Mbikëqyrësin e punimeve dhe me përdorimin e matësit të lagështisë.

10.3.5.6 Suvatimit në dhoma me lagështi

Në dhoma me lagështi nuk duhet te perdoret allci si material lidhes .

10.3.6 KRITERE TË PËRGJITHSHME TË SUVATIMIT TË JASHTËM TË (GODINAVE)

10.3.6.1 Përgatitja dhe pastrimi i fasadave

Duhet të kushtohet kujdes gjatë pastrimit të fasadave me ujë me presion, por ne menyre qe uji mos të depërtojë midis tullave nëpërmjet plasaritjeve apo fugave të plastikës. Nëse uji përdoret në mënyrë agresive, aty ku ka dhe agjente apo materiale shtesë reagues ndaj presionit dhe që mund të rrezohen, atëherë uji nuk duhet të derdhet në toke por të grumbullohet në konteniere të përshtatshme.

10.3.6.2 Ruajtja e fortesise

Fortesia e suvase nuk duhet të jetë më e vogël se fortesia e nëntokës. Kur është ekspozuar jashtë çdo shtresë suvaje do të pesoje nje dobësim të fortesise.

10.3.6.3 Tharja midis shtresave

Çdo shtresë suvaje duhet lejuar të thahet para se ti mbivendoset shtresa tjetër. Koha normale e tharjes është 1 ditë për çdo cm trashësi të shtresës.

10.3.6.4 Materialet e paqëndrueshme të nëntokës

Në situatën kur nëntoka është e përbërë nga materiale të ndryshme atëherë për të krijuar një shtrese homogje, duhet aplikuar nje shtrese e ashper suvaje e cila mund të mpikset për një javë para se të vendoset dora tjetër e suvase. Te aplikohen në qendër ose në 1/3 e sipërfaqes rrjeta përforcuese të cilat jane rezistente .

10.3.6.5 Suvaja mbi kornizime

Kornizimet me materiale druri apo metalike, nuk duhet te lidhen mekanikisht me suvane si dhe te shkeputen prej saj.

10.3.6.6 Suvaja rezerve per riparime.

Të paktën 10 kg llaç duhet të mbahet rezervë për të riparuar fasadën ose krisjet në të.

10.3.6.7 Qëndrueshmëria e ngjyrës dhe e tekstures.

Kujdes duhet treguar për të pasur qëndrueshmëri të ngjyrave trashësisë dhe përmbajtjes se suvase së jashtme. Paregullsite duhen të klasifikohen si defekte madhore. Nëse duhet përdorur suva duhet të sigurohemi që ajo është e një dore.

10.3.6.8 Plintusat mbrojtëse

Plintusat në pjesën fundore të seksionit të fasadave duhet të jene izoluese.

10.3.6.9 Rrjetat përforcuese

Rrjetet përforcuese duhet të fiksohen rrafsh me sipërfaqen (pa rrudhosur). Gjate hapjes së rrjetës ajo duhet të hapet në mënyrë diagonale nga këndet e shpalosjes. Mbivendosjet duhet të jenë minimalisht 100 mm. Mbivendosja në nyje lidhëse ose elementët e tjerë të godinës duhet të jenë 300 mm. Rrjetat duhet të instalohen në fugat midis dy materialeve nën tokë dhe kur fillon suvatimi.

10.3.6.10 Plasaritjet

Plasaritjet në suvatim, me të gjera se 0.2 mm duhet të konsiderohen defekte.

10.3.6.11 Perpuethshmeria e Suvatimit me nëntokën

Kur përzgjidhet vendosja e suvse, duhet marre në konsideratë dhe tipi i nëntokës. Me punimet e reja të tullës Moduli i Elasticitetit nuk duhet të tejkalojë 2500 N/mm².

10.3.6.12 Paisje kundra ndryshkut

Te perdoren paisje kundra ndryshkut kur te shtrohen shtresat e suvase.

10.3.6.13 Depozitat e kripës

Depozitimet e kripës duhet të hiqen nga sipërfaqja e nëntokës duke përdorur një furçë të tendosur (jo metalike) pas lenjes së murit për tu tharë.

10.3.7 NJOLLAT DHE SHENJAT

Të prerat ose njollat, plasaritjet, dëmtimet ose ngjitjet difektoze gjate suvatimit, duhet të jenë në përputhje me formën e tekstures finale, si dhe me të njëjtën ngjyrë me pastrimin përfundimtar që është vendosur në sipërfaqe suvatimit. Fillea e punës përmbledhëse ose e punës së përfunduar duhet kryer në mënyrë të pastër. Te hiqen derdhjet e pikave ose plasaritjet nga sipërfaqja. Te lihet e paster për lyerje ose fino.

10.3.8 PUNIME ME BOJËRA VINILI DHE SINTETIKE

Parametrat e materialit

Bojërat me bazë uji dhe vaji duhet të jenë prodhime të fundit, të mos kenë copëzime, mpiksje, qime ose xhelatinizim. Ato do të ofrohen në vendin e punës të vulosura, në enët përkatëse me udhëzimet e prodhuesit, si: lloji i cilësisë që duhet përdorur, mënyra e ruajtjes dhe konservimit të produktit, datën e skadencës etj. Ena do të hapet vetëm në momentin e përdorimit dhe në prezencë të Mbikëqyrësit të punimeve. Produktet duhet të jenë gati për përdorim, pas hollimit sipas udhëzimeve të dhëna nga prodhuesi. Ato duhet të kontribuojnë në sipërfaqet ku pritet dhe të japin efekt brenda kohës.

Produktet për muraturat duhet të jenë të llojit jo cipe formuese. Testime që kanë lidhje me karakteristikën e materialit, do të zhvillohen para dhe pas vendosjes: shembujt, pigmentin bazë, hollësinë e grimcave të finos, konsumin e energjisë, shpejtësinë e tharjes, trashësinë rezistencën ndaj agjenteve atmosfere, agjentet kimik, deri tek ciklet termale, rrezet ultra vjollcë, lagështia. Në çdo rast produkti duhet të ketë aftësi të mira penetrimi dhe përputhshmëri me sipërfaqen ku do të vendoset duke garantuar ajrosje të mirë. Këto tipare do të mbizotërojnë në kohëzgjatjen e ngjyrave.

10.3.8.1 Përgatitja e sipërfaqes

Betoni – për trajtimin e mureve prej betoni dhe mureve prej betoni të përforcuar referojuni kapitujve perkates.

Hekuri dhe çeliku - për trajtimin e sipërfaqeve metalike referojuni kapitujve përkatës.

Suvatimit dhe pllakave te gipsit- te pastrohet sipërfaqja qe do të lyhet, nivelimi i parregullsive me ane të stukimitme, stukos dhe rëres përkatëse. Çdo njollë vaji apo graso duhet të hiqet me anë të përdorimit të solucioneve.

Trajtimi paraprak do të jetë me konsolidimin e shtresës, 0.2 l / m me bazë rrëshire të veçantë dhe vajrash tretës alifatike jo më pak se 0.85 Kg / m² peshë specifike.

10.3.8.2 Aplikimi i cikleve dhe materialeve

Metoda duhet të çojë në aplikimin uniform të bojës, teknikisht të kënaqshëm. Para se të fillojë lysterja duhet njoftuar dhe rënë dakord me Mbikëqyrësin e punimeve për datat e inspektimit. Lysterja që tregon mpiksje ose shenja përkeqësimi kur hapet duhet të hidhet. Nëse ajo ka krijuar një cipë të hollë mbi sipërfaqen e bojës atëherë te hiqet cipa para përdorimit. Përzierja e komponentëve të ndryshëm me hollues dhe ose me forcues duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet dhe raportin e të dhënave nga furnizuesi. Dy komponente lysterje duhet të përdoren në kohën e specifikuar nga prodhuesi. Lysterja mund të kryhet me furçë, spraj, me ose pa ajër, ose me një kombinim të këtyre metodave sipas udhëzimeve të prodhuesit. Aplikimi duhet të kryhet nga një bojaxhi me përvojë, trashësia e shtresave të ndryshme të bojës duhet të jetë uniforme dhe sipërfaqja e lyster duhet të jetë e pastër pa lënë shenjat e furçës, fryrje, plasaritje dhe defekteve të tjera. Kujdes i veçantë duhet treguar që rastësisht gjatë punës të mos bie boje mbi: dyer, tavane, dysheme, bimësi, etj. Përfundimisht e gjithë boja që mund t'ëketë rënë në to duhet të hiqet menjëherë. Vëmendje e veçantë gjatë lysterjes duhet t'i kushtohet qosheve, kapakëve dhe zonave të vështira për tu arritur. Shtresa e parë duhet të vendoset brenda 24 orëve pas përgatitjes së sipërfaqes. Nëse sipërfaqja është me bazë rëre, atëherë preferohet që boja të vendoset brenda 6 orëve dhe për çdo rast tjetër, nëse ndryshojnë standardet e pastërtisë së sipërfaqes.

10.3.8.3 Kushtet klimaterike

Lysterja nuk duhet kryer në rast se bie shi, borë, mjegull, stuhi rëre ose në asnjë lloje kushti atmosferik që mund të shkaktojë kondensim dhe avullim të sipërfaqes që do të lyhet. Shenjat e lagështisë duhet të largohen nga sipërfaqja brenda 5 minutash. Lysterja nuk duhet kryer nëse ndryshueshmëria e lagështisë në ajër është me e madhe se 85%, kur temperaturat janë nën 5 grade celsius dhe mbi 45 gradë celsius, lysterja duhet të aprovohet vetëm nga prodhuesi.

10.3.8.4 Lysterja e nënshtresave deri te finalja.

Para se të vendosni çdo nënshtresë fillimisht ato duhet të jenë të thata plotësisht ose e mpiksuar mjaftueshëm. Para se të vendosen shtresat e tjera çdo dëmtim i mundshëm në shtresën ekzistuese duhet të riparohet duke përdorur të njëjtën lloje boje. Çdo shtresë e re boje duhet të jetë me ngjyrë të ndryshme nga ato të mëparshmet, për të shmangur zona të humbura dhe për të lehtësuar inspektimin.

10.3.8.5 Trashësia e lysterjes

Matjet shërbejnë për të kontrolluar trashësinë e shtresës mbrojtëse si dhe uniformitetin e vendosjes së bojës në të gjithë gjerësinë e saj. Verifikimi duhet bërë në shtresën e bojës së njomë dhe në shtresën

e thatë. Raporti i trashësisë të bojës së njomë dhe të thatë do të tregohet nga personi përgjegjës për marrjen e mostrave. Në asnjë zonë trashësia nuk duhet të jetë më pak se sa nevojitet.

Në rast se trashësia minimale e përshkruar nuk është arritur, në zona të caktuara duhet vendosur dhe një shtrese tjetër boje. Trashësia e lyerjes nuk duhet të jetë më e lartë se minimumi i përcaktuar në mënyrë që të mos ndikojë në pamjen apo performancën e lyerjes.

10.3.8.6 Mbrojtja dhe pastrimi

Pas çdo dorë lyerje duhet te aplikohet një pastrim tërthor i ambientit

Punimet duhet të mbrohen nga goditjet aksidentale dhe sulmet e mundshme fizike apo kimike.

10.3.8.7 Kontrolllet dhe sistemet e kontrollit

Para lyerjes, te kontrollohet që përgatitjet për lyerje janë bërë në përputhje me standardet. Sipërfaqet e lyera do t'i nënshtrohen ekzaminimit vizual për të kontrolluar pamjen dhe vazhdimësinë e lyerjes. Zonat ku dyshohet se mund të ketë porozitetin ose ndërprerje të bojës do të kontrollohen me instrumenta të përshtatshme. Trashësia e bojës së njomë mund të kontrollohet me instrumentet e duhura. Trashësia e shtresës së thatë të lyerjes do të kontrollohet me instrumenta të përshtatshme. 5 matje dhe testime duhen kryer (rezultati i përgjithshëm i matjeve duhet të japë rezultatin në leximin e trete) çdo pesë pikë për çdo 10 m² ose më pak. Mesatarja e 5 matje/testime nuk duhet të bjerë nën trashësinë e kërkuar.

11. VESHJET E DYSHEMEVE DHE MUREVE (PUNIME SHITESA)

11.1 PJESA 1- TË PERGJITHSHME

11.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara me poshtë formojnë një pjese të specifikimeve dhe referencave shtese. Publikimet që referohen në këtë tekst janë vetëm ato themelore.

11.1.1.1 Zbatimi sipas ligjeve dhe normave Shqiptare

11.1.1.2 Normat dhe standardet Evropiane

DIN 18195	Hidroizolim i ndërtesave dhe strukturave; hidroizolim i shtresave që i nënshtrohen presionit hidrostatik nga brenda; projektimi dhe mjeshtëria profesionale
DIN EN 87	Dysheme dhe mure me pllaka qeramike -Përkufizimi, klasifikimi, karakteristikat dhe marka.
DIN EN 186-1	Pllaka qeramike -pllaka qeramike kundra ujit që ta kenë përthithjen e ujit në mes të 3% dhe 6% sipas (Grupit A IIa)
DIN EN 176	Pllaka qeramike prej pluhuri të presuar që e kanë përthithjen e ujit të ulët (E deri në 3%) – Grupi BI
DIN EN 177	Pllaka qeramike prej pluhuritë presuar me përthithjen e ujit të klasit E nga 3% deri në 6% (Grupi B IIa)
DIN EN 1347	Kollë për vendosje pllakash – përcaktimi i kapacitetit të lagështisë
DIN EN 12808	Kollë dhe llaç për pllakat -Pjesa 1 përcaktimi rezistencës të agjentëve kimik Reagimi ndaj rrëshirës Kolle dhe llaç për pllakat - Pjesa 2: Përcaktimi dhe rezistenca ndaj gërryerjes/abrazionit

Kolle dhe llaç për pllakat – Pjesa 3: Përcaktimi i fleksibilitetit dhe fuqisë ngjeshëse.
Kolle dhe llaç për pllakat – Pjesa 4: Përcaktimi i tkurrjes
Kolle dhe llaç për pllakat – Pjesa 5: Përcaktimi i përthithjes së ujit
DIN EN 13888 Kolla dhe llaçi për pllaka – Përkufizime dhe specifikime

11.1.2 PARAQITJET

Publikimet e Listuara me poshtë formojnë një pjesë të specifikimeve dhe referencave shtesë Publikimet që referohen në këtë tekst janë vetëm ato themelore.

Te paraqiten mostrat e mëposhtme për miratim:

Pllaka qeramike për shtrim dyshemeje -100m katror shtrim duhet te tregojë: ngjyren, shtresen, motivin, formen, tipin, fugat mes pllakave për vendosjen e bojakut.

Pllaka qeramike për mure - set me 4 pllaka, duhet te tregojë: permasat, formen, shtresen, tipin dhe motivin, fugat mes pllakave për vendosjen e bojakut.

Aksessore për pllaka qeramike- copëza për çdo lloj që të tregojnë ngjyrën, shtresen, llojin dhe modelit, Në përgjithësi produktet që vijnë nga një fabrikues tjetër nuk duhet të aplikohen në të njëjtën sipërfaqe.

Të gjitha dyshemetë do të bëhen me metodat dhe materialet e ndërtimit që janë në përputhje me legjislacionin aktual për llojet e pershtatshme të dyshemeve. Të gjithë mostrat e materialeve duhet të nënshtrohen për aprovim, në lidhje me ngjyren e perhershme. Materialet me përbërje dhe prodhues të njëjtë ku origjina dhe cilësia është provuar duhet të përdoren në të gjithë sipërfaqen e dyshemesë.

Gjatë shtrimit të dyshemesë muret dhe të gjithë orenditë e tjera duhet të mbulohen dhe mbrohen që të mos dëmtohem gjatë procesit të punës. Për të pasur kohën e duhur të tharjes së dyshemesë dhe në çdo rast tjetër deri në 10 ditë pas mbylljes së punës. Të vendosen barrierat paralajmëruese që të mos lejojnë shkeljen e dyshemesë, që do të thone të sapo vendosura dhe te pakalueshme për momentin.

Dyshemetë PVC, sipërfaqet dhe/ose te forta, të mbuluara me rere dhe te pastruara, do të mbrohen deri në mbërritjen e klientit së bashku me materialet si (pllaka, takot e drurit, tallashi etj.) të cilat janë vendosur për të shmangur dëmtimin e sipërfaqes së dyshemesë së shtruar.

Para dorëzimit, dyshemetë duhet të lahen pastrohen dhe thahen me produkte të veçanta në përputhje me udhëzimet që ka dhënë fabrika për larjen dhe pastrimin e produktit. Detergjente me përqendrim të lartë ose hollues që nuk janë aprovuar nga fabrika ose Mbikëqyrësi, nuk duhet të përdoren mbi dysheme.

Dyshemetë të cilat mund të jenë të ekspozuara ndaj shiut ngricës ose nxehtësisë nga rrezatimi diellor do të mbrohen në mënyrë të përshtatshme. Çdo lloj shtrimi kërkon kohë të mjaftueshme për tu bërë gati të shkelet vendosja/shtrimi i sipërfaqes së tij duhet të marrë kohën e duhur dhe jo të përshpejtohet por brenda limiteve kohore të përcaktuara që mos të ketë ndikim në fortësinë dhe cilësinë e përgjithshme të shtrimit. Në rastet që përshkruhet në projekt ose në përputhje me pragun, zona të ndryshueshme në lartësi të dyshemesë etj, kulmet dhe cepat e dyshemesë dhe/ose shkarkimet, duhen mbrojtur nga rreziqet e dëmtimit të instalimeve, ngjitjeve të përshtatshme të PVC- së, të gomës, çelikut normal apo atij special, bronzit dhe gurit që të kenë karakteristikat e përshtatshme për të rezistuar nga trafiku i pritur.

Shtrimi me materiale dhe veglat e tjera për inertet dhe materialin lidhës duhet të bëhet për të përfituar kohën dhe cilësinë e kërkuar. Mallrat dhe veglat e tjera duhet të kenë një sipërfaqetë thatë, dhe fortësinë dhe nivelimin e duhur (sipas sipërfaqes që duhet të punojnë), të jenë kompakte pa plasaritje në sipërfaqe dhe të jenë të qëndrueshme në të gjithë sipërfaqen e tyre. Dyshemeja duhet të ketë ngjyrë uniforme në varësi të ngjyrës së kërkuar, si dhe me kualitetin e kërkuar, pa defekte dhe ciflosje për gjatë gjithë shtrirjes së saj. Sipërfaqja përfundimtare duhet të jetë e rrafshët në mënyrë perfekte.

Mbulimi i murit dhe çdo mbrojtje tjetër duhet bërë me materiale rastësore ose në përputhje me ato që ka thënë Mbikëqyrësi i punimeve. Vëmendje e veçantë ti kushtohet vendosjes së elementëve mbështetës

/binarëve që janë pas strukturës që të puthiten fiks me njëri tjetrin, linjat e bashkimeve/vidhosjeve duhen puthiten drejtë. Shtresa përfundimtare duhet të bëhet me elementë special si plinte, shirita dhe korniza. Pas përfundimit të punës mbulesat e murit duhet të pastrohen dhe lahen.

11.1.3 KUSHTET MJEDISORE

Te mos aplikohet shtrimi i pllakave në një ambient apo zonë me temperaturë minimale nga 10 gradë celsius e sipër. Te mbahet temperatura e ambientit mbi 10° C ndërkohë që punohet dhe për të paktën 3 ditë pasi të jete përfunduar shtrimi. Te mos përdoret kollë ose ngjitës në zona jo të mbuluara.

Nëse kushtet e motit janë veçanërisht të vështira, ose kur konsiderohen si të papërshtatshme për punë, kontraktori duhet të vazhdojë shtrimin dhe duke mbrojtur dyshtemenë me litarë, peceta, mushama etj. dhe nëse ato nuk janë të mjaftueshme, pezullimi i punës duhet të bëhet me aprovim të mbikëqyrësit.

Në kushtet e klimës së nxehtë shtrimi duhet të mbahet i njomë/ lagësht për të shmangur tharjen e përshpejtuar të shtresës nën pllaka/ llaçit dhe kollës. Procedurat dhe metodologjia e punës duhet të koordinohet dhe aprovohet nga mbikëqyrësi (inxhinieri zbatues), teprica e sasisë të ujit mund të shkaktojë shpërbërjen e llaçit/ kollës dhe për pasojë rezistencës e shtresës, me një kohë të përcaktuar të shkëputjes së pllakave. Gjatë shtrimit të dyshtemesë , shtresa e llaçit nuk lejohet të rrise përqindjen e ujit dhe llaçit për të shmangur fenomenin e tharjes së përshpejtuar.

11.1.4 MATERIAL SHTESE

Te furnizohet me një shtesë prej 2% të çdo tipi pllake të përdorur .

11.2 PJESA 2 – PRODUKTET DHE MATERIALET

11.2.1 BETON I LEHTESUAR

Nënshtresat e dyshtemesë duhet të furnizohen dhe instalohen në përputhje me praktikat më të mira dhe të shoqëruara nga të dhënat përkatëse që certifikojnë të dhënat teknike dhe karakteristikën e performancës. Shtrimi i llaçit do të realizohet në dy shtresa. E para do të jete beton i lehtësuar i tipit CT-C20-F4, në varësi të trashësisë që do të vendoset mes soletes, shtresës finale të llaçit të përbërë nga një produkt dy komponent që ka lidhës çimentoje dhe hollues. Përzierja duhet bërë me makinerinë e duhur. Dozat duhet të jetë 300 kg/m³ lidhës çimentoje dhe 2 l/m kolle duke mundësuar një llaç me një forcë ngjeshëse për 28 ditëtë 1 N/mm².

11.2.2 LLAÇ Ç IMENTO DHE LLAÇ Ç IMENTO ME RERE

Shtresa e dytë do të jetë: shtrese llaçi nivelues e llojit çimento dhe rërë, trashësia variabel. Llaçi do të copëzohet gjatë hapjeve në mure ose çfarë do lloj platforme, duke futur një pllakëz ndarëse në llaç, gjatë shtrimit ose pas forcimit /mpiksjes. Pas mpiksjes, llaçi i duhet të ketë një forcë ngjeshje dhe përkuljeje pas 28 ditëve prej 20 dhe 45 N /mm².

11.2.3 BARRIERAT AVULLIZOLUESE

Barrierat e avullit duhet të jenë fletë polietileni, të trasha 0.50 mm, përshkueshmëria ndaj avujve "s" më e madhe se 2-100m, mos suksesi në thithje 450%. Fletët do të pozicionohen ndërmjet shtresës së parë dhe të dytë të betonit të lehtësuar. Shtresat përftohesh nga grimcat e virgjëra, me ngjyrë neutrale ose të bardhë, me densitet Kg/dm³ 0.95, tharja e shtresës sipas procedurave të mëposhtme:

- Me 20 cm mbivendosje dhe 10 cm e mbledhur lart në pjesët vertikale,

- Me 5 cm mbivendosje, e mbyllur me shirit ngjitës fugash 8 cm të gjerë, 10 cm e mbledhur në pjesët vertikale.
Lidhjet me të gjitha pjeset e përfshira të bashkuara përmjet shiritit të fugave të perdoren edhe në muret vertikale.

11.2.3.1 Trashësia e izolimit

Duhet të ofrohet për të mundësuar rezistencën termale. Trashësia duhet të bazohet sipas faktorit "R" për izolim për një kohë të gjatë. Izolimi i platformave të hekurit duhet të jete i kenaqshëm si faktor i specifikuar R por edhe trashësinë minimale për shtrimi të publikuar në literaturën e fabrikës. Trashësia duhet të jetë jo më pak se 30 mm.

11.2.4 PLLAKAT

11.2.4.1 Ngjyrat dhe modelet

Ngjyra e pllakave dhe modelet duhet të zgjidhen nga kampionet e ngjyrave standarde të fabrikës. Ngjyrat dhe modelet e treguara si reference të emrit të fabrikës dhe emëruesit shërbejnë si identifikim ngjyrash për atë fabrikë por nuk kufizojnë produkte të ngjashme dhe ngjyrat e modelet të një fabrike tjetër.

11.2.4.2 Dyshemetë prej qeramike – pllakat Gres

Të gjitha pllakat e përdorura duhet të jenë ato të cilat janë miratuar gjatë vështrimit të mostrave /modeleve. Përzierja e pllakave në mure apo dysheme të blera nga një fabrikë tjetër nuk lejohet. Të gjitha pllakat e dyshemesë duhet të jenë kundra rrëshqitjes. Pllakat s' duhet të kenë përmbajtje plumbi, siç klasifikohet në grupin B1 në përputhje me UNI EN 87 dhe që përmbushin parametrat e standardeve të UNI EN 176, të cilat konsistojnë në një masë të vetme qoftë edhe kompakte (e ngjeshur) e parreshkitshme ose e trajtuar në sipërfaqe, e nxjerrë nga presimi i ftohtë ose i ngrohtë automatik i pastës që del nga mpiksi i kaolinitës. Materialet inerte ose me përbërës çeliku duhet të jenë shumë të vogla në përmbajtje.

Temperatura e pjekjes 1200°C

Përthithja e H₂O 0,05% UNI EN 99

Fuqia e perkuljes 45-55 N/mm² UNI EN 100

Fortësia e sipërfaqes 7/8 Mohs UNI EN 101

Rezistenca ndaj sulmeve kimike në përputhje me UNI EN 106

Rezistenca ndaj ngricave në përputhje me UNI EN 202

Rezistence termale dhe ndaj tronditjes në përputhje me UNI EN 104

Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj rrezeve UV në përputhje me DIN 51094

Rezistence ndaj gërryerjes së thellë 125-140 mm³ UNI EN 100

Kundra zjarrit

Të dhënat teknike

KLASIFIKIMI SIPAS RREGULLORES CEN GRUPI B1 EN 176				
Paraqitja	Rregullat/mën yra e matjes	Masa e matje	UNI EN 176	Vlerat minimale
Përthithja e ujit%	UNIEN 99	%	<input type="checkbox"/> 0,5	<input type="checkbox"/> 0,05

Dimensio net(A)	Gjatësi dhe gjerësi (B)	UN I 98	EN	%	<input type="checkbox"/> 0,6	<input type="checkbox"/> 0,3
	Trashësia	UNI 98	EN	%	<input type="checkbox"/> 0,5	<input type="checkbox"/> 3,0
	Fuqia e kulmeve	UNI 98	EN	%	<input type="checkbox"/> 0,5	<input type="checkbox"/> 0,3
	kuadratimi	UNI 98	EN	%	<input type="checkbox"/> 0,6	<input type="checkbox"/> 0,3
	rrafshësia (C)	UN I 98	EN	%	<input type="checkbox"/> 0,5	<input type="checkbox"/> 0,2
Fuqia e lakimit		UN I 100	EN	N/mm ²	<input type="checkbox"/> 27	45-55
Ngarkesa e thyerjes	cm 20x20 trashësim 8,5	UN I 100	EN	Kg	Nuk nevojitet	200-220
	cm 20x20 trashësim	UNI	EN	Kg	Nuk nevojitet	420-460
	cm 20x20 trashësim 15	UN I 100	EN	Kg	Nuk nevojitet	680-720
Rezistenca ndaj gërryerjes në thellësi		UNI 102	EN	mm ³	<input type="checkbox"/> 205	125-140 mm
Fuqia e sipërfaqes		UNI 101	EN	MOHS shkalla	<input type="checkbox"/> 6	7/8
Koeficienti i përçimit termal të njëtrajtshëm		UNI 103	EN	Mk ⁻¹	<input type="checkbox"/> 9	6,5
Rezistencë ndaj tronditjeve termale		UN I 103	EN		Asnjë moster s duhet te kete alternative tjeter	Përmbush
Rezistencë ndaj sulmeve kimike	Përdorimi shtëpiak i produkteve kimike	UN I 106	EN		Asnjë moster s duhet te kete alternative tjeter	Përmbush
	Bojak të pishinës	UN I 106	EN		Asnjë moster s duhet te kete alternative tjeter	Përmbush

	Rezistencë ndaj acideve dhe bazikëve.	UN EN I 106	Asnjë moster s duhet te kete alternative tjeter	Përmbush
	Rezistencë ndaj ngricave	EN 202	Asnjë moster s duhet te kete alternative tjeter	Përmbush
	Qëndrueshmëria e ngjyrës përkundrejt dritës	DIN 51094	Asnjë moster s duhet te kete alternative tjeter	Përmbush

- (A) Format referues cm 30x30
(B) Pranueshmëria në % format e devijuara sipas atyre që prodhon fabrika
(C) Qendra e harkimit, ka lidhje me përllogaritjen diagonale te përmasave të fabrikës

Shtrimi

Shtrimi i pllakave duhet të jetë i tillë që të ruaj dhe vetë karakteristikat që potencialisht mund të japi vet produkti i shtrimit. Te pastrohen gjithë njollat ose mbeturinat, pluhurat që mund të ketë sipërfaqja gjithashtu te laget me pas. Kujdes duhet treguar gjatë përgatitjes së llaçit që do të shtrohet (të mos kalojë trashësinë maksimale nga 3-5 cm).

Ndërsa ajo minimale si në vazhdim:

Rërë e larë (□ maks3 mm) - 1 mc,

Çimento- 325 200 Kg,

Ujë- 80□100 lt.

Përmbajtja e ujit e cila ka të bëjë me minimalen por mund të ndryshojë në varësi të temperaturës, lagështisë së rërës, sasia e holluesve kimik që i janë shtuar llaçit. Te perzihet perberja në një pajisje tjetër mekanike(betoniere) për të arritur përzierjen perfekte dhe te perdoret në një kohë shumë të shkurtër që të perftohet kapaciteti lidhës i tij. Është e udhës të kufizohet hapja e tepërt e kollës në mënyrë që pllaka e porcelanit apo gurit të ngjisin në kollë të njomë.

Te përdoren pajisje vibruese në mënyrë që kolla të bëhet më kompakte dhe të nxjerrë jashtë sasinë e tepërt të ajrit. Te spërkatet me çimento 325 në sasinë e 5-7 kg për m²dhe te laget para se të vendosen pllakat,në mënyrë për të rritur ngjitjen midis pllakës dhe llaçit. Nuk është e nevojshme të lagësh pllakën e porcelanit sepse nuk është se ka aq shumë porozitet, por një zhytje e shpejtë e pllakës mund të bëj punë dhe largon pluhurin prej saj.

Te shtrohen pllakat ngjitur cep me cep, nëse shtrohet një ambjent i ngushtë ose te përdoren kryqë ndarës per bojakun ne sipërfaqe me të gjëra; metoda e dytë është më e preferueshme në rast riparimi të strukturës dhe lejon një tolerancë të lehtë midis pllakave gjithashtu mundëson vendosjen në linjë të pllakave me anë të distancuesve në formë kryqi.

Te shtypi pllakat me një çekiç ose vibrator të veçantë prej gome, qëllimi është ngjeshja e llaçit/kollës për të rritur kontaktin midis llaçit dhe pllakës dhe që të lejojë daljen e tepicës së ujit apo llaçit/kollës. Ky proces vlen në rast se e ngremë pllakën dhe 80 deri 90 % e sasisë të llaçit/kollës ngelet në pllakë. Te sigurohet që çekiçi i gomës të jetë gjithmonë i pastër për të mos lënë shenja apo dëmtime atje ku ka prekur sipërfaqen e pllakës.

Te përgatitet bojaku me materiale organike me bazë çimentoje, për shembull: përzierje të rrëshirës dhe holluesve të tjerë si dhe solucione ngjitesë. Bojaku duhet të pastrohet më së miri midis zgavrave të pllakave pas 3-4 orësh.

Pastrimi i veshjes ne pllaka, nga bojaku dhe kolla duhet të bëhet në përputhje me kërkesat që parashtron prodhuesi i pllakave para se ai të ngurtësohet përgjithmonë, një ndërhyrje e vonuar për pastrimin e bojakut mund të kërkojë përdorimin e solucioneve dhe acideve duke krijuar efektet e tyre të avujve të cilat mund të dëmtojnë bojakun ose çdo objekt metalik të kromuar që ndodhet aty afër. Sipërfaqet eferveshente për tu tharë nga uji ose nga mbetjet aksidentale të njollave të llaçit mund të hiqen pasi fenomeni të ketë përfunduar, përdor me kujdes acide organike me përqendrim të ulët dhe pasi të jetë lagur fillimisht me ujë të pastër me ane të një sfungjeri. Fugat e ekspansionit duhet të përfshihet, shtrihen pjesërisht në nënshtresa, për sipërfaqe që nuk i kalojnë 30 metra² si dhe përveç njejeve të tjera strukturore. Lëvizjet e vogla që kanë lidhjet me nyjet mbështetëse ekzistuese të mund të bëhen me anë të ndërthurjes së materialit elastik që lejon ndryshime pa krijuar rrezikun e thyerjeve me apo pa të çara, kusht që lëvizjet mos të tejkalojnë një të pestën e pllakave. Valëzime si për 2 mm për metër linear në gjatësi nuk do të lejohen. Me përdorimin e ngjitesëve të përshtatshëm

pllaka mund të vendoset në sipërfaqe të veçanta të tilla si suva, plastike, metalike, druri, panele fibre, mbi pllakat ekzistuese ose në të gjitha rastet në të cilat sipërfaqja e strukturës është paksa poroze dhe ku nuk na siguron pikat tradicionale të ngjitjes/saldimit. Sasia e mjaftueshme e kollës/stukos do jetë në varësi të llojit të nënshtrësës, llojit të kornizës dhe që mund të kërkojë 2,5-4 kg/m² për veshje muri dhe 4-5 kg /m² për dysheme; një konsum i tillë është shumë më i ulët se një veshje tradicionale e cila merr rreth 25-40 kg/ llaç /kollë. Vlerësimi i gjendjes së nën dyshemesë e cila duhet të jetë krejtësisht e sheshtë pa pluhur duke vlerësuar këndet e mureve, shkallën e teksturës së tyre.

Te parandalohet përdorimi i solucioneve /stukos për nivelim si për mure dhe për dysheme në rast se sipërfaqja shtrimit nuk është mjaftueshëm në vendosje të rrafshët. Shtrimi duhet të bëhet në strukturat të paktën dy muaj para dorëzimit duke llogaritur tkurrjen e betonit 300-500 mikronë/metër. Te hiqen dhe pastrohen të gjitha gjurmët e mbeturinave dhe pluhurit nga sipërfaqja me anë të një furçe të bollshme/ fuqishme dhe me anë të lagies në mënyrë të njëtrajtshme me ujë dhe te lihet të thahet me anë të mjeteve përthithëse të ujit ose me anë të tharëseve nëpërmjet nxehjes së ambientit. Zgjerimi dhe ngurtësimi i njeje bashkuese duhet të realizohet përgjatë gjithë gjatësisë së mureve rrethues dhe strukturave të larta nëpërmjet përdorimit të një materiali të fortë që shtrëngohet me përmasa 0,6-1,2 cm trashësi dhe lartësi të përshtatshme. Gjithashtu tkurrja e bashkueseve duhet të kryhet me qëllim që shtrimi mos të kalojë 16m² secili, në ambiente të jashtme dhe 25m² ambiente të brendshme.

11.2.4.3 Dysheme betoni dhe shtrim me pllaka betoni

Pllaka betoni vete-shtrenguese, me trashësi 50 mm, me sipërfaqe kuarci dhe rezistente për shtrim dyshemesh industriale perbere prej një konglomerat betoni me cilesi të garantuar, klasa e ekspozimit XC1- XC2 dhe rezistence minimale minimum Rck 30, të përforcuar me rrjetë e përbërë nga shufra çeliku me diametër 6 mm dhe FeB44k rrjetë 20x20 cm. Veshja ka një sipërfaqe rezistuese e cila është e përbërë nga agregate minerali të kuarcit të korundumit, lloje të veçanta solucioni, oksiduesish dhe ngjyrueshish të klasifikimit 5 kg/m² (ngjyra sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit).

Gjithashtu kjo dysheme duhet të ofrojë një koeficient fërkimi të caktuar, si dhe duhet të përmbushë standardet e ndërtimit për eliminimin e barrierave arkitekturore në godina, hapësira publike dhe vende shërbimesh komunitare.

Ky proces do të përfshijë pjerresite, të prerjeve të thella dhe fugave të PVC-së të cilat formojnë një 4x4 m element dhe sidoqoftë të mos i tejkalojë 20m², shtrirjen e shiritave izolues të polistirenit prej 10mm, në muret perimetrale me mbrojtjen e nevojshme deri në 1 m lartësi, vendosjen e ulluqeve prej çeliku në përputhje me pragjet, hedhjen e rërës përfundimtare, lyerjen me detergjentet e përshtatshëm, si dhe ndërtimin e sistemit dhe kanalit të kullimit të ujërave .

11.2.4.4 Dysheme Epokside

Me këtë sistem është e mundur të lyhen dysheme, të cilat përftojnë rezistencë të lartë kimike, papërshkueshmëri ndaj vajrave dhe elementëve agresive, rezistencë ndaj lavazheve të vazhdueshme dhe ndaj lëvizjeve të karrocave apo mjeteve të tjera lëvizëse. Dyshemetë epokside kanë pamje të bukur estetike dhe bëhen të parrëshqitshme.

Aplikimi bëhet në dysheme industriale me trafik normal ose të rënduar, si: magazina, ambiente teknike, zona të depozitimit të mallrave, parking dhe garazhe të mbuluara, në zonat e këmbësoreve dhe në zonat me trafike të rënduar të mjeteve lëvizëse, në laboratorë, etj.

Këto dysheme rezistojnë ndaj:

acideve minerale të holluar, si: acid kloridrik, nitrik, fosforik dhe sulfurik,

alkaleve, hidroksidit të natriumit me përqëndrim 50% dhe detergjentëve të përdorur për pastrimin e dysHEMEVE me përqëndrim 20-30% sheqerit, edhe në kontakt të vazhdueshëm vajrave minerale dhe karburanteve Para aplikimit, sipërfaqja duhet të jetë e rrafshuar, e lëmuar dhe e pastruar mirë. Më pas të shtrohet me rul.

11.2.4.5 Veshje e Mureve

- Pllaka majolike të glazuara ose gres qeramike, klasi standard
- Dimensionet nominale pamjes 300 x 150 mm, 13 mm trashësia, asnjë opsion tjetër
- Ofrohet në vende si: WC
- Montimi i pllakave për përdorim në zona me lagështi
- Përfshi gjithë aksesorët specifikë (këndoret, bojaku, distancuesit kryq, etj)

Për sipërfaqe të tilla si stukime, panele gipsi, panele gipsi të parapergatitura, tallash i presuar, çimento, suva, beton i parapërgatitur etj, duhet aplikuar një ngjitës i qëndrueshëm. Duhet bërë një trajtim paraprak i sipërfaqes me prajmer izolues, i cili duhet parashikuar para aplikimit të kollës në suva apo sipërfaqes së stukuar. Për përzierjen e përbërësve të ndryshëm të ndiqen udhëzimet e fabrikës; në rastin e ngjitesit me baze çimentoje të miksuar me uje të pastër në masën 25-30% të peshës, për të përfunduar një miks homogjen kokrriza. Të qëndrojnë për rreth 10-15 minuta pastaj të trazohet sërish. Të shpërndahet ngjitesit me anë të një shpatulle me profilet e përshtatshme për shpërndarje të paktën në 80-90% të sipërfaqes së pllakës.

Në rast përdorimi të ngjitesit me dy komponent poleritani pllaka duhet të jetë komplet e thatë; nëse përdorni ngjitës me bazë çimentoje nuk ka nevojë të laget pllaka para shtrimit (vetëm lajini ato në ujë të pastër kur janë tepër të pluhurosura).

Të shpërndahet ngjitesit në një sipërfaqe të vogël (rreth 2 m² për çdo shtrim) dhe pastaj të vendoset pllaka në stuko akoma të freskët duke përdorur një mall të mirë. Në rastin kur stuko/ngjitësi ka formuar një cipë të lehtë të hiqet nëpërmjet përdorimit të spatulës. Të vendosen pllakat cep më cep gjatë shtrimit të hapësirave të ngushta si dhe distancuesit e duhur në formë kryqi sipas hapësirës.

Defekte të vogla të shtrimit, si dhëmbë apo distancues jo të barabartë mund të korrigjohen brenda kohës së mpiksjes së ngjitesit. Të vendoset bojaku ndërmjet hapësirave të pllakave me trashësinë e duhur.

11.2.4.5.1 Pajisjet e prerjes së pllakave

Të mundësohet prerësi i duhur i pllakave për punë. Të ofrohet sipas udhëzimeve për të kompletuar dhe përfunduar shtrimin e pllakave. Të mundësohen bulona dhe tako druri, përveç rasteve kur tako e drurit mund të ndikojnë në sipërfaqen e pllakave të murit. Këndet e brendshme duhet të jenë kuadratike dhe këndet e jashtme të rumbullakosen duke përdorur pajisjen e duhur prerëse.

11.2.4.6 Agregatet

Rëra për pergatitjen e llaçit s' duhet të kalojë sitën 16.

11.2.5 Uji

I pastër dhe i transportueshëm.

11.2.5.1 Çimento portland

E bardhë për ngjitje dhe gri për përdorim tjetër.

11.2.5.2 Shiritat ndarës prej metali

Me majë të rëndë të llojit terrazzo, prej bronzi ose aliazh zinku, rreth 2mm me 6mm trashesi dhe thellësi të barabartë me trashësinë e pllakave plus vendosjen në bazament.

11.2.5.3 Plintuset-pragjet

Mermer i fortë dhe i bollshëm për shtrim brenda minimumit 25mm i trashë për shtrim dhe 13mm i trashë për shtrime të holla, vetëm nëse nuk udhëzoheni ndryshe. Rrumbullakosja e këndeve bëhet për fluks shkeljeje. Ndërsa ai i gomuar për ekspozim të jashtëm. Pjerrësia e skajeve vertikale maksimalisht deri në 13mm në lartësi, ose sipas udhëzimeve.

11.2.5.4 Llaçi dhe mbushësi

11.2.5.4.1 Llaçi për vendosjen e pllakave

Llaç me çimento portlandi

Set i thatë të llaçit me çimento portlandi i përzier që në fabrikë.

Ngjitës organike –përdorimi i ngjitesit organik është i limituar në aplikimet e murit

11.2.5.4.2 Mbushësi

Çimento portlandi;

Rërë e çimentuar portlandi;

Kuader për pllaka dhe mbushje;

Që nuk lënë njolla;

Neutrale ndaj mjedisit.

11.2.6 VINILI

11.2.6.1 Ngjyrat dhe modelet

Ngjyrat e vinilit dhe modelet duhet të zgjidhen sipas katalogut dhe standarteve të fabrikës. Ngjyrat dhe modelet tregojnë referencën për identifikimin fabrikës që e ka prodhuar, modelin, emrin e prodhuesit dhe nuk kane kufizim për të mos marrë ngjyra apo borja vinili dhe produkte të ngjashme

11.2.6.2 Shtrimi i dyshemeve me PVC

Dysheme PVC anti-statike Homogjene

Shtrimi i dyshemesë me pvc duhet të bëhet me rregulloret e tanishme dhe udhëzimet e mbikëqyrësit të punimeve.

Shtrimi i dyshemesë sipas markimit të çetifikimit Evropian CE (EN 14041), duhet të kryhet nëpërmjet një gome anti-statike homogjenë ose nga shtresë dopio të presuar PVC- të kalandruar (EN 649), për higjenizim dhe jetëgjatesi të madhe.

Dyshemeja duhet të ofrohet me një trashë totale minimumi $t=2.00$ mm (EN 428), me një grup T të rezistencës ndaj gërryerjeve (EN 660-2). Shumë rezistente ndaj trafikut, jo poroze dhe e vulosur me poliuretane të pastër. Kjo dysheme nuk do të ketë nevojë për dyllosje dhe mirëmbahet lehtësisht. Falë kualitetit të lartë të materialeve dhe sipërfaqes që mund të rinovohet pas një pastrimi të thatë. Vetitë jo rrëshqitëse të dyshemesë janë konform standardeve EN 13893 ($\geq 0,3$ μ s që kërkojnë nga markimi CE), R9 në përputhje me normat DIN 51130, reagimi ndaj zjarrit (EN 13501-1) Bfl s1 e ngjitur në mbështetëse

kundra zjarrit dhe fiziologjikisht anti statike sipas (EN 1815) <2KV. Material i natyrës kompakte do të ofrojë karakteristika kundër bakteriale në përputhje me normat (DIN EN ISO 846-A/C. Shtresat dhe dyshemeja nuk do të saldohet me shtratin me të njëjtën ngjyrë apo kualitet me qëllim pasjen e një sipërfaqe monolitike që përfshin edhe bashkimin me faqet e murit të jenë tërësisht kundra ujit.

Dyshemeja duhet të jetë prodhuar nga fabrikat e çertifikuara sipas standardeve ISO 9001 dhe ISO 14001 dhe duhet të ketë këto vlera standardesh.

Mbetje gjurmësh	EN 443	Përreth 0.03 mm
Ngrohje nëndysheme	EN ISO 717/2	Përmbushë - max27°C
Rezistencë ndaj kimikateve	EN 423	Mirë
Qëndrueshmëri të dimensionit	EN 434	<input type="checkbox"/> 0,40% për fletët <input type="checkbox"/> 0,25% për pjata
Përmirësim akustik	EN 140-8	d dB
Përçim termal	EN 12667/DIN 52612	përreth. 0.01 m2/KW
Siguri ndaj dritës	EN ISO 105-B02	<input type="checkbox"/> 6
Dhome të pastër testimi	ASTM F51/00	Klasi A

Dyshemeja duhet të ngjitet me një ngjitës të veçantë me bazamentin e dyshemesë, të jetë kompakte, e thatë, pa plasaritje dhe e izoluar nga lagështia. Përdorimi i ngjitesve dhe adeziveve duhet të bëhet në përputhje me llojet e përdorimit sipas kërkesave të prodhuesve. Me qëllim përfitim të një shtrese uniforme të dyshemesë do të shtrohen një seri shtresash, me shtresa të kundërta në jo më pak se 24 orë pas përshtatjes në një temperaturë jo më të ulët se 18° Celsius. Dyshemeja nuk do të lahet përveç se me ndihmën e detergjenteve që nuk kërkojnë përdorimin e rrëshirës metalike.

Dysheme PVC statike Homogjene

Shtrimi i dyshemesë për tu çertifikuar me vulën CE (EN 14041), duhet të kryhet nëpërmjet përdorimit të gomës jo statike homogjene nga shtresë dopio të presuar PVC të kalandruar (EN 649), me një shtresë të veçantë (karboni të zi), ngjyra zgjidhet prej Mbikëqyrësit të punimeve. Falë aftësive ndaluese-statike të dorezës së zezë dyshemeja do të lejojë vendosjen e shtresave me një stuko/ngjitës normal(stuko/ngjitës elektro-përçues në kuti ose enë).

Dyshemeja duhet të pajiset me një trashësi totale minimale prej 2.00 mm (EN 428), në 200 fletë cm(EN 426) me një rezistencë kundër gërryerjes të grupit P (EN 660). Shumë rezistente ndaj trafikut, jo-poroz dhe vulosur me poliuretan të pastër. Dyshemeja e tillë nuk ka nevojë të kërkojë rrëshirë dhe mund të mirëmbahet lehtësisht. Në sajë të cilësisë së lartë të lëndëve të para sipërfaqja duhet të jetë e riparueshme vetëm duke kryer një lustrim të thatë. Aftësitë jo-rrëshqitëse të dyshemesë do të jenë në përputhje me EN 13893 (≥0,3 μ siç kërkohet nga standardin CE), R9 në përputhje me normat DIN 51130, reagimi ndaj zjarrit (EN 13501-1) BFL s1 ngjitur në mbështetjen jo statike kundra zjarrit(EN 1815) <2KV. Natyra kompakte e materialit do të sigurojë karakteristika kundër bakteriale në përputhje me DIN EN ISO 846-A / C. Aftësitë e përçimit të energjisë elektrike do të jenë në përputhje me IEC 61340 dhe me një rezistencë sipas EN 1081 të

barabartë me $R \leq 108$ om, gjithashtu në përputhje me IEC 61340-4-1 dhe $R \leq 108$ om dhesipas miratimit të metodës SD PS- 2472 me një vlerë prej $106 \leq R \leq 108$ Om. Shtresat dhe dyshemeja nuk do të saldohet me shtratin me të njëjtën ngjyrë apo kualitet me qëllim pasjen e një sipërfaqe monolitike që përfshin edhe bashkimin me faqet e murit të jenë tërësisht kundra ujit. Dyshemeja duhet të jetë prodhuar nga fabrikat e certifikuar sipas standardeve ISO 9001 dhe ISO 14001 dhe duhet të ketë këto vlera standardesh:

Elektrike	VDE 100, pjesë 600	$R1 \leq 5C104$ Om
Izolimi		
Gjurme Mbetjesh	EN 443 EN ISO 717/2	përreth. 0.03 MM I adaptuar – maks 27°C
Ngrohja e dyshemesë		
Rezistenca ndaj kimikateve	EN 423	Me rezistencë të mirë
Qëndrueshmëri dimensionale	EN 434	<input type="checkbox"/> 0,40% përtopt <input type="checkbox"/> 0,25% për pjata
Përmirësimi i akustikës	EN 140-8	4 Db
Mbrojtja nga ndriçimi	EN ISO 105-B02	<input type="checkbox"/> 6

Dyshemeja duhet të ngjitet me një ngjites të veçantë me bazamentin e dyshemesë, të jetë kompakte, e thatë, pa plasaritje dhe e izoluar nga lagështia. Përdorimi i ngjitesve dhe adeziveve duhet të bëhet në përputhje me llojet e përdorimit sipas kërkesave të prodhuesve. Me qëllim përfundim të një shtrese uniforme të dyshemesë, do të shtrohen një seri shtresash, me shtresa të kundërta në jo më pak se 24 orë pas aklimatizimit në një temperaturë jo më të ulët se 18° Celsius. Dyshemeja nuk do të lahet përveç se me ndihmën e detergjenteve që nuk kërkojnë përdorimin e rrëshirës metalike.

11.2.6.3 Veshja e mureve me PVC

Muret duhet të vishen duke përdorur shtrese PVC-je të ngjeshur me gomë dhe të printuar jo më pak se 0.12 mm (EN 429) veshja e sipërfaqes, ngjyrat sipas udhëzimeve të mbikëqyrës të punimeve. Shtresa/veshja duhet të mundësojë një trashësi totale prej 1-2 mm (EN 428), 200 cm shtresat (EN 259). Reagim ndaj zjarrit (EN 13501-1) B-s2 d0 ngjitur në A1 or A2 në mbështetëse dhe panele gipsi. Natyra kompakte e materialit ofron karakteristika kundër bakteriale në përputhje me DIN EN ISO 846-A/C. Mbulesat e murit duhet prodhohen nga fabrikat e certifikuar sipas standardeve ISO 9001 dhe ISO 14001 dhe duhet të kenë këto vlera standardesh;

Rezistence ndaj kimikateve	EN 423	E mirë
Përmirësim akustik	NF EN ISO 354 <input type="checkbox"/> Ë	0.05 (H)
Mbrojtje ndaj dritës	EN ISO 105-B02	<input type="checkbox"/> 6
Qëndrueshmëria dimensionale	EN 434	<input type="checkbox"/> 2 mm
Rezistencë ndaj zjarrit	EN 13501	B-s2 d0

Shtresa e murit duhet të ngjitet me ngjites të veçantë me sipërfaqen e murit, të jetë kompakte e thatë pa plasaritje dhe e izoluar nga lagështia. Përdorimi i ngjitesve dhe adeziveve duhet të bëhet në përputhje me llojet e përdorimit sipas kërkesave të prodhuesve. Me qëllim përfundim të një shtrese uniforme të dyshemesë do të shtrohen një seri shtresash, me shtresa të kundërta në jo më pak se 24 orë pas përshtatjes në një temperaturë jo më të ulët se 18° Celsius. Dyshemeja nuk do të lahet përveç se me ndihmën e detergjenteve që nuk kërkojnë përdorimin e rrëshirës metalike.

11.2.6.4 Njësitë Prerëse

Te mundesohen pajisjet e përshtatshme prerëse

11.2.6.5 Përbërja e vinilit

Dysheme PVC anti-statike homogjene

Përbërja e produktit në përqindje sipas peshës është me 54% përbërës natyral dhe 25.5% produkte të ricikluara. Materiali duhet të jetë 100% i riciklueshëm. Për cilësinë e ajrit brenda godinave ai duhet të ketë një përçim >10 g/mc (pas28 ditësh vendosje).

Dysheme PVC statike homogjene

Përbërja e produktit në përqindje sipas peshës është me 51% përbërës natyral dhe 25.5% produkte të ricikluara. Materiali duhet të jetë 100% i riciklueshëm. Për cilësinë e ajrit brenda banesave ai do të ketë një përçim >10 g/mc (pas28 ditësh vendosje)

Veshja e mureve

Përbërja e produktit në përqindje sipas peshës është me 31% përbërës natyral. Materiali duhet të jetë 100% i riciklueshëm. Për cilësinë e ajrit brenda banesave ai do të ketë një përçim >10 g/mc (pas28 ditësh vendosje)

11.2.6.6 Plintuset - pragjet

Vendosja e PVC-së me skaje gome të përforcuar përsëri me polimerie dhe materiale koherente në një dysheme të zgjedhur. E bashkuar me dyshemene dhe e ngjitur në mur. Ajo siguron pastrimin e lehtë dhe higjienik. Disponohet në të gjitha ngjyrat , për të gjitha produktet. Rezistente ndaj tronditjeve dhe kundra ujit. Kompakte. 60/80/100 x 100 x 2400 mmm

11.2.7 RIFINITURA E SHKALLEVE

11.2.7.1 Shkalle te Jashtme betoni e veshur me Granil/Mermer

Shkallë e jashtme betoni veshur me granil

Dozimi për një m² me një trashësi prej 1 cm i dyshemesë me granil të derdhur është: 13 kg çimento të tipit 400, 0.002 m³ granil dhe ujë, duke përfshirë kallëpet, përforcimin dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

Shkallë e jashtme betoni veshur me mermer

Për veshjen e shkallëve të betonit me mermer duhet të parashikohen këto punë: Në fillim duhet që shkallët e betonit të pastrohen mirë si dhe të rrafshohet vendi. Pastaj duhet që shkalla prej betoni të lyhet me qumësht çimentoje, i cili e lehtëson ngjitjen e pllakave të mermerit. Ngjitja e pllakave të mermerit bëhet ose duke përdorur llaç ose në rast se shkallët e betonit janë të rrafshta, atëherë mundet që këto të ngjiten edhe me kollë. Ngjitja e pllakave të mermerit nuk ndryshon nga ngjitja e pllakave në mur

11.2.7.2 Dysheme/Shkalle te brendshme me Pllaka Mermeri t=2/3cm, te

cilesise se pare permasa sipas V.T., te tipit te zgjedhur, perfshire :

- ngjitja pllakave realizohet me llaç,
- prerjen me prerës pllakash dhe ngulitjen e inkastrimeve ne mur, vendosjen ne veper ne menyre plotesisht te ngjeshur ndermjet tyre dhe te stukuara me boiake çimentoje ne fugatura,
- larjen dhe pastrimin,
- çdo detyrim tjetër për mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte.

11.2.7.3 Korimanot Metalike

Korimanot në ndërtime kanë funksione të ndryshme për të plotësuar. Ata duhet të ofrojnë mbrojtje dhe siguri gjatë të ecurit në shkallë. Po ashtu, korimanot luajnë një rol të veçantë në pamjen dhe bukurinë arkitektonike të një ndërtimi. Duhet që korimonat të jenë të larta 100 cm. Në raste kur gjatësia e shkallëve është më e madhe se 12 m korimonat duhet të jenë 110 cm të larta. Masa prej 100/110 cm varet edhe prej sipërfaqes të sheshpushimit. Korimanot montohen në shkallë ose anash shkallëve, të fiksuara mirë që të garantohet stabiliteti dhe qëndrueshmëria e tyre. Në rastet kur shkallët janë më të gjëra se 100 cm, atëherë duhet që përveç korimaneve, vendosen në muret e anës tjetër të shkallëve, parrmakë për të siguruar një ecje të sigurt. Parrmakët nëpër shkallë nuk duhet të jenë më të ulëta se 75 cm dhe jo më të larta se 110 cm.

11.3 PLLAKAT

11.3.1 KONTROLLI

Te mos aplikohet shtrimi i pllakave para se të kete përfunduar dhe të jenë testuar punimet hidraulike, elektrike ato të ventilimit dhe të ngrohjes, si dhe të jenë montuar vaskat, dushet si dhe te jete testuar me pare sistemi izolimit.

11.3.2 PËRGATITJA

11.3.2.1 Përgatitja e shtresave

Te mos aplikohet shtrimi i pllakave të dyshemesë në vendet ku do të shtrohen pllaka muri deri sa ato të jenë shtruar. Shtresa duhet të zgjidhet që të përshtatet me shtresën e nëntokës.

11.3.2.2 Shresat në dysheme betoni.

Te përgatitet me llaç shtrati ku do shtrohen pllakat, para se të vendoset ngjitesi i pllakave. Te mbushen zonat e dyshemesë që nuk janë në nivel. Te vendosen distancues kryq kur ata nevojiten.

11.3.2.3 Përgatitja e përzierjes së llaçit

Te matet sasia e materialeve për përgatitjen e llaçit në enë të kontrolluar për tu siguruar që masat e materialeve janë të mbajtura dhe kontrolluara siç duhet - matja e materialeve me anë të lopatës nuk është e lejueshme. Nëse nuk specifikohet ndryshe përzierja e llaçit sipas sasive të matura me anë të volumit bëhet në përzierësin mekanik të miratuar ose në kutitë e llaçit. Kontrolli i sasisë të ujit duhet të bëhet në masë dhe uniformitet.

11.3.2.4 Depozitat e kripës në mure

Depozitimet e kripës nga thellësia duhet të hiqen nëpërmjet një furçe të ashpër jo metalike pasi muri është thare sic duhet.

11.3.3 VENDOSJA / SHTRIMI

11.3.3.1 PLLAKAT E DYSHEMESË

Llaçi i çimentos portland: te nivelohet ose te përgatitet shtresa sipas udhezimeve. Pllakat nuk duhet të vendosen në llaç çimentoje me një lagështi më të madhe se 2%.

11.3.3.2 Pllakat e murit

Sipërfaqes e murit që do ti vendosen pllaka qeramike pasi ti jetë vënë shtresa e llaçit, e cila duhet të ketë kënde të drejta, te jete e niveluar dhe të mos i kalojë 2.5 mm deformim për metër në një plan të rrafshët. Te perdoret llaç çimentoje portlandi ose tjetër lloj ngjitesi organike.

11.3.3.3 Fugat

Te behet nje nivelim, paralel , me plumbce, nivelues ne nje rresht. Te vendoset lidhese fundore dhe ato në qendër dhe midis pllakave nëse është e mundur, për aq kohë sa është e zbatueshme. Te vendosen pllakat e drejta me lidhesa të drejtë dhe ato të prera me bashkues të prerë. Lidhesit drejtues duhet të ndjekin dhe vendosen vetëm mbi shtresen e llaçit.

11.3.3.3.1 Gjerësia e fugave

Fugat duhet të jenë uniform për shtrimin e pllakave me një minimum prerje por duke ruajtur standardin që të mos lejoje ngatërrimin midis shtresave dhe të mozaikut qeramik të pllakave. Te krijohen fuga si me poshtë,:

Vendosja e pllakave: siç përcaktohet për distancën e vendosjes.

Pllakë qeramike e pa rreshkitshme : siç përcaktohet në hapësirat ndarëse.

Pllaka guri: 6 mm minimumi dhe gjerësi maksimale 10 mm

Veglat dhe njësitë prerëse; në përputhje me llojin dhe madhësinë e pllakave.

11.3.3.3.2 Mbushesit dhe fugat

Te parashikohen fuga ekspansioni dhe kontrolli gjate shtrimit.

Te aplikohen fuga ekspansioni dhe kontrolli gjate shtrimit si me poshte:

Te vendoset mbushes fuge me performancë ose materiale mbushese në thellësi të fugave për të siguruar izolim dhe lidhje te mire.

Para mbushjeve, fugat duhet te jene te hapura dhe te pastra, të përdoren letra apo materiale te tjera për të mos lejuar bllokimin e tyre.

Pasi mbushja e pllakës te jete tërësisht e thatë, te hiqet letra ose materiali tjetër si mbushës të përkohshëm; te pastrohen nyjet me një furçe të pastër dhe ose të mbushen me material izolues.

11.3.3.4 Shiritat ndarës metalik

Te vendosen shirita ndarës metalik në shtratin e llaçit ndërkohë që shtrati është në gjendje plastike. Te vendosen ndarëset sipas udhezimit, në drejtimin e duhur, me linjë të pashkëputur, rrafsh me sipërfaqen dhe papërfunduar të dyshemesë. Te vendosen shirita ndares atje ku pllakat e dyshemesë kufizohen me tipe te tjera shtrimi, përveç se hapësirave ku jane parashikuar pragjet e dyerve.

11.3.3.5 Pragjet

Te vendosen kulmet me pamje nga prerjet në të dy krahët e hapjes. Te vendosen pragjet në shtratin e çimentos në mënyrë të përshtatshme me llaçin e dyshemesë.

11.3.3.6 Fiksimi i nyejve bashkuese

Fuga midis pllakave të dyshemesë ose te mureve dhe fiksimi i tyre (psh.në banjë) duhet të jete e pa depertueshme nga uji, si dhe elastike, nqs nuk specifikohet ndryshe. Piletat e dyshemeve duhet te rrethhen nga pllakat dhe te kene nje pjerrresi te lehte.

11.3.3.7 Fugat elastike

Fugat e elasticitetit duhet të vendosen në të gjitha pikat ku tubat kalojnë, nëntokë apo poshtë materialeve të tjera. Gjithashtu fuga e elasticitetit duhet parashikuar edhe atje ku kthehen tubat. Kulmet e fugave duhet të ngjiten në të gjitha pikat duke përdorur shirit adeziv. Nyjet duhet të jenë të pastra nga depozitimet e mbushjes. Mbushjet në fugat elastike duhet të përputhen me pllakat dhe me materialet që e rrethojnë. Në raste shkallësh nyjet elastike duhet të parashikohen midis pllakave të shkalleve dhe plinusave.

11.3.3.8 Ngjitja poshte fiksuesve

Te parashikohet ngjitje poshte vaskave dhe pllakave te dusheve.

11.3.3.9 Veshja ne zonat me lageshti

Gjate veshjes me pllaka ne zonat me lageshtire, duhet treguar kujdes qe te mos lihen boshlleqe ne shtresat ku do te vendosen.

11.3.3.10 Gjeometria e motivit të shtrimit

Në përgjithësi shtrimi i pllakave do të përcaktohet paralelisht me shtrimin e mureve, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe. Aty ku është e mundur, fugat e pllakave të dyshemese duhet të jenë të vazhdueshme me fugat e mureve. Kontraktuesi duhet të konfirmojë synimet e tij me Mbikëqyrësin e punimeve para fillimit të shtrimit të pllakave. Në qoftë se pllakat janë të lugeta nga poshtë atëherë duhet të konsiderojmë që gjithë të tjerat të kenë marrë të njëjtin drejtim

11.3.3.11 Përdorimi i copave të prera të pllakave

Vetëm copat më të mëdha se gjysma e madhësisë së pllakave kryesore mund të përdoren. Përdorimi i copëzave të vogla si mbushje të pllakave duhet të shmanget.

11.3.3.12 Fugat e ekspansionit

Fugat e ekspansionit duhet të vendosen çdo 4 metra.

11.3.3.13 Prerja e cepave

Të gjithë cepat e dukshëm në pllakat e mureve duhet të priten me element prerës, vetëm nëse cepat kanë specifikë pllake të lemuara.

11.3.4 PASTRIMI

Pas përfundimit të shtrimit çdo njëra dhomë duhet të pastrohet dhe lahet me furçë, të gjitha mbeturinat duhet të hiqen.

Larja me acid duhet të bëhet në pllakat që janë të pa lëmuara dhe duhet bërë jo më vonë se 14 ditë pas vendosjes së pllakave.

11.3.5 MBROJTJA

Gjatë shtrimit të pllakave të gjitha fugat duhen ruajtur që të mos u futet llaci etj, Te mbulohen sipërfaqet e përfunduara me pllaka me leter 1.45 kg për m²për të ruajtur dyshe-menë nga shenjat e shkeljes.

Te vendosen shirita (pllaka druri) përsipër vendit ku shkelet më se shumti ne dyshemetë e korridoreve që duhet të përdoren nga punonjësit. Te mbuloen me derrasa, pragjet prej mermeri Te mbrohen cepat e veshur, këndet e jashtme me anë të shiritave në qoshe (pllaka druri)për kalimin e punëtorëve.

11.4 PJESA 3 – ZBATIMI -

PVC NGJITJA

Dyshemetë e përshtatshme për shtrimme me pvc të karakterizuar nga sipërfaqe të lëmuara. Shtrimi nëpërmjet përdorimit të ngjitësit është metodologjia më e zakonshme e shtrimit dhe siguron karakteristikat e vlefshme teknike së bashku me një shpejtësi shtrimi. Ky lloj shtrimi është i kufizuar kur nënshtresa ka tendence lagështie të lartë (duke pasur parasysh kufirin maksimal të pranueshëm të lagështisë prej 2% në shtratin e dyshemesë që do shtrohet), si dhe në përgjithësi kur shtresa është e shkrifët , me pluhur ose kur mund të krijojë plasaritje.

LLAÇI

Ajo duhet të vendoset në një plan të sheshtë të fortë, rezistente ndaj goditjeve pa plasaritje me lartësinë e duhur e thatë dhe e pastër; trashësia minimale e kërkuar është midis 4 dhe 6 cm.

Në rast të sistemeve hidraulike ose kalimit te sistemeve te tjera, elementët do të përfshihen në të paktën 6 cm trashësi të shtresës, te vendoset rrjete përforcuese prej çeliku. Gjithashtu një shtresë polietileni duhet të vendoset poshtë shtresës izoluese që per te lejuar perdorimin sa me te pak gjendjes se lengshme te çimentos dhe të funksionojë si barrierë për avujt që ngrihen.

Parametrat qëkërkon shtresa izoluese		
Lloji i mbështetjes	Izolim betoni	Sipërfaqe e rrafshët
Toleranca e sheshtë : 2,0 m anë të drejtë 0,2 manë të drejtë	7,0 mm 2,0 mm	Niveli i tolerancës C.C.B.A. 68
Gjendja e mbështetjes mbi sipërfaqe	E rregullt dhe fine	Pozicioni i nivelit duhet respektua
Punimet shtesë		Përfundimi i rrjetës
Performaca të garantohet nga ekzekutuesi i punimeve	Trashësia mesatare copëzat	Copëz e hollë e prerë pas përfundimit
Lagështia e lënë	MAKS 2%	MAKS 2%
Tolerancat e pllakave 2,0 m anë të drejtë 0,2 m anë të drejtë	7,0 mm 2,0 mm	5,0 mm 1,0 mm

NIVELIMI

Në mënyrë që të reduktohen dallimet në lartësi, ashpërsi te tepruar të sipërfaqes se llacit , se pari nevojitet nivelimi i shtreses. Para se te nivelohet te pastrohet teresisht siperfaqja. Produktet për nivelim mund të përgatiten në vendin e ndërtimit, nga përzierja e çimentos, stukove me bazë akrilike, agregateve me një madhësi grimce shumë të ulët, ose furnizimit me pluhura të gatshme të përzieria. Aplikimi i nivelimit për disa milimetra pergjate shtreses te behet nepermjet spatules, në mënyrë që të marrë një sipërfaqe të përshtatshme stukoje. 24 orë pas nivelimit sipërfaqja duhet fërkuar me rërë, për të hequr çdo ashpërsi të vogël të mbetur dhe pastaj pastrimi me produkte pastrimi. Gjithmonë pastrimi me vakuum duhet të bëhet në përputhje me udhëzimet e fabrikës.

NGJITËSIT

Ngjitës te ndryshem mund të përdoren sipas kushteve të përdorimit dhe zonat e ndërtimit.

Akrilik i holluar në ujë

Akrilik i holluar në ujë përbëhet nga një polimer akrilik i holluar në ujë. Ai mund të ndërpritet nga avullimi i ujit që ato përmbajnë, për këtë arsye ata kanë nevojë për porozitet. I përshtatshëm vetëm për përdorim të brendshëm, mbi llac cemento, ekspozuar në trafik të lehtë dhe aplikim të tepruar uji

Ngjites epoksid bi-komponent

Përbërëset nga një polimeringjitës (pjesa A) i cili stabilizohet kur përzihet me një katalizator (pjesa B). Ajo ndërpret reaksionet kimike mes dy përbërësve. E përshtatshme për përdorim të brendshëm mbi llac cemento, ekspozuar në trafik mesatar /te rende

Poliuretani bi-komponent

Përbërë nga një polimeri poliuretani (pjesa A) që stabilizohet/rregullohet kur të përzihet me një katalizator (pjesa B). Ai ndërpret nga reaksionet kimike mes dy përbërësve. I përshtatshëm si për aplikimet të brendshme dhe të jashtme, mbi shtresa të natyrave të ndryshme, ekspozuar në trafik të rënduar.

Polikloroprene gome sintetike (neoprenë)

I bërë nga tretësira e neoprenit. Ajo ngurtësohet nga avullimi i holluesit dhe absorbimi nëpërmjet materialeve poroze. Duke pasur parasysh vendosjen e tyre të shpejtë, këto ngjitës (të duhet të jenë të veshura në të dy sipërfaqet për tu lidhur bashkë) mund të përdoret për shtrimin e aksesorëve (plintusat, veshjet e shkalleve etj).

Përdorimi i ngjitësit

Për përgatitjen dhe zbatimin e ngjitësve të ndryshme, ndiqni me kujdes udhëzimet e prodhuesit. Shtrimi i ngjitësit duhet të bëhet me anë të shtresave në mënyrë të rregullt, me përdorimin e shpatullës së dhëmbëzuar dhe sipas udhëzimeve të mëposhtme të prodhuesit të ngjitësit. Shpatulla duhet të zëvendësohet sa më shpejt në momentin që dhëmbët fillojnë të veshin cipën.

VENDOSJA

Shtrimi i ngjitësit/stukos duhet të kryhet nga operatorët e specializuar, në përputhje me hapat e mëposhtme: vendosja e materialit (parket dhe ngjitëse/stuko) në dhomë të paktën 48 orë para shtrimit, temperatura e brendshme nuk duhet të jetë më pak se 15 ° C,

te sillen në kënd të drejtë linjat brenda dhomes, si dhe te venosen udhezues,

te aplikohet shtrimi i thate (pa ngjitës/stuko) të shtresave të dyshemesë të paktën 24 orë para shtrimit nëpërmjet 1.0 cm të mbuluar, për të kontrolluar uniformitetin ngjyrën dhe paraqitjen e dyshemesë, te priten mbivendosjet e kulmeve, te mblidhen rolete deri në gjysëm, te vendoset ngjitës, te shtrohen rolete duke u trokitur lehtë nga qendra tek skajet për të hequr bulëzat e ajrit, te perseritet veprimi për gjysmen tjetër të rolese, pas shtrimit të sigurohet kontakt sa më i mirë me shtresën e dyshemesë, te ushtrohet peshe gjate shtrimit të stukos

12. RIFINITURA E TAVANEVE

12.1 PJESA 1 – TË PËRGJITHSHME

12.1.1 REFERENCA

Publikimet e Listuara me poshtë formojnë një pjesë të specifikimeve dhe referencave shtesë Publikimet që referohen në këtë tekst janë vetëm ato themelore.

12.1.1.1 Zbatimi i normave dhe ligjeve shqiptare

12.1.1.2 Normat dhe standartet Evropian

DIN 1748	Ndërtimi i xhamave – produktet speciale bazë - Pjesa 1: xhama borosilikatë Xhami në godina – Produktet speciale bazë- Pjesa 2: Qeramika e xhamit
DIN 18168-1	Kundër tavanet dhe tavanet veshjet e tavaneve të lehta
DIN 4102	Sjellja ndaj zjarrit të materialeve të ndërtimit dhe elementët – Klasifikimi i materialeve të ndërtimit–Kërkesat dhe testimi
DIN EN 485-1	Pllakat dhe fletët e aluminit dhe produkteve të tij; kushtet teknike të dhëna
DIN EN 1396	Alumini dhe materialet prej alumini – fletët e lyera për përdorim të përgjithshëm - Specifikimet
ISO 1461	Artikujt e çelikut të prodhuara me galvanizim të nxehtë– Specifikimet dhe metodat e testimit
VDI 3755	Izolimi dhe thithja e zhurmave tek tavanet e varur

12.1.2 PARAQITJET

Te paraqiten si me poshte:

Vizatime teknike

Të dhënat

Mostrat/modelet

Sistemi i amortizimit

Te paraqitet sistemi i kapjes dhe metodat e lidhjes dhe bashkimit si dhe planet e tavanit.

Nga dy shembuj për çdo të njësi kapse, tekstura dhe ngjyra përfundimtare.

Certifikatat

Zjarr durueshmeria

Raportet dhe certifikatat e testimeve

12.1.3 DORËZIMI DHE MAGAZINIMI

Njësitë e dorëzimit të dërgesave nga fabrika origjinale duhet të jenë në kontenier të pa hapura së bashku me emrin dhe llojin të shënuar dhe të dukshëm plotësisht. Te mirembahen me kujdes materialet dhe te ruhen ne te thate. Vetëm 24 orë para vendosjes materialet duhet të dalin nga magazina dhe të vendosen në të njëjtën temperaturë dhe lagështi si hapësira ku do të instalohen.

Mostrat e materialeve të përcaktuara do të furnizohen në llojet e parashikuara nga projekti të shoqëruara nga dokumenti që vërteton se ata plotësojnë kërkesat. Para se të porositen materialet, mostrat duhet të miratohen.

Për 24 orë para, gjatë, dhe 24 orë pas instalimit të njërive ruaj temperaturën dhe lagështinë relativetipikesi kushte shërbimi. Puna e përfunduar brendasi suvatimin, betone dhe tarraca duhet të përfundojë dhe të jetë e thatë para instalimit. Lagështia relative duhet të jetë më pak se 80%.

Punimet e tjera Mekanike, elektrike, mbi vijën tavanit duhet të kenë përfunduar dhe miratuar para fillimit të instalimit të tavanit.

12.2 PJESA 2 – PRODUKTET

12.2.1 TAVANET E SUVATUAR

SHIKO KAPITULLIN 11

12.2.2 TAVANET E VARUR

Pllake gipsi standarte

Përforconi, shponi dhe bashkoni dyert dhe kornizat për tëqenë të gatshme për vendosjen e aksesorëve. Përgatisni dyert dhe kornizat për aksesorët.

14.2.6.9 Rifiniturat

Përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe, siguroji pajisje me veshje zinku të aplikuar në nxehtësi dhe me rifiniturë fillestare të përfunduar nga fabrika. Më pas, aplikoni dy shtresa llaku në sipërfaqet e ekspozuara. Thani ose piqui në furrë secilën prej duarve të llakut. Kërkesat për kohën e tharjes dhe temperaturës duhet të jenë në përputhje me rekomandimet e prodhuesit të llakut. Ngjyra e rifiniturës së përfunduar duhet të përputhet me shembullin e ngjyrës që është aprovuar.

14.2.6.10 Cilësia e punimit

Dyert dhe kornizat e përfunduara duhet të jenë të forta dhe të papërkulshme, të pastra në dukje dhe pa defekte, valëzime, gërvishtje, prerje, vrima, deformime dhe ngjitje. Elementët e vendosur në to me korniza duhet të kenë prerje të qarta, të drejta dhe të plota, me bashkime të mirë formuara me bashkime të drejta ose me kënd, dhe tërësisht të niveluara. Vendet e bashkimeve me saldim ose ngjitje duhet të jenë të lëmuara. Dizajni i seksioneve të kornizave të dyerve për përdorim duhet të jetë sipas cilësimeve të ndërtimit të murit. Bashkimet e elementëve duhet të jenë të mirë formuar dhe të niveluara.

14.2.7 DYERT E ALUMINIT

Kontraktori duhet të certifikojë konformitetin e produkteve të ofruar sipas specifikimeve të kërkuara më poshtë dhe duhet ti japë punëdhënësit dhe Supervizorit/arkitektit certifikime të tjera që provojnë konformitetin e mallrave me standardet e Komunitetit Evropian.

Për instalimin e sistemit të përshkruar në këtë kapitull, kontraktori duhet ti dorëzojë Supervizorit një skicë të plotë instalimi duke përfshirë llogaritjet dhe pajisjet siç përshkruhet në këto specifikime teknike. Skica duhet të jetë në përputhje me skicën e detajuar të vizatimeve në dokumentin e tenderit dhe me materialet e specifikuara. Të gjitha skicat dhe blerjet duhet të jenë të aprovuara nga Supervizori/arkitekti dhe nga punëdhënësi. Vetëm teknikë me aftësi të veçanta dhe të licencuar jenë të autorizuar të instalojnë këtë sistem. Kontraktori duhet ti sigurojë Supervizorit/arkitektit prova të kualifikimit të personelit montues para fillimit të punimeve. Gjithashtu, duhen përmbushur edhe kriteret bazë të përmendur më poshtë:

Ndarëset vertikale/horizontale të ndërtuara prej çeliku ose profili alumini

Të gjithë profilet e çelikut duhet të jenë të galvanizuar (brenda dhe jashtë) dhe të lyer Të gjithë profilet e aluminit duhet të jenë të lyer

Profilet me ndarje termike duhet të jenë si grupi 1.0 i materialeve me 5 dhomëza termike

Forma profili të përshtatshëm për xham strukturor me panele hapjeje që përfshijnë vulosës në EPDM, absolutisht rezistent ndaj motit.

Profilet kapës të jashtëm me vida V2A të dukshme dhe profile mbulues – profile U si horizontal dhe vertikale si profilet H.

Sigurimi për hapësirë të mjaftueshme kullimi të ujit të kondensuar

Dimensionet e Profilin:

Gjerësia e dukshme nga brenda në panelet e dritareve rreth 50 mm

Gjerësia e dukshme nga jashtë e profileve fiksues rreth 50 mm Gjerësia

e dukshme e ndarëseve të kanateve rreth 50 mm

Buza ballore e dymave (ose më mirë e kornizave) duhet të jetë rrafsh me profilet fiksues.

Seksioni i profileve duhet të jetë në përputhje me përlllogaritjet strukturore.

Modeli montimit dhe i vendosjes së elementëve mbushës në përputhje me detajet e vizatimeve.

15.2.4.1.1 Panel tek

15.2.4.1.2 Panel dopjo

15.2.4.1.3 Panel rrëshqitës

14.2.7.1 Xhamat

Kërkesat

Minimale:

Xham ISO $U_v < 1,1 \text{ } \ddot{\text{E}}/\text{m}^2\text{K}$ si xhamat pluskues, të jashtëm dhe të brendshëm me xham sigurie të temperuar, trashësia min. 8 mm, cepa plastikë

Izolim për zhurmat ajrore: R'ëp 37 dB

Izolim i Zhurmave Aksiale

46 dB në drejtimin Horizontal dhe

51dB në drejtimin Vertikal (në afërsi të pllakave)

Lartësia Maksimale – shih vizatimet

Xhamat:

Xhama të dyfishtë sigurie të temperuar – (ngjyra ekzakte për tu dakorduar me Supervizorin).

Ngjyra:

Të gjithë elementët e dukshëm të veshur (DIN EN ISO 12944) në RAL të përshkruar në vizatime ose të dakorduar me Supervizorin).

Sistemi i Izolimit:

$K = 1,30 \text{ Ę/m}^2\text{K}$

Transparenca Totale e Energjisë $g=0,58$

Montimi duhet të lejojë bashkimin pa shtrëngim duke lejuar lëvizjet zgjeruese.

Bashkimet me strukturën e ndërtesës duhet të jenë kundra avull.

Nëse kërkohet nga Supervizori, Kontraktori duhet të kryejë një test për të provuar veçoritë e izolimit akustik të dyerve të aluminit.

Të gjithë bashkimet duhet të jenë mekanikë. Përdorimi i shkumave zgjeruese dhe ngjitësve është i ndaluar.

Kontraktori do të jetë përgjegjës, me kostot e tij, për të kontrolluar përfundimisht dimensionet e materialeve para dorëzimit të tyre në sheshin e ndërtimit.

Mbrojtja nga korrodimi i elementëve duhet të rregullohet, nëse dëmtohet, gjatë montimit. Ngjitësit nuk duhet të përmbajnë agjentë zbutës.

14.2.8 AKSESORËT

14.2.8.1 Hapesira e drites në Dyer

Siguroni hapje xhami me kornizat prej druri standarde të prodhuesit. Kornizat për dyert që do të marrin rifiniturë natyrale duhet të jenë të njëjtës tipi dhe ngjyre si rimeso e faqeve. Kornizat për dyert e rrafshëta do të jenë të tipit me buzë.

Aksesorët e dyerve

Siguroni, aq sa mund të jetë e realizueshme, brava, mentesha, akse, dhe mekanizma të një fisheku, menteshe ose mekanizmi, ose të përafërt me ato të prodhuesit.

Aksesorët duhet të jenë të studiuar për të mbajtur peshën e vdekur të 1-1/2 më shumë se e vetë derës dhe aksesorët e fiksuar duhet të jenë pa deformime që do të pengonin në funksionimin e derës.

Menteshat nësipërfaqe druri natyral ose plastike të dyerve të brendshme duhet të jenë prej çeliku me veshje tunxhi ose bronxi

Dorezat do të jenë prej tunxhi

Fishekët cilindrikë, duhet të jenë si më poshtë:

Kasa dhe shul prej çeliku të plotë, të veshura me zink për mbrojtje nga ndryshku Të garantuara për më shumë se 150 000 cikle jete

Pjesët e ekspozuara duhet të jenë ose prej çeliku të farkëtuar ose tunxhi.

Cilindra me 5 kunjë, bravë me tre çelësa tunxhi të nikeluar

Bravat elektronike duhet të kenë kode të ngjashëm për të theksuar komoditetin,

Bravat elektronike duhet të kenë një kod bazë me një kombinim të thjeshtë, Bravat elektronike duhet të jenë të lehta për tu montuar.

Trashësia e kornizave të bravës duhet të jetë 2 mm dhe madhësia e saj duhet të jetë 28mm x 70 mm, Thellësia e vendit të gjuhëzës duhet të jetë 12,5 mm,

Krahu duhet të jetë tërësisht i ndryshueshëm për montim si në dyer me krah hapjeje të djathtë ose të majtë, Trashësia e derës duhet të jetë e modifikueshme 35 mm deri 50 mm sipas standardeve ose 50 mm deri në 70 mm në raste të veçanta,

Dyert e Hyrjes do të kenë:

Gjuhëza me mekanizëm sigurie

Duke shtypur butonin në dorezën e brendshme bllokohet doreza e jashtme.
Doreza e brendshme qëndron gjithmonë aktive
Rrotullimi i dorezës së brendshme ose çelësi nga jashtë do të hapin gjuhëzën
Secila nga dorezat vepron mbi gjuhëzën përveç rastit kur doreza e jashtme është bllokuar nga brenda Banjat ose
Dyer të tjera Private do të kenë:
Secila nga dorezat vepron mbi gjuhëzën përveç rasteve kur doreza e jashtme është kyçur nga shtypja e butonit të brendshëm,
Futja dhe rrotullimi i një monedhe në bravën e urgjencës do të hapë derën nga jashtë.
Doreza e brendshme është gjithmonë aktive
Shtypja e butonit të brendshëm bllokoi dorezën e jashtme
Dyert që nuk kërkojnë mbyllje do të kenë:
Secila nga dorezat vepron gjithmonë mbi gjuhëzën
Të përshatshme për përdorim në dhoma magazinimi ose kuzhinë
Dyert e magazinimit, hotelit dhe të daljes do të kenë:
Gjuhëza të aktivizuara nga doreza në pjesën e brendshme dhe çelës në anën e jashtme
Doreza e brendshme është gjithmonë aktive
Doreza e jashtme është gjithmonë e palëvizshme
Grupet e levave cilindrike, të dhënat e tyre teknike duhet të jenë si më poshtë:
Kasa dhe trup prej çeliku, të veshura me zink për mbrojtje nga ndryshku
Të garantuara për më shumë se 150 000 cikle jete
Pjesët e ekspozuara duhet të jenë prej zinku të derdhur ose tërësisht prej tunxhi. Cilindra me 5 kunjë, bravë me tre çelësa tunxhi të nikeluar
Bravat duhet të jenë të ngjashme me ato me gjuhëza siguria për të maksimizuar sigurinë, Bravat duhet të jenë të lehta për tu montuar.
Trashësia e kornizave të bravës duhet të jetë 2 mm dhe madhësia e saj duhet të jetë 28mm x 70 mm, Thellësia e vendit të gjuhëzës duhet të jetë 12,5 mm,
Krahu duhet të jetë tërësisht i ndryshueshëm për montim si në dyer me krah hapjeje të djathtë ose të majtë, Trashësia e dymëve duhet të jetë e modifikueshme 35 mm deri 50 mm sipas standardeve,
Të gjitha instalimet dhe kërkesat për të kompletuar një punim të cilësisë së parë duhet të jenë të përfshira.
Shembuj të bravave automatike do të dorëzohen Mbikëqyrësit për një aprovim paraprak para montimit të tyre.

14.2.8.2 Etiketa

Të gjitha dyert duhet të kenë një stampë, markë, ose një shenjë identifikimi që tregon cilësinë dhe ndërtimin e derës.

14.2.8.3 Para-përgatitja

Sipas dëshirës së Kontraktorit, dyert mund të jenë të para-përgatitura për montim nga fabrika. Dyert duhet të kenë përmasat dhe përpunimin që në fabrikë nga prodhuesi në përputhje me standardet përkatëse të prodhimit të tyre. Puna duhet të përfshijë përmasat, zmusimi i cepave, kllapat dhe hapja e vendeve të aksesorëve si dhe sigurimi i hapjeve të nevojshme për xhamat dhe pajisjeve të ajrimit. Prodhuesit i duhet siguruar shembujt e nevojshëm të aksesorëve, si dhe programin përkatës të dorëzimit të kornizave dhe aksesorëve që nevojitet për të koordinuar punën.

14.2.8.4 Rifinitura

14.2.8.4.1 Rifinitura me Plastikë të Laminuar

Është e aplikuar në fabrikë, e tipit të Përgjithshëm ose Specifik, me trashësi minimale 1.25 mm. Laminati Plastik ngjitet në venir druri, kompensatë ose plakë druri për të formuar panelin e derës për dyer me bërthamë boshe. Trashësia minimale e fletëve të laminuara dhe atyre mbështetëse duhet të jetë 2.5 mm

14.2.8.4.2 Ngjyra

Sigurori ngjyrat e rifiniturës së dyerve sipas përzgjedhjes së bërë nga Supervizori bazuar nëkampionin e ngjyrave.

14.3 PJESA 3 - EKZEKUTIMI

14.3.1 INSTALIMI

14.3.1.1 Kornizat

Vendosni kornizat, nivelojini, drejtojini dhe sigurojini deri sa të vendosen ankoruesit përfundimtarë. Ankoroni fundin e kornizave me bulona vetë-zgjerues ose me fiksues me ajër të kompresuar. Vendosni ose sigurori ankoruesit me muret pranë tyre. Për korniza në muret e jashtëm, sigurohuni qëbllokuesit të jenë të mbushur me izolues të ngurtë para se të vendoset finoja. Pas montimit të kornizës dhe xhamave, pastroni dhe rregulloni aksesorët.

14.3.2 MBROJTJA

Mbroni dyert dhe kornizat nga dëmtimet. Riparoni dëmtimet e dyerve dhe kornizave, para përfundimit dhe pranimit të projektit ose zëvendësojini me të reja, sipas udhëzimeve. Pastroni kornizat e ndryshkura me furçë metalike deri sa të hiqet ndryshku. Pastroni me kujdes. Aplikoni një bojë kundra ndryshkut të të njëjtit tip si ai i prodhuesit.

14.3.3 PASTRIMI

Pas përfundimit, pastroni me kujdes sipërfaqet e ekspozuara të dyerve dhe kornizave, eliminoni njollat e stukos dhe shenja të tjera.

15. DRITARET

15.1 PJESA 1 - E PËRGJITHSHME

15.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi në masën që janë marrë si referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin bazë:

15.1.1.1 Ligjet dhe Rregullat e Aplikueshme Shqiptare

15.1.1.2 Normat dhe Standardet Evropiane

DIN 4102-18 Sjellja ndaj zjarrit e materialeve të ndërtimit dhe elementëve; barrierat e zjarrit, verifikimi i mbylljes automatike (testim i përforcimit të vazhdueshëm)

- DIN 4108 Izolimi termik dhe ekonomizimi i energjisë në godina
- DIN 4109 Izolimi zanor në godina; kërkesat dhe testimet
- Vulosësit
- DIN 7863 Mbyllja me material jo-qelizor dhe shirit gome; kushtet teknike të dorëzimit
- DIN 18540 Vulosja e bashkimeve të mureve në godina duke përdorur vulosësh bashkimesh
- DIN 18545 Shkëlqimi me vulosësh; kthimi; kërkesat
Vulosja e shkëlqimit me vulosësh – Pjesa 2: Vulosësit, përcaktimet, kërkesat, testimet
- DIN 52460 Vulosja dhe shkëlqimi - Termat
- Xhami
- DIN EN 356 Xhami në godina – Shkëlqimi i sigurisë – Testimi dhe klasifikimi i rezistencës kundër sulmeve manualë
- DIN EN 1063 Xhami në godina – Shkëlqimi i sigurisë – Testimi dhe klasifikimi i rezistencës kundër sulmeve me fishekë
- DIN 1286 Rubineteria – Valvul mekanike përzierje të presionit të ulët; specifikime të përgjithshëm teknike
- DIN 18056 Mure xhami; dizenjimi dhe ndërtimi
- DIN 18232 Sistemet kontrollit të nxehtësisë dhe tymit -Pjesa 1: Terma, objektivat e sigurisë
Pjesa 2: Ventilatorët e nxjerrjes së tymit natyral dhe nxehtësisë, kërkesat dhe instalimi
Pjesa 4: Sistemet e nxjerrjes së nxehtësisë (ËA); Metodatat e testimit
Pjesa 5: Sistemet e fuqizuar të nxjerrjes së tymit; Kërkesat, dizajni
Sistemet e fuqizuar të nxjerrjes së tymit-Pjesa 6: Kërkesat për testimet e elementëve dhe leverdisë
- DIN EN 1202 Kimikate të përdorur për trajtimin e ujit për përdorim nga njerëzit - Di-potassium hidrogjen orthofosfat
- DIN EN 1935 Aksesorë ndërtimi – Mentasha me një aks – Kërkesat dhe metodatat e testimit
- DIN EN 12020 Alumini dhe aliazhet e aluminit – Profile të nxjerra me precizion në aliazhet EN AË-6060 dhe EN AË-6063
Pjesa 1: Kushtet teknike për inspektimin dhe dorëzimin
Pjesa 2: Tolerancat në dimensione dhe forma
- DIN EN 12365 Aksesorë ndërtimi – Llastikët dhe shiritat e izolimit për dyer, dritare, grila dhe vetrata
Pjesa 1: Kërkesat e performancës dhe klasifikimi
Pjesa 2: Metodatat e testimit të forcës së shtypjes lineare
Pjesa 3: Metoda e testimit të korrigjimit të shmangies
Pjesa 4: Metoda e rikuperimit pas testit të mohimit të përshpejtuar
- Dritaret
- DIN EN 1522 Dritaret, dyert, grilat e jashtme dhe të brendshme –Rezistente ndaj plumbave– Kërkesat dhe klasifikimi
- DIN EN 12051 Aksesorë ndërtimi – Gjuhëzat e dyerve dhe dritareve – Kërkesat dhe metodatat e testimit
- DIN EN 12207 Dritare dhe dyer – Mos përshkueshmëria nga ajri - Klasifikimi
- DIN EN 12208 Dritare dhe dyer – Mos përshkueshmëria nga uji - Klasifikimi
- DIN EN 12210 Dritare dhe dyer – Rezistenca ndaj ngarkesës së erës – Klasifikimi
- DIN 18055 Dritaret; mos përshkueshmëria e ajrit në bashkime, mos përshkueshmëria nga uji dhe tensioni mekanik; kërkesat dhe testimi
- DIN EN 573 Alumini dhe aliazhet e aluminit –Përbërja kimike dhe format e produkteve të përpunuar

15.1.2 CERTIFIKIMI

Çdo njësi dritareje e veçantë duhet të mbajë Etiketën e garancisë së produktit. Raporte të çertifikuar që vërtetojnë që njësia e dritares në fjalë përmbush kriteret, duke përfshirë tipat e testeve, do të jetë e pranueshme në mungesë të etiketimit të produktit.

15.1.3 PARAQITJET

Dorëzimi i të dhënave më poshtë:

Të dhënat e Produktit të dritares, aksesorëve, mbrojtëseve

Shembull i Përfunduar

Shembull Dritareje

Të dhëna disenjimi

Përlllogaritjet për shmangien strukturore

Raportet e Testimeve:

Infiltrimi i ajrit

Infiltrimi i ujit

Klasifikimi i Izolimit Termik & Zonor

Ngarkesa e erës së ndarëseve horizontale dhe vertikale të kanateve Të

dhëna Përdorimi dhe Mirëmbajtjeje

Dritaret, Paketa e të dhënave

15.1.4 SIGURIMI I CILËSISË

15.1.4.1 Kërkesat për vizatimet teknike

Vizatimet duhet të tregojnë lartësinë e dritareve, seksionin në madhësi reale, trashësinë dhe tipin e metalit, mbërthyeset, metoda e propozuar e ankorimit, madhësia dhe distanca ndërmjet ankoruesëve, detaje të ndërtimit, metoda e shkëlqimit, detaje funksionale të aksesorëve, detaje të ndarëseve horizontale, metodat dhe materialet e izolimit ndaj motit, metoda e vendosjes së ekrameve mbrojtës, materialet dhe metodat e fiksimit të nënkornizave, parvazeve, zburimeve, ankoruesëve, detajet e instalimit, dhe informacione të tjera në lidhje me këto.

15.1.4.2 Kërkesat për Shembuj

15.1.4.2.1 Kërkesat për Shembuj të Përfunduar, të parashikohet ngjyra e veshjes përfundimtare.

15.1.4.2.2 Kërkesat për Shembujt e Dritareve

Dorëzoni një dritare në madhësi reale për secilin tip të propozuar për përdorim, të kompletuar me etiketë, shkëlqim, aksesorë mbyllës, ankorues dhe aksesorë të tjerë. Aty ku janë të nevojshëm ekranet mbrojtës ose izolim kundër motit, plotësoni dritaren shembull me këto artikuj që do të përdoren. Pas aprovimit, instaloni secilin prej shembujve në objekt, të identifikuar qartësisht, dhe shënoni vend-ndodhjen e tij.

15.1.4.3 Kërkesat e të Dhënave të Dizajnit

Dorëzoni llogaritje për të arsyetuar përputhshmërinë me kërkesat e shmangies. Llogaritjet duhet të jepen nga një Supervizor Profesional.

15.1.4.4 Kërkesat për Raportet e Testimeve

Dorëzoni raportet e testimeve për secilin tip dritareje që provon faktin që dritare identike janë testuar dhe plotësojnë kërkesat e specifikuar.

15.1.5 DORËZIMI DHE MAGAZINIMI

Dorëzoni dritaret në vendin e zbatimit të projektit të padëmtuara. Kini kujdes në lëvizjen dhe ngritjen e tyre gjatë transportit dhe në kantier. Magazinoni dritaret dhe elementët e tyre larg kontaktit me terrenin, nën një mbulesë rezistente ndaj kushteve të motit, për të parandaluar përthyerjen, shtrembërimin, ose dëmtime të tjera të dritareve. Dritaret e dëmtuara duhet të riparohen deri në shkallën “si të reja” sipas aprovimit. Nëse dritarja nuk mund të riparohet, siguroni një të re.

15.1.6 MBROJTJA

Mbroni sipërfaqet e rafinuara gjatë transportit dhe lëvizjeve duke përdorur metodën standarde të prodhuesit, përveç sipërfaqeve ku nuk do të ketë bojë ose llak në të cilat duhet të ngjisin materialet e stukimit dhe të shkëlqimit.

15.2 PJESA 2 - PRODUKTET

15.2.1 DRITARET

Njësitë e dritareve duhet të përmbushin kërkesat e specifikuar. Elementët e kornizave të dritareve për secilin fletë xhami nuk duhet të shmanget në masën ku kjo shmangie perpendikulare me fletën e xhamit tejkalon tolerancat kur i nënshtrohet ngarkesave uniforme të specifikuar në dizenjimin e presionit. Përlllogaritja strukturore për shmangien duhet të sigurojë përputhjen me kërkesat e shmangies. Siguroni dritare të tipave, klasave të performancës, kombinimeve, dhe madhësive të treguara ose specifikuar. Dizenjoni dritare që të përshtaten me aksesorët, xhamin, mbrojtëset ndaj elementeve të motit, ekraneve mbrojtës, dhe aksesorët e tjerë që do të montohen. Secila dritare duhet të jetë një njësi e kompletuar në fabrikë me ose pa xham të instaluar. Dimensionet janë të treguara në listën e dritareve të përfshira në vizatimet teknike.

15.2.1.1 Dritaret Plastike

15.2.1.2 Dritare kundra zjarrit

15.2.1.3 Xhami dhe Shkëlqimi

15.2.1.2 Stukimi dhe Vulosja

Përdorni vulosësh elastomeric dhe vulosësh kimik për aplikim në ambiente të brendshëm dhe të jashtëm

15.2.1.3 Izolimi ndaj elementëve të motit

Izolimi ndaj elementëve të motit duhet të jetë me vinil, neopren të formuar ose të zgjeruar, ose me etilen të formuar ose të zgjeruar, me neopren dhe polivinilklorid

15.2.1.4 Shiritat e kanatave rrëshqitës

Tuba alumini të vazhdueshëm, me trashësi minimale paret 1.50 mm, me diametër 25 mm, me kapëse alumini të derdhur dhe kapak mbrojtës ose buzë në pjesën e fundit. Ngjyra duhet të përshtatet me dritaret.

15.2.2 DRITARET PLASTIKE

F.V dritare d/alumini plastike me dopio xham me gaz argoni, me prerje termike dhe me izolim akustik, $U=2 \text{ W/m}^2\text{K}$; standart ISO EN 9002

Furnizimi dhe vendosja e dritareve siç pershkruhet ne specifikimet teknike me dimensione te dhena nga kontraktori, perbehen nga material PVC profilet e te cilit jane sipas standarteve Europiane ISO EN 9002. Ngjyra e dritares do te jete sipas kerkeses se investitorit. Boshlleku brenda xhamit dopio duhet te jete 20-24mm.

Sistemet e dritareve PVC duhet te sigurojne ne menyre perfekte izolimin nga ajri dhe uji. Ato duhet te sigurojne nje rezistence nga uji nen 500Pa (te barazvlefshme me shpejtesine e eres prej 150km/ore). Testet per kete duhet te jene ne perputhje me DIN 18055. Koefiçenti I konduktivitetit termal duhet te jete 2.0W (m2K) e cila konfirmon Standartet Europiane. Ne lidhje me izolimin e zerit, dritaret prej PVC duhet te sigurojne izolim ndaj tingujve deri ne shkallen 4 (>40dB).

Korniza fikse e dritares (ndarjet) do te kete nje dimension 74-116mm. Ato jane te siguruar me elemente, qe sherbejne per vendosjen dhe ankorimin ne strukturat e murit si dhe pjeset e dala qe sherbejne per rreshqitjen e skeletit te dritares. Forma e profilit eshte tubolare me qellim qe te mbledhe gjithë aksesoret e saj. Profili i skeletit te dritares do te jete me permasen 25 mm e cila do te mbulohet nga profili kryesor qe do te fiksohet ne mur.

Te dyja korniza fikse ose te levizshme jane projektuar dhe jane ndertuar me fuge ajri qe sherben si thyerje termike. Ato duhet te ofrojne zbatim te Standarteve Europiane te vendosjes se xhamit (Xham tek 4-6mm, xham dopio 20-24mm, xham tresh 24-28 mm), me kullues uji me mbledhes uji, me inklinim 2 grade per te siguruar kullim uji perfekt, mbyllje perfekte nga mbyllesit qendror, trashesi muri qe arrin EN (t-3.1mm), izolim per eren dhe shiun ulluk unik I projektuar per te ndihmuar instalimin e materialeve te gomuar, qe sherbejne per kete qellim. Karakteristikat e ngjitesit kunder agjenteve atmosferike duhet te jene te provuar nga nje testim i çertifikuar i bere, nga prodhuesit e kornizes se dritares ose nga prodhuesit e profileve.

Panelet e xhamit do te jene 4mm te trasha secila dhe me gaz argon ne hapesiren ndermjet tyre. Sipas kerkeses se investitorit, dritaret prej PVC do te jene me xham dopio 24mm

Te gjitha punet e lidhura me rifinituren dhe te gjitha kerkesat e tjera per kompletimin e punes duhet te behen me kujdes.

15.2.2.1 Dritaret e Zjarrit

15.2.3 PËRBËRËSIT

Të mundësohen dritaret plotësisht me të gjithë pajisjet e nevojshme, kapëset, lidhëset, ankorimet dhe pajisjet e tjera të nevojshme për instalimin e plotë dhe operimin e duhur. Të mundësohet alumini i dalë ose nën kuadratin e galvanizuar me secilën dritare.

15.2.3.1 Materialet

Njësia, lloji dhe karakteristikat funksionale duhet të jetë standardi i prodhuesit për atë lloj të veçantë dritareje. Të mundësohet pajisja e përcaktimit të duhur dhe e fuqisë së mjaftueshme për të kryer funksionin për të cilin është krijuar. Të pajisen të gjithë ventilatorët me një pajisje lidhëse ose kyç të cilat mund të sigurohen nga brenda.

15.2.3.2 Lidhjet dhe Ankorat

Të mundësohen ankorat e fshehta të llojit të rekomanduar nga prodhuesi i dritareve për atë lloj të veçantë ndërtimi. Ankorimet dhe lidhëset duhet të jenë të përputhshme me dritaren dhe ndërtimin ngjitur me të. Të mundësohet një minimum prej tre ankorimesh për secilin thep të vendosur 150mm nga secili fund dhe në mesin tyre.

15.2.3.3 Rifinitura

Të ri lyera.

15.2.4 OPERATORËT SPECIAL

Për dritaret të cilat kanë pajisjet operuese ose mekanizmat e mbylljes ose të hapjes të vendosura më shumë se 1,800mm mbi dysheme, të mundësohen operues mbyllës të nevojshëm për operimin e duhur të dritareve.

15.2.5 TË DHËNAT E XHAMIT

Të mundësohet xhami i pastër, trashësia jo më pak se 4 mm aty ku xhamat e brendshëm janë të preferuar.

15.2.6 BASHKIMET METAL-ME-METAL

Të vendosura në mastic, duke përdorur llojin e rekomanduar nga prodhuesi i dritareve për të mundësuar bashkimet ndaj motit. Të hiqet mastici i tepërt para se ai të forcohet.

15.2.7 AKSESORËT

Të mundësohen dritaret me materiale, kapëse, ankorime, dhe materialet e nevojshme për instalimin e plotë dhe operimin e ventilatorëve.

15.2.7.1 Ankorimet

Të përdoren ankorat e çelikut të galvanizuar me të nxehtë. Të vendosen ankorat dhe kapëset tek kokat dhe pragjet e dritareve dhe të lidhen në mënyrë të sigurt me dritaret ose kornizat. Të përdoren ankorat e rekomanduara nga prodhuesi i dritareve për llojin specifik të ndërtimit dhe fshehjen e tyre. Të ankorohet secila kornizë me një minimum prej tre ankorimeve të rregullueshme prej çeliku.

15.2.7.2 Materialet

Të pajisen të gjitha rripat me mjete mbyllëse të cilat mund të sigurohen nga brenda. Sendi, lloji dhe funksioni i materialeve të kërkuara specifikohet nën llojin e veçantë të dritares. Të lidhen materialet në mënyrë të sigurt tek dritaret me bulona kundër oksidimit ose vida; të mos përdoren vidat për fletët metalike.

Në grilat e fiksuara, të adaptohen pajisjet për të lejuar operimin e ventilatorëve.

15.2.8 RIFINITURA E DRITAREVE

15.2.8.1 Përfundimet si në Fabrikë

Dritaret kimikisht të pastruara dhe të lidhura. Lyerja me zhytje të shtresës së dorës së parë të ngjitësit të vendosur në furrë për jo më pak se 15 minuta në jo më pak se 149 gradë C e ndjekur nga një shtresë e përfunduar nga enameli alkid-amin prej jo më pak se 0,025mm një milimetër trashësi, e vendosur në furrë për 15 minuta në jo më pak se 149 gradë C.

Të përfundohet lyerja me bojë e cila të zgjidhet nga treguesi standard i ngjyrave të dhëna nga prodhuesi.

15.3 PJESA 3 - EKZEKUTIMIT

15.3.1 INSTALIMI

15.3.1.1 Metoda e Instalimit

Te instalohet në përputhje me udhëzimet e printuara të prodhuesit dhe detajet. Të ndërtohen dritaret ndërsa puna vazhdon ose të instalohen pa forcë në hapjet e dritareve të përgatitura. Një nënshtresë e fortë alumini në metal tubular të galvanizuar do të vendoset me kujdes me kapëse çeliku tek muret duke përdorur llac çimentoje (pa vida). Kapëset duhet të kenë një distancë nga cepat prej jo më shumë se 150mm në një hapësirë se jo më shumë se 800mm. Korniza e vendosur e dritares do të vidhoset me nënshtresën pasi të mbarojë e gjithë puna me llaç e fino. Të vendosen dritaret në lartësinë e duhur, vendndodhjen dhe daljen; plumbçi, niveli dhe drejtimi si dhe kapja të parandalojnë prishjen dhe keq vendosjen. Të instalohen dritaret në një mënyrë të cilat parandalojnë futjen e ujit dhe erës. Të lidhen rrjetat kundër insekteve në vend aty ku specifikohet. Hapja e paneleve prej xhami do të jetë me mentesha tek korniza dhe do të mundësohet e tillë nga një sistem ankorimi me tre mentesha dhe me bravë e kyç.

Duke përdorur materialet plastiko-elastike, pasi është mbushur çdo hapësirë me materiale izoluese, do të kryhet mbushja ndërmjet kasave dhe godinës. Në brendësi të kornizës tubolare dhe pjesës së jashtme të alumini të ruhet një tolerancë instalimi prej 6mm, duke konsideruar një dalje te elementeve fiksuës prej rreth 2mm.

15.3.1.2 Materialet jo të Njëjta

Aty ku sipërfaqet e aluminit janë në kontakt me ose të lidhura me muraturen, betonin, drurin ose metale jo të njëjta, përveç çelikut të pa oksidueshëm ose zinkut, sipërfaqja e aluminit duhet të ruhet nga materialet jo të njëjta. Sipërfaqet në kontakt me mbushësit pas instalimit nuk duhet të jenë të lyera me ndonjë lloj materiali mbrojtës.

15.3.1.3 Ankorimet dhe Lidhjet

Të mundësohen njësitë siguroese më njëra tjetrën, si dhe tek ndërtimi. Dritaret e instaluar tek muret duhet të kenë pjesët e përcaktuara në ndërtimin jo më pak se 11mm.

15.3.2 PASTRIMI

Të pastrohen sipërfaqet e brendshme dhe të jashtme të dritareve nga allçia ose fino, pikat e bojës dhe ndonjë material tjetër për të prezantuar një paraqitje të pastër, për të parandaluar prishjen e sipërfaqeve, rezistente ndaj motit, dhe të parandalojë ndërhyrjen me veprimin e materialeve. Të zëvendësohen të gjitha

dritaret e gërryera, të njolloosura, me ngjyrë tjetër të cilat nuk mund të restaurohen në kushtet e tyre origjinale me dritare të tjera.

Poljester me ngjyrë RAL

16. PUNIME METALIKE

16.1 PJESA 1 - TË PËRGJITHSHME

16.1.1 REFERENCA

Publikimet e renditura më poshtë formojnë pjesë të këtij specifikimi deri në atë masë që është referuar. Publikimet e referuara në këtë tekst vetëm në përcaktimin bazë.

16.1.1.1 Ligjet dhe normativat e zbatueshme shqiptare

16.1.1.2 Normat dhe ligjet evropiane të zbatueshme

16.1.2 DORËZIMET

Dorëzoni dokumentet e mëposhtme:

Skicat për gardhet dhe portat

Të dhënat e komponentëve të produktit

Aksesorët

Raportet e testimeve

Pesha në gram për veshjen me material zinku

Certifikatat

Udhëzimet e prodhuesit

16.1.3 FURNIZIMI, MAGAZINIMI DHE TRAJTIMI

Dorëzoni materialet në vendin e punimeve në gjendje të padëmtuar. Magazijoni materialet në lartësi nga toka për të siguruar mbrojtje nga oksidimi që shkaktohet nga kontakti me tokën.

16.2 PJESA 2 - PRODUKTET

16.2.1 GARDHI DHE AKSESORËT

16.2.1.1 Shtyllat vertikale

Shtylla vertikale në çelik të veshur me zink, min. 50x50 mm, 3 mm shtresë. Përmasat dhe lartësia siç tregohet dhe detajohet te skicat.

16.2.1.2 Portat

Lloji, me një hapje, me dy hapje, me rrëshqitje me një rrotë, Forma dhe përmasa e materialit të kornizës së portës, e ngjashme me gardhin siç tregohet. Korniza e portës dhe mbajtëset me përmasa minimale duhet do të jenë 50 mm, 3 mm trashësi minimale të murit Kanatat e portës më shumë se 2.4 m të gjera do të kenë elemente të ndërmjetme e nevojshme për të siguruar konstruksion të qëndrueshëm, pa epje apo përdredhje. Kanatat e portës më pak se 2.4 m të gjera do të kenë shufra lidhëse apo mbajtëse të ndërmjetme. Bashkëlidhni elementet e portës me kornizën e portës në përputhje me standardet e

prodhuesit, përveç se saldimi nuk lejohet. Vendosini rezet për drynin në mënyrë të tillë që të jenë të aksesueshme nga të dyja anët e portës, pavarësisht funksionimit të rezesë.

16.2.1.3 Aksesorët e gardhit

Siguroni lidhje me tela të ndërtuara nga i njëjti material si ai i gardhit.

16.2.1.4 Betoni

Siguroni sipas specifikimeve në Seksionin "STRUKTURA BETONI TË HEDHURA NË VEND"

16.2.1.5 Llaç fino

Siguroni fino sipas proporcioneve një pjesë çimento Portland dhe tre pjesë rërë të pastër, të mirë-granuluar dhe një sasi minimale uji për të prodhuar një mix të punueshëm.

16.3 PJESA 3 - EKZEKUTIMI

16.3.1 PËRGATITJA E VENDIT KU DO TË KRYHEN PUNIMET

16.3.1.1 Pastrimi dhe gradimi

Pastroni pemët, shkurret apo pengesa të tjera në linjën e gardhit, për të mundësuar instalimin e gardhit. Vendosni një linjë të graduar dhe kompakte të gardhit para instalimit të tij. Mbushje kompakte për të vendosur linjën e gardhit.

16.3.1.2 Gërmimi

Gërmoni në përputhje me përmasat e treguara për njësitë që do të ngrihen të vendosura në beton. Largoni të gjitha materialet mbeturina nga kantieri, sipas udhëzimeve.

16.3.2 INSTALIMI I GARDHIT

Instalojeni gardhin mbi sipërfaqet e përgatitura, sipas linjës dhe gradës së treguar. Siguroni që lidhjet dhe menteshat të jenë në vendin e duhur në kornizën e gardhit, me anë të përthyerjes ose saldimit.

16.3.2.1 Pllaka betoni dhe Muret

Siguroni baza betoni sipas përmasave të treguara. Kompaktësoni betonin për të eliminuar hapësira boshe, dhe përfundoni siç tregohet në skica. Lejoni që betoni të konsolidohet për të paktën 72 orë para se të kryeni punime të tjera.

16.3.2.2 Distancat dhe vendosja e shtyllave vertikale

Shtyllat vertikale duhen vendosur në hapësira të baraslanguara, siç tregohet në figurë, po jo më larg se 170mm. Vendosini shtyllat vertikale në nivel. Vendosini shtyllat vertikale në këllëfë të veshur me zink, të vendosura në mur betoni, në thellësi minimale prej 300 mm.

16.3.2.3 Elementet e gardhit

16.3.2.4 Instaloni elementet e gardhit nëse është e nevojshme. Kalojini elementet nëpër shtyllat e ndërmjetme vertikale. Siguroni kanxha për zgjatim.

16.3.3 INSTALIMI I AKSESORËVE

Kapuçë për shtyllat vertikale
Instaloni kapuçë për shtyllat sipas rekomandimeve të prodhuesit.

16.3.3.1 Portat

Instaloni porta me hapje në 180 gradë nga pozicioni mbyllur në hapur. Instaloni porta me rrëshqitje të plotësuara me rrota dhe shina.

16.3.4 PASTRIMI

Largoni mbeturinat e materialeve të përdorura për gardhin si dhe mbeturina të tjera nga kantieri.

17. PUNIME SISTEMIMI TË

JASHTME RRUGËKALIMET DHE

TROTUARET

17.1 PJESA 1 –E PËRGJITHSHME

17.1.1 REFERENCAT

Botimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi në sasinë e marrë si referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm më përcaktimin e tyre bazë.

17.1.1.1 Normat dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare

17.1.1.2 Normat dhe Standardet Evropiane

DIN 18315 Procedurat e kontraktimit për punimet e ndërtimit - Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për punimet e ndërtimit; Punimet e ndërtimit për vijat e trafikut, shtresat e sipërme pa lidhëse

DIN 18316 Procedurat e kontraktimit për punimet e ndërtimit - Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për punimet e ndërtimit; Punimet e ndërtimit për vijat e trafikut, shtresat e sipërme me lidhëse hidraulike

DIN 18317 Procedurat e kontraktimit për punimet e ndërtimit - Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për punimet e ndërtimit; Punimet e ndërtimit për vijat e trafikut, shtresat e sipërme të asfaltit

DIN 18318 Procedurat e kontraktimit për punimet e ndërtimit - Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për punimet e ndërtimit; Punimet e ndërtimit për vijat e trafikut, trotuaret dhe rrugëkalimet me pllaka

DIN EN 1338 Bllloqet e betonit për rrugëkalime – Metodat e kërkesave dhe testimeve.

DIN EN 1339 Shpatoret e betonit – Metodat e kërkesave dhe testimeve .

DIN EN 1340 Njësitë e trotuareve prej betoni; Metodat e kërkesave dhe testimeve.

DIN EN 1342 Setet e gurit natyral për shtrimin e jashtëm - Metodat e kërkesave dhe testimeve

DIN EN 1343 Trotuaret e gurëve natyral për shtrimin nga jashtë - Metodat e kërkesave dhe testimeve

17.1.2 KËRKESAT E PËRGJITHSHME

Shtrimi duhet të përbëhet nga një seksion shtrimi me thellësi të plotë ose aplikim të agregateve të mineraleve të nxehta në mënyrë uniforme të përzier me materialin e nxehtë bituminoz mbi shtresa në zhavorrin e nivelit të përzier me çimento nën shtresë në zhavorrin e shkallës së përzier. Vendosni pllakat dhe rrugëkalimet siç tregohet.

17.1.2.1 Konferenca Para Ndërtimore

Të kryhet para se të fillojë veprimi i sharimit për të konfirmuar punimet e kullimit, rrjedhën e trafikut dhe kontrollin, sekuençën e punimeve të shtrimit, fillimin dhe ndalimin e punës, kërkesat për shenjat e sigurisë dhe barrikadat dhe ndonjë ndalesë tjetër ndërtimi e cila duhet marrë në konsideratë.

17.1.2.2 Rrugëkalimi

Para se të fillojnë operacionet e shtrimit duhet patur nën veshim:
Asnjë pengesë ose mjete të lëna të mos ndalojnë operacionet e shtrimit;
Përgatitja e kërkuar e sipërfaqes të jetë kryer dhe zona të jetë e gatshme për ekzekutimin e nën shtresës, dhe sipërfaqes prej bitumeni.

17.1.3 PËRCAKTIMI I TERMAVE

Nënshtresë: themelet ekzistuese ose të tokës mbi të cilën ndërtohet trotuari
Shtresa e poshtme: për rrugët me thellësi mesatare prej 30.0 cm të zhavorrit të shkallës së përzier ndërmjet shtresave të agreguara dhe të nën shtresave
Shtrese mbushese: thellësia 30.0 cm. Shtresa me zhavorr të shkallës së përzier menjëherë poshtë shtreses bituminoze ngjithëse të betonit.
Shtrese bituminoze binder: thellësia 5.0 cm
Shtrese bituminoze betoni menjëherë poshtë shtreses veshese bituminoze
Shtrese veshese bituminoze e betonit: thellësia prej 3cm
Shtresa bituminoze prej betoni për të përfunduar shtrimet si një shtresë e sipërme mbajtëse e trafikut Shtresa bituminoze prej betoni për të përfunduar shtrimin e rrugës si shtresa e sipërme e cila mban trafikun. Nënshtresa për rrugëkalimet në shtresën e zhavorrit me thellësinë 20 cm dhe e derdhur në vend 10 cm e përforcuar me rrjetë çeliku të elektrosaldur 10x10 cm d. 4mm.
Rrugë kalimi në beton të para fabrikuar me thellësinë 6 cm në shtresën 50 mm me rërë të thatë.
Rrugëkalimi për këmbësorët në thellësinë prej 10cm në beton për rrugëkalimin

17.1.4 PARAQITJET

17.1.4.1 Shembujt

Te paraqiten shembujt e materialeve sipas udhezimeve nga Mbikëqyrësi, (b) duke parë shembujt e duhur të sigurohen certifikatat e përputhshmerise për secilën nga materialet e listuara më poshtë me miratimin nga Mbikëqyrësi:

Granulimi i perzjerjes

Granulimi i perzierjes se stabilizantit

Mbushesit (2 kg për çdo madhësi mbushesi nga secili burim)

Materiali bituminoz katër (4) litra

Trotuaret e parafabikuara

Materialet për trajtimin e betonit për trotuar

Boja shënjuese e trotuarit.

17.1.4.2 Certifikatat

Paraqitni një certifikatë për secilën dërgesë të materialeve të bitumenit të përdorura në përzierje. Paraqitni një certifikatë për bojën shënjuese të trotuarit.

17.1.4.3 Raportet e Testeve

Para se të dërgohen materialet, kopje të certifikuara në triplikat e raporteve të të gjitha testeve të kërkuara këtu tek materialet dhe tek publikimet e marra si referencë duhet të paraqiten për miratim. Testim shtesë duhet të paraqitet kur materiali burimor ndryshohet.

Paraqitni një raport të testit të certifikuar si më poshtë:

Përzierjet e grimcave

Përzierjet e grimcave të stabilizuara

Përbërësit e Mineraleve

Materialet e Bitumenit

Betoni

17.1.5 DËRGIMI DHE RUAJTJA

17.1.5.1 Dërgimi dhe ruajtja e materialeve për trotuaret prej betoni dhe shtrezave (përveç betonit të para përgatitur)

Materialet e paketuara duhet të dërgohen në kantier në paketimin e tyre origjinal të pahapur ose me kontenierët të cilët kanë etiketën e prodhuesit të cilat identifikojnë qartësisht emrin e prodhuesit, emrin tregtar, materialin peshën ose volumin dhe ndonjë informacion tjetër të rëndësishëm dhe të ruhen në paketimin e tyre origjinal në një vend të thatë i cili nuk preket nga moti. Agregatet e pa pakeluar duhet të ruhen në mënyrë të tillë që të shmanget ndarja e tepërt ose ndotja e materialeve të tjera ose madhësive të tjera të përbërësve. Të ruhen përforcimet e formave dhe madhësive të ndryshme në ndarje të veçanta të ngritura mbi tokë për të shmangur oksidimin e tepërt. Të ruhen nga ndotësit si graso, vaji ose papastërtitë. Të sigurohet identifikimi i saktë pasi shumat të copëtohen dhe etiketat të hiqen.

17.1.5.2 Dërgimi dhe ruajtja e përzierjes bituminoze

Të inspektohet çdo ngarkesë e përzierjes së bitumenit në kantier për gamën e saktë të temperaturës dhe të shmangen të gjitha ngarkesat të cilat vijnë në kantier që nuk përmbushin kërkesat e temperaturave. Jo më shumë se një ngarkesë duhet të jetë duke pritur radhën dhe temperatura e përzierjes në ngarkesën në pritje, duhet të verifikohet ndërsa plotëson limitet e kërkuara për përdorim. Çdo ngarkesë e cila ka kohë që qëndron në pritje për tu shkaktuar, shkakton ftohje të temperaturës së pranueshme të ngarkesës, nuk duhet pranuar.

17.1.5.3 Materialet markues të bojës

Materialet të cilat shënojnë bojën duhet të dërgohen dhe ruhen në kontenierë të mbyllur të cilët qartazi tregojnë emërtimin, formulën ose numrin e specifikuar, numrin e partisë, ngjyrën datën e prodhimit dhe të gjitha udhëzimet të cilat duhet të jenë dukshëm të lexueshme në kohën e përdorimit.

17.1.6 KONTROLLI I TRAFIKUT:

Trafiku i mjeteve nuk do të lejohet mbi shtresën e shtruar deri sa temperatura e sipërfaqes të jetë ftohur në te paktën 50 gradë Celsius dhe të jetë arritur shtresa e fundit e kërkuar dhe ngjeshja. Temperatura e sipërfaqes duhet të matet nga termometra të miratuar sipërfaqeje. Të vendosen barrikadat dhe shenjat paralajmëruese pranë fillimit të punimeve në kantier dhe përreth zonës së projektit për të paralajmëruar trafikun e këmbësorëve dhe operacionet e ndërtimit si dhe pengesat.

Përdorimi i materialeve me shumë ngjyra të cilat mund të fryhen lehtësisht nga era, nuk lejohet si barrikadë. Përdorni barrikadat dhe shenjat paralajmëruese të cilat do të kryejnë funksionin e tyre edhe pas orëve të natës.

17.1.7 KUFIZIMET E MOTIT

17.1.7.1 Nivelimi, binderi dhe shtresat e përdorshme

Te vendoset përzjerja e bitumenit vetëm gjatë motit të thatë dhe në sipërfaqe të thata. Të hidhen shtresat vetëm kur temperatura e sipërfaqes se shtresës së më poshtme është më e madhe se 7 Gradë Celsius për trashësi shtrese më të madhe se 2.5 cm dhe 12 gradë C për trashësinë e shtresës prej 2,5 cm ose më pak.

17.1.8 SHEMBUJ DHE TESTIMET

Te kryhen teste të nënshtresës dhe përzjerjet e bazës gjithashtu, për ti konfrontuar me nivelin e specifikuar të cilësisë.

17.1.8.1 Testimi i përzjerjes bituminoze

Te kryhen testet e kërkuara në përzjerjen bituminoze për përbushje të përbërësve specifik të asfaltit dhe klasen. Përzjerjet të cilat nuk janë konform duhet të mos pranohen.

17.1.8.2 Testimi i betonit për trotualet

Testet e sipërfaqes

Pas trajtimit, të testohet sipërfaqja e shtruar më një mastar (gjatësi minimale 3m) të cilat do të tregojnë ndonjë parregullsi në sipërfaqen e betonit. Të zëvendësohet betoni, mekanikisht të kruhet sipërfaqja e betonit, ose të korrigjohet sipërfaqja sipas miratimit të çdo pjese të shtresës e cila tregon rregullsi më të mëdha se 3mm në 3m, ose rregullsi në një drejtim transversal më të madh se 6mm në 3m.

17.2 PART 2 - PRODUKTET

17.2.1 UJI

Duhet të jetë i butë, i pijshëm dhe pa material inorganik ose përbërës sulfati klorhidrik të cilët tejkalojnë përqindjet e treguara. Uji duhet të jetë pak alkaline me PH ndërmjet 6 dhe 8, nuk duhet të përfshijë më shumë se 2 pjesë për 100, me peshë, me shtypje të materialit dhe jo më shumë se 15 pjesë për 100, me peshë e materialit në shkrire. Nuk duhet të përmbajë lëndë organike ose në të ose të tretura. Sulfati nuk duhet të jetë më shumë se 1 pjesë për 1000 nga pesha. Uji i detit është i ndaluar.

17.2.2 GRANULOMETRIA E GRIMCAVE

Për ndërtimin e nënshtresës së rrugës do të jetë e nevojshme të përdoret një përzjerje e materialeve të granuluar, duke filluar me baltën 0.074mm dhe deri në gurët e shtypur të zhavorrit me dimensione

maksimale prej 50mm. Shkalla duhet të përmbahet ndërmjet limiteve të kurvës të përcaktuar nga linja Talbot. Shtresa duhet të ketë një indeks plasticiteti ndërmjet 6 dhe 9 (përveç situatave të caktuara, në bazë të mbikëqyrjeve laboratorike të cilat shtojnë limitin maksimal që mund të shtohet deri në 10), jepni një garanci që shtresat e mësipërme të mos ndahen, në një mënyrë për të marrë një argjilë betonit me strukture të duhur gurësh. Në fund duhet të ketë një limit likuiditeti prej 35 dhe një CBR (Gama Mbajtëse Kaliforniane). Përthithja prej 2,5 mm dhe penetrimi jo më pak se 50%. Trashësia e shtresës së stabilizuar do të përcaktohet në marrëdhënie me ngarkesën e nënshtresës dhe të ngarkesave të cilat duhet të mbahen nga trafiku mbi to (maks. Kg 8/m²) i kryer nga një CBR, test goditjeje në një shembull të ngjeshur më parë nga metoda e Proctorit.

17.2.2.1 Niveli i pranueshmërisë së agregateve

Fraksioni >4mm		
C. Los Angeles (LA)	% □	40
Dimensioni Maksimal (Dmax)	mm	63
Ndjeshmëria ndaj akullit(G)	% □	30
Fraksioni □4mm		
Limiti i Ujit (LU)	% □	35
E barazvlefshmjia në ujë	% □	40
Treguesi i plasticitetit	% □	6
Kalimi i sitës me madhësi 0,075	6	

17.2.3 GRANULIMI I PERZJERJES TE STABILIZANTIT ME CIMENTO

Për ndërtimin e nënshtresës së rrugës do të jetë e nevojshme të përdoret një përzierje e materialeve me grimca, duke filluar me baltën 0.074mm dhe deri në gurët e shtypur të zhavorrit me dimensione maksimale prej 50mm. Shkalla duhet të përmbahet ndërmjet limiteve të kurvës të përcaktuar nga linja Talbot. Shtresa duhet të ketë një indeks plasticiteti ndërmjet 6 dhe 9 (përveç situatave të caktuara, në gjatë mbikëqyrjeve laboratorike të cilat shtojnë limitin maksimal që mund të shtohet deri në 10), të sigurohet që shtresat e mësipërme nuk do të ndahen, në një mënyrë për të arritur baltë e betonit me skelete të duhura gurësh. Në fund duhet të ketë një limit lëngu prej 35 dhe një CBR (Gama Mbajtëse Kaliforniane). Përthithja prej 2,5 mm dhe penetrimi jo më pak se 50%. Trashësia e shtresës së stabilizuar do të përcaktohet në përputhje me ngarkesat e trafikut (maksimumi Kg 8/m² i kryer nga gomat pneumatike të kamionëve të mëdhenj) të kryer nga një test CBR, test goditjeje në një shembull të ngjeshur më parë nga metoda e Proctorit.

17.2.3.1 Niveli i cilësisë së pranueshme

Fraksioni >4mm		
C. Los Angeles (LA)	% □	40
MicroDeval Umida (MDU)	% □	35
Dimensioni Maksimal	mm	30
Ndjeshmëria ndaj Akullit	% □	30
Kalimi në sitë me madhësinë 0,075	% □	2

Fraksioni 0,075-4 mm

Limiti i Ujit % 35

E barazvlefshmja në Rërë % 35

Treguesi i Plasticitetit % 6

17.2.3.2 Cimento per stabilizantin

Çimento e përdorur do të jetë konform DIN EN 206. Çimento duhet të dorëzohet në thasë të mbyllur.

17.2.4 PËRZIERJA E NXEHTË BITUMINOZE

17.2.4.1 Agregatet

Për trajtimin bituminoz të sipërfaqes dhe ndërtimin e kurseve lidhëse; duhet të jetë e nevojshme të përdorni një përzierje e mjaftueshme që duhet të konsistojë në gurin e shtypur, zhavorrin e shtypur, rërën dhe mbushësit minerale. Agregatet e shkallës dhe proporcionit mbushës në mënyrë që agregatet minerale të përmbushin gradimet e specifikuara këtu. Mbushësi mineral dhe agregatet e butë duhet të gradohen në të njëjtin karakter që kur ato të kombinohen, një përzierje do të prodhohet që të përmbushë kërkesat e specifikuara këtu. Gurët ose zhavorri i cili duhet shtypur duhet të dalë si rezultat i gurëve metamorfik ose të strukturës mikrokristaline, ose prej silikoni ose të pathyeshëm, pa dalje me fuqi të lartë shtypëse. Produktet e gurëve të shtypur ose zhavorrit duhet të jetë i përbërë nga pjesëza të pastra dhe të durueshme dhe materialeve të huaja. Copëzat nuk duhet të kenë më shumë se një anë të rrumbullakët, të paktën dy anë të fraktuara dhe duhet të jenë të një natyre të tillë të përbërësit bituminoz i cili nuk do të hiqet nga volumi i lartë i trafikut. Përbërja e lagështisë duhet të jetë e tillë që të gjitha copëzat të jenë thjeshtësisht të lyera me përbërësin bituminoz. Tharja duhet të kryhet në bazë të kërkesave ose udhëzimeve.

17.2.4.2 Niveli i pranueshmërisë së agregateve bashkues

Fraksioni >4mm

C. Los Angeles (LA) % 40

MicroDeval Umida (MDU) % 35

Dimensioni Maksimal 2/3 trashë. (Dmax) mm 30

Ndjeshmëria e Akullit % 30

Kalimi në një sitë me madhësinë 0,075 2

Fraksioni 0,075-4 mm

E barazvlefshmja në rërë % 40

Kalimi në një sitë me madhësinë 0,075 3

Mbushësi

Kalimi në një sitë me madhësinë 0,18 % 100

Kalimi në një sitë me madhësinë 0,075 % 80

Hapësira Rigden V % 35-40

17.2.4.3 Niveli i pranueshmërisë së agregateve të kursit

Fraksioni >4mm

C. Los Angeles (LA) % 25

MicroDeval Umida (MDU) % 20

Dimensioni Maksimal \square 1/2 trashe. (Dmax)	mm	20
Ndjeshmëria ndaj Akullit(G)	% \square	30
Kalimi në një sitë me madhësinë 0,075		2
Fraksioni 0,075-4 mm		
E barazvlefshmjia në rërë(ES)	% \square	40
Kalimi në një sitë me madhësinë 0,075	% \square	
3 Mbushësi		
Kalimi në një sitë me madhësinë 0,18	%	100
Kalimi në një sitë me madhësinë 0,075	%	80
Hapësira Rigden V	%	30-45

17.2.4.4 Materiali Bituminoz

TABELA I: PERQINDJA E MATERIALEVE BITUMINOZE (ME PESHË)

Materialet Bituminoze	Shtresa e Nivelimit	Shtresa Lidhëse	Shtresa e punueshme
Asfalt	4-5	4-6	6-8
Asfalt i prerë	4-5	4-6	6-8
Asfalt i emulsifuar	4-5	4-6	6-8
Çimento Asfalti	4-9	4-9	5-10

17.2.4.5 BORDURAT E TROTUAREVE DHE RRUGËKALIMEVE

Bordurat do të jenë prej betoni vibrues te parafabrikuar me sipërfaqe të lara, seksioni i këtij materiali do të jetë në dimensione kuadrate 6x20cm.

17.2.5 BETONI I DERDHUR NË KANTIER PËR RRUGËKALIMET

Trotuari do të kryhet me beton të rezistencës normale Rck 20N/mm², Klasi 1 (atmosferë e thatë me lagështi relative më pak se 70%), dimensionimi maksimal i materialeve inerte të baras vlefshme me 30mm, të baras vlefshmet e hedhjes në 3S (gjysmë lëng), A/C marrëdhënia më pak se ose e barabartë me 0.65.

17.2.6 PAJISJET E NDËRTIMIT

Të mundësohen pajisje të mira dhe të duhura për qëllimet e punës dhe të mirëmbahen në kushte të kënaqshme operuese gjatë të gjithë kohës. Pajisjet e kalibruara si shpërndarësit e asfaltit, shkallëzimet, pajisjet ndarëse, përhapësit dhe pajisjet e tilla, të cilat duhet të jenë ri kalibruar nga një laborator i miratuar kalibrimi brenda 12 muajsh para se të fillohen punimet (dhe çdo 12 muaj qe nga ai moment, nga ai laborator që ka kryer datën e ri kalibrimit, gjatë termave të kontratës).

Gërryesi i motorizuar –ata duhet të jenë të motorizuar, të furnizuar me goma me trashësi baze prej më pak se 4m. Pajisjet sperkatese të përbëra nga kamionët e shpërndarjes së ujit duke përdorur një shufër sperkatese të ujit në mënyrë uniforme dhe në sasi të ndryshme dhe të kontrolluara.

Ngjeshësi i dheut i përbërë nga:

Rulat: me cilindra të thjeshtë ose të dyfishtë për të ngjeshur materialet e treguara. Të drejtuar ashtu siç duhet për të ngjeshur materialet e treguara. Të drejtuar sipas kërkesës nga Drejtori i Punimeve.

Shtypësi Mekanik: të furnizuar me goma të tërhequra nga një traktor me goma

Shtypësit me dorë: Minimumi i peshës prej 12 kg me kokë shtypëse prej jo më shumë e 300 cm²; duhet të përdoret në zonat ku nuk mund të shkojnë pajisjet me rryla.

Rryli vibrues: me kapacitetin për të zhvilluar një ngarkesë të ndryshme statike ndërmjet njëmin 300Kg dhe 1,300Kg

